



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I SHKODRËS “LUIGJ GURAKUQI”**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE**  
**INSTITUTI I STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE**

**Tezë për mbrojtjen e gradës**  
**“Doktor i shkencave në gjuhësi”**

**TEMA: TOPONIMIA DHE ANTROPONIMIA E GJAKOVËS ME RRETHINË**  
**( Shqyrtime etnolinguistike )**

**Punoi:**  
**shkencor :**

**MND në Gjuhësi Zeki Morina**  
**Shkurtajt**

**Udhëheqës**

**Akad. prof.dr. Gjovalin**

**Shkodër, 2017**

## DOKTORATË

---

Përgatitur nga: **MND në Gjuhësi Zeki Morina**

Për mbrojtjen e gradës shkencore: **“Doktor” në Gjuhësi**

Specialiteti: **Gjuhësi**

Fusha e vaçantë: **Onomastikë - Sociolinguistikë**

Titulli: **Toponimia dhe antroponimia e Gjakovës me rrethinë**

(Shqyrtime etnolinguistike )

Udhëheqës shkencor: **Akad. prof. dr. Gjovalin Shkurtaç**

Mbrohet më: **4 dhjetor 2017** para jurisë:

1. **Prof. dr. Mimoza Prik** - profesor oponent / \_\_\_\_\_ /
2. **Prof. dr. Tefë Topalli** - profesor oponent / \_\_\_\_\_ /
3. **Prof. dr. Artan Haxhi** - kryetar / \_\_\_\_\_ /
4. **Prof. asociuar dr. Rrezarta Draçini** - anëtare / \_\_\_\_\_ /
5. **Akad. prof.dr. Gjovalin Shkurtaç** - anëtar / \_\_\_\_\_ /
6. **Prof. dr. Hasan Mujaj** - anëtar / \_\_\_\_\_ /
7. **Prof. dr. Xheladin Zymberi** - anëtar / \_\_\_\_\_ /

**Shkodër, 2017**

## **ABSTRAKT**

Materiali i parashtruar në këtë punim përbën sintezën e një pune shkencore afër pesëvjeçare. Ky studim synon të japë informacione shpjeguese, për të njohur më mirë lexuesin për onomastikën dhe përbërjen e saj në dy grupe të mëdha emrash: **a/.** emrat e njerëzve apo emrat vetjakë (**antroponimet**) dhe emrat familjarë përkatës të tyre (**patronimet**) dhe **b/.** emrat e vendeve (**toponimet**), të cilat, duke qenë të shumta dhe të ndryshme, mund të grupohen edhe sipas ndarjeve të tjera: **oikonimet** apo emrat e vendeve të banuara (qytete, qyteza, katunde, lagje etj.); si pjesë e tyre mund të shihen edhe **etnonimet** apo emrat e shteteve, kombeve, kombësive, krahinave, nënndarjeve administrative e shoqërore të ndryshme; **hidronimet** apo emrat e ujërave (dete, lumenj, liqene, kënetë, përrenj, hudhra etj.), **oronimet** apo emrat e maleve, fushave, kodrave etj. që janë në përputhshmëri të plotë me studimin e temës: **Toponimia dhe antroponimia e Gjakovës me rrethinë (Shqyrtime etnolinguistike)**. Në vazhdimësi nga ato që u thanë më lartë po paraqesim shkurtimisht duke parashtruar se Toponimet dhe antroponimet janë emra të përveçëm dhe, si të tillë, **kanë të përbashkët burimin e tyre kryesisht nga emra të përgjithshëm** (apelativa).

Kjo dukuri është universale për të gjitha gjuhët e botës, prandaj edhe studiuesit e vendeve të ndryshme, si edhe albanologët e gjuhëtarët shqiptarë për shqipen, kanë vënë në dukje se sa të ndërlikura e të pleksura me njëra tjetrën janë kudo toponimet dhe antroponimet me emrat e përgjithshëm. Po nisemi nga një shembull krejt i thjeshtë: nga emri i përgjithshëm pëllumb, -i ka dalë emri i përveçëm, i përdorur aq dendur gjithandej në trojet shqiptare: Pëllumb,-i (geg.Pllum, -i), i vënë për të shënuar edhe dëshirën që “djali të bëhet i bukur si pëllumbi”. Po kështu edhe në gjininë femërore Pëllumbeshë,-a. Mirëpo nga emri pëllumb kanë dalë edhe emra vendesh si Pëllumbari (fshat në rrethin e Përmetit). Nga emri zog, -u janë formuar antroponimet Zog, -u dhe Zog (ë), -a, të përdorur si në Veri ashtu edhe në Jug.

**Fjalë kyçe:** *antroponimet, patronimet, toponimet, oikonimet, etnonimet, hidronimet, oronimet.*

*The toponymy and anthroponymy of Gjakova and its region*

*( Ethno-linguistic  
reviews )*

---

**ABSTRACT**

The material presented in this paper is a result of synthesis of a scientific work for about 5 years. This study aims to offer explanations to make the reader more familiarized with onomastic and its consistence into two main noun groups: **a)** names of the people or proper nouns (**anthroponyms**) and their respective family names (**patronyms**), and **b)** names of locations (toponyms), which as being in a large amount and different as well, might be listed according to other groups, such are: names of the inhabited locations (towns, small towns, villages, neighborhoods, etc); in this light it can also be **ethnonyms** or names of countries, nations, nationalities, provinces, different administrative and social subdivisions, etc; **hydronyms** or names of bodies of water (seas, rivers, lakes, marshes, streams, etc); **oronyms** or names of mountains, fields, hills, etc which are in a full accordance with the thesis: **Toponymy and anthroponymy of Gjakova and its region (Ethno-Linguistic reviews)**. Further to this, as follow is briefly presented the fact that Toponyms and Anthroponyms are proper nouns, and as such, **they have in common their root mainly from common nouns (appellatives)**.

This occurrence is universal to all world's languages, therefore many foreign scholars as well as Albanian linguists have emphasized the huge complexity of toponyms and anthroponyms with common nouns. Let us have a very simple example: from the common noun "pëllumb" (English translation: pigeon) – has derived a proper noun which is widely used in all Albanian regions: Pëllumb, - i, (in Gegë dialect: Pllum,-i), it is used to express the wish (of someone), for example: "May the boy be handsome like a pigeon". It is the same case with feminine gender such as "Pëllumbeshë,-a". However, from the noun "pëllumb" have derived some names of locations such as "Pëllumbari" (a village in the region of Përmet). In addition, from the noun "zog" (English translation: bird) are formed anthroponyms "Zog,-u" and "Zog(ë), -a, which are used in the North and South of Albania.

**Key words:** Anthroponyms, Patronyms, Toponyms, Oikonoms, Ethnonyms, Hydronyms, Oronyms.

*Toponimia dhe antroponimia e Gjakovës me rrethinë*

( *Shqyrtime etnolinguistike* )

---

**Shkurtime:**

**BShSh** = *Buletin për Shkencat Shoqërore*, Instituti i Shkencave, Tiranë, 1952 - 1957.

**BUSHT, SShSh** = *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria Shkencat Shoqërore*, Tiranë, 1958-63.

**DSh** = *Dialektologjia Shqiptare*, Tiranë, I 1971, II 1974, III 1975, IV 1982, V 1987, VI 1990.

**FESh** = *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Akademia e Shkencave e RPSSH, Tiranë, 1985.

**FEGJRSh** = *Fjalori i Emrave Gjeografikë të Republikës së Shqipërisë*, Akademia e Shkencave e RPSSH, Tiranë, 2002.

**GJA, SShF** = *Gjurmime Albanologjike, Seria e Shkencave Filologjike*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1971.

**GJA, SFE** = *Gjurmime Albanologjike, Seria e Folklorit dhe e Etnografisë*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1971.

**GJJ** = *Gjuha Jonë*, Akademia e Shkencave e RSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.

**ESh** = *Etnografia Shqiptare*, Akademia e Shkencave e RPSSH, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë.

**KP** = *Kultura Popullore*, Akademia e Shkencave e RSH, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë.

**SA** = *Studia Albanica*, Academie des Sciences de la RPS d' Albanie, Institut d'Histoire, L'Institut de Linguistique et Literature, Tirana, 1964.

**SF** = *Studime Filologjike*, Akademia e Shkencave e RSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1964.

**Sh** = *Studime Historike*, Akademia e Shkencave e RSH, Instituti i Historisë, Tiranë.

**OK** = *Onomastika e Kosovës*, Simpozium i mbajtur më 25 - 27 shkurt 1977, Prishtinë, 1979.

**MND** = Master i Nivelit të Dytë

*Toponimia dhe antroponimia e Gjakovës me rrethinë*

( *Shqyrtime*

*etnolinguistike* )

<i>Shkurtime e emrave të qarqeve</i>					
<b>Br.</b>	Berat	<b>Ko</b>	Korçë	<b>Man.</b>	Manastir
<b>Di</b>	Dibër	<b>Kos.</b>	Kosovë	<b>Pr.</b>	Prishtinë
<b>Dr.</b>	Durrës	<b>Ku.</b>	Kukës	<b>Pz.</b>	Prizren
<b>El.</b>	Elbasan	<b>M.m.</b>	Malësia e Gjakovës	<b>Pe.</b>	Pejë
<b>Gji.</b>	Gjirokastrë	<b>Mal.m.</b>	Malësia e Madhe	<b>Tr.</b>	Tiranë
<b>Gj.</b>	Gjakovë	<b>M.m.Sh.</b>	Malësia e mbi Shkodrës	<b>VI.</b>	Vlorë
<i>Shkurtime të tjera</i>					
<b>V.E.F.</b>	Vëzhgime për emrat familjarë				
<b>F.P.</b>	Fjalori patronomik				
<b>F.D.</b>	Fjalori drejshkrimor				
<b>Gj.m.</b>	Gjinia mashkullore				
<b>Gj.f.</b>	Gjinia femërore				
<b>B.f.</b>	Bie fjala				

<i>Shkurtimet e emërtimeve të gjuhëve dhe të dialekteve</i>					
<b>arab.</b>	arabishte	<b>hebr.</b>	hebraishte	<b>serb.</b>	serbishte
<b>aram.</b>	aramaishte	<b>i-e.</b>	indoevropianishte	<b>skt.</b>	sanskrishte
<b>arum.</b>	arumanishte	<b>ital.</b>	italishte	<b>sllav.</b>	sllavishte
<b>bullg.</b>	bullgarishte	<b>lat.</b>	latinishte	<b>sllov.</b>	sllovenishte
<b>dalm.</b>	dalmatishte	<b>lat.ballk.</b>	latinishte ballkanike	<b>turq.</b>	turqishte
<b>etr.</b>	etruskishte	<b>mesap.</b>	mesapishte	<b>ven.</b>	venetishte
<b>greq.</b>	greqishte	<b>pers.</b>	persishte	<b>maq.</b>	maqëdonishte
<b>greq.re</b>	greqishte e re	<b>rum.</b>	rumanishte	<b>pol.</b>	polonishte

*Toponimia dhe antroponimia e Gjakovës me rrethinë*

*( Shqyrtime etnolinguistike )*

## PËRMBAJTJA

- ABSTRAKT.....3
- ABSTRACT.....4
- LISTA E SHKURTIMEVE.....5 - 6
- FJALË PARAPRIJËSE.....1 - 4
- Hyrje.....5 - 14
- ARSYETIM.....15

## HYRJE

## KREU I

<b>1. Toponimia e Gjakovës me rrethinë dëshmuere e hershmërisë dhe e autoktonisë së shqiptarëve.....</b>	<b>1</b>
2. Gjurmë të toponimisë politike në toponiminë e Gjakovës.....	8
3. Toponimia dhe antroponimia e Gjakovës në arkivat dhe dokumentacionin e shkruar.....	9
4. Parimet e standardizimit të emërvendeve të Kosovës-shqyrtime vlerësuese.....	13
5. Struktura morfologjike dhe fjalëformuese e toponimisë së Kosovës.....	14
6. Për ubifikimin e emërvendeve të lashta.....	15
7. Toponimia dhe hartografia e Gjakovës.....	17
8. Rreth prejardhjes së emrit të Gjakovës.....	19
9. Kërkime mbi mikrotoponiminë e rrethinës së Gjakovës.....	21
<b>10. Toponimia e territorit të Gjakovës.....</b>	<b>22</b>
10.1. Emërvendet dhe përbërja e tyre.....	23
10.2. Emërtimet e rrugëve në qytetin e Gjakovës.....	23



10.3. Emërtimet e lagjeve në	
Gjakovë.....	
27	
10.4. Emërtimet e mullinjve në	
Gjakovë.....	
33	
10.5. Emërtimet e lugjeve në	
Gjakovë.....	34
10.6. Emërtimet e	
kodrave.....	
35	
10.7. Emërtimet e	
urave.....	
35	
10.8. Emërtimet e krojeve mbrenda qytetit në	
Gjakovë.....	
37	
10.9. Emërtimet e	
livadheve.....	
38	
10.10. Emra vendesh sipas natyrës së punës dhe veprimtarive të kryera	
aty.....	38
10.11. Vjelje dhe prurje onomastike të tjera në	
terren.....	
39	

## **KREU II**

<b>11. Toponimia e Dushkajës me disa të dhëna</b>	
<b>historike.....</b>	
42	
11.1.	
Arrnjeti.....	
42	
11.2.	
Mikrotoponimet	më
.....	karakteristike
42	

11.3.	Mikrohidronimet	ose	emrat	e	krojeve	dhe
ujërave.....						
43						
11.4.						Bec-
i.....						
43						
11.5.						
Batusha.....						
45						
11.6.			Mikrotoponimet			më
karakteristike.....						
46						
11.7.						Bardosana
.....						
49						
11.8.			Mikrotoponimet			më
karakteristike.....						
49						
11.9.						
Bardhaniqi.....						
50						
11.10.			Mikrotoponimet			më
karakteristike.....						
50						
11.11.						
Zhabeli.....						
53						
11.12.						Zhabeli
Plak.....						
53						
11.13.			Zhabeli			i
Ri.....						
53						
11.14.	Mikrotoponimet më					
karakteristike.....						
53						

11.15. Hidronimia ose emrat e krojeve .....	54
11.16. Emrat e ujrave ( hidronimet ).....	54
11.17. Plançori.....	55
11.18. Mikrotoponimet më karakteristike.....	55
11.19. Mogliku.....	57
11.20. Mikrotoponimet më karakteristike.....	58
11.21. Sprovë për etimologjinë e disa toponimeve të Gjakovës.....	59

### **KREU III**

<b>12. Përpyjekjet për standardizimin e emërvendeve në kuadrin</b> .....	61
<b>e përgjithshëm të Kosovës</b>	

### **KREU IV**

<b>13. Historia e emrave familjarë (patronimeve të</b> <b>Gjakovës.....</b>	69
13.1. Patronime nga emërvende ( toponime ).....	70

13.2. Patronime nga emri i etërve me ose pa prapashtesa.....	72
13.3. Patronime shqiptare me origjinë nga leksiku i zejeve popullore.....	75
13.4. Patronime që vijnë nga emërtimi i personit sipas punës që kryen.....	81
13.5. Patronime që vijnë nga emërtime të mjeteve të punës.....	81
13.6. Patronime që vijnë nga emërtimi i lëndës së parë që punohet.....	81
13.7. Patronime metaforike në të cilat trajtimi merr një natyrë të dyfishtë frymorësh.....	82
13.8. Patronime me origjinë nga terminologjia e rendit fetar, ushtarak dhe administrativ e shtetëror.....	84

## **KREU V**

<b>14.</b>	<b>Emrat</b>	<b>shpotitës</b>	<b>në</b>	<b>funksionin</b>
<b>patronomik</b> .....				86
14.1. Patronime që vijnë nga fjalë që shënjojnë vetitë fizike a morale të njerëzve.....				86
14.2. Nofka të bazuara në emra shpendësh a kafshësh.....				87
14.3. Patronime me zanafillë orientale.....				89

14.4. Patronime	me	burim
sllav.....		
93		
14.5. Emrat familjarë apo patronimet e përbëra dhe të përngjitura.....	93	
14.6. Emri vetjak i atit ka shërbyer si emër familjar.....	93	
14.7. Emrat e njerëzve (antroponimet) dhe bigëzimi i tyre në forma zyrtare dhe jo zyrtare...95		

## KREU VI

### **15. Emrat vetjakë me prapashtesa përkëdhelëse dhe zvogëluese..... 101**

15.1. Emra me prapashtesa zvogëluese.....	102
---	-----

15.2. Ndërtimi i toponimeve të çiftëzuara sipas cilësimeve (Tipi i Epërm-i Poshtëm).....	106
--	-----

### **16. Përbërja morfologjike e fjalëformuese e toponimisë shqiptare..... 107**

16.1. Toponime të formuara drejtpërdrejt nga emra të përgjithshëm.....	108
--	-----

16.2. Toponime antonimike	
.....	
113	

16.3. Toponime antonimike mbi bazën e mbiemrave	
.....	
115	

( *epërm*, - e (*i, e*), *sipërm* – e *posht/ëm*, - e (*i, e*) )

16.4. Toponime antonimike mbi bazën e  
mbiemrave:.....  
117

( *ri ( i ) / re, ( e ) - vjetër ( i, e )* )

16.5. Struktura fjalëformuese e toponimeve të trevave  
shqiptare..... 119

16.6. Emërtimet e formuara me prapashtesën -  
*th*.....  
120

## **KREU VII**

**17. Veçoritë** **stilistiko** -  
**sintaksore**.....123

## **KREU VIII**

**18. Leksiku**.....126

18.1. Fjalë nga fusha e  
bujqësisë.....127

18.2. Fjalë prej sferës së  
bujqësisë.....127

18.3. Fjalë nga fusha e  
bimësisë.....128

18.4. Fjalë që shënojnë  
shpendë.....128

18.5. Fjalë që emërtojnë  
kandra.....129

18.6. Fjalë që shënojnë sende, mjete pune, orendi  
etj.....129

18.7. Fjalë që emërtojnë koncepte dhe cilësi abstrakte.....129

**Përmbyllje**.....  
.....130

## **KREU IX**

### **19. Veçori semantike dhe strukturore rreth përformëzimit të Patronimeve të shqiptarëve**

**me theks të veçantë, zgjidhja alternative:njëjësi shquar / prapashtesa – AJ**..... 133

19.1 . Konstatime paraprake rreth patronimeve në veprat e I.Shpuzës.....138

/ Vëzhgime emrat familjarë dhe Fjalori i patronimeve të Çlirim Bidollarit.....146

## **KREU X**

### **20. Mendime faktografike rreth rëndësisë historike - kombëtare**

**dhe studimit të patronimeve në gjuhën shqipe**.....147

20.1. Patronime me shembuj faktik nga vepra e studiuesit Ç. Bidollarit.....148

të dëshmuar shekuj më parë.

20.2. Shembuj patronimesh nga përditshmëria jonë të cilët edhe kanë .....149

gjurmë historike, por edhe që motivojnë krijime të reja të ngjashme.

## KREU XI

**21. Rishqyrtime rreth zgjidhjes alternative nyjë - mbaresat.....151**

### **e shquarsisë / prapashtesa - AJ**

21.1. Shembuj me formantet fundore konkurruese.....158

## KREU XII

**22. Shqyrtime në drejtim të aspektit drejtfjalëformues..... 159**

### **me formante shquarsi dhe prapashtesim**

22.1. Formimet për temën përkatëse me prapashtesa të tjera vendëse.....167

22.2. Shembuj me fundore - me prapashtesën - **EJ**.....167

22.3. Shembuj me fundore - me prapashtesën - **OJ**..... 168

22.4. Shembuj me prapashtesën - **RAJ**.....169

22.5. Shembuj me prapashtesën - **ANJI**.....170

22.6. Shembuj me temë në - **ËSI**.....171

22.7. Shembuj me temë në - **ASI**.....171



22.8.	Shembuj	me	temë	në	-	<b>J</b>	/
<b>ANI</b> .....							172
22.9.	Shembuj	me	fundore-prapashtesat-		<b>TAR</b>	<b>(-DAR</b>	/
<b>I)</b> .....							173
22.10.		Shembuj		me		prapashtesën-	
<b>ARI</b> .....							173
22.11.		Shembuj		me		prapashtesën-	
<b>ORI</b> .....							173
22.12.	Shembuj	me		prapashtesën-	<b>LER</b>		/
<b>I</b> .....							174
22.13.	Shembuj	me		prapashtesën-	<b>LLAR</b>		/
<b>I</b> .....							175
22.14.	Shembuj	me		prapashtesën-		<b>OLLI</b>	
.....							175
22.15.	Shembuj	me	prapashtesën	<b>-XHI, - XHIU</b>	,	<b>(ÇI- ÇIU )</b>	
.....							176
22.16.	Shembuj	me	prapashtesën-	/	<b>LL</b>	/	<b>u, - LIJ</b>
<b>A</b> .....							177
22.17.	Shembuj	orientalizmesh		me	<b>-I</b>	fundore	
.....							178
<b>Përmbledhje</b> .....							.....179

### **KREU XIII**

**23. Patronimet me fundoret e imponuara:- E, - O, - i, dhe A e - AJ**.....180

**dhe zgjidhja alternative me shquarsi ose me prapashtesën -AJ**

23.1. Shembuj me fundoren - <b>E</b> në temë.....	180
23.2. Shembuj me fundoren - <b>O</b> në temë.....	182
23.3. Shembuj me - <b>I</b> të imponuar në temë .....	184
23.4. Formimet e patronimeve me fundoren- <b>A</b> e <b>AJ</b> të imponuar dhe prapashtesa- <b>AJ</b> ....	185
23.5. Nga toponimet me - <b>AJ</b> fundore.....	185
23.6. Nga huazimet me- <b>AJ</b> .....	186

#### **KREU XIV**

#### **24. Kujdesi i thjeshtëzimit e konsolidimit të “Patronimeve shqiptare”..... 188**

##### **sipas zgjedhjes së mundshme**

24.1. Rreth thjeshtëzimit strukturor të patronimeve.....	188
---	-----

24.2. Përmbledhje rreth konsolidimit sipas zgjedhjes alternative:.....	190
---	-----

(emërorja e njëjësit të shquar) prapashtesa - **AJ**

<b>Përmbledhje</b> .....	198-205
--------------------------	---------

<b>PËRMBLEDHJE</b> .....	206
--------------------------	-----

<b>I.</b>	<b>QËLLILIMI I STUDIMIT.....</b>	206
<b>II.</b>	<b>OBJEKTI I STUDIMIT.....</b>	206
<b>III.</b>	<b>METODAT.....</b>	207
<b>IV.</b>	<b>STRUKTURA EPUNIMIT.....</b>	207

**ABSTRCT**

<b>I.</b>	<b>PURPOSE OFSTUDY.....</b>	208
<b>II.</b>	<b>SCOPE OF STUDY.....</b>	208
<b>III.</b>	<b>METHODS.....</b> ...	209
<b>IV.</b>	<b>PAPER FORMAT.....</b>	209

<b>Literatura e shfrytëzuar.....</b>	210 - 221
--	-----------

## *Fjalë paraprijëse*

---

*Ky punim përbën sintezën e një pune shkencore afër pesëvjeçare. Duhet ta bëja, jo vetëm për t'i justifikuar vetës këmbënguljen, por për të studiuar deri në një thellësi çështjen e toponimisë dha antroponimisë në qytetin e Gjakovës me rrethinë madje, edhe të një treve sa të pasur aq edhe të pahulumtuar shterueshëm siç është Gjakova vendlindja ime. Sigurisht që, kur unë fillova të interesohemi për këtë studim, nuk dyshoja, se do të më duhej t'i kushtoja një pjesë të mirë të kohës sime.*

*Nëse do ta kisha përlllogaritur mirë këtë problem me të gjitha shqyrtimet e hulumtimet që kërkon një nismë kësodore, do ta kisha lënë. Por, kur takohesh me prof.dr.Gjovalin Shkurtaç, Akademik i asociuar, e në veçanti pasi njihesh me ligjërimin e tij dhe, që pata fatin në mbrojtjen shkencore, për Master i Nivelit të Dytë ( MND ), në Universitetin Shtetëror të Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Departamenti i Gjuhësisë vendosa që mos të shkëputemi nga një shkencëtar i mirëfillt i kulturës dhe i gjuhësisë shqiptare, ashtu si edhe shumë të tjerë të këtij universiteti që nuk ka më përlllogaritje, por ka vetëm përvjelje llërësh se profesor Gjovalini, është një mjeshtërndezez*

*i shkëlqyer i “zjarrit” të gjuhës, që di t’i palojë drutë” dhe pranë këtij zjarri s’ke se si të mos ngrohesh, dhe që nuk mund mos t’i shërbesh këtij zjarri.*

*Në këtë punim synojmë që përmes hulumtimeve të vëmë në dukje dallimet themelore të onomastikës dhe përbërjes së saj në Gjakovë dhe rrethinë duke sqaruar se onomastika përbëhet nga dy grupe të mëdha emrash: **a/**. emrat e njerëzve apo emrat vetjakë (**antroponimet**) dhe emrat familjarë përkatës të tyre (**patronimet**) dhe **b/**. emrat e vendeve (**toponimet**), të cilat, duke qenë të shumta dhe të ndryshme, mund të grupohen edhe sipas ndarjeve të tjera: **oikonimet** apo emrat e vendeve të banuara ( qytete, qyteza, katunde, lagje etj.), që si pjesë e tyre mund të shihen edhe **etnonimet** apo emrat e shteteve, kombeve, kombësive, krahinave, nëndarjeve administrative e shoqërore të ndryshme. Pastaj si përbërës të onomastikës janë edhe **hidronimet** apo emrat e ujërave (dete, lumenj, liqene, kënetë, përrenj, hurdhë etj.), si dhe **oronimet** apo emrat e maleve, fushave, kodrave etj.*

*Pra, në hulumtim të kësaj teme gjatë studimeve doktorale kam bërë përpjekje të ofroj të dhëna nga fusha e onomastikës, e një shekncë të re shumëdimensionale, e cila po zhvillohet te ne falë angazhimit të disa studiuesve tanë, duke u pykëzuar kryesisht në hulumtimet për toponiminë e një treve të veçantë siç është qyteti i Gjakovës me rrethinë.*

*Është e ditur se ai që i qaset toponomastikës i bie barra t’i përcaktojë shtresat, e ndryshme, natyrisht, duke shfrytëzuar edhe të dhënat e shkencave të tjera, në radhë të parë, të gjuhësisë, të historisë, të arkeologjisë, të gjeografisë, të etnologjisë etj.*

*Ndonëse, toponimia e Gjakovës me rrethinë, siç del nga sa kanë shkruar shumë studiues, dallohet për nga numri i madh i emërvendeve të pastra shqiptare, gjë që sundimi i gjatë romak, serb dhe ai osman, ku më pak e ku më shumë, kanë lënë gjurmë edhe në toponiminë e kësaj treve dhe të shumë të tjerave, gjurmë të cilat shërbyen si bazë për interpretime të gabuara dhe shtrembërime tendencioze të “shkencëtarëve” të “kalibrit” të Milenko Filipoviçit, Radomir Ivanoviçit etj. të cilët kanë vizituar këtë trevë dhe kanë shprehur opinionet e tyre, të cilat duhet parë me sy kritik.*

*Prandaj, duke marrë parasysh mundësitë e shumta që ka onomastika për të hedhur dritë, sidomos kur mungon dokumentacioni tjetër, çështje të historisë së një populli dhe të gjuhës së tij, duke parë faktin se toponimet janë më të qëndrueshme ndaj ndryshimeve*

ekonomiko-shoqërore sesa emrat e përgjithshëm, na u duk me vend të ndërmarrim një hetim sa më të gjerë. Emërvendet, shpeshherë mbeten dëshmi të pazëvendësueshme për të përcaktuar shtresat historiko-gjuhësore të marrëdhënieve të ndryshme që një vend dhe një popull ka pasur me trevat dhe popujt fqinj.

Krahas toponimisë, s'ka se si të mos përqafohet edhe arkeologjia që është e lidhur ngushtë me onomastikën shqiptare dhe zë vend të rëndësishëm edhe me disiplinat e tjera të kësaj degeje. Në korrelacion të këtij punimi janë përfshirë edhe antroponimet, patronimet, toponimet, etnonimet, dhe një krahasim i mirë i këtij punimi ka të bëjë me emrat e ujërave apo hidronimet...

Në përfundim të kësaj fjale paraprijëse për mbrojtje të doktoratës me temën: **“Toponimia dhe antroponimia e Gjakovës me rrethinë”** pa e zmadhuar e as minimizuar askënd, nuk është e tepërt të shprehi kënaqësinë dhe falënderimet më të sinqerta për profesor Gjovalinin, që pa dyshim është një yll “shenjtërie” për gjuhën tonë të bukur, që pata fatin të më frymëzojë për studim drejt shkollës doktores, që më dha kurajon e nevojshme nga e bardha zemër, për pa i ngrysur asnjë çast vetullat, e as pa ndryshuar asnjëherë zërin e tij melodik, e në veçanti, pa i humbur asnjëherë edhe buzëqeshja e tij natyrale. Profesor Gjovalini, meriton të përmendet e të falënderohet kudo e në çdo kohë, i cili në rrethana favorizuese për ne, u gjend i pakursyer drejt punimit shkencor në mbrojtje të temës së doktoratës, duke më ngjeshur me ideime e informacione shtesë për të kompletuar sa më mirë, për modele të qarta shkrimtarie sipas regjistrave dhe nënkodeve të ndryshme, në mënyrë që prej tyre të marrim model për temat e diplomës nga mikrotezat e studimeve pasuniversitare e deri te ajo e doktoratës se me të, e pranë tij, s'ke se si të mos ndihesh i sigurt, të cilin dua ta cilësoj si përkrahësin tim më fisnik që pati gjithë atë durim të lexojë e rilexojë me dëshirë e pasion dorëshkrimin e punës sime. S'do mend se mentori ynë i takon, së bashku me shokë, një brezi më brilant shkencëtarësh. Dhe përfundimisht, akademik Gjovalin Shkurtaç është një emër tashmë i mirënjohur në studimet kushtuar onomastikës, për përditësimet e disa prej zërave të bibliografisë kushtuar studimeve dhe ndihmesave të tij rreth standardizimit të onomastikës në Kosovë që, pa dyshim, është dhe do të mbetet një pirograf i mendjes dhe mendimeve për studentë e bshkëpunëtorë të shkencës, që është një medikament i gjuhës, si ai për mosngjizje të gjakut, është një “antivirues” për gjuhën tonë

*të bukur që “kujdestaron” ditë e netë për ta ruajtur këtë gjuhë prej stuhish e uraganesh që po e përplasnin sa andej e këtej.*

*Përmes hulumtimit në këtë punim synohet që të nxirret në pah origjinaliteti i kombit tonë në pikëpamje etnolinguistike dhe etnokulturore, duke iu përkushtuar një fushe, thuhet, të virgjër në studimet shqiptare për onomastikën.*

*Nëpërmjet argumentimit shkencor, të mbështetur në një lëndë të pasur gjuhësore, ndriçohen aspekte të patronimisë, duke mbrojtur autoktoninë tonë kombëtare në këtë fushë, të cilat me dashje, apo pa dashje, janë keqinterpretuar nga autorë të huaj.*

*Gjatë këtij hulumtimi në drejtim të temës objekt studimi kanë qenë edhe dukuri të ndryshme të patronimisë shqiptare, që janë ndriçuar edhe më mirë veçoritë e fondit patronimik të trevës së Gjakovës dhe të Malësisë së saj të cilin e kam njohur në hollësi falë vëzhgimeve e burimeve më të plota dhe pranisë së një dokumentacioni të mjaftueshëm arkivor.*

*Për hartimin e kësaj monografie janë shfrytëzuar vëzhgimet në terren, angazhimet e studentëve të gjuhës shqipe me detyra orientuese sipas vendbanimeve, burimet e shumta bibliografike e, në mënyrë të veçantë, regjistrat e popullsisë dhe ata kadastrale veneciane e turke, dokumentet portale të skelave të Adriatikut, si dhe regjistrat e gjendjes civile të shtetit të Kosovës, shtetit shqiptar, sidomos ata të rrethit të Shkodrës.*

*Duke iu falënderuar për durim, delikatesë dhe vëmendje që treguat e ndjej për detyrë të falënderoj në veçanti drejtuesen e Departamentit të Gjuhës, dekanen prof. dr. Mimoza Priku, prof. dr. Tomorr Osmani, prof. dr. Artan Haxhi, si dhe drejtoreshën e shkollës doktrale prof. dr. Rrezarta Draçini të cilët në tërësi ditën që me aq dashamirësi e mirësjellje të lëvdueshme ta përcjellin e gjithë punën pesëvjeçare që bëmë në kuadrin e shkollës doktrale. Poashtu, falënderoj dhe shpreh konsideratën time të lartë për të gjithë profesorët që patëm rastin, të kontaktojnë me ne pse jo edhe fatin e lumtur, që ishim studentë në gjiun këtij universiteti me një mbarësi të shkëlqyer dhe mjaft mbresëlënëse.*

*Së mbrami, por me kënaqësi e sodisfaksion të plotë, një falënderim i sinqertë u takon, anëtarëve të jurisë së nderuar, para të cilëve e quaj për nder që patën mirësinë ta lexojnë*

*me kujdes këtë punim shkencor që dola sot para jush me studimin tim në kërkim të gradës Doktor shkence në gjuhësi.*

*Krejt në fund, edhe pse nuk mendoj që, me këtë ndihmë modeste, i kam shteruar të gjitha burimet e shkruara në drejtim të kësaj teme, prapëseprapë ka shumëçka që nuk është hedhur në letër, ka shumë vende që s'ka shkelur këmbë njeriu dhe nuk është mbledhur gjithë ai thesar autokton shqiptar, sidomos në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në një pjesë të Serbisë e banuar me shqiptarë. Vullneti për kërkime shkencore në këtë drejtim nuk do të ndalet edhe më tutje, përkundrazi, prore do të jem në shërbim të shkencës.*

*Hyrie*

---

**Toponimia dhe antroponimia e Gjakovës me rrethinë duhet të trajtohet jo vetëm sipas vështrimit onomastikë e etnolinguistikë por, edhe sipas syrit kritik të standardizimit të shqipes.**

Prej kohësh në studimet albanologjike të dhënat e onomastikës dhe hulumtimet e shqyrtimet e hapëta rreth emrave të vendeve (toponimeve) dhe emrave të njerëzve (antroponimeve), bashkë me emrat familjarë (patronimet), kanë përbërë një mëtim të lakmueshëm për studiuesit më në zë. Madje, nuk mund të mos themi se, në hapat e parë të kërkimeve rreth shpjegimeve historike për gjuhën shqipe dhe në fazat e hershme të zhvillimit të saj, kanë qenë pikërisht emrat e vendeve dhe përgjithësisht onomastika e përmendur nëpër mbishkrime, pastaj edhe në shkrime të ndryshme, që kanë pasur rolin e dëshmuesve të pranisë



së shqipes e të shqiptarëve në trojet e tyre të sotme. Mjafton të përmendim se shumë nga shpjegimet serioze rreth historisë së gjuhës shqipe e, madje, edhe për historinë e popullit shqiptar si vijues i ilirëve, të kulturës e të traditave shqiptare si trashëguese e vijuese të pandërmjetshme të kulturës, gjuhës e të historisë ilire, nga lashtësia deri në mesjetë e në ditët tona, janë shestuar, zhदारitur e mbështetur sa me gërmimet arkeologjike, aq edhe me të dhënat e onomastikës iliro-shqiptare. Onomastika ka qenë gur themeli e lëndë e parë me rëndësi parësore në të gjitha hulumtimet e shqyrtimet historiko-gjuhësore rreth iliro-shqiptarëve, së pari, për albanologët e huaj, pastaj (në hullinë e tyre e me përmasa përherë e më të gjera) edhe për studiuesit shqiptarë. Në radhën e brezit të ri të gjuhëtarëve shqiptarë do të mëkëmbej sidomos “reparti mbledhës” i toponimisë dhe i antroponimisë së trevave shqiptare dhe, mbi atë lëndë, do të shestoheshin e kryheshin ndërmarrje të tjera studimore me interese e me prurje të reja. Siç e dimë, për një kohë të gjatë e me ndihmesa të rëndësishme, onomastikës shqiptare i kanë kushtuar rreshta të shumtë dy mjeshtërit e mëdhenj të historisë së gjuhës shqipe: i ndjeri prof. Eqrem Çabej, që u priu mbarë studimeve tona në Tiranë, duke bërë rishqyrtimin kritik të asaj çka ishte thënë (herë mbarë e herë pa baza) nga studiuesit e huaj, po edhe zbatoi për herë të parë ndër ne një metodë pune, ku gërshetoheshin kundrimet nga shumë anë për të mbështetur e mbërritur në etimologjitë e sakta apo, në mos tjetër, sa më të pranueshme të toponimeve shqiptare; dhe prof. Idriz Ajeti në Prishtinë, i cili, gjithashtu, vuri gurë themelin në ngrehinën e studimeve objektive kushtuar onomastikës shqiptare. Me raste të ndryshme dhe me trajtesa të rëndësishme onomastikës i janë kushtuar kumtesa, referime e artikuj edhe nga jo pak studiues të tjerë të mirënjohur. Vlejnë të përmenden ndihmesat e të ndjerëve M. Domi, A. Kostallari, Kolë Luka e Palok Daka, pastaj edhe të shumë të tjerëve. Hullitë e mbara të mjeshtërve të albanologjisë në fushën e onomastikës shqiptare, për fat të mirë, po ndiqen nga një numër i mirë studiuesish shqiptarë këtej e përtej kufijve të RSH-së<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> .Në mënyrë të veçantë na duken me rëndësi argumentimet e të dhënat e shumta të sjella në studimet e K. Lukës, ku mund të veçoheshin: “*Elemente toponomastike mbi feudalizmin paraturk në Shqipëri*”, “*Gjeografia toponomastike në dy kadastrat e Shkodrës të shek. XV*”, “*Gjurmime të toponomastikës mesjetare në trevën e Sopotit*”, “*Rreth toponimisë së trevës së Pjetërshpanëve në shekujt e parë të sundimit osman*”, “*Raste të ndërhyrjeve administrative në toponiminë e Defterit të Shkodrës*” etj. Në fushën e emrave të njerëzve

Në një numër studimesh toponimia shqiptare vijon të jetë si mbështetje për autoktoninë e shqiptarëve në trojet e veta, si dhe përgjithësisht për lidhjet e ngushta të onomastikës me historinë e gjuhës shqipe ku mund të veçonim disa artikuj problemorë të S. Mansakut, si p.sh. “Autoktonia e shqiptarëve në dritën e të dhënave të toponimisë së lashtë”. Po ashtu meritojnë vëmendje të veçantë disa trajtesa të Rexhep Ismajlit, si “Disa çështje të onomastikës shqiptare të mesjetës” dhe “Mbi disa toponime në Serbi të Jugut dhe në Maqedoninë e Veriut” (GjA., 1-2, 1970) etj. Përmendim edhe “Studime për onomastikën historike” të Fran Lulit (Shkodër, 2005), “Trajtesa onomastike” të Bahtiar Kryeziut (Prishtinë, 2010); pastaj një varg librash e trajtesash kushtuar standardizimit të onomastikës, ku shquajnë botimet e Begzad Baliut, si: “Demitizimi dhe standardizimi i onomastikës së Kosovës” (Tiranë, 2006); “Gjendja e toponimisë shqiptare në Ballkan” (Prishtinë, 2004) e “Onomastikë dhe identitet” (Prishtinë, 2012).

Shqyrtime interesante dhe me rezultate të tumirueshme për onomastikën shqipe të anëve të Ulqinit e më gjerë të trevave shqiptare në Mal të Zi ka sjellë në këta dhjetëvjeçarët e fundit edhe Ruzhdi Ushaku. Kemi parasysh, sidomos, librin e tij “Ulqini në gjurmët e shekujve”, Ulqin, 1991 dhe studimin “Një rishqyrtim i prejardhjes së hidronimit Buna” (“Filologji”, 1997, nr. 4) dhe “Hulumtime etnolinguistike” (Prishtinë, 2000) e “Ulqini në përmasa kërkimi e frymëzimi” (Ulqin, 2010).

Ndihmesë me rëndësi në studimin e onomastikës shqiptare përbën edhe Simpoziumi Shkencor i mbajtur më 25-27 shkurt 1977 nga Instituti Albanologjik i Prishtinës, ku u shqyrtuan probleme me rëndësi të toponimisë së lashtë, të onomastikës mesjetare e të onomastikës së sotme.

Në këtë Simpozium u mbajtën 45 kumtesa e referime shkencore nga studiues të Instituti Albanologjik të Prishtinës, nga pedagogë të Fakultetit Filozofik e të disa fakulteteve të tjera të Universitetit të Prishtinës, si edhe nga Enti i Historisë së Kosovës, nga Shkolla e Lartë Pedagogjike e Prishtinës, Gjakovës dhe e Prizrenit, nga shumë të ftuar të tjerë nga trevat shqiptare e më gjerë. Lënda e vlefshme e këtij Simpoziumi është botuar në vëllimin “Onomastika e Kosovës” (Prishtinë, 1979, 624 faqe), të cilit edhe i jemi referuar shpesh në studimet tona të më parshme, si edhe në faqet e këtij libri.

---

janë për t’ u përmendur studimet e P. Dakës : “Vëzhgime mbi emrat vetjakë të ardhur ngaleksiku i përgjithshëm i shqipes”, “Rreth disa antroponimeve të hershme shqiptare”, “Emrate njerëzve në gjuhën tonë”, të R. Doçit “Antroponimia e Llapushës” (Prishtinë, 1979) etj.

Shtojmë se, me rëndësi të tillë është edhe përmbledhja me titull “Toponimia e Gjakovës me rrethinë” (Gjakovë, 2002), ku janë përmbledhur kumtesat e tryezës shkencore të mbajtur më 4 maj 2001, një botim serioz me redaksinë e përbërë nga akad. Besim Bokshi, prof. dr. Qazim Lleshi, prof. dr. Edi Shkuriu, prof. dr. Shefki Sejdiu, prof. dr. Rexhep Doçi dhe prof. dr. Masar Rizvanolli.

Përmbledhja përmban një numër të madh kumtesash me rëndësi teorike e praktike rreth onomastikës, si: “Kontribut për ndriçimin e toponimisë së një treve me rëndësi” (nga M. Rizvanolli), kushtuar emrave të vendbanimeve të Gjakovës; “Standardizimi i emrave të vendbanimeve të Kosovës” (Jusuf Osmani); “Rreth disa parimeve emërtuese të toponimisë së Kosovës” (Shefki Sejdiu); “Standardizimi i onomastikës së Kosovës dhe universi i saj” (Begzad Baliu); “Rreth disa emërve me burim të shqipes në disa anavende të Kosovës” (Abdullah Zymberi); “Trashëgimia arkelologjike në kontekst të ndryshimeve të toponimeve (Komuna e Gjakovës)” (Edi Shkuriu); “Të dhënat arkeologjiko-toponimike për trevën e Gjakovës” (Exhlale Dobruna-Saliu); “Çështje të onomastikës së Gjakovës” (Qazim Lleshi); “Mbi disa toponime të rrethinave të Gjakovës” (Latif Mulaku); “Rreth prejardhjes së toponimit Gjakova dhe të disa toponimeve të Komunës së Gjakovës (Rexhep Doçi); “Disa çështje të onomastikës dhe të hidronimisë” (Ruzhdi Pllana); “Tipe të fjalëformimit të emërve në rrethinën e Gjakovës” (Mehmet Halimi); “Onomastika e disa vendbanimeve mesjetare të arealit të Gjakovës” (Sipas defterëve osmanë të shek. XV-XVI) (Iliaz Rexha); “Përkime onomastike të regjionit të Prokupljes dhe të atij të Gjakovës...” (Sabit Uka); “Toponime të Gjakovës” (Abdullah Konushevc); “Disa të dhëna rreth toponimisë së Dushkajës” (Skënder Hoxha); “Toponomastika e Hasit të Gjakovës” (Hysni Halilaj-Bedri Muhadri); “Një vështrim për disa vendbanime të Hasit në veprën e Milenko Filipoviqit” (Sabri Rexhepi). Përmbledhja ka edhe një numër diskutimesh e ndihmesash të tjera me interes nga kjo fushë.

Nga lënda e botuar në vëllime më vete meritojnë të përmenden kryekreje librat e H.Krahe-s “Die altern balcanillyrischen geographischen Namen”, Heidelberg, 1925; i E. Armao-s “Localita’, chiese, fiumi, monti e toponimi varidi un’ antica carta dell’ Albania Settentrionale”, Roma, 1933 dhe “Acta et Diplomata Veneta...” botuar nga Zef Valentini, të cilave nuk mund të mos u referohet cilido që ia hyn punës në lëmin e onomastikës shqiptare.

Për pasurinë e madhe e të larmishme përmendim edhe “Fjalori onomastik i Epirit”(Tiranë, 1995) i Fatos M. Rrapajt, ku përmbledhen toponimet dhe patronimet e Çamërisë dhe të trevave të tjera të Shqipërisë Jugore, një punë me të vërtetë madhore e me vlerë; “Fjalor bibliik dhe i termave kishtarë” (Shkodër,2004) i Fran Lulit. Me interes e prurje të pasura është edhe përmbledhja “Velça-Toponimia dhe antroponimia” (Tiranë, 2003) nga Lilo D. Nuraj. Lëndë të vlefshme onomastike kanë pasur edhe gati të gjitha monografitë e skicat dialektologjike të botuara në revistat dhe në përmbledhjet shkencore të Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë (“Buletini i Shkencave”, “Studime Filologjike”, “Dialektologjia Shqiptare” (I-VI) dhe në botimet e Institutit Albanologjik të Prishtinës (“Gjurmime Albanologjike”, “Studime Gjuhësore-Dialektologji”) etj.; mjaft lëndë onomastike dhe shkrime për këtë fushë ka botuar në Kosovë edhe revista “Përparimi”.

Mund të përmendim, në mënyrë të veçantë, ndihmesat e një numri studiuesish të dhënë pas hulumtimeve në lëmin e onomastikës së Kosovës e më gjerë, si S. Gashi, M. Pirraku, M. Halimi, H. Kajtazi, L. Mulaku, A. Zymberi, Q. Murati etj., të cilët, krahas (e në shërbim )të punës kërkimore shkencore në drejtimet përkatëse, për vite me radhë, nuk iu reshtën hetimit e mbledhjes në terren të toponimeve e të antroponimeve shqiptare. Pa përmendur lëndën e mbledhur e të pabotuar, por të depozituar në arkivat e sektorëve shkencorë të Institutit Albanologjik të Prishtinës, që urojmë të botohet një ditë, studiuesve të lartpërmendur u detyrohen prurje të rëndësishme onomastike nga një numër i madh katundesh e krahinash të Kosovës dhe të trevave të tjera shqiptare në Maqedoni, në Mal të Zi etj., ku kanë bërë ekspedita kërkimore<sup>2</sup>.

Shohim me kënaqësi se, edhe në vitet e fundit, onomastika ka pasur vendin e duhur në hetimet dhe trajtesat shkencore, si në qarqet shkencore e universitare të Shqipërisë, ashtu edhe në Kosovë e më gjerë, në qendrat shkencore e universitare të hapësirave shqiptare ballkanike.

Me vlerë të veçantë për t’u përmendur janë, ndër të tjera, një numër studimesh rreth onomastikës shqipe të trevave të Kosovës e të Maqedonisë, si shqyrtimet onomastike nga M. Halimi, botuar në revistat shkencore dhe, pjesërisht, të përfshira edhe në librin e tij

---

<sup>2</sup> E. Fetahu- D. Bislimi- S. Gashi, *Bibliografi e punimeve onomastike të Kosovës (1945-1976)* në OK, Prishtinë, 1979, f. 607-620.

“Vështrime gjuhësore”, 1993 të Qemal Muratit, prej të cilave veçojmë librin e tij “Dëshmi onomastike për autoktoninë e shqiptarëve në trojet e tyre etnike në Maqedoni”, 1993. Kanë qenë të mirëseardhura, këto vitet e fundit, një numër i mirë studimesh monografike, kryesisht disertacione për gradën e doktorit të shkencave filologjike, me anën e të cilave pothuajse është plotësuar një areale e hapët, ndoshta edhe gati shteruese, e hetimeve dhe e përshkrimeve dialektologjike edhe onomastike të trevave shqiptare në Kosovë e në Maqedoni. Po përmendi, me këtë rast, se kam lexuar dhe vlerësuar me kënaqësi monografinë “Onomastika e Hashanisë” të Baftjar Kryeziut nga Gjilani. Me mjaft interes kam ndjekur edhe disa studime e teza doktorate të kohëve të fundit nga studiues shqiptarë të trevave të Maqedonisë, nga të cilat janë për t’u përmendur kërkimet e Haki Ymerit “Patronimet dhe mikrotoponimet e regjionit të Lipkovës” 1985 dhe “Mikrotoponimet e regjionit të Markova Rekës”, si edhe një studim doktorate të Xhemaludin Idrizit “Mikrotoponimia e Karshiakës së Shkupit” (2003). Një studim të gjerë ka kryer e botuar edhe Izmit Durmishi në temën e tij të masterit me titull “Vëzhgime gjuhësore mbi toponiminë dhe antroponiminë e Pollogut të Epërm të Gostivarit” (Gostivar, 2008). Po ashtu, nga botimet e këtyre viteve të fundit te ne, mund të veçojmë librat e Jusuf Shpuzës “Vëzhgim për emrat familjarë të shqiptarëve” (Shkodër, 1998) dhe “Përsiatje onomastike” (Shkodër, 2008). Po ashtu edhe librin “Efolmja dhe toponimia e Qeparoit” (Tiranë, 2001) nga Natasha Sotiri.

Me vlerë njohëse dhe kodifikuese për drejtshkrimin e emrave të vendeve kanë qenë, në këto vitet e fundit, edhe “Fjalor i emrave gjeografikë të Republikës së Shqipërisë”(Tiranë, 2002), hartuar nga Emil Lafe e Nikoleta Cikuli; “Fjalor onomastik i Malësisë së Bujanovcit” (Prishtinë, 2006) nga Bahtiar Kryeziu; “Mikrotoponimet në vendbanimet shqiptare të rrethit të Prilepit, Krushevës dhe Velesit” (Shkup, 2010) nga Mustafa Ibrahimit dhe “Fjalor i patronimeve të shqiptarëve” (Tiranë, 2011) nga Çlirim Bidollari.

Përmes këtij hulumtimi, në këtë punim jemi përpjekur të qartësojmë përveç toponimisë dhe antroponimisë së Gjakovës me rrethinë edhe problemet me të cilat janë ballafaquar folësit gegë në Gjakovë dhe Malësinë e saj të cilët kanë paraqitur pak a shumë vështirësi të përvetësimit të standardit nga kjo pjesë e etnisë shqiptare. Trajtimi i kësaj çështjeje (jo vetëm për të folmen e Gjakovës), është mjaft aktual në trevat shqipfolëse, sidomos në kohën kur po zhvillohen debate shkencore dhe të tjera lidhur me standardin,

vendin dhe pranueshmërinë e tij në arealin shqipfolës, konkretisht në Kosovë. Kemi vërejtur se nivelet e sistemit gjuhësor janë të ndjeshme në masa të ndryshme ndaj ndikimit të jashtëm (ndaj ndikimit të faktorëve shoqërorë), përkatësisht në Kosovë.

Gjuhëtari italian Gaetano Berruto<sup>3</sup>, në manualin «Fondamenti di sociolinguistica» (Bazat e sociolinguistikës), botuar më 1995-ën, paraqet në mënyrë vijuese se ku janë ndryshimet ndaj ndikimit të jashtëm nga ato më të voglat e deri në ato më të ndjeshme. Ai thotë: **“duke nisur nga niveli më pak i ndjeshëm, (po i një rëndësie shumë të veçantë) do të ishte kjo: morfologjia, sintaksa, fonologjia, leksiko-semantika dhe në fund pragmatika gjuhësore”**.<sup>4</sup>

Vihet re se mund të kemi ndryshime në realizimin e një njësie gjuhësore të caktuar (mund të variojë një fonemë) dhe në këtë rast duket se më i ndjeshëm është sistemi fonetik, por mund të kemi edhe ndryshime të inventarit të njësive (rritja e numrit të fjalëve) dhe, në këtë rast, më i ndjeshëm shfaqet niveli leksikor.

Nga ana tjetër, dallimet në shqipen e folur, e parë kjo në shtrirjen gjeografike dhe evoluimin historik krahasuar me shqipen e shkruar, gjithashtu e shtrirë në arealin gjuhësor, si dhe në evolucionin historik vërehet se dinamika e zhvillimit të këtyre dy formave nuk është e njëjtë.

Është i njohur fakti se gjuha e folur është vazhdimisht në lëvizje, në zhvillim të pandërprerë, ndërsa gjuha e shkruar, për vetë natyrën e saj, nuk u përgjigjet hap pas hapi këtyre zhvillimeve, që do të thotë se nuk ka lidhje organike midis të folurit dhe të shkruarit dhe, për pasojë, lind dhe thellohet vazhdimisht një hendek midis gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar.

Duke qenë mjeti më i përsosur në përcaktimin e identitetit, gjuha vendos marrëdhënie edhe midis brezave të ndryshëm; ajo transmeton gjithë perceptimin kolektiv nga njëri brez në tjetrin, duke siguruar në këtë mënyrë vijimsinë e arketipit shoqëror të një bashkësie.

---

<sup>3</sup> Gaetano Berruto, *Fondamenti di sociolinguistica*, Laterza & Figli, Roma-Bari, 1995, f. 64

<sup>4</sup> Gaetano Berruto, *Fondamenti di sociolinguistica*, Laterza & Figli, Roma-Bari, 1995, f. 65

Pavarësisht zhvillimeve teknologjike (të cilat janë të vonshme) për të dëshmuar trashëgiminë gojore, gjuha e shkruar mbetet mjete më i mirë për të siguruar komunikimin midis brezave, për të përcjellë përvojën njerëzore nga brezi në brez. Për këtë arsye, ajo ka natyrë konservative dhe ruan njëjtësinë e normës drejtshkrimore, përndryshe, pas tre ose katërqind vjetësh, qoftë edhe këta rreshta që po shkruhen sot këtu, do të mund të lexohen vetëm nga filologët e specializuar.

Është e vërtetë se zbatimi i parimit fonetik siguron në masë të madhe përputhjen e normës shkrimore me atë të gjuhës së folur (si një lloj ekonomizmi) por, nga ana tjetër, rishikimi i shpeshtë i normës drejtshkrimore për t'iu përgjigjur kërkesës së parimit fonetik do ta gjymtonte gjuhën. Kjo praktikë do t'i cenonte gjuhës edhe funksionet e saj.

Në këtë punim kemi vërejtur edhe aspektin historik, sociolinguistik dhe psikolinguistik me të cilin është e ndërlidhur historia e popullit shqiptar ndër shekuj. Këta faktorë kanë pasur ndikime ndërgjuhësore si, bie fjala, në fjalët-huazimet serbe apo sllave, që deri diku kanë ekzistuar, por ekzistojnë ende në vernakularin e kosovarëve, duke u përdorur si në shqipen formale ashtu në atë joformale. Nga ana tjetër, anglicizmat e shfaqura sidomos pas luftës së Kosovës 1999 kanë zënë dhe po zënë një vend të pasqerëm në këtë të folme.

Diskutimet e ndryshme që po bëhen në lidhje me standardizimin e shqipes, nuk kanë reshtur dhe ka bërë vend ideja sikur faktori subjektiv ka një rol të rëndësishëm, madje vendimtar (e përpunon një standard, nuk e përpunon; e pranon një standard, nuk e pranon; krijon një standard të ri, ndërron një standard me një tjetër etj.), por sërish duhet kuptuar se nuk mund të jetë aspak kështu, duke iu referuar procesit të standardizimit. Kur i shikuar veçoritë e standardit në temën që e shtjelluam, ndryshe nga dialekti që përdoret vetëm në formën e folur, standardi përdoret si në formën e folur, ashtu edhe në atë të shkruar, për më tepër që është edhe i unisuar.

Është e qartë se çdo folës është në gjendje të përdorë të paktën dy variante të një gjuhe. Gjatë analizës së dukurive apo problemeve që u shfaqen gjatë trajtimit të temës, vërejtëm gjithashtu se të rinjtë e sotëm në çdo shprehje të tyre gjuhësore përdorin edhe fjalë të huaja të panevojshme, kryesisht anglicizma. Atëherë shtrohet pyetja: “këta po mundkan të përdorin edhe fjalë që nuk i kanë pasur në përdorim më herët, d.m.th. në të folurën e tyre joformale,

po me rritjen dhe zhvillimin e tyre që e kanë mësuar një gjuhë të huaj, konkretisht anglishten, pse nuk e përvetësojnë shqipen standarde? Sigurisht këtu është aspekti psikologjik i kompleksit të njeriut, i cili vihet re qysh prej gjuhëve të mëparshme në kontakt si: turqishtja, serbishtja dhe tani anglishtja, dhe që lidhet me faktin e të ndjerit “i privilegjuar”.

Gjuha si performancë pragmatike ndryshon edhe brendapërbrenda një bashkësie dhe na paraqitet si dukuri sociale, ku na kundrohet si subsistem edhe nga pikëpamja e faktorëve jashtëgjuhësorë. Siç shprehet dhe prof. Hasan Mujaj<sup>5</sup>, nga vrojtimit ekstreme të gjuhës si veprim, përfshihen këtu edhe aspektet kulturore të saj. Vështrime këto që na paraqiten nga këndi sociokulturor me refleksë të ndryshimeve shoqërore.

Dhe termi “i privilegjuar”, në shoqëritë e zhvilluara ose, të paktën, në ato shoqëri që kanë pranuar përdorimin e një varianti gjuhësor standard, kjo gjë fillon e bëhet një dukuri zakonshme. Dihet se shqipfolësit joformalë, apo bartësit e një gjuhe fitojnë variantin dialektor si «gjuhë të nënës» apo “gjuhë e zemrës” dhe duke qenë se asnjë nga variantet dialektore nuk mund të jetë i njëjtë me variantin standard, duhet që ata të përftojnë edhe variantin standard si gjuhë e shtetit dhe e institucioneve apo si thuhet në ndonjë rast si «gjuhë e bukës».

Duke e parë në këtë mënyrë, është i pambështetur shqetësimi prej bartësve të gegërishtes, të cilët ndoshta mund të ndihen të kompleksuar, ngaqë kanë më tepër vështirësi për të përqafuar standardin. Megjithë këtë, nuk mund të gjejmë ndonjë arsye për të ndërruar standardin.

Nga ana tjetër, është po aq e nevojshme të theksojmë se edhe të konsideruarit e standardit si një sistem i përfunduar, i mbyllur, është gjithashtu i gabuar. Si një dukuri dinamike, ai është një sistem i hapur ndaj ndryshimeve, të cilat vijnë kryesisht prej faktorëve shoqërorë. Në këtë mënyrë rrugët e pasurimit janë të larmishme, duke filluar nga gurra popullore dialektore e deri tek vetë zhvillimi i tij i brendshëm.

---

<sup>5</sup> Hasan Mujaj, *Kërkime sociolinguistike*, Faik Konica, Prishtinë, 2012, f. 106.



Përfundimisht, nuk duhet të kërkojmë «rrugë të reja» për formimin, përmirësimin, ndërrimin, as edhe për mbrojtjen e standardit, por duhet thjesht ta njohim dhe ta lëvrojmë atë; të pranojmë se ai mbetet një sistem i hapur dhe të lëvrojmë, pa komplekse, edhe variantet letrare, në mënyrë që, me ndërmjetësinë e tyre, ky sistem i hapur të pasurohet natyrshëm nga gurra dialektore.

Duhet ta kemi parasysh faktin se në të gjitha proceset e ardhshme, që kanë të bëjnë me gjuhën standarde, një rol të shumë rëndësishëm luan sistemi arsimor. Në të gjithë shtrirjen e tij ky sistem duhet të jetë i unifikuar dhe të synojë ngulitjen e standardit në të gjitha rrafshet e gjuhës, kryesisht në të shkruar, por edhe në komunikimin gojor në të gjithë shtrirjen institucionale të shtetit, në mass-media dhe kulturë <sup>6</sup>.

Rregullat e drejtshkrimit të shqipes standarde duhet të mos jenë të ngurta, por fleksibile, të pasurohen dhe të krijohen mundësi reale për përvetësimin më të lehtë të normës standarde për shqipfolësit gegë nga varietetet e tyre popullore, po që gjithmonë të jenë brenda normës në të gjitha nivelet gramatikore.

Në përfundim të kësaj parathënieje, lidhur me raportet gjuhë standarde dialekte, biem në një mendim me krahasimin e të drejtë të bërë prej prof. Musa Nushi <sup>7</sup>, i cili thotë: “Të dy dialektet e gjuhës shqipe, janë si të dy lumenjtë Drini i Bardhë dhe Drini i Zi, po që të dy bashkërisht derdhen dhe e formojnë Drinin e Madh.” Prandaj, edhe shqipja standarde pa këto dy dialektet dhe nëndialektet e saj, nuk do të kishte fuqinë e saj që e ka sot, dhe që ne mburremi si shqiptarë se jemi një komb dhe kemi një gjak, po që dimë ta flasim dhe ta shkruajmë një gjuhë, shqipen standarde. Nga kjo pikëpamje do parë edhe veprimtaria e leksikografëve shqiptarë që nga Pano Tase, pastaj Fjalori i Bashkimit, i Gazullit, i Kristoforidhit e deri te Fjalori i Mehmet Elezit dhe shumë fjalorë të tjerë të fjalëve të qëmtuara nga të folmet dialektore të shqipes. S’ka dyshim se këta fjalorë përmbledhin një

---

<sup>6</sup> Shezai Rrokaj, *Mësimdhënia e gjuhës shqipe në shkollë*, në Studime Albanologjike, I, Fak. Histori - Fil, UT, Tiranë 2011, f. 10.

<sup>7</sup> Musa Nushi, *Gjuha e sotme shqipe I*, Dukagjini Pejë, Gjakovë, 1998, f. 3.

pasuri të madhe leksikore dhe janë me shumë interes për pasurimin e fjalorit të gjuhës standarde. Lidhja midis gjuhës standarde dhe varieteteve dialektore mund të shihet edhe në krijimtarinë letrare të shkrimtarëve të ndryshëm të letërsisë shqipe, të cilët gjuhën e varieteteve dialektore shpeshherë e përdorin në veprat letrare, me qëllim që të bëjnë tipizimin e fytyrave të skenave të veprës.

Si gjithandej edhe në Gjakovë u kushtohet rëndësi ndërtimeve gjuhësore origjinale, duke u marrë më konkretisht me purizmin në përgjithësi si dhe duke u munduar që të jenë sa më të pastër ndaj shprehjeve të huazuara, që janë futur në përditshmërinë e të folurës sonë në Kosovë. Që prej rilindësve deri në kohët e sotme ka përpjekje të vazhdueshme për ta pastruar gjuhën shqipe, duke filluar me orientalizmat e asaj periudhe, e deri tek autorët e sotëm, të cilët mëtojnë ta fusin purizmin si pjesë e domosdoshme për një shqipë të pastër standarde.

Nga ana tjetër, në komunën e Gjakovës, në dallim nga komunat e tjera të Kosovës, për të folmen e saj në këtë trevë ka ndikuar shumë faktori gjeografik dhe ai politik. Pse gjeografik? Dihet se gjeografikisht Gjakova shtrihet pranë shtetit amë Shqipërisë dhe nga aspekti teknologjik i televizionit të Shqipërisë (TVSH), sinjali televiziv gjithmonë është marrë në këtë komunë, pra e gjithë Gjakova me shumë ëndje dhe më një fshehtësi të madhe nga politika dhe pushtuesit serbë, i ka përcjellë të gjitha programet që janë transmetuar nga kanali i TVSH-së (Televizioni i Shqipërisë) që, doemos, ka ndikuar në të folmen e tyre më afër standardit sesa qytetet e tjera të Kosovës.

Në aspektin politiko-historik vërehet sërish një veçori e njohur në këtë komunë ku, siç dihet, prej shekujsh nga kjo komunë kanë dalë patriotë me emër, të cilët janë përndjekur e keqtrajtuar nga regjimi serbo-sllav. Dihet gjithashtu se ka pasur një dendësi të lartë shkëmbimesh martesore me shqiptarët e Shqipërisë; tregtia ka qenë më e hapur edhe për vetë faktin e shkëmbimeve sociale ku, komuna e Gjakovës ka qenë dhe është më afër standardit të gjuhës shqipe.

*Arsyetim*

Trajtimi i kësaj çështjeje merr rëndësi të veçantë për kohën kur po zhvillohen debate shkencore dhe të tjera lidhur me standardin, vendin dhe pranueshmërinë e tij në arealin shqipfolës. Në vijim kjo rëndësi rritet me marrjen në shqyrtim dhe trajtimin e ligjërit të kësaj treve, ku na mungojnë shumë të dhëna dialektologjike krahasuar me të folmet e trevave të tjera të Kosovës

Ky shqyrtim do të mund të krijonte një ide më të qartë lidhur me dallimet themelore të shtrirjes së shqipes standarde me shqipen e folur në Gjakovë, konkretisht në rastin e shqipes dhe do të mund të jepte, sipas gjykimit tonë, ndonjë orientim me vlerë për rrugët e mëtejshme të zhvillimit dhe kontributit të gjuhës standarde dhe ndërtimit të raporteve të gjuhës standarde me dialektet ose vernakularët e shqipes.

## Kreu I

### 1. Toponimia e Gjakovës me rrethinë si dëshmuese e hershmërisë dhe autoktonisë së shqiptarëve

Trashëgimia e pasur arkeologjike, pozita gjeografike e Gjakovës, zejtaria e zhvilluar dhe një arsimim i hershëm, pa dyshim që këtë qytet e sjellin në një rrafsh të rëndësishëm studimi jo vetëm të studiusve vendas, por edhe të atyre të huaj që nga shekulli XIV e deri në ditët e sotme. Gjakova, me rrethinë shtrihet në pjesën jugperëndimore të fushëgropës së Rrafshit të Dukagjinit. Vetë pozita gjeografike, konfiguracioni i terrenit dhe resurset natyrore të kësaj treve, që në një anë i përbën miniera e pasur e Devës dhe në anën tjetër rrafshina e pllëshme e përshkruar nga dy lumenj: Drini ( ant. *Drillon, Drinus* ) në lindje, i cili ka rëndësi të madhe meqë lidh Adriatikun me Ballkanin qendror, dhe Ereniku në perëndim e jug, kanë ndikuar që kjo trevë të ketë qenë e banuar që nga koha parahistorike, duke i takuar pjesës qendrore të territorit dardan, ku zinte vend në skajin perëndimor të tij. Mirëpo, fatkeqësisht ashtu si shumë treva të tjera të Kosovës, që janë hulumtuar pak, ose aspak, edhe kjo trevë ka pasur këtë fat dhe, bën pjesë në ato treva që kohë pas kohe, por edhe në vazhdimësi, rrethanat nuk kanë lejuar për një dritëdhedhje në hulumtimet e nevojshme, madje-madje nuk është arritur të bëhet as rinjohja e plotë e lokaliteteve. Në bazë të rekognoscimit vetanak dhe informacioneve që janë në dispozicion, një varg lokalitetesh, vendbanime dhe vendvarrime, dëshmojnë për një jetë të lulëzuar në këtë rajon që nga parahistoria e deri në mesjetë.<sup>8</sup>

---

<sup>8</sup> Prof.dr. Edi Shukriu, *Toponimia e Gjakovës me rrethinë - Trashëgimia arkeologjike në kontekst të ndryshimeve të toponimeve*, Kuvendi i Komunës , Gjakovë, 2002 f. 45.

Siç dihet, sipas studiuesve të mirëfilltë, pjesa dërmuese e onomastikonit të tanishëm të Kosovës, sigurisht që, bazohet në materialet e shkruara mesjetare sllave, që tmerrësisht e rrënjësisht u shkoi për dore ta zëvendësonin e ndryshonin toponiminë ekzistuese shqiptare të kësaj pjese të Evropës Juglindore për më pak se dyqind vjet të qëndrimit të tyre në këto anë. Nuk do mend se këtë përpjekje e realizuan duke pasur si pikësynim shlyerjen e çfarëdo gjurme iliro-arbëro-shqiptare në viset e posapushtuara dhe sllavizmit të patjetërsueshëm e, si kryeqëllim përfundimtar, të krijimit të një kapitali të shpikur kombëtar, e që, në këtë drejtim, u ndihmoi "fatbardhësisht" posedimi i shkrimit çirilik të lashtë.

Ata, nuk u ndalën vetëm me kaq, por as edhe nuk u hamendën, në zbatimin gjithësesi të mundshëm të përkthimit të fjalëpërfjalshëm të emërtimeve, të cilat i hasëm me rastin e vendosjes së tyre në mjedisin e ri gjeografik. "Këtij rregulli e parimi" të përgjithshëm nuk i shpëtoi as onomastikoni i visit në shqyrtim-regjioni i Gjakovës.<sup>9</sup> Nuk është e lehtë edhe për studiuesit e kësaj fushe, ngaqë kanë përpara një punë shumë të vështirë dhe jashtëzakonisht të koklavitur në zbrërthimin e njëjtësimin e onomastikonit ekzistues parasllav në këtë vis, sikundër edhe që në të gjitha trevat gjithëkombëtare shqiptare. Dihet se gjithë pushtuesit kanë vetëm një emër, por, ai sllav është më largvajtës dhe dimensional. Gjithësesi do të ndalemi te ndërhyrjet që bënë veçanërisht sllavët në toponimet shqiptare dhe "stilin gjuhësor të përkthimit" të fjalëpërfjalshëm, përkthim tejet vulgar dhe pa kriterë gjuhësorë, jo pse s'i dinin, por me qëllimin e mbrapsht për ta përrulur edhe më si komb. Si shembull do të marrim oronimin Bjeshkët e Nemuna, i cili në të gjitha burimet e shkruara dhe paraqitjet hartografike që prej shek. XIX figuron si "Prokletije"<sup>10</sup>. I njëjti, si dhe shumica e makrotoponimeve, nuk figurojnë fare. Në krisobulat e Manastirit të Deçanit. Tani më është e ditur dhe e njohur se sllavët, për nga mënyra e jetesës e gjallërimit të tyre, në ngjashmëri me visin e tyre prejardhës (ultësirat moçalike të Pripetit në Bjellorusinë e sotme), vazhdimisht parapëlqenin luginat dhe rrafshinat për të qenë më të siguar qoftë për banim, qoftë për ta pasur më të lehtë edhe një shpërngulje të rastit. Kjo dëshmohet edhe nga vetë shkrimet e krisobulave në

---

<sup>9</sup> Prof.dr. Qazim Lleshi, Toponimia e Gjakovës me rrethinë, *Çështje onomastike të anës së Gjakovës* Kuvendi Komunal, Gjakovë, 2002 f. 62

<sup>10</sup> Po aty, f. 64, (paragrafi 1).

fjalë, ku gjejmë shprehjen “katuni Vlashki i Arbanashki”<sup>11</sup>. Në të cilin dëshmohet shprehimisht se viset e larta malore e bjeshkore ishin krejtësisht jashtë domenit të tyre jetësor. Saktësisht se është fjala për një përkthim të këtij makro-oronimi prej shqipes në serbisht, prof. Qazim Lleshi e dokumentoi para profesionistëve në këtë fushë, me rastin e ekspozimit në Konferencën e VI Onomastike ish jugosllave, të mbajtur në Donji Millanovac të Serbisë, midis 9 e 12 tetor 1985<sup>12</sup>.

Një çështje tjetër me rëndësi për onomastikën që u përoq prof.dr Qazim Lleshi, për një dritëdhedhje është prejardhja e hidronimit Erenik, lumit kryesor që e përshkon këtë vis kryq e tërthor. Në trajtën e fundit e hasim edhe në shkrimet e materialin tjetër hartografik sllav ç’prej më së një shekulli. Ndërkaq, në shkrimet mesjetare sllave (krisobulat) e gjejmë në trajtat: “*Ribnik*”, “*Ribnica*”, “*Ribnička reka*”, dhe “*R’venik*” (“*Mege v’sem...od Drima na “R’venik*”).

Mundësinë krejtësisht të natyrshme të shndërrimit të trajtës rrënjëse *Erenik* në atë sllave “*R’venik*”, artikullshkruesi e ekspozoi në Konferencën e IV onomastike ish jugosllave, të mbajtur në Portorozh të Sllovenisë prej 14 deri më 17 tetor 1981<sup>13</sup>. Ndërsa emërtimi e tretë i kësaj ane, të cilin prof.dr. Qazim Lleshi e njëjtësoi duke e ekspozuar në Konferencën III Onomastike ish jugosllave, ka të bëjë me fshatin: **Bishtazhin**, 7 km. në juglindje të Gjakovës. Për fat të keq, edhe sot e gjithë ditën është në përdorim e në shkrimet zyrtare, madje edhe si mbiemër familjar, formulon në trajtën e sllavizuar “*Bistrzhin*”. Këtë dhe shumë shtrembërime të tjera padyshim që i bëri administrata serbe e kohës më të re, e mbështetur edhe nga interpretimi falsifikues i gjuhëtarit Radomir Ivanović, i cili trajtës origjiniale mesjetare sllave “*Bisazhane*” i pykëzoi pas rrënjës “*Bis*” dy bashkëtingëllore “*tr*”, duke u përpjekur që ta tregojë me ndërlidhje të emrit të fshatit, me mbiemrin çfarësor sllav “*bistra*”, që do të thotë “*i (e) kthjelltë*”, “*i (e) tejdukshëm*”, kinse ka lidhje me cilësinë

---

<sup>11</sup>Prof. dr. Qazim Lleshi, shih sipas fusnotës 3 f. 64

<sup>12</sup> Prof. dr. Qazim Lleshi, *Prilog rasvetljavana oronima Bjeshkët e Nemuna - Prokletije*, Zbornik Šeste Jugoslovenske onomastike. Konferencie, SANU, XXXVII- odelenje vezika i književnosti, knj. 7, Beograd, 1987, f. 509 - 515.

<sup>13</sup> Prof.dr.Qazim Lleshi, *Toponimia e Gjakovës me rrethinë*, Kuvendi Komunal - Gjakovë, 2002, *Çështje onomastike të anës së Gjakovës*, f. 65.

e ujit të Erenikut, buzë të cilit shtrihet fshati. Faktet janë krejtësisht të kundërta. Fshati në të vërtetë, ka marrë emërtimin sipas pozitës, qoftë në skaj të lumit (Erenikut), ose shtrirjes së tij skaj një fshati më të madh, pra, **“në fund”, “në skaj”, “në bisht”, “bishtak”**<sup>14</sup>.

Këto që u trajtuan, në një farë mënyre nuk janë për t'u habitur, por kërkojnë profesionalizëm, durim e objektivitet shkencor për t'i rivendosur të gjitha toponimet në vendin e caktuar që e meritojnë. S'duhet kurrë të harrojmë, se me shtrembërime faktesh për autoktoni të shqiptarëve merret një Akademi e tërë e Shkencave të Serbisë, natyrisht, të “bekuar” paraprakisht dhe të prirë nga ”engjujtë” kriminelë kishtarë, e me “barinjte engjullorë” serbë të Artemije Radosavleviqit dhe Sava Janjiqit, të cilët tanimë, si duket “janë pajtuar me fatin” se Kosova nuk është vetëm djep dhe zemër e serbëve, por edhe e shqiptarëve. Këtë e ilustron edhe kjo thënie e Artemije Radosavleviqit: **“...Zoti e ka shkruar, që serbët dhe shqiptarët, të jetojnë pranë njëri - tjetrit në Kosovë”!** Çfarë parulle demagogjike! Çfarë ironie politike! Çfarë gënjeshtre “engjullorë - ekumeniste”! Në të vërtetë ky “apel” nuk është version origjinal i “lutjes pastorale” të Artemije Radosavleviqit, por është dogmë e vjetër e Kishës ortodokse serbe, që nuk ka kurrfarë përmbajtje as fetare, e as njerëzore, por thjesht është hipokrizi e politikës mistike e klerikëve serbë, që thërret shqiptarët, t'i “amnistojnë” serbomalazezët çetnikë nga krimet gjenocidale dhe nga gjitha padrejtësitë, që u janë bërë atyre gjatë historisë nga kolonizatorët mizorë serbomalazezë shkruan me të drejtë studiuesi prof.dr.Qazim Lleshi. Mirëpo, përkundër thirrjeve të këtilla, plotësisht, të rreme të politikës kishtarë serbe, pala shqiptarë më nuk do të pranojë kurrfarë kompromisi me kolonistët agresorë serbë në dëm të interesit fetar, kombëtar dhe shtetëror shqiptar. Logjikisht, as realisht nuk mund të arrihet kurrfarë pajtimi me pushtuesit kriminelë serbë, sepse ata për shqiptarët janë vetëm armiq dhe kolonizatorë të huaj...

Kujtojmë, me keqardhje por është fakt se një Çubrilloviq u bë akademik i shkencës serbomadhe pikërisht me platformën e tij famëkeqe **“Për ç’kombtarizimin e shqiptarëve”**. Kjo pangopësi u pa sheshazi edhe në dëbimin e afër 1 milion shqiptarëve në luftën e vitit 1999. Po ashtu, nuk mund të mos përmendim me këtë rast, botimet e ribotimet e shumta të

---

<sup>7</sup> Prof. dr. Qazim Lleshi, Toponimia e Gjakovës me rrethinë, Kuvendi Komunal - Gjakovë, 2002, *Çështje onomastike të anës së Gjakovës*, f. 66.

veprave famëkeqe dhe shumë të njohura për përpjekjet e qëndrimet e hapura shoveniste e të pambështetura ndaj toponimisë shqiptare, duke nxjerrë si zona e popullsi sllave masën e gjerë të toponimeve me origjinë sllave, që nga Podguri i Kosovës e deri te Zagoria në Jug të Shqipërisë.

**Fshaj** - Emërtimi që lidhet me këtë anë është ai i urës, e cila e tejkalon Drinin e Bardhë rreth 11 km. në jug-lindje të Gjakovës. Te banorët e kësaj ane mbizotëron mendim i gabuar, i cili lidhet kinse me ndonjë veti “shenjtërie”. Në këtë grackë bie edhe studiuesi i ndjerë, Hasan Kaleshi, i cili në një vend shënon ” **Ura e Shenjtë**” Ura, në të vërtetë, e mori emërtimin sipas fshatit skaj të cilit iu qe ngritur në kohë të panjohur **FSHAJ**. Këtë e mësojmë edhe nga vetë Krisobula e Deçanit, e cila e shënon në trajtë metateze “**Shvanj**” “**Shvanjski most**”, gjë që trajtën e fundit serbët e përdorin edhe sot e gjithë ditën. Emërtimi korrekt i prejardhjes shqipe të fshatit është “**Fshaj**”, ndërsa i urës është pra “**Ura e Fshajt**”.<sup>15</sup>

Këto të dhëna që u paraqitën dhe që po vazhdoj të paraqes nuk kanë të bëjnë me ngarkesa nacionaliste e as shoveniste por kanë të bëjnë me një të vërtetë të hidhur kundrejt popullit shqiptarë në përgjithësi ngado që gjenden në trojet e tyre stërgjyshore të shkaktuara nga pushtuesit tashmë të njohur serbosllav e që kemi obligim të mos heqim dorë për ruajtjen e standardizimit të emërvendeve në Kosovë, duke iu dhënë atyre shqiptarizimin që kanë pasur në shekuj. Për studiuesit është më i rëndësishëm ky proces, tashmë kur serbët nuk kanë më atë pushtet që përvijojë në trajta manipuluese dhe mbi toponiminë e emërvendeve të Kosovës. Profesori kosovar, Begzad Baliu, është një ndër ata studiues, që e ka shndërrua në kauzë studimin dhe pasqyrimin e toponimisë në trevat shqiptare të Ballkanit. Në një studim të tij thuhet se “Problemi i emërtimeve të vendbanimeve të Kosovës është ndërlikuar posaçërisht gjatë njëqind vjetëve të fundit, kur pas pushtimit serb të Kosovës, pasqyra e emërtimeve u bë pasqyrë nacional-mitike e pushtuesit të ri dhe gjendje e padurueshme e banuesve shekullorë të këtyre vendbanimeve. Pas vitit 1912, dhe sidomos ndërmjet viteve 1914-1924, qeveria serbe e Beogradit, me dekret të veçantë dhe me të ashtuquajturat “kërkesa të vetë qytetarëve shqiptarë” (!)<sup>16</sup>, ka bërë ndërrimin e emrave të vendbanimeve të

<sup>15</sup> Shih: Prof. dr. Qazim Lleshi, *Toponimia e Gjakovës me rrethinë*, Gjakovë, 2002, *Çështje onomastike të anës së Gjakovës*.

<sup>16</sup> Bisedë me gazetarin e së përditshmes “Shqip”, Ermir Hoxha botuar më 16 qershor 2006, Tiranë, f. 38-39. Shih Begzad Baliu *Onomastika e Kosovës (Ndërmjet miteve dhe dhe identiteve)* Prishtinë, 2008.



Kosovës, duke i stërkequr emrat e mëparshëm, duke i ndërruar emërtimet e mëparshme, duke i shtuar emrave të mëparshëm prapashtesat sllave *-iq* e *-viq*, duke hequr emërtimet e mëparshme dhe duke vënë emrat e rinj etj. Më tutje, qeveria serbe ka ndjekur së paku dy rrugë, sidomos, gjatë gjysmës së parë të shekullit XX: vendbanimet e reja i ka emërtuar me emra mitikë të miteve sllave (madje të krijuara kryesisht në fund të shekullit XIX ), për të ndërtuar tezën e tyre mbi të drejtën historike serbe mbi Kosovën, ndërsa në gjysmën e dytë të shekullit XX, me qëllim të krijimit të një baraspeshe më të madhe ndërmjet shumicës absolute shqiptare dhe pakicës serbe, qeveria serbe ka krijuar vendbanime të reja, qoftë edhe prej lagjeve serbe, të cilat gjendeshin pranë fshatrave të mëdha shqiptare. Vendbanimet e reja janë emërtuar, ose me emra të rinj sllavë, ose shpesh për të fshehur qëllimin e emrit të mëparshëm të fshatit u shtonin fjalët *e Poshtme*, ose *e Epërme*. P.sh. fshati **Makresh** (Gjilan) u nda në tri: **Makresh i Poshtëm**, **Makresh i Epërm** dhe *Dragancë*, edhe pse *Draganca* ishte pjesë e *Makreshit të Poshtëm*, të banuar krejtësisht me shqiptarë, ndërsa lagjja e vetme me shqiptarë e *Makreshit të Epërm* u shua pas masakrës që kryen partizanët e Brigadës Maqedono - Kosovare në dhjetor të vitit 1944.

Në të njëjtën mënyrë kanë vepruar edhe në fshatrat e komunës së Gjakovës *Novosella e Poshtme*, *Novosella e Epërme*, *Beci i Epërm*, *Beci i Poshtëm* dhe të Komunës së Deçanit me *Strellci i Poshtëm* dhe *Strellci i Epërm*, *Carrabregu i Epërm* dhe *Carrabregu i Ulët* etj.

*“Ne nuk i durojmë dot çibanët e huaj zoti gjeneral...”* (nga filmi “Në fillim të verës”)

*Sa për ilustrim po përmendim periudhën gjatë muajve të luftës në Kosovë, në '99-ën, media e Tiranës do të binte herë pas here në kurthet gjuhësore serbe të imponuar në zhargonin mediatik ndërkombëtar, duke artikuluar emrat e qyteteve kosovare sipas versionit serb: **Peç** në vend të **Pejë**, ose dy vjet më vonë, **Tanushës** në veri të Maqedonisë i thoshin **Tanushevc**<sup>17</sup>.*

Për këtë më së miri flet edhe emërtimi korrekt i prejardhjes shqipe *Fshaj* e jo *“Shfanj”* si dhe disa nga shembujt e mësipërm flasin dukshëm për përpjekjet e pareshtura të qeverisë serbe në këtë drejtim, ndërsa toponiminë e huaj në viset shqiptare, përfaqësia ruse,

---

<sup>17</sup> Begzad Baliu po në këtë studim, f. 289.

në Konferencën e Londrës, do ta përdorte si argument për mosekzistimin e një shteti shqiptar. Si do qoftë, studiues kosovarë kanë ndërmarrë iniciativën për standardizimin e emër vendeve në Kosovë, duke u dhënë atyre shqiptarizimin që kanë pasur në shekuj.

Në këtë rrafsh shikimi, mendoj se ka rëndësi të theksohet edhe fakti i zhvillimit të vendbanimeve koloniale serbe, apo të atyre të përziera dhe shuarja e vendbanimeve komunale të banuara krejtësisht me shqiptarë. “Shembulli më i mirë besoj se janë *Juniku* dhe *Deçani*. *Juniku*, nga një vendbanim i madh, me traditë historike të organizimit urban, u rrudh në një vendbanim rural, ndërsa *Deçani*, nga një vendbanim i vogël u zgjerua dukshëm për të marrë më në fund edhe statusin e një komune”<sup>18</sup>.

## 2. Gjurme të toponimisë politike në toponiminë e Gjakovës

---

<sup>18</sup> Shtojcë nxjerrë nga vepra, *Demitizimi dhe standardizimi i onomastikës së Kosovës*, “Argeta LMG”, Tiranë, 2006, f. 33 - 34.

Kur flitet për probleme të rëndësishme të së kaluarës shqiptare, qoftë të moçme, qoftë të kohëve tona, nuk mund të mospërfillet e të kundrohen edhe krizat gjatë përndjekjeve të shqiptarëve si ajo e Krizës Lindore.

Në kumtesën *“Përkime onomastike të regjionit të Prokuples dhe të atij të Gjakovës dhe disa veçori të Gjakovës me rrethinë”*, dr. Sabit Uka sjell një material të pasur të përkimeve ndërmjet toponimisë dhe patronimisë së Gjakovës dhe të Prokuples. Të dhënat e tij në këtë fushë nuk dëshmojnë thjesht vetëm për vijimësinë e toponimisë dhe patronimisë si rezultat i lëvizjes së popullatës apo siç jemi mësuar të lexojmë, për shpërnguljet e dhunshme të shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit në Kosovë dhe më gjerë, por për një proces tjetër, të cilin, me të drejtë prof. Çabej e quante homogjenizim të onomastikës shqiptare. Përtej kontekstit historik, në këtë studim dëshmohet për një strukturë gjuhësore dhe sidomos semantike të onomastikës shqiptare, të cilën në dokumentet e ndryshme e kishim gjetur që nga mesjeta e hershme, dhe që dokumentohet ndër kolonitë shqiptare në Greqi e Itali, Bosnje e Kroaci dhe më shumë se askund tjetër në Gjakovë e me rrethinë, por më pak kishim të dhëna dhe ndonjë sintezë të tillë për praninë kaq të pasur të kësaj patronimie edhe në zonën tjetër të skajshme të trojeve shqiptare, në Sanxhakun e Nishit.

### **3. Toponimia dhe antroponimia e Gjakovës në arkivat dhe dokumentacionin e shkruar**

“Edhe vendbanimet e komunës së Gjakovës, si dhe ato të viseve të tjera shqiptare, veçanërisht të Kosovës, mbajnë emra të periudhave të shumta të së kaluarës historike: të Kohës së Lashtë ( antike ), të Mesjetës së Hershme, të Mesjetës së Vonshme dhe të Kohës së Re. Perandoritë dhe shtetet pushtuese kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në toponiminë e këtyre viseve, si Perandoria Romake, Perandoria Bizantine, shtetet sllave të mesjetës, Perandoria Osmane, shtetet e mëvonshme sllave, veçanërisht Mbretëria e serbëve, e kroatëve dhe e sllovenëve. Këto perandori sunduese kanë lënë shtresime toponimesh, në radhë të parë shtresime emërtimeve të vendbanimeve” ( Prof.dr.Latif Mulaku ).

Toponimet janë përmendore të kujtesës njerëzore<sup>19</sup>. Kuptohet se zbërthimi dhe shpjegimi i drejtë i toponimeve ka vlerë të barabartë me deshifrimin e një epigrafi të lashtë, por të rëndësishëm për zhvillimin e kulturës së një populli në rrjedhën ngjarjeve historike të tij. Prandaj, si të këtilla, toponimet nuk duhet lënë në mëshirën kohës por duhet kushtuar kujdes të veçantë ruajtjes, mbledhjes dhe studimit të tyre. Nëpërmjet toponimeve dëshmohet ruajtja e gjuhës dhe historia e së kaluarës sepse, toponimet janë gjurma të kulturës shpirtërore dhe materiale të popujve të ndryshëm. Pra, si përkujtues, onomastika përbëhet nga dy grupe të mëdha emrash: **a/** emrat e njerëzve apo emrat vetjakë (**antroponimet**) dhe **b/** Emrat e vendeve (**toponimet**), të cilat duke qenë të shumta dhe të ndryshme, mund të grupohen edhe sipas ndarjeve të tjera: **oikonimet** apo emrat e vendeve të banuara ( qytete, qyteza, katunde, lagje etj); si pjesë të tyre mund të shihen e **etnonimet** apo emrat e shteteve, kombeve, kombësive, krahinave, nëndarjeve administrative e shoqërore të ndryshme; **hidronimet** apo emrat e ujërave (dete, lumenj, liqene, kënetë, përrenj, hurdhë etj.), **oronimet** apo emrat e maleve, fushave, kodrave etj.)

Për toponiminë e Gjakovës me rrethinë janë botuar vëllime me synime të ndryshme teorike dhe metodologjike, për të trajtuar onomastikën e Gjakovës në mënyrë sa më të plotë, sipas disiplinave prej nga vijnë edhe autorët, por njëri prej tyre dallohet për shumë arsye. Studimi i mr. Iljaz Rexhës *Onomastika e disa vendbanimeve mesjetare të areali të Gjakovës (sipas defterëve osmanë të shek. XV - XVI)* është një kontribut i rëndësishëm jo

---

<sup>19</sup> Šimunović Petar, *Toponimija otoka Brača*, Zegreb 1972, f. X të parathënies së librit.

vetëm për këtë vëllim dhe jo vetëm për temën që merret, por për një studim që autori vazhdon të trajton onomastikën e Gjakovës me rrethinë, duke pasur për bazë jo vetëm materialet e terrenit, siç veprojnë pjesa më e madhe e studiuesve të këtij studimi. Studiuesi Rexha e hap një pasqyrë të problemit të leximit dhe kuptimit të toponimisë së tërthoreve ballkanike, duke filluar së paku me mijëvjeçarin e dytë. Gjatë kësaj kohe ka pasur shumë lëvizje fisesh e kufijsh, shumë luftëra e shumë ndikime kishtarë e kulturore, prandaj, jo çdo gjë në dokumentet e mbetura është e përkryer dhe e sigurt për t'u përdorur. Për shkak të gjithë këtyre ndryshimeve, të përkryera nuk janë as dokumentet kishtarë serbe, të cilat jo rrallë bëhen dëshmi vendimtare për identifikimin e toponimeve të Kosovës dhe leximin e saktë të tyre.

Dy shekujt e parë të mijëvjeçarit të dytë janë shumë të rëndësishëm, sepse siç dihet shënojnë epokën e kalimit të etnonimit *arbër* në *alban*. Një pasqyrë e gjendjes historike të trojeve shqiptare deri tani dihet kryesisht vetëm prej dokumenteve bregdetare, por jo edhe për zonat e brendshme të Arbërisë.

Nuk ka dyshim se një dorë e rëndësishme e dëshmimeve dokumentare dhe të shkruara të kësaj periudhe ( fjala është për periudhën e ndarjeve kufitare mes kishës romane-katolike dhe ortodokse), gjenden në arkivat kishtarë ortodokse bizantine në Atos, ku ende nuk ka hyrë këmba e studiuesit shqiptar ose përgjithësisht e albanologut. E gjetur mes kishës greke-bizantine dhe katolike-romane, zona e krishterë shqiptare e trojeve shqiptare pas rënies nën perandorinë osmane, shpesh bëhet pre e ndikimit të kishës serbe, prej nga edhe e kemi pasqyrën e gjendjes jo të plotë dhe aq më pak të drejtë të toponimisë dhe sidomos antroponimisë së etnikumit shqiptar.

Në këtë rrjedhë autori fillimisht sjell disa shembuj nga fusha mikrotoponimisë dhe sidomos e antroponimisë dhe patronimisë së shtrembëruar të dokumenteve kishtarë serbe, si: *Kurikuq - a* në vend të *Gurikuq - i*, *Brzota* në vend të *Bardhota* etj.

Pasqyra e toponimisë dhe patronimisë së sjellë këtu dëshmon për përpjekje zëmëdha të kishës serbe për të sllavizuar plotësisht toponiminë dhe antroponiminë shqiptare, Më parë se për sllavizmin e saj, në këtë zonë, toponimet që i kanë bërë ballë presionit të administratës serbe tregojnë për atë pjesë të vogël të mbijetesës kulturore, historike, gjuhësore, materiale

dhe shpirtërore që, mbase më shumë sesa në shumë zona të Kosovës, ka arritur të mbijetojë pikërisht në Gjakovë dhe në rrethinat e saj. Materialet e *Defterit* të botuara në këtë vëllim tregojnë se një vendbanim që autori nuk ka arritur ta identifikoj plotësisht quhet *Bardani* (sigurisht fjala është për *Bardhanin*) quhej edhe *Bardonja*, se *Bardoniqi* i sotëm i rrethit të Gjakovës quhej me emrin tjetër sllav *Beliqi* se *Bradosani* i sotëm i rrethit të Gjakovës në shekullin XVI quhej *Lipovac*, se *Bishtazhini* quhej *Bistarzhin* se *Bunoshefci* shënohej si *Plonoshefci*, se *Hereçi* shënohej si *Çrno Potok*, se emri i *Morinës* shënohej *Murina*, se *Morina* tjetër shënohej si *Vulloviq*, se *Palabardhi* shënohej si *Belopavliq*, se *Shishmani* shënohej si *Shishmanci*, se vendbanimi *Ujzi* shënohej me motivim të ri *Radotinc*, se *Vokshi* shënohej si *Tërnavë* etj. Autori një të dhënë me interes sjell për vetë emrin e Gjakovës kur shënon se ”në bazë të disa monedhave origjinale që janë gjetur në fshatin Bunincë, në vitin 1928 si dhe disa ekzemplarë në *Artanë*, ish - *Novobërdë*, në vitin 1965, me mbishkrimin e fisnikut *Jakova* ( nga *Jak* + *ova* prapashtesë sllave që formon mbiemër pronësor që shpreh zotërim), i cili mendohet se ishte qeveritar i Gjakovës me rrethinë kah fundi i shekullit XIV dhe ndoshta emrin e ka marrë sipas këtij fisniku, së pari *Jakova* e më vonë me përshtatjen e gjuhës sllave në *Gjakovë* ”<sup>20</sup>.

Që emri i *Gjakovës* vjen nga një *Jak* kjo është thënë edhe më parë dhe do të mund të thuhej edhe më tej në nivel të një logjike e kurtuazie, por kur kjo thuhet duke iu referuar fakteve materiale dhe të shkruara, siç ka bërë studiuesi I. Rexha, merr peshë të veçantë, pra një rëndësi të kësaj natyre merr ky studim edhe për faktin se krahas unifikimit të vendbanimeve të sotme, duke iu referuar të dhënave të defterit osman, autori ka sjellë një regjistër të rëndësishëm të antroponimisë dhe patronimisë së këtyre vendbanimeve, me të cilin ka plotësuar dëshmitë e tij për sllavizmin si të toponimisë, ashtu edhe të antroponimisë shqiptare nga administrata mesjetare sllave.

Të dhënat e këtyre defterëve dëshmojnë se antroponimia dhe sidomos toponimia arbërore ishte formuar dhe stabilizuar jo vetëm para shtrirjes së sundimit serb, por edhe sundimit bullgar, prandaj hipotezat e shkencës serbe se shqiptarët e këtyre trojeve ishin thjesht blegtorë, tregtarë ose xehetarë të kohëpaskohshëm deri në fund të shekullit XVII nuk

---

<sup>20</sup> Mr. Iljaz Rexha *Toponimia e Gjakovës me rrethinë* f. 162 (*Tryezë shkencore, mbajtur më 4 maj 2001*). Botoi Kuvendi i Komunës së Gjakovës.

qëndrojnë. Ato, përkundrazi, dëshmojnë për praninë e tyre të përhershme me vendbanime etnike absolute, “si bujq të përhershëm, pronarë që i kanë shlyer detyrimet ndaj administratës osmane”<sup>21</sup>. Për të gjitha këto, studimi i Iljaz Rexhës pa dyshim që ka rëndësi të veçantë nga ky dorëmbarë jo vetëm për toponiminë Gjakovës, por edhe për toponiminë dhe antroponiminë e Kosovës e të trojeve shqiptare.

#### **4. Parimet e standardizimit të emërvendeve të Kosovës - shqyrtime vlerësuese**

---

<sup>21</sup> Mr. Iljaz Rexha, *Toponimia Gjakovës me rrethinë* f. 187-188 (Tryezë shkencore, mbajtur më 4 maj 2001). Botoi Kuvendi i Komunës së Gjakovës.

Çështja rreth disa parimeve emërtuese në toponiminë e Kosovës është një studim gjithëpërfshirës i shpjegimit të onomastikës si dije, si shkencë dhe si vlerë kulturore e gjuhësore. Ndryshe nga përpjekjet e më hershme të studiuesve për të paraqitur shtresat gjuhësore të toponimisë së Kosovës, e si pjesa më rezistente e gjuhës, i ndanë toponimet në tri kategori: toponime të ashtuquajtura *topographica*, *possessiva* dhe *patronimica*. Dobësia e trajtimeve të deritanishme të toponimisë së Kosovës qëndron në studimin e saj si fjalë dhe si kategori leksikore e jo si shenjë gjuhësore në sistem. Kjo është arsyeja pse Komisioni ka punuar për një kohë të gjatë dhe në mënyrë komplementare duke trajtuar strukturat gjuhësore të toponimeve mbështetur në metodat, teoritë dhe shkollat më të arritura bashkëkohore të kohës, brenda gjuhësisë dhe disa disiplinave të ndryshme shkencore të dijeve shkollore dhe universale. Një vend të rëndësishëm të studimit të tij zë, sikur shkruan autori Begzad Baliu, *çështja e kontekstit*, në të cilën me shembuj konkret autori sjell një pasqyrë në nivel të Kosovës mbi kontekstin historik të vendosjes së toponimeve të reja dhe të dhunshme njëkohësisht të administratës pushtuese sllave, për t'u ndalur në një kontekst më të gjerë: historik, gjeopolitik, ekonomik, kulturor, strategjik, politik etj., të toponimisë së Rrafshit të Dukagjinit. Gjithnjë në vijim të kësaj çasjeje autori arsyeton dhe mbulon përmasën e përdorimit të kontekstit, kryesisht të atij historik, edhe në punën e Komisionit për Standardizimin e Emërvendeve të Kosovës. Sikur e ka theksuar, studiuesi, prof. Baliu që në fillim të pasqyrës përmbajtësose të punimit të tij *Standardizimi i onomastikës së Kosovës dhe universi i saj*, autori, mjeshtërisht, trajton problemin e përkufizimit të onomastikës dhe problemin e parimeve të saj: *standardin* dhe *arbitraritetin*, gjithnjë në kontekst të punës praktike të Komisionit për Standardizim të Kosovës. Në një nënkaptinë më vete vazhdon autori i këtij punimi të merret me parimet universale të onomastikës së Kosovës, të përcaktuara në literaturën më bashkëkohore, si dhe me shembuj të caktuar të botës Lindore e Perëndimore; toponiminë dhe antroponiminë, si dy vlera të pandashme dhe të ndërlidhura në shumë aspekte; homogjenitetin e saj jo vetëm brenda kulturës shqiptare po dhe asaj botërore; për të përfunduar me disa, sikur shkruan autori, anomali dhe moskuptime të aparatqikëve politikë të ditës etj.

## **5. Struktura morfologjike dhe fjalëformuese e toponimisë së Kosovës**



Dy studiuesit tjerë prof. dr. Abdullah Zymberi dhe dr. Mehmet Halimi merren me problemin e strukturës, kryesisht morfologjike të toponimisë sa të Gjakovës dhe rrethinave të saj, aq edhe të Kosovës si tërësi. Dr. Abdullah Zymberi, në studimin *Rreth emërvendeve me burim të shqipes në disa anavende të Kosovës*, merret me “emërvendin *Plangçor*, hidronimet **Dështicë e Krenë** të komunës së Istogut, ojkonimin *Gorozhup* të Komunës së Prizrenit, *Buçe* të Opojës së Dragashit dhe masivin *Podgur-i* të komunës së Pejës dhe të Burimit”. Duke u nisur nga një numër i madh fjalësh të leksikut të përgjithshëm mjaft arkaik, si të Kosovës po kaq edhe të krahinave anësore ku janë ruajtur disa forma të moçme të leksikut të shqipes, autori mendon se në toponiminë *Plangçor* do kërkuar fjala *plang*; tek emri i lumit *Krenë*, fjala shqipe *krye*; tek emri i lumit *Dështicë*, fjala shqipe *shtie*, parashtesa parashtesa *dë-* dhe prapashtesa sllave *-ic*; në emërvendin *Dreth* fjala *dre*; në ojkonimin *Gorozhup* fjala *gur*, sikur edhe masivin *Podgur*; dhe në emërvendin *Buçe* fjala *bushtër*. I kësaj metode të vlerësimit dhe konkretizimit gramatikor të toponimisë është edhe studimi i dr. Mehmet Halimit *Tipet e fjalëformimit të emërvendeve në rrethinën e Gjakovës*, i cili deri më tash jo njëherë ka trajtuar onomastikën e Kosovës mbi këto parime dhe rezultate<sup>22</sup>. Në fillim autori vlerëson rëndësinë historike, kulturore, gjuhësore dhe metodologjike të onomastikës si fushë studimi, ndërsa më pas ndalet në disa prapashtesa të shqipes, me të cilat në të vërtetë nuk është shumë e pasur toponimia dhe sidomos ojkonimia shqipe e Kosovës, por është posaçërisht toponimia dhe sidomos ojkonimia shqipe e Gjakovës dhe e rrethinës së saj. I mbështetur në toponimet e sotme dhe në ato historike gjatë gjysmës së dytë të mijëvjeçarit të dytë, autori ndalet dhe vlerëson e plotëson me ojkonime historike të nxjerra nga literaturë perëndimore, ajo sllave dhe ajo orientale prapashtesat shqipe: *-aj, -an, -z(ë), -ak, -osh*; me prapashtesat sllave: *-iq, -oc, -ec, -icë, -inë dhe -ov (ë)*; si dhe me prapashtesat turke - orientale: *-li dhe -xhi*.

Një vend të veçantë autori i kushton patronimisë së toponimizuar si dhe toponimeve kompozita me të cilat është e pasur toponimia dhe sidomos ojkonimia e Kosovës. Nisur nga kjo gjendje, autori ka bërë edhe arsyetimin e punës së Komisionit në kërkimin, përpunimin dhe studimin e standardizimit të onomastikës së Kosovës.

## 6. Për ubifikimin e emërvendeve të lashta

---

22. Mehmet Halimi, *Vështrime gjuhësore*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1993.

Dy studimet e prof. dr. Edi Shukriut dhe një tjetër i dr. Exhlale Dobrunës – Salihut merren me problemin e identifikimit të emërvendeve antike dhe mesjetare të Gjakovës me rrethinë, duke u nisur nga prizmi i arkeologjisë. Në studimin e parë *Trashëgimia arkeologjike në kontekst të ndryshimeve të toponimeve*, studiuesja E. Shukriu trajton këtë problem duke u nisur nga kërkimet e deritanishme dhe informacionet që disponon për Komunën e Gjakovës. Autorja i konsideron të kohës parahistorike lokalitetet *Kalldrëma* dhe *Selishta* të Rogovës si: *Livadhet e Xërxës*; toponimet *Suka e Cermjanit*, *Çuka e Hereqit*, *Gadisha*, *Kalaja*, *Gradina*, *Fusha*, *Pozhega*, *Varret e Dardanëve* dhe *Gomuret e Shaban Balës* të cilat shtrihen në lokalitetet e kësaj ane. Të kohës së antikës, autorja i konsideron *Çivlakun* – si lokalitetin më të madh rrafshinor; si edhe lokalitetet *Karuqe* ( Xërx ), *Çeremidanë* (Dublibarë), *Lugi i Arave të Thata* (Skivjan ) , *Kisha Katolike* (Raçë), *Kalaja e Madhe* dhe *Kalaja e Vogël* (Batushë), *Gryka e Batushës* ( Hereq ), *Te Kisha* apo *te Ara Hasanit*, *Suka e Cermjanit* dhe *Kishna* (Cermjan). Të periudhës së Mesjetës i konsideron lokalitetet *Suka e Cermjanit* (Cermjan), *Kalaja e Madhe* dhe *Kalaja e Vogël* ( Batushë ), *Murana* dhe *Kroni i Priftit* (Voksh), *Gjoze* dhe *Kisha* (Xërxë). Një vend të veçantë autorja i ka kushtuar toponimit *Gradina*, për të cilin më parë kishte botuar një studim me titull *Toponimi Gradinë në suazat e zhvillimit të vendbanimeve kodrinore në Kosovë*<sup>23</sup>, dhe që këtu botohet si kontribut i veçantë.

Ndonëse nuk është pretendim i saj i veçantë për të nxjerrë etimologjinë, autorja përkujton se “toponimet *Gradinë*, *Gradishtë*, *Gjytet*, *Qytezë*, *Çukë* apo *Kala*” u përkasin periudhave antike dhe mesjetare, d.m.th. janë të kohës së paraardhjes së sllavëve në Ballkan. Në studimin e saj, autorja ka sjellë një varg të dhënash, sigurisht të rëndësishme edhe për onomastikën, por nga shqyrtimi i etimologjisë së saj, ndonëse ka një mbështetje në rezultatet e Profesor Çabejt, nuk mund të thuhet se është gjetur zgjidhja, për shumë arsye. Së pari, sepse baza etimologjike e emrit *Gradinë*, gardh, vjen nga një i.e. *ghordo* prej të cilës vijnë edhe fjalët në gjuhën shqipe dhe ate sllave, si gjuhë me bazë indoeuropiane. Problemi nuk qëndron tek etimologjia e saj, ajo dihet, sepse edhe shqipja edhe serbishtja kanë burim të përbashkët për këtë fjalë, problemi qëndron tek ubifikimi i toponimeve të caktuara, të cilat gjenden në territoret etnike shqiptare. Shqipja ka ruajtur me gjasë të dy format: atë *gardh*, si strukturë tipike brendagjuhësore dhe atë *grad* të mesjetës (sllave), e cila shtrihet madje jo vetëm tek

23 . Buletini i Fakultetit Filozofik, nr. XXII, Prishtinë, 1994, .127-132.

mikrotoponimet e tipit *gradina*, por edhe tek ojkonimet e njohura për qytete të mëdha si: *Pogradec*, *Grashticë*, *Graçanicë* etj. Do të ishte pretendim i madh dhe joserioz insistimi që shqipet t'i kushtojmë prejardhjen e rrënjorëve *gardh* dhe *gradinë* njëkohësisht, aq më tepër që kjo e dyta mbështetet si prej rrënjorit, ashtu edhe prej prapashtesës tipike të sllavishtes *-in*, ndërsa shqipja ka trashëguar edhe forma të tjera, si *gjytet*, *çukë*, *kala* etj. Në këtë vëllim botohet edhe kumtesa e prof. dr. Exhlale Dobrunës - Salihut, *Toponimia e Gjakovës me rrethinë*, një studim ky i cili jo vetëm ka plotësuar në shumë anë punën e Komisionit dhe e ka zgjeruar kompleksin e temave të rrahura në Tribunën shkencore të Gjakovës, por për një kohë të gjatë u ka munguar studimeve shqiptare të kësaj fushe. Autorja e këtij studimi, arkeologja E. Salihu, ka kohë që merret me ngulm me hulumtimin dhe studimin e pasurisë arkeologjike të antikitetit të Dardanisë antike<sup>24</sup>, prandaj është e kuptueshme pse studimi i saj, kur në mënyrë të përmbledhur e në mënyrë të thelluar dhe hulumtuese, sjell të dhëna të reja nga terreni, ngre teza e sinteza, gjithnjë duke u mbështetur si në materiale arkeologjike të dorës së parë, ashtu edhe në studime të deritanishme të dijes së arkeologjisë ndër shqiptarët si: N.Ceka, Z.Mirdita, B.Jubani, Q.Lleshi, E.Shukriu – Hoti etj., ose dijes së arkeologjisë ndër të huajt, si: H.Krahe, A.J.Evans, K.Patsch, K.Miller, F.Papazoglu, J. Jastrabov, A. Meyer, I. Mikuljiç, E.Çershkov etj. Prej studimit të arkeologes Salihu, mësojmë pozitën gjeografike të Gjakovës dhe rrethinës së saj, që siç shkruan autorja, është pjesa jugperëndimore e fushëgropës së Rrafshit të Dukagjinit; për burimet natyrore dhe historike të saj, hulumtimi i të cilave ende nuk është bërë në nivel të dëshiruar; për shtresat historike të toponimisë së kësaj zone, të sjella kryesisht nga studiues të huaj; për vlerësimet e saj shpesh vetanake dhe për plotësimin e atyre të dhënave edhe me material të ri, për të cilat shkencëtarët e huaj janë interesuar më shumë se një shekull më parë.

Në këtë pasqyrë, ajo sjell pozitën e lumenjve: ***Drinit*** (ant. *Drilon*, *Drinus*) në lindje dhe ***Erenikut*** në jug e perëndim; pozitën e topogërmadhës ***Gradishtë***, të lidhur ngushtë me toponimin ***Ura e Fshejt***; lokalizimin e stacionit ***Gabuleo***, midis Nishit dhe Lezhës, për mundësinë e identifikimit të një “municipit mu në Gjakovën e sotme me ***Therandën*** në Tabula Peutengiriana” (Evans) me të cilin, siç shprehet arkeologja Salihu, me të drejtë nuk

<sup>24</sup> · Shih, Exhlale Dobruna - Salihu, *Mbi disa toponime të kohës antikenë Kosovë*, "Onomastika e Kosovës", Simpozium i mbajtur më 25-27 shkurt 1977 në Prishtinë, Instituti Albanologjik, 1979, 27-46; Toponimet antike të Kosovës, "Rilindja" Prishtinë, maj 1985; *Tipologjia e monumenteve sepulklare të periudhës romake në Kosovë*, Gjurmime albanologjike- seria e shkencave historike nr. IV-V, 1974-1975, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1977.

pajtohen shumë studiues, sepse tashmë ubifikimi i Therandës është vlerë antologjike e kuptueshme për të gjithë, megjithëse ubifikimi i saj edhe më tej lëviz ndërmjet Prizrenit dhe Suharekës. Gjithnjë, duke u mbështetur në gjurmët e pakta të hulumtimeve arkeologjike dhe atyre të shkruara ndër kohë të ndryshme të dy shekujve të fundit, por duke kërkuar gjithmonë veçoritë etnike dardane të trevës së Gjakovës me rrethinë, autorja vjen në një përfundim sipas së cilit “shihet qartë se këto të dhëna dhe ky material arkeologjik i trevës së Gjakovës, edhe pse tash për tash i vogël në numër, (.) ka një vlerë të madhe, meqë hedh dritë mbi praninë e lokaliteteve arkeologjike, të cilat presin të gërmohen e të studiohen. Aq më shumë, disa lokalitete, duke qenë që herët objekt studimi i studiuesve të ndryshëm, janë lidhur me toponime të caktuara.

Pa marrë parasysh se a mund të qëndrojnë në tërësi, ato kanë një rëndësi të madhe, meqë tregojnë se kjo trevë ka qenë sferë interesi që moti. Në mesin e tyre, *Gabuleo* dhe sidomos *Theranda*, nga njohuritë e deritanishme, janë të paqëndrueshme, ndërsa *Qafa e Prushit* ka gjasë të jetë vazhdim i emrit të fisit ilir të *Pirustëve* (*Pirustae*, -autorja i referohet prof. Çabejt. B.B.), kurse hidronimi *Drinus* është i pakontestueshëm. Toponimi *Rripa*, i cili këtu trajtohet për herë të parë, lypset të studiohet më tej dhe të verifikohet”. (60-61).

## 7. Toponimia dhe hartografia e Gjakovës

Shtojmë se, me rëndësi të veçantë është edhe përmbledhja *Toponimia dhe hartografia* e Gjakovës me rrethinë e hulumtuar nga studiuesi i mirëfillt prof. dr. Qazim Lleshi, në kontributin e tij prej hulumtuesi e studiuesi të shkëlqyer në Tribunën shkencore që e pat dhënë me studimin *Çështje onomastike të anës së Gjakovës*, ndërsa brenda vëllimit me kumtesa dhe diskutime boton edhe studimet *Përkitazi me prejardhjen e hidronimit “Erenik” dhe kontributi ndriçimit të oronimit “Bjeshkët e Nemuna-Prokletije”*. Në vazhdim të kërkimeve të tij në gjurmë të toponimisë dhe antroponimisë ilire-arbërore-shqiptare, prof. Lleshi, kësaj here merr për obligim sjelljen e një pasqyre të pasur nga aspekti i shtresave gjuhësore dhe historike, si: *Katun Vllashki i Arbanashki*, trajtat e hidronimit *Erenik*, që në krisobula e gjejmë si: *Ribnik*, *Ribnica*, *Ribniçka reka*, dhe *R'venik*; disa struktura

gramatikore të ojkonimit *Bishtazhin*, kontekstin kulturor-historik të toponimit *Ura e Fshejt*, prejardhjen joslave të mikrotoponimit Gradishtë, prejardhjen antroponimike të ojkonimit Batushë etj., duke i krahasuar ato shpesh edhe me gjurmë të tilla antike, mesjetare e të kohës së re edhe në hapësirat më të skajshme të Ilirisë dhe Europës Perëndimore. Në pjesën e *Kontributeve*, autori, edhe njëherë shtron problemin e prejardhjes së hidronimit *Erenik*, duke e parë atë në kontekst të kërkimeve të shumta nga studiues vendës dhe sidomos të huaj. Nga dëshmitë e mbledhura dhe të sintetizuara të këtij punimi, autori vjen në këtë përfundim: “Duke u bazuar në prapashtesën e njëjtë të përbashkët për hidronimin *Erenik* dhe toponimin mesjetar *Ribnik*, jemi të bindur se është fjala për emërtimin e të njëjtit lum si dhe vendbanimin ( *Junik* ), i cili është në përdorim të popullatës vendore-rrënjëse e kësaj ane-të Gjakovës, që prej kohërave të panjohura. Ndërkaq, trajta *Ribnik*, e cila haset në *krisobula*, paraqet shtrembërim të qëllimshëm të regjistruesve për t’i dhënë trajtës burimore popullore *Erenik* veçori, tingull e ngjyrë sllave e për ta përdorur si argument kombëtar”.

Me studimin tjetër autori merret me oronimin “Bjeshkët e Nemuna, përkatësisht *Proklete Planine* ose *Prokletije*, i cili shtrihet në pjesën veriore të Malit të Zi dhe në atë më lindore në Kosovë. Duke nxjerrë një numër të madh faktesh të shënuara nga studiues vendës dhe të huaj: Çabej, Jokli, Hahni, Skoku, Shuflai, Bartoli, Dobrovski, Markoviqi, Ami Bue, Elisee Reclus, Levassier-Perigot etj., pjesa më e madhe e të cilëve sajuan emërtimin *Alpet e Shqipërisë Veriore*, ndërkohë që vendësit ruanin emërtimin e gjuhës së tyre *Bjeshkët e Nemuna*, sikur edhe *Prokletije* më vonë. Pa dashur që të merrem me parimet e kërkimit dhe të studimit të këtij oronimi, hulumtimi i tij që etimologjinë e oronimit *Bjeshkët e Nemuna* ta kërkojë tek fjala *bjeshkë*, metodologjikisht nuk çon në rrugë të drejtë. Shqyrtime të tilla brenda një strukture gjuhësore të një toponimi bëhen vetëm kur toponimi është togfjalësh, kur njëra gjymtyrë është me etimologji të huaj e tjetra me etimologji shqipe, siç është toponimi *Udhë Pukë*.

## 8. Rreth prejardhjes së emrit të Gjakovës

Sipas kumtesës studimore të dr. Rexhep Doçit, *Rreth prejardhjes së toponimit Gjakova dhe të disa toponimeve të Komunës së Gjakovës*, trajton probleme themelore në

zhvillimin cilësor të onomastikës si disiplinë gjuhësore, emrin e Gjakovës dhe ojkonimin e njërit prej vendbanimeve të rrethit të Gjakovës, *Batushë*. Dyzetë vjet pas vërejtjes së Profesor Çabejt se “studimet onomastike, me aq rëndësi për historinë e gjuhës, me pak përjashtime kanë mbetur djerrë”, autori kujton se gjendja e studimeve në këtë fushë ka ndryshuar shumë, sidomos në Kosovë. Në këtë fushë të dijes janë botuar jo vetëm një mal studimesh, por edhe tetë vëllime të cilat trajtojnë probleme më të gjera ose më të rrudhura në fushën e onomastikës. Rezultatet shkencore të arritura deri më tani, sidomos botimi i dokumenteve të ndryshme, i japin autorit mundësi që të bëjë krahasime edhe me ojkonimin e Gjakovës dhe rrethinës së saj me struktura përkatëse historike gjatë pesëqind vjetëve të fundit. Pasi sjell një inventar të zgjeruar të emrit Gjakovë në botime të ndryshme të proveniencës sllave, orientale, romane dhe të traditës, autori pranon mendimin e Palok Dakës lidhur me prejardhjen e toponimit Gjakovë, siç shkruan Doçi, “prej një emri të moçëm shqiptar *Jakob, Jakov, Jak* (emër vetjak i shkurtuar, përkëdhelës), sepse edhe sot te shqiptarët e besimit katolik kudo në Kosovë dhe më gjerë ekzistojnë antroponime e patronime të tipit *Jaku*, kurse në Gjakovë, siç u tha, ekziston edhe patronimi i shqiptarëve të besimit islam *Jaka*”. Po me këtë koncept autori trajton edhe etimologjinë e ojkonimit *Batushë-a*, të cilin e konsideron të gurrës iliro-shqiptare dhe e ndërlidh me “rrënjorin *bat-*, të cilin më tej e kërkon te emri i fjalës shqipe *bathë-a* “groshë, fasule”.

Ndërsa, në studimin *Toponimia e Gjakovës*, Abdullah Konushevc, trajton aspektet historike, kulturore dhe veçanërisht gjuhësore të toponimisë së Gjakovës dhe rrethave të saj. “Toponimia e Gjakovës – shkruan autori, – veçohet me një varg karakteristikash të cilat dallojnë nga regjistri i emrave të kazave e sanxhaqeve të tjera të Kosovës. Së pari, janë shumë toponime të pastra shqiptare me rrënjën *bardh*, pastaj disa me prapashtesën zvogëluese, dikur shumë prodhimtare - *ëz*, si dhe një numër i madh emërvendesh me prapashtesën - *aj* (*ë*)“. Për autorin karakteristikë gjuhësore e toponimisë së rrethinës së Gjakovës është metateza *a-r > r-a*, prapashtesa iliro - shqiptare, - *ana* dhe - *an* etj.

Në pjesën e dytë të studimit, Konushevc trajton *toponimet latino-romane*, sipas të cilit, në rrethinën e Gjakovës janë ojkonimet: *Romaja* (*vi*) *ja*, *Skivjan*, *Smolica*, *Radoniq* etj; ndërsa në pjesën e tretë merret me prejardhjen etimologjike të hidronimit *Erenik* dhe *Krena*. Te këto dy hidronime, autori kërkon “një apelativ të zhdukur të shqipes \**ren* > *ron* ‘rrjedh,

del' (205), megjithëse në kontekst të fenomeneve, dukurive e shtresave ndërgjuhësore sjell edhe një varg krahasimesh të emërvendeve të Gjakovës dhe rrethinës së saj. Përtej shpjegimeve e venerimeve nga më të ndryshme: historike, kulturore e gjuhësore, vlera e studimit të A. Konushevcit qëndron në një pasqyrë të rëndësishme të pamjes së emërvendeve të rrethinës së Gjakovës 1896-2002.

Nga prizimi i shkencave të veçanta ose edhe i periudhave të veçanta të studimit, emërvendeve të Gjakovës dhe rrethinës së saj iu qasen studiuesit prof. dr. Ruzhdi Pllana (në kontekstin gjeografik), Iljaz Rexha (në kontekstin e hulumtuesit të pasionuar të arkivave të orientit), dr. Sabit Uka (në shtratin e përkimeve të onomastikës së Prokuples me atë të Gjakovës) etj.

Në studimin e tij *Disa çështje të oronimisë dhe të hidronimisë së rrethinave të Gjakovës*, profesor dr. Ruzhdi Pllana, i qaset toponimisë së Gjakovës me rrethinë nga këndi i gjeografit, por njëkohësisht edhe të njohësit të mirë të hartografisë e të onomastikës së Kosovës. “Emërvendet mund të sistematizohen dhe të klasifikohen sipas kriterëve të ndryshme, mirëpo-shkruan prof. Pllana, rezultatet më të mira bazohen në grupimet e emërvendeve sipas përmbajtjes popullore të termave gjeografikë”. Autori njëkohësisht ua zë për të madhe ekspertëve, të cilët nuk e kanë shfrytëzuar mjaftueshëm fjalësin popullor për të krijuar terma dhe neologjizma të ndryshme për disiplinat shkencore.

Autori iu gjen koncepteve të tij kërkimore hapësirë dhe përmbajtje të pasur materiale, gjeografike e gjuhësore pikërisht në Gjakovë dhe në rrethinën e saj. “Karakteristikë kryesore e oronimisë dhe hidronimisë së rrethinave të Gjakovës, shkruan prof. Pllana, është mbizotërimi i tyre në gjuhën shqipe, që shpreh përkatësinë e popullatës vendase”.

Për studimin e tij autori ka shfrytëzuar burime të rëndësishme historike dhe hartografike, të cilat nuk kanë qenë dhe fatkeqësisht ende nuk janë burim i shfrytëzuar me kompetencë nga specialistë të fushave përkatëse pra, edhe të onomastikës.

Në kërkim të hidronimeve të Gjakovës me rrethinë dhe të aspekteve gjeografike, semantike e gjuhësore të formimit të tyre, autori vjel me kompetencë dhe sjell një pasqyrë shumë të pasur të oronimeve dhe hidronimeve sipas hartave topografike<sup>25</sup>, për të bërë njëkohësisht edhe një sintezë të tyre mbi kriteret e formimit të oronimeve dhe hidronimeve: ngjyrës, formës, pozicionit, veçorive fitonimike etj.

---

<sup>25</sup> Topografska karta 1:50.000 Gjakovica 1,2, Peç 4, Prizren1; Karta1:100.000 Gjakovica (679), Prizren (680); Topografska karta 1:25.000 Gjakovica 1-2, 1-3, 1-4, 2-1, 2-2.

## 9. Kërkime mbi mikrotoponiminë e rrethinës së Gjakovës

Hulumtimet e fundit trajtojnë kërkimet dhe studimet e onomastikës së dy krahinave etnografike të rrethinës së Gjakovës: toponiminë e Dushkajës nga Skënder R. Hoxha<sup>26</sup>, i cili ka disa vjet që me ngulm bën kërkime dhe boton kumtesa lidhur me rezultatet e kërkimeve të tij në këtë zonë; toponiminë e Hasit të Gjakovës nga bashkautorët Hysni Halilaj e Bedri Muhadri dhe në fund një kumtesë polemizuese e Sadri Rexhepit me Milenko Filipoviqin. Në kumtesën e tij *Disa të dhëna rreth toponimisë së Dushkajës*, Skënder R. Hoxha, sjell një sintezë kur të zgjeruar e kur të plotësuar të toponimisë së Dushkajës, duke filluar me shtrirjen gjeografike të kësaj krahine (“në pjesën lindore të Dukagjinit qendror”); me praninë e toponimeve ndër defterë mesjetarë dhe harta të moçme (*Krisobula e Deçanit* e vitit 1330; *Defteri i regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës (1485)*; *Gastaldi, Carta dei paesi Danubjani, 1517* etj.); me gjurmët e administratës turke në këtë toponimi (*Arat Çerkeze, Livadhi Begit, Ulica Spahive* etj.); me sferat kryesore nga të cilat sajohet toponimia e Dushkajës (sipas kryefamiljarëve, sipas konfiguracionit të terrenit, sipas llojit ose përbërjes së tokës, sipas kulturës bimore, pozitës gjeografike, formës etj.); me strukturën fjalëformuese dhe leksikore të saj (njëgjymtyrëshe, me fjalë të parme, të prejardhura e togfjalësh, kompozita) etj. Po në këtë vëllim, në rubrikën e diskutimeve, S. Hoxha boton artikullin *Rreth herrjes dhe emërimit të disa toponimeve të Krahinës së Dushkajës*, me të cilën plotëson kontributin e tij dhënë punës së Komisionit për Standardizimin e Emërvendeve të Kosovës. I motivuar prej punës shumëvjeçare në kërkimin e toponimisë së Krahinës së Dushkajës, i nxitur prej aktivitetit të dendur të Komisionit për standardizim, si dhe prej diskutimeve të shpeshta në shtypin ditor e shkencor, edhe S. Hoxha që angazhuar në diskutimin publik të shumë ojkonimeve të Kosovës, duke u përqendruar në mënyrë të veçantë në ojkoniminë e Dushkajës. Nëse në studimin e parë autori sjell një artikull mbi strukturën kryesisht gjuhësore të ojkonimeve dhe mikrotoponimeve të Krahinës së Dushkajës, në artikullin tjetër të botuar në rubrikën e diskutimeve do të kujdeset që ojkonimet e kësaj krahine t’i trajtojë nga aspekti etimologjik,

---

<sup>26</sup> Skënder R. Hoxha, *Kontributi për studimin e toponimisë së Dushkajës*, I, “Përparimi”, Prishtinë, 1993; *Kontributi për studimin e toponimisë së Dushkajës*, II, “Art poetika”, Pejë, 2000.



duke u ndalur dhe kërkuar etimologjinë e secilit prej tyre veç e veç, për të dhënë më tej edhe propozimet e reja: Bardhaniq-*Bardhan*; Bec-*Bec*; Berdesane, ( propozimi i ri *Kodërthanë* ) ; Cermjan ( propozimi i ri *Dashaj* ) ; Dublibare (propozimi i ri *Kënetishtë*) ; Gërgoc (propozimi i ri *Gurkuq*); Janosh (propozimi i ri *Gjinaj*); *Kodrali*; *Kralan* (propozimi i ri *Kështjellë* ); Llugagji (propozimi i ri *Miraj*), *Maznik*; *Meqe* (propozimi i ri *Gradishtë*); Netic-i (propozimi i ri *Rogë-a*); Palabardh; Radoniq (propozimi i ri *Radaj*); Rakoc (propozimi i ri *Rakaj*); Rakovinë (propozimi i ri *Rakaj*); Rashkoci (propozimi i ri *Qarret*); Ratishë (propozimi i ri *Luginë e Epërme*); Ratishë e Ulët (propozimi i ri *Luginë e Poshtme*); Rezinë (propozimi i ri *Rrezinë*); Sapot-i (propozimi i ri *Skërkë*); Velikobare (propozimi i ri *Ligatinë*); Vraniq-i (propozimi i ri *Vrahishtë*); Vranoc-i; Zhabel-i (propozimi i ri *Zabeli Plak*; Zhdrellë, propozimi i ri *Grykë* ). Bashkautorët Hysni Halilaj e Bedri Muhadri në kumtesën *Toponomastika e Hasit të Gjakovës* kanë sjellë një pasqyrë të toponimisë së zonës së Krahinës së Hasit, i cili nuk është i ndarë vetëm mes administratave të qyteteve të Kosovës, por edhe të Shqipërisë. Pasi bëjnë një paraqitje të pamjes historike të kufijve të tij dhe strukturës gjuhësore të onomastikonit të kësaj krahine, autorët sjellin edhe një pasqyrë të fshatrave të kësaj krahine, sado që shpjegimet e tyre janë të natyrës popullore.

## 10. Toponimia e territorit të Gjakovës

*“Edhe vendbanimet e komunës së Gjakovës, si ato të viseve të tjera shqiptare, veçanërisht të Kosovës, mbajnë emra të periudhave të shumta të së kaluarës historike: të Kohës së Lashtë (antike), të Mesjetës së Hershme, të Mesjetës së Vonshme, dhe të Kohës së Re. Perandoritë dhe shtetet pushtuese kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në toponiminë e këtyre viseve, si Perandoria Romake, Perandoria Bizantine, shtetet sllave të mesjetës, Perandoria Osmane, shtetet e më vonshme sllave, veçanërisht Mbretëria e serbëve, e kroatëve dhe e sllovenëve. Këto perandori dhe shtetet sunduese kanë lënë shtresime emërtime të vendbanimeve”* ( Prof. dr. Latif Mulaku ).

### 10.1. Emërvendet dhe përbërja e tyre

Onomastika përbëhet prej dy grupeve të mëdha emrash:

**a/.** emrat e njerëzve apo emrat vetjakë (**antroponimet**) dhe emrat familjarë përkatës të tyre (**patronimet**) dhe **b/.** emrat e vendeve (**toponimet**), të cilat duke qenë të shumta dhe të ndryshme, mund të grupohen edhe sipas ndarjeve të tjera: **oikonimet** apo emrat e vendeve të banuara (qytete, qyteza, katunde, lagje etj.); si pjesë e tyre mund të shihen edhe **etnonimet** apo emrat e shteteve, kombeve, kombësive, krahinave, nëndarjeve administrative e shoqërore të ndryshme; **hidronimet** apo emrat e ujërave (dete, lumenj, liqene, kënetë, përrenj, hurdhë etj.), **oronimet** apo emrat e maleve, fushave e kodrave etj. Në vazhdimësi të kësaj do të paraqesim një mori emra vendesh të ndryshme në qytetin e Gjakovës që janë mjaft karakteristike për onomastikën shqiptare: P.sh.

## **10.2. Emërtimet e rrugëve në qytetin e Gjakovës:**

**ULICA ( RRUGA ) E BOKSHIT** / Emrin e mori sipas familjeve Bokshi që jetonin dhe ende jetojnë në këtë lagje-patronim familjar. Gjendet në mesin e Çarshisë së Vogël. /

**RRUGA E BAKALLIT** / Bakalli-nga një fjalë e shqipes *bakall-i*, me burim prej turqishtes *bakal* “tregtar mallrash ushqimore dhe artikujsh shtëpiakë”, pra, një patronim prej një emri profesioni: *Bakallbashi*. (“Fjalor i patronimeve të shqiptarëve” të autorit Çlirim Bidollari f. 34.) Lagje e banuar kryesisht me patronimin Bakalli, familje e nderuar dhe e arsimuar si Baba Qazim Bakalli-udhëheqës i Teqes Bektashiane në Gjakovë, dhe ish nxënës i Normales së Beratit. /

**RRUGA E GUTAVE** / Gjendet në Mahallën e Gërçarëve, në veri - perëndim të qytetit kryesisht rrugë e banuar nga familja me patronimin Guta. /

**RRUGA E SHKIJEVE** / Lagje e banuar kryesisht me serbë dhe malazezë të vendosur pas pushtimit serbo-sllav të 6 nëntorit 1912. / Tani rruga e re.

**RRUGA E KAURRIVE** ( Kështu quhej kjo lagje që dikur kanë banuar popullatë kryesisht e besimit katolik, ndërsa sot, popullata jeton nga të dy besimet dhe me marrëdhënie të shkëlqyera bashkëjetese. /

**RRUGA E MAGJUPËVE - MINORITARËVE** / kryesisht rom dhe ashkalinjë. /

**RRUGA E GABELËVE - MINORITARËVE** / Rrugët e këtyre dy minoriteteve janë të ndara /

**RRUGA E TÓÇIT** (Patronim familjar) / ( Br., Vl., El.) nga trajta e shkurtuar e emrit vetjak *Teodor-i*, shkurtim karakteristik vetëm për anët e Beratit, ndërsa për Kavajën ky *shkurtim* është specifik prej emrit *Mihal*, pos trajtave të tjera të shkurtuara si *Miho, Miha, Misha* etj., *i vetmi patronim në Gjakovë*. (“Fjalor i patronimeve të shqiptarëve” të autorit Çlirim Bidollari f. 322).

**FUSHA E SAHATIT** / ( v. ) Lagje me elitë familjesh. Eshtë quajtur kështu sepse në mes të kësaj lagjeje e cila gjendet në mes të qytetit dhe zhvillimit të hovshëm iu imponua nevoja për vendosjen e një rregulli që do të përcaktonte kohën e punës, u ndërtua Sahat Kulla në të ashtu quajturën Fusha e Sahatit. /

**FUSHAT E BAJRAM PASHËS** ( Përfshinte një territor mjaft të gjerë që nga stacioni i autobusëve, nga qendra e qytetit e deri te Rruga e shkijeve po ashtu në këtë fushë ishte edhe Lama e Drithit, kur pas korrijes së grurit bëhej shirja ( ndarja e grurit nga kallinjtë me anë të kuajve dhe gomarëve.)

**RRUGA E DIBRANËVE** / (vl.) Lagje që gjendet në qendër të qytetit e ndërtuar në shek. XIX me arkitekturë orientale nga mjeshtërit dibranë rreth vitit 1830 që paraqiste një arritje kulmore të shtëpive qytetare me qoshk./

**RRUGA E SPITALIT** / ( jp.) Rrugë në Bllokun e Ri që të qon në drejtim të spitalit. /

**RRUGA E MULLINIT** / ( jp.) Rrugë që të qon drejt mullinit, që gjendet në brendi të qytetit.

**RRUGA E DASHIT** / ( jp.) Në këtë rrugë ka banuar Hasan Efendi Dashi personalitet i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit si dhe farefisi i gjerë i familjes Dashi, që banojnë edhe sot në këtë lagje. /

**RRUGA E HAZYRIT RAMADAQELËS** / ( v p.) Kjo rrugë mori këtë patronim familjar nga që HAZYRI I RAMADAQELËS ishte mjeshtër punues i qerreve për kuaj dhe qe kije.

**RRUGA E HAJDARHOXHËVE** / (vl.) Rrugë që banonin një numër familjesh me këtë patronim./

**RRUGA E ÇABRATIT**/ (vp.) **Çabrat-i** Është kodër e lashtë me një lartësi dhe pozitë të mirë gjeografike që lidhet me shumë rrugë të qytetit, ishte dhe është frymëzues për shumë këngëtarë popullorë, poet dhe shkrimtarë, të cilët ia kushtuan një pjesë të veprimtarisë së tyre artistike./

**RRUGA E GAZISË** / (jl.) Gjendet në Lagjen Qerim. Është rrugë gjatë me nën rrugica anësore, ndër ato rrugica është edhe rruga e ashtuquajtur **RRUGA E GAZISË**./

**RRUGA E NEZIRIT-RRUGA E DËRVARËVE** / (jl.) Është e banuar nga disa familje me patronimin Neziri (Kukës, Gjakovë, me burim oriental turqisht *Nezir* < arabisht *Nadir*“ predikues; prurësi i ngadhënjimit; mbkqyrësi i pasurisë jetimëve; në Turqi edhe ministër”.~ *Neziraj* Kukës, Tiranë, Shkodër, Kosovë, Berat~*Nezirja Vlorë, Elbasan, Gjirokastrë, Durrës~ Neza~Nezaj*. (Sipas: “Fjalor i patronimeve të shqiptarëve” të autorit Çlirim Bidollari f. 268 )./

**RRUGA E POLLOSHKËS** / Është e banuar nga disa familje me patronimin Polloshka, familje e vjetër qytetare./

**RRUGA E DANQELIT**/ Rrugë e banuar me patronimin familjar Danqeli./

**RRUGA E EFENIVE**/ Kjo rrugë mban këtë patronim familjar ngaqë ka qenë dhe vazhdon të jetë e banuar me familje të zgjedhura që për atë kohë, por edhe sot janë familje të nderuara. Efendi-u, titull nderimi për njerëzit që dinin shkrim e këndim, por jo për shtresën e lartë, por për t’i dalluar prej popullit të thjeshtë-analfabetët. Në shqipe ka hyrë nëpërmjet **turqishtes - Efendia - Efendija** (Shkodër), ndërsa në Gjakovë, *Efenia*, sepse grupi bashkëtingëllor - **nd**, del i paraqitur me hundoren - **n Efenija**. (Sipas: “Fjalor i patronimeve të shqiptarëve” të autorit Çlirim Bidollari f.107 )./

**RRUGA E STAVILECIT** / Emri i kësaj lagjeje i mbeti sipas familjes Stavileci që ishte aty e para./

**RRUGA E FERIZIT** / Kjo lagje e mori këtë emër sipas familjes shumë të hershme këtu, që mbajnë patronimin FERIZI. *Ferizi* (Gjakovë, Elbasan, Tiranë, Durrës, Dibër,) nga një emër vetjak oriental *Feriz-i* prej turqishtes *Fērūz* e ky prej arabishtes me kuptimin “me fat, fatbardhë”, pra, një patronim prej një antroponimi për të shenjuar filiacionin, birërinë. ~ *Ferizolli* (Tiranë) ~ *Ferizoviku* (Durrës). Sipas: “Fjalor i patronimeve të shqiptarëve” të autorit Çlirim Bidollari f.117 ) ./

**RRUGA E BAKISË**/ Emrin e mori sipas familjes BAKIA ku banonin në një rrugë shumë familje me patronimin BAKIA ( Baki-mb. nga tq. *baki*); *i pavdekshëm, emër njeriu*. (Sipas “Fjalor Këshillimor” për pastërtinë e gjuhës shqipe f.43 të autorit Shkëlqim Llanaj /.

**RRUGA E PALLASKËS** / Lagje jo e madhe e banuar nga disa familje me patronimin **Palláska** (Gjakovë) nga një fjalë e shqipes *pallask/ë-a*, me burim prej turqishtes *palaská* me kuptimin e “rripit të fishekëve, fishekores”, por edhe “spaleta gradash” e madje në shqipen edhe me kuptime të tjera ... (Sipas: “Fjalor i patronimeve të shqiptarëve” të autorit Çlirim Bidollari f. 276 ) ./

**RRUGA E ZHAVELIT** / ( jp.) Familje e madhe shumë anëtarëshe që banojnë edhe sot, e mbajnë me nderë këtë patronim dhe dallohen për sjellje të gjitha gjeneratat. Të parët e familjes Zhaveli janë marrë me punimin e qelesheve, (plisave) - qeleshepunues./

**RRUGA E MALOKIT**/ (jl.) Patronimi *Maloku* haset në vitin 1376 (Lazarus *Malliocus*). Të gjitha variantet e këtij patronimi bashkohen në identifikimin e dikujt si banor malësie me ngjyresa emocionale negative./ (“Fjalor i patronimeve të shqiptarëve” të autorit Çlirim Bidollari f. 237). /

**RRUGA E ROGOVAVE** / Është patronim i familjes ROGOVA që mbanë emrin kjo rrugë që shumica e banuesve janë me këtë patronim~ *Gryka e Rugovës* - Pejë.

**RRUGA E GOLËS** / Nga se shumica në këtë rrugë janë të së njëjtës farefisni me patronimin GOLA. **Gola-j** fshat i zonës kufitare Kosovë - Shqipëri, që të parët e kësaj familjeje e kanë prejardhjen nga ky fshat./

**ÇARSHIA E MADHE**/ Kompleks dyqanesh të ndërtuara në stilin oriental më 1594/1595, në Gjakovë, ndër komplekset më të mëdha në Ballkan që ushtroheshin kryesisht një numër i shumtë i zejeve e cila çarshi, përmbante 1100 dyqane - qendër e zejtarisë. /

**ÇARSHIA E VOGËL** / Qendra e qytetit të atëhershëm me laramani dyqanesh për punimin e zejeve të ndryshme - qendër e zejtarisë dhe e tregëtisë. /

**GJYLI I ÇARSHISË** / Mesi i qarshisë ( gjyli - trekëndëshi ) që ka lidhur të gjitha rrugët e qytetit me njëra tjetrën, /

**RRUGA E XHAMISË** / Rrugë në të cilën ka qenë dhe ekziston xhamia, natyrisht, duke cekur edhe emrin e xhamisë, orientim për të gjetur më me lehtësi personin apo familjen e kërkuar. /

**RRUGA E KUTIXHIVE** / Gjendet në një pjesë të Çarshisë së Madhe. Kjo rrugë quhej kështu sepse ka pasur vetëm zejtarë që kanë punuar kutia-arka për nuse për të palosur pajën, / si dhe një mori toponimesh të tjera që gjithsesi Gjakovën e sjellin si një vend mjaft të pasur nga struktura morfologjike dhe fjalëformuese e toponimisë së Kosovës.

### **10.3. Emërtimi i lagjeve të Gjakovës:**

- RRUGA E BICURRËVE / Patronim familjar /
- RRUGA E PULSËVE ( Banues të familjes *Pula*- patronim familjar)
- RRUGA E HALILABAZËVE / Patronim familjar /
- RRUGA E KUMNOVËS / Patronim familjar /
- RRUGA E BERDONIQIT / Patronim familjar /
- RRUGA E RREMËS TAHIRLILËS / Patronim familjar /
- RRUGA E SHASIVARIT / Patronim familjar /

**RRUGA E NALLBANIT**/ **Nallbábani** (Gjakovë, Berat, Tiranë, Durrës, Vlorë, Kukës Shkodër) nga një fjalë e shqipes *nallban-i*, me burim prej turqishtes *nalbant* dhe me kuptimin

e njohur të “atij që mbath kuajt, që u vë atyre potkonj, mbathtar” (Sipas “Fjalor i patronimeve të shqiptarëve” të autorit Çlirim Bidollari f. 263).

**RRUGA E XHUXHAVE** / (Patronimi cili vjen nga familjet trupvegjël të quajtur me nofkën xhuxha). /

**RRUGA E ABRASHIT** / ABRASH, ~i, ~ët; emër (nga turqishtja *Abras* abrash; *laradash-i*, latinisht *pelicanus*, greqisht *pelekan*, në shqip ka hyrë *pelican*, *laraman*, *qimebardhë-i*, njeri me qime të verdha dhe të bardha, *pikalosh*. (Sipas “Fjalor Këshillimor” për pastërtinë e gjuhës shqipe f. 14 të autorit Shkëlqim Llanaj . /

**RRUGA MIDIS DY EKMEQIHONEVE** / ( Rrugë mes dy furrave të bukës ~*ekmeçi*, nga turqishtja bukëpjekës). /

**RRUGA E PAZARIT** / **Pazar**, ~ i, ~et; emër nga turqishtja, treg, blejtore, vend, shitblerje, marrëveshje, marrëveshje e fshehtë, nëndhes ( Sipas “Fjalor Këshillimor” për pastërtinë e gjuhës shqipe f. 329 të autorit Shkëlqim Llanaj )./ Ndërsa sipas Bidollarit: **Pazári** nga një fjalë e shqipes *pazar - i* me burim prej turqishtes *pazâr* < persisht *bazar* dhe me kuptimin e njohur të “tregut”. Motivimi i patronimit mund të jetë i lidhur sa me kuptimin e vendit ku bëhet pazar, ku shitet e blihet, po aq edhe me çmimin e mallit që shitet e blihet (bëj pazar, jap pazar ). Sipas “Fjalor i patronimeve të shqiptarëve” të autorit Çlirim Bidollari f. 279). /

**RRUGA E KUMONIT** / Patronim familjar /

**RRUGA E ZANATLIVE** / **Zanat**, ~ i, ~ et emër nga turqishtja, zeje, zejtar, rruga e zejtarëve, shoqata e zejtarëve. /

**RUGA E SARAÇVE** / **Saráci**, nga një emër zeje, zanati profesioni *saraç-i* me burim prej turqishtes *saraç* < arabisht *sarraxh* “lëkurëpunues”, për të identifikuar dikë, ndonjë paraardhës i të cilit ka ushtruar këtë profesion. I renditur në vendin e nëntëdhjet e tretë për nga denduria e përdorimit. (Sipas “Fjalor i patronimeve të shqiptarëve” të autorit Çlirim Bidollari f. 301)./

**RRUGA E ADEM NUSHIT** / Patronim familjar /

**RRUGA E SHEHLITES** / Patronim familjar - emër i një sherbyesi fetar /

**RRUGA E DOMSIVE** / Patronim familjar /

**RRUGA E HALILASMONIT** / Patronim familjar /

**RRUGA E DAN LLESHIT** / **Lléshi** ( Gjakovë, Dibër, Tiranë, Elbasan, Durrës, Shkodër.) nga një trajtë e shkurtuar e emrit *Aleksandër* < *Aleks* me burim të panjohur paragrek ( është emri i dytë i heroit të “Iliadës”, princit Parid), por që mund shpjegohet përmes greqishtes *alekso* “mbroj” dhe *andros* trajta e gjinore e *aner* “njeri, burrë”. Përdorimi i këtij emri ndër shqiptarët nuk mund të mos jetë i ndikuar nga emri i Aleksandrit të Madh të Maqedonisë, që në shqipe është përvetësuar deri në trajtën *Lekë* e pas themelimit të shtetit shqiptar u bë edhe emër i monedhës, i parasë së shtetit shqiptar. ~ *Lleshaj* ( Tiranë, Shkodër) ~ *Lleshdri* (Shkodër) ~ *Lleshanaku* (Elbasan). Dy variantet e fundit janë rrjedhoja të emrit vetjak Aleksandër i pari dhe i toponimit *Lleshan* emër vendbanimi në Elbasan i dyti, duke identifikuar një familje që ka banuar në atë fshat dhe është mbartur diku tjetër. I dëshmuar si emër personal në vitin 1330 ( *Les Tuz* ).

**RRUGA E MAGARIT** ( Magarit) / Patronim familjar / F.P.Sh.Ç. Bidollari f.235.

**RRUGA E KUSARIT** / Patronim familjar /

**RRUGA E SHABAQUKËS** / Patronim familjar /

**RRUGA E HONAVE** / Patronim familjar Hona /

**RRUGA E KAZAZIT** / **KAZAZ, ~i, ~ët** , emër nga turqishtja *kazaz*; *përpunues mëndafshi, mëndafshpunues, emër njeriu*. (Sipas “Fjalor Këshillimor” për pastërtinë e gjuhës shqipe f. 214 të autorit Shkëlqim Llanaj). /

**RRUGA E BAN ZHUBIT** / Patronim familjar /

**RRUGA E MYEZINIT** / Patronim familjar **Myezíni**, (Gjakovë, Berat, Durrës, Tiranë, Vlorë, Elbasan), nga një fjalë e shqipes me burim prej turqishtes: *muezzin*- titull i ulët i hierarkisë së klerit mysliman, hoxhë i dorës së tretë, ndihmës i imamit, që lajmëron e fton për faljet e ditës nga minarja e xhamisë, duke recituar me zë të lartë lavde për Allahun e Profetin. Pra një patronim nga një titull a ofiq i hierarkisë fetare myslimane, me fjalë të tjera



nga një mbiemër profesioni. ~ *Mezinaj* ( Berat ). I renditur në vendin e dyzetetretë për nga denduria e përdorimit. (Sipas“Fjalor i patronimeve të shqiptarëve” të autorit Çlirim Bidollari f. 248)./

**RRUGA E VULSIVE - VULA**/ Patronim familjar /

**RRUGA E XHARRËS** / Patronim familjar /

**RUGA E DOLSIVE - DOLI** / Patronim familjar /

**RRUGA E DËRVARIT** / Patronim familjar /

**RRUGA E DERVISHDANËS** / Patronim familjar /

**RRUGA E GODENSIVE - GODENI** / Patronim familjar /

**RRUGA E SMOLICËS** / Patronim familjar /

**RRUGA E BINXHISË** / **Binxhú** nga një fjalë e shqipes, e dalë jashtë përdorimit

*Binxhí-u-ja* me burim prej turqishtes *binçi* me kuptimin e një “njeriu që di ti hipë e të qëndrojë mirë mbi kalë, kalorës profesionist”. ~ *Binxhiu* ( Tiranë, Elbasan. )~ *Binxho* (Berat) dhe të jetë kështu një emër familjeje, që identifikon një pararendës të asaj me këtë aftësi. (Sipas“Fjalor i patronimeve të shqiptarëve” të autorit Çlirim Bidollari f. 47 ) ./

**RRUGA E DEMLUSH HALITIT** / Patronim familjar /

**RRUGA E PAZHARIT** / Patronim familjar /

**RRUGA E TAHIRIT SALI HEJNIT** / Patronim familjar /

**RRUGA E SANESË** / Patronim familjar /

**RRUGA E DURAKIT** / Patronim familjar /

**RRUGA E GOJANSIVE** / Patronim familjar /

**RRUGA E FËRDULLIT** / Patronim familjar /

**RRUGA E SPAHIVE** / Patronim familjar **Spahíu** (Gjakovë, Berat, Vlorë, Gjirokaster, Dibër, Kukës.) nga një ofiq në hierarkinë ushtarake të Perandorisë Osmane *spahi-u* “ kalorës që merrte si shpërblim për merita ushtarake në shërbim të Portës së Lartë me një numër të caktuar ushtarësh”. (Sipas “Fjalor i patronimeve të shqiptarëve” të autorit Çlirim Bidollari f. 304)./

**RRUGA E HAXHISHABANIT** / Patronim familjar /

**RRUGA E STAVILECIT** / Patronim familjar /

**RUGA E VOKSHIT** / Patronim familjar /

**RRUGA E TAFARSHIKUT** / Patronim familjar /

**RRUGA E BËRDONIQIT** / Patronim familjar /

**RRUGA E ZHUBSIVE** / Patronim familjar /

**RRUGA E QARKAXHISË** / Patronim familjar /

**RRUGA E OLLONIT** / Patronim familjar /

**RRUGA E KATONAVE** / Patronim familjar /

**RRUGA E BUNJAKSIVE** / Patronim familjar /

**RRUGA E MUHAXHIRËVE** /**Muhaxhíri** (Kosovë-Gjakovë, Tiranë, Berat, Durrës) nga një fjalë e shqipes *muhaxhir-i*, me burim prej turqishtes *muhacir* nga *hixhra* “ dyndje” e aty prej arabishtes me kuptimin e njohur të “ atij që lë vendin e vet, emigrant ardhacak”, pra, një patronim që identifikon dikë që është shpërngulur nga vendbanimi i vet~*Muhaxhir* (Kosovë, Durrës) ~ *Muhaxheri* (Pejë) ~ *Muhaxhiri* (Gjakovë - Kosovë).

**RRUGA E LEJÇIT**/ Patronim familjar/

**RRUGA E NALLONEGJIVE** / rrugë e zejtarëve në punimin papuçeve të punuara nga druri./

**RRUGA PARKU I LIRISË** / Emër ky që iu vu me rastin e vrasjes së dy të rinjëve gjakovarë nga forcat serbe në janar-shkurt të vitit 1990 që protestonin kundër gjenocidit serbomadh. /

**MAHALLA E QYLIT**

**MAHALLA E QERIMIT**

**MAHALLA E HADUMIT**

**MAHALLA E MULLAISUFIT**

**MAHALLA E HONKËS**

**MAHALLA E GECËS**

**MAHALLA E GERÇARËVE**

**MAHALLA E KUSARËVE**

**MAHALLA E SEFËS 1** ( Banuesit e kësaj lagjeje janë minoritarë-magjup)

**MAHALLA E SEFËS 2** (Banuesit e kësaj lagjeje janë minoritarë-rom dhe ashkali)

**MAHALLA E HAXHIYMERIT**

**MAHALLA E RE** (Rruga e shkijeve, para luftës 1999 ).

**MAHALLA E SOFES - SOFISË**

**MAHALLA CULLAK** ( Quhej kështu ky toponim ngaqë ishte lagje e re dhe pa mure ( pa rrethojë ) të oborreve, e kanë konsideruar si një njeri të zveshur, (nudo).

**MAHALLA E KOLONISË SË DUHONIT** ( Kryesisht e banuar me minoritarë- me rom dhe ashkali *Kolonia e duhonit* e shprehur me togfjalësh, ku në të kaluarën në këtë vend bëhej dorëzimi i duhanit të vjelur).

**MAHALLA E CUBAVE / Cúbi** ( Gjakovë, Shkodër ) nga një fjalë e shqipës veriore  *cub-i*, që veç kuptimit “hajdut, kusar” do të thot edhe “trim”, sepse në Lurë e ndonjë vend tjetër si Labëria cubnia mbahej si gjest trimërie. Prej këtyre kuptimeve ka dalë edhe patronimi. I

dëshmuar që në vitin 1471 (Lecha Xubi), (Sipas “Fjalor i patronimeve të shqiptarëve” të autorit Çlirim Bidollari f. 64)./

#### **10.4. Emërtimi i mullinjve të Gjakovës:**

**MULLINI I MACULAVE** / Patronim familjar /

**MULLINI I SYLPEJËS**, / Patronim familjar /

**MULLINI I ZAJMIT**, /Patronim familjar **Zájmi** (Gjakovë, Tiranë, Berat,) nga një ofiq *zaim-i / zájmi-i* në Perandorinë Osmane prej turqishtes *záim* “Zot i një ziameti, (lloj prone) zot timaresh të mëdha (gjithashtu lloj prone), bej, kreu i timarlijve”, por edhe emër vetjak *Zaim*. Interesante paraqitet shtrirja e trajtës **Zájmi** edhe në Jug të Vendit. ~ *Zaimi* ( Kosovë-Gjakovë, Elbasan, Berat, Gjirokaster, Tiranë, Vlorë, Durrës~*Zaimaj*(Berat) ~*Zaimasi* (Berat) ~*Zaimas* (Kosovë). I renditur në vendin e gjashtëdhjetetë për nga denduria e përdorimi. (Sipas “Fjalor i patronimeve të shqiptarëve” të autorit Çlirim Bidollari f. 348)./

**MULLINI I HAXHISË** , / Në jp. Në dalje të Gjakovës në drejtim të Prizrenit. /

**MULLINJTË E SHLLAKUT**, / Te Ura e Taliçit, dy mullinj të njëpasnjëshëm. /

**MULLINI I POLLOSHKËS**, / Në anën jp.pas Spitalit “Isa Grezda”. /

**MULLINI I BEGDUSHIT**, / Te Xhamia e Kuqe, pa minare në ish rrugën “Shefki Shasivari” dhe në rrugën e tanishme “Përmet Vula”. /

**MULLINI I EFENIVE + URA E AHMET EFENISË**, / Afër Jahocit, fshat në periferi të Gjakovës. /

**MULLINI I PULËSVE**, / Në Skivjan . /

**MULLINI I GUTËS**, / Në Cërpanjë, vendbanim në dalje të Gjakovës në drejtim të Pejës./

**MULLINI I NIMON JAHËS**, / Në Jahoc. /

**MULLINI I ALI VULËS**, / Skaj fshatit Jahoc. /

**MULLINI I ZEKËS**, / Pronari i së cilës ishte Halim Zeka - Halimaga. /

**MULLINI I SHEJH LITËS**, / Te *Zidi i Sadikagës* (toponim) në dalje të Gjakovës në drejtim të Prizrenit e banuar kryesisht me popullatë të besimit katolik. /

**MULLINI I KOSHIT**, / Koshi - Patronim familjar në qytetin e Gjakovës. /Gjithë mbiemrat, pronarët e mullinjve, kanë qenë dhe janë patronime familjare të qytetit të Gjakovës. /

## **10.5. Emërtimi e lugjeve të Gjakovës:**

**LUGI I DRAGOIT**

**LUGI I EMIN UFLLËS** / Patronim familjar /

**LUGI I SOFISË**

**LUGI I ÇILIT**, / Te ish Podrumii verës në pjesën verilindore të Gjakovës. /

**LUGI I BUNARIT**, / Fshat përtej fshatit Qerim, në dalje të Gjakovës në drejtim të Prishtinës. /

**LUGI I GERËS**, / Përballë Urës së Telit./

**LUGI I DASHIT**, / Dashi-patronim familjar nga Gjakova./

**TABJA E MADHE DHE TABJA E VOGËL**, / Poligone ushtarake në kohën të pushtimit turk në fillim të rrafshnaltës së Çabratit me largësi afër 200 m./

**RRIPË**, / Rrugë në drejtim të fshatit Jahoc, që fillon nga fillimi i Rrugës së Çabratit, por që ndahet në të majtë në drejtim të fshatit Jahoc./

## **10.6. Emërtimi i kodrave:**

**BREGU I PERJUCIT** / Patronim familjar /

**BREGU I SARAJIT**

**BREGU I SHLLAKUT** / Patronim familjar /

**BREGU I BRAHËS** / Patronim familjar /

**BREGU I RRIPËS**

**SHPATI GUTAVE** / Patronim familjar /

**BREGU I PËRRONIT** ( lum- rrjedhë uji)

**10.7. Emërtimi i urave:**

**URA E TËRZIVE** / Shekulli XVIII rreth vitit 1730./ , Gjendet në kilometrin e 7-të të rrugës Gjakovë-Prizren.Tërzinjtë (rrobaqepësit) dhe tabakët (lëkurëpunuesit) bënë ndërtimin e kësaj ure mbi lumin Erenik që lidhte Gjakovën me Prizrenin për intensifikimin e lidhjeve tregtare. Kjo urë është e gjatë 192.8 m.dhe gjerë 5.1 m. dhe ka njëmbëdhjetë harqe, ndërtimi i së cilës zgjati afër 10 vjet./<sup>27</sup>

**URA E TABAKËVE** / Tabaku / Patronim familjar / Shekulli XVII rreth vitit 1790 që lidhte Gjakovën dhe Shkodrën. Kjo urë u ndërtua nga esnafët e Gjakovës edhe kjo mbi lumin Erenik, ndërtimi i së cilës zgjati 5 vjet. Është e gjatë 127 m.dhe me gjerësi 4.03m. Kjo urë ka 14 qemere (harqe) me dritare shkarkuese./<sup>28</sup>

**URA E RABAXHIVE** / Tregëtarët e Gjakovës e ndërtuan edhe këtë urë mbi lumin Mirushë për të lidhur Gjakovën me Vushtrinë dhe vendet tjera.U ndërtua në të njëjtën kohë me ndërtimin e Xhamisë së Kusarëve më 1770./

**URA E FSHAJT** / Gjendet 10 km. në lindje të Gjakovës. Është urë guri njëharkor gjysmërrethor mbi lumin e Drinit të Bardhë në nëntë kilometrëshin e parë Gjakovë - Prizren.

---

<sup>27</sup> *Toponimia e Gjakovës me rrethinë, tryezë shkencore e mbajtur më 4. V. 2001, Çështje onomastike e anës së Gjakovës, f. 66.*

<sup>28</sup> *Toponimia e Gjakovës me rrethinë, tryezë shkencore e mbajtur më 4.V.2001, Çështje onomastike e anës së Gjakovës, f.66.*

U shkatërrua tërësisht gjatë Luftës së Parë Botërore. Më 1942, u ndërtua nga SIMONSENI i Italisë. Është e gjatë 37 m., e gjerë 7 m. dhe me një lartësi 18.50 m<sup>29</sup>./

**URA E AHMET EFENISË** (Efendia-Patronim familjar). Kjo urë gjendet në veriperëndim të Gjakovës, në drejtim të pikës kufitare Qafë Morinë./

**URA E LLUKACIT** / Duket se ka prejardhje nga emra bimësh. Fjalën *llukë* “bli”e kanë Fj.e gju.Shq., që mund të jetë bazë etimologjike e toponimit *Llukacet*, këtu në trajtë të shumësit. Ka mundësi që në këtë emërtim të jetë ngurosur trajta sll. *luk* “qepë” ( *Allium cepa*); me zgjerim në trajtën tjetër *llukac*, me të njëjtin kuptim; apo *luka* “liman, port, sklele”, nga do parë edhe prejardhjen e lumit Llukac të Gjakovës, toponimeve Llukë, Llukarë, patronimit që mbajnë serbët Llukiq etj./

**URA E NAKARADES + FUSHAT E NAKARADES** - Nakarade - patronim familjar me prejardhje sllave që nga pushtimi serbosllav i vitit 1912.

**URA E TELIT**

**URA E TALIÇIT**

**URA E ZAJMIT** / Patronim familjar **Zájmi** (Gjakovë, Tiranë, Berat,) nga një ofiq *zaim-i* / *zájm-i* në Perandorinë Osmane prej turqishtes *záim* “Zot i një ziameti, (lloj prone) zot timarësh të mëdha (gjithashtu lloj prone), bej, kreu i timarlijve”, por edhe emër vetjak *Zaim*. Interesante paraqitet shtrirja e trajtës *Zájmi* edhe në Jug të Vendit. ~*Zaimi* (Kosovë, Gjakovë, Elbasan, Berat, Gjirokastrë, Tiranë, Vlorë, Durrës)~ *Zaimaj* (Berat)~ *Zaimasi* ( Berat ) ~ *Zaimas* ( Kosovë ). I renditur në vendin e gjashtëdhjetetë për nga denduria e përdorimit. (Sipas “ Fjalor i patronimeve të shqiptarëve ” të autorit Çlirim Bidollari f. 348)./

## **10 .8. Emërtimi i krojeve brenda qytetit të Gjakovës:**

---

<sup>29</sup> *Toponimia e Gjakovës me rrethinë, tryezë shkencore e mbajtur më 4.V.2001, Çështje onomastike e anës së Gjakovës, f.66.*

## **KRONI I RXHEPAGËS**

**KRONI QERIMIT** / Kroni gatë /

**KRONI RUZHDIJE**/ Përballë Shkollës Mejtepi Ruzhdije./

**KRONI I HASIT** / Patronim familjar /

**KRONI I BEGIT** / Patronim familjar /

**KRONI I PANXHALLËS** / *Panxh*-në gjuhën rome do të thotë *pesë* ( 5 ), pra kroni i pesë rrugëve, rrugë të cilat janë të lidhura dhe të gjitha të qojnë në drejtim të kronit në fjalë. /

**KRONI XHAMISË SË HONKËS** / Krua që gjendej pranë xhamisë pa minare./

**KRONI I XHAMISË SË HADUMIT** / Krua që gjendet në territorin e Xhamisë së Hadumit dhe ka sherbyer mjaft mirë jo vetëm për besimtarët muslimanë që kryenin ritualet fetare, por edhe për popullatën dhe zejtarët e Qarshisë së Madhe./

**KRONI I XHAMISË SË FETAHAGËS** /

**KRONI I MAHALLËS SË MULLAISUFIT** / Krua që gjendet në territorin e Xhamisë së Mullaisufit, mu në qendër të kësaj lagjeje që ka sherbyer mjaft mirë jo vetëm për besimtarët muslimanë që kryenin ritualet fetare, por edhe për popullatën zejtarët e fillimit të Qarshisë së Madhe dhe frekuentimit mjaft të madh për tri ditët e pazarit që bëheshin gjatë javës për shkak të kryqëzimit të rrugës së rëndësishme transferzale Shkodër-Kosovë, ose të Zetës (Via di Zenta) me atë longitudale të Rrafshit të Dukagjinit në drejtim Prizren-Pejë. /

**KRONI I SHKAUT** (Ky toponim e ka prejardhjen gjatë kohës së okupimit serbo-malazez. Ka qenë në anën verilindore, në hyrje të Gjakovës ku janë sherbyer me ujë të pijes të gjithë ata që kanë punuar tokat e punës në këtë territor.

## **10.9. Emërtimi i livadheve:**



**LIVADHI I LEJÇIT** / ( jp. ), Fushë e gjerë pronarë i së cilës ishte familja me patronimin

**LAJÇI**, familje shumë antarëshe/.

**LIVADHI I RASHËS**

**LIVADHI DHE LISAT E DYLES**

**LIVADHI ,TOKA E NELREGJEPËVE** / Patronim familjar /

**LIVADHI I DEMLUSHHALITËVE** / Patronim familjar /

**LIVADHI I HALIM BINAKIT**

**LIVADHI I SHYTIT KUPA DYLËS** / Patronim familjar /

**LIVADHI I MAZES** / Patronim i gjinisë femërore /

**LIVADHI I TOÇIT** / Patronim familjar /

**LIVADHI I REXHAVE** / Patronim familjar /

**LIVADHI I GODENIT**/ Patronim familjar /

**LIVADHI I TAPHONEVE**

#### **10.10. Emra vendesh sipas natyrës së punës dhe veprimtarive të kryera aty:**

**LOMA E DRUVE** / Vend ku shiteshin drutë - lëndë djegëse

**LOMA E LESHIT** / Vend ku shitej leshi, produkt i deleve./

**LOMA E DRITHIT** / Vend ku shiteshin drithërat /

**LOMA E THIVE** / Vend i vaçantë ku shiteshin vetëm derrat /

**PAZARI I GJOVE** / Vend ku shiteshin bagëtia dhe kafshë të trasha/

**PAZARI I GRAVE** / Vend ku shiteshin veshëmbathje dhe artikuj të jerë vetëm për gjininë femërore./

## 10.11. Vjelje dhe prurje onomastike të tjera në terren:

**GJIRI I LLOÇIT** / Është quajtur kështu nga se qytetarët laheshin dhe për rreth këtij gjiri kishte edhe baltë dhe mori mikrotoponimin nga vetë qytetarët *Gjiri i Lloçit*, që shërbente edhe si orientim për ta gjetur më lehtë vendin ku laheshin. /

**GJIRI I BERKIT** / Identifikimin e këtij gjiri e bënë nga X personi që kishte barkun e madh dhe i mbeti *Gjiri Berkit*./

**GJIRI I SADETIT** / Në vitet e 50-ta, gjinia femërore nuk shkonte për të kaluar ditët e nxehta të verës rreth brigjeve të Erenikut nga që fanatizmi ishte i paparë nga analfabetizmi i kohës. Por, në mesin e popullates ishte një femër me emrin Sadet që shkonte të lahej në këto brigje që për atë kohë ishte shumë e çuditshme dhe i mbeti *Gjiri Sadetit*./

**GJIRI I SHALËS** /Në këtë gjiri laheshin kryesisht familjarët me këtë patronim./

**GJIRI I BUNARIT** / Në këtë gjiri ndodhej edhe një bunar ku pushuesit kolonin ditët e verës ku i mbeti edhe emri *Gjiri i Bunarit*./

**GJIRI I OMLLADINES** / *Omlladina*-nga sebokrotishtja-*rinia*, që kryesisht lahej vetëm rinia, të folme nga ndikimi serbosllav./

**GJIRI I MELLES** / *Mellë* - f. krahinore. Lloj i një dheu të bardhë që përdorej për të bërë enë./

**GJIRI I THIKES**/ Nga forma e bregut të mpreftë në formën e thikës./

**GJIRI I HOXHVE** / Ngaqë kanë rasisë edhe disa hoxhë të lahen rreth një bregu ku kalonte lumi Erenik, gjë që ishte e çuditshme për atë kohë dhe i mbeti ky mikrotoponim *Gjiri i Hoxhve*./

**GJIRI I SHKAUT** / Në Gjokovë përherë numri i banuesve serbë ka qenë në një masë prej 2-3% dhe në atë gjiri janë larë vetëm komuniteti serb/shkijet/ dhe quhej *Gjiri i Shkijeve*./

**GJIRI I JAHOCIT** / Emri fshatit Jahoc - *Gjiri i Jahocit.*

**GJIRI I STUDENTIT** / Pas viteve të 50-ta ku filloj të zvogëlohej shkalla e analfabetizmit dhe filluan studimet e rinisë gjakovare, për t'u treguar më të vaçantë këta laheshin në një gji tjetër dhe i mbeti *Gjiri i Studentit.*

**GJIRI I ZIDIT** / (vl.) Ishte periferi e qytetit të Gjakovës që quhet *Zidi i Sadikagës* i banuar kryesisht me popullatë të besimit katolik. Kalimi i lumit Erenik në këtë zone kishte formuar një pellg uji që dallonte nga pjesët e tjera të *Erenikut* nga thellësia e ujit, peshkut, njalës dhe rërës shumë të mirë për të bërë plazhin, ku popullata i vuri këtë toponim *Gjiri i Zidit.*

**GJIRI I PONTAXHIVE** / Vend ku argëtoheshin pensionistë dhe të tjerë që luanin me letra bixhozi për të kaluar ditën./

**GJIRI I DYLBERT** / Në këtë anë të këtij gjiu të lumit në fjalë kishte peshkë të shumtë me patronimin *dylber* - *ky lloj peshku shumohet shumë dhe nuk gjatësi të madhe shkon deri në 15 cm.* /

**GJIRI I CULLAK** / Kryesisht laheshin fëmijë të moshave të ndryshme që në atë kohë, pas Luftës së Dytë Botërore, nga varfëria e madhe që kishte kapluar popullatën, kostum për plazhin e fëmijëve nuk kishte dhe laheshin pa to *cullak*. – ndajfolje e zhveshi e la cullak./

**GJIRI I ZALLIT** / Që kishte sasi të madhe të rërës (*zallit*)./

**GJIRI I GURIT** / Që kishte gurë të shumtë dhe e mori toponimin *Gjiri i Gurit.*

**GJIRI I SHARANIT** / Vende-vende laheshin anëtarë të një familjeje të tërë-familje me patronimin *SHARANI*, si dhe nga lloji i peshkut me emrin *sharani* - *krapi* që kishte ky gji./

**GJIRI I NAGAVCIT** / kryesisht laheshin anëtarë të familjes me patronimin *Nagavci*, për shkak të intimitetit familjar që kishin në atë kohë./

Të gjitha këto mikrotoponime i takojnë rrjedhës së lumit Erenik që buron nga Liqeni i Akullnajave të Gjeravicës dhe kalon nga ana jugperëndimore në drejtim të asaj juglindore të vendit dhe derdhet në lumin Drini i Bardhë, ku qytetarët e Gjakovës dhe rrethinës së saj, gjatë sezonit veror laheshin rreth këtij lumi ku morën edhe shumë toponime të ndryshme varësisht nga pozitat gjeografike dhe popullatës që laheshin.

Këto që u përmenden, mendoj se nuk janë pa ndonjë vlerë, por për kundrazi janë një pasuri e mirë për onomastikën. Toponimet të tilla kanë pasë sado kodo një rëndësi të mirëfillt nga se popullata ka krijuar orientime të duhura për lëvizje dhe qarkullim brenda qytetit të vet.

## **KREU II**

### **11. Toponimia Dushkajës me disa të dhëna historike**

#### **11.1 Arrnjeti (Rakovina)**

Gjendet në bregun e djathtë të Drinit të Bardhë dhe shtrihet rreth 15 km. në verilindje të Gjakovës. Bën pjesë në tipin e fshatrave me vendbanim të grumbulluar. Ka konfiguracion kodrinor, ku pjesa më e madhe e tokave nuk kanë mundësi të ujiten.

**Lagjet:** Hasanaj, Olluri dhe Sejday dhe dy shtëpi hashkali-Berisha dhe Gashi. Banorët e Rakovinës janë të fiseve: Kelmend ( të ardhur nga Vuthajt ) dhe Thaç të formuar nga lagjet e lartpërmendura.

**11.2 Mikrotoponimet më karakteristike:** *Përroni i Verrave, Podi i Livadheve, Gaja, Sukzat, Birat e Macës, Bira e Hutit, Kafjani, Guri i Shpum, Bari i Ollurit, Skaj Livadheve, Shushica, Shpatiet, Mazniqe etj.*<sup>30</sup>

Mendoj se është me interes të përmendim se në lokalitetin e quajtur **Kafjan** të këtij vendbanimi, në pjesën veriore malore të fshatit, sipas hulumtimeve arkeologjike shkojnë në kohën e bronzit dhe të hekurit dhe i takojnë disa grumbuj tumash të zbuluara në vitin 2001 Poashtu, kur është ndërtuar ura mbi lumin Drini i Bardhë në vitin 1979 janë zbuluar disa skelete njerëzish dhe gurë mulliri.<sup>31</sup> Në dokumentet e shkruara përmendet në krisobulen e Deçanit të vitit 1330, është i shënuar vendbanimi me emrin Rilkovina,<sup>32</sup> ku mendojmë se është fjala për këtë vendbanim. Me emrin Rilkovina është i regjistruar edhe në defterin e Sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485 ku kishte 15 shtëpi, 2 beqarë dhe 1 të ve.<sup>33</sup>

### **11.3. Mikrohidronimet ose emrat e krojeve dhe ujërave:**

*Kroni i Gurit t' Shpum ( në veriperëndim ) / Sipas një guri të shpuar /, Kroni i Sukzave, Kroni i Verrave.*

---

<sup>30</sup> Dr. Jusuf Osmani, *Vendbanimet e Kosovës, Gjakova 14*, Prishtinë, 2005, shënimet(sipas autorit ) janë marrë gjatë vizitës së fshatit më 04.07.2004 nga Sali Hasanaj (1928), f. 186.

<sup>31</sup> Dr. J.Osmani ( sipas autorit ) shënimet janë marrë gjatë vizitës së fshatit më 10. 11. 2001 nga Osman Olluri, administrator i fshatit dhe disa banorë të tjerë f. 86.

<sup>32</sup> Dr.J.Osmani: *Vendbanimet e Kosovës, Gjakova14*, Prishtinë, 2005, f.186, Rad. Ivanović, Dečanska vlastiteljinstva, Istorički Časopis, knj.IV,1952-1953,Beograd, 1954; Selim Daci, *Feudi i Manastirit të Deçanit, Buletini i Fakultetit Filozofik, XXII / 1992*, Prishtinë, 1994, f. 135-146

<sup>33</sup> *Defteri i Regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485*, Tiranë, 1974, nr. 2.

-**Drini i Bardhë** (në lindje), kalon afër territorit të katundit Rakovinë, ana e djathtë e rrjedhës së tij.

**Jazi i Mullinit** ( krahu jugor ), ky jaz ndahet në Dri të Bardhë te Vau i Rakovinës dhe e drejton për ujin në mulli.

**Prroni**, lum i vogël që bie përmes Rakovinës. Buron në pikën e quajtur Qafa e Sukës e derdhet në Dri të Bardhë.

**Prroni i Mazniqeve** ( krahu perëndimor ). Është përrua i vogël, i cili gjatë verës edhe thahet, shteron. Buron në malet e quajtura *Mazniqet*.

**Prroni i Shushic's**, ky përrua buron në male të Gërgocit e derdhet në Dri të Bardhë, në territorin e Rakovinës, në vendin e quajtur “Ku lahet peshku”.

**Prroni i Thatë**, na duket se emri i ka mbetur sipas rrethanës se shpesh thahet e shterohet. Buron në Malet e Trojeve.<sup>34</sup>

#### 11.4. Bec - i

Është njëri ndër katundet më të mëdha të Dushkajës, i cili gjendet pjesërisht në veri (verilindje) të Gjakovës, me një largësi rreth shtatë kilometra. Beci është vendbanim i ndarë në lagje, ku disa janë të tipit të grumbulluar e disa të tipit të shpërndarë. Ky vendbanim përfshin një territor mjaft të gjerë dhe si qendër administrative, arsimore e kulturore ka Gjakovën. Katundi Bec kufizohet me katundet: Sapot-në perëndim, Zhdrellë dhe Rashkoc - në veriperëndim dhe veri, Cërmjan - verilindje, Meqe - lindje, Doblbare e Vraniq - juglindje dhe me Lugun e Bunarit - në jug dhe jugperëndim. Në pikëpamje territoriale ky katund ndahet në dy pjesë: *Beci i Epër* dhe *Beci i Poshtëm*. Më parë ky katund ndahej në katër lagje të vjetra vendore: Biblekët, Ndreajt, Salcët dhe Tetajt, origjinalisht të një vëllazërie: Mertur të fisit Berishë para 300 vjetëve. Popullata shqiptare myslimane e katolike janë të një vëllazërie. Në vendin e quajtur *Livadhet e Mëdha* ka gjurmë të qeramikës, tullave, gypave të botës etj. që dëshmojnë se vendi ishte i banuar mjaft herët. Poashtu edhe në pjesën e epërme të fshatit

---

<sup>34</sup>Prof. S. Hoxha, *Toponimia e Dushkajës*, Shtyp. "Jakova", 2007, f. 264

janë gjetur disa pjesë të qelqit, karakteristikë me përmasa të mëdha. Ekziston *Lisi i Malokut*, shumë i vjetër<sup>35</sup>. Në dokumentet e shkruara përmendet në defterin kadastral të Sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485 me emrin *Beçi*, atëherë mund të themi që shumë katunde në Kosovë dhe me gjerë në trojet shqiptare nuk janë aq të reja siç mendohet e përfillet nga ndonjë studiues. Në lidhje me këtë po shtoj se në një dokument burimor mesjetar, shkruar sllavisht, përmendet një katund në rrethinat e Shkodrës me emrin “Bec”. Në Shkodër dhe rrethina të saj qyshkur ekziston patronimi i disa familjeve shqiptare *Beci* (Bahri *Beci* etj.). Mendoj që këto familje kanë marrë këtë llagap sipas emrit të katundit (Bec), prej të cilit janë shpërngulur ato, gjegjësisht të parët e tyre, dukuri kjo shumë e përhapur ndër shqiptarë. Siç shihet emri *bec-i* është fjalë autoktone e gjuhës shqipe dhe tregon “qengj të vogël”, ( Shih *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 2002), f. 99.

Në fillim po themi se pjesa dërmuese e ojkonimeve të Gjakovës janë me burim nga gjuha shqipe, kurse disa mund të jenë latine-vllahe (arumune) e sllave, dhe këto të futura në popullatën shqiptare të kësaj ane me anë të administratave, e jo pse në këto anë kishte popullatë romake apo sllave para 300 - 400 vjetësh. Edhe toponimet romake e sllave po të studiohen me një akribi të thellë analitike onomastike e gjuhësore, mund të dalin shumë prej tyre kalke, të përkthyer prej gjuhës ilire-shqiptare autoktone, sepse populli iliro-shqiptar është ai që i ruajti në mënyrë stoike në onomastikë shtresëzimet gjuhësore ilire-trakase, romake-latine, greke-bizantine, sllave, osmano-turke etj. Përfundimisht po përmendim toponimin e sotëm *Bec-i* që në defter është regjistruar si *Beçi*, që mendoj se që të dyja trajtat janë të lashta dhe të mirëfillta edhe si *Beç-e* edhe *Bec-i* sepse burojnë prej një rrënje të hershme bar- (më vonë si *ber* > *bers* > *berc* > *bec*, *beç*), që prof. E.Çabej na jep me 8 e më shumë trajta me fjalën bar. Gjithsesi me pejdardhjen e toponimit **Bec** vlenë të përmendim se prof. E. Çabej, duke shkruar për etimologjinë e fjalës *bec*, konstaton: “**bec**“ “**qengj i vogël**”, është demunitiv i berit me anë të sufiksit - *c*.”<sup>36</sup>

Nga kjo dhe shumë prej toponimeve mesjetare të tjera, del se përreth Gjakovës është bërë një studim i mirëfilltë e me përpikëri nga studiuesit tanë mjaft të zellshëm. Në këtë

<sup>35</sup> Dr. J.Osmani, *Vendbanimet e Kosovës, Gjakova 14* f. 101 parg. 1, ( sipas autorit ) shënimet janë marrë gjatë vizitës së fshatit nga Sadri Ademi (1937) dhe Bedri Ibrahim, aktivist, më 01.12.2001.

<sup>36</sup> Shih: *Studime gjuhësore, III*, Prishtinë, 1976, f. 60

drejtim padyshim dha shumçka edhe prof. Selami Pulaha, duke hapur shtigje për një punë të mëtejme shkencore në fushën e onomastikës edhe për studiues të tjerë. Dritëdhedhje në toponiminë e Gjakovës dhe rrethinës së saj po japin një numër i shënueshëm punëtorësh shkencorë si: prof.dr. Ragip Mulaku, prof.dr. Qazim Lleshi, prof.dr. Masar Rizvanolli, prof.dr. Exhlale Dobruna - Salihu, prof.dr. Rexhep, Doçi, dr. Mehmet Halimi etj.

### **11.5. Batusha** ( Rajoni Rekë e Keqe )

Në Krisobulën e Deçanit të vitit 1330, për herë të parë përmendet Batusha, vendbanim mesjetar shqiptar, që shtrihet në rrjedhën e epërme të lumit Ereniku, rrëzë Bjeshkëve të Nemuna 20 km. larg Gjakovës. Batusha është vendbanim i tipit të dendur me sipërfaqe prej 834 ha, 45 ari, 84 ha.

**Lagjet kryesore:** Lagjeja e Xhamisë me këto vëllazëri: Buçezët, Aliçkajt, Gjokajt e Epërm, Kocajt, Ahmetajt dhe Mahmutajt; Lagjeja Hasanaj, të cilën e përbëjnë vëllazëritë: Hoxhaj, Zajmi; Lagjeja Agaj: Agaj, Lutajt dhe Tolaj, si dhe Lagjeja Gjokaj të Poshtëm.

**11.6. Mikrotoponimet më karakteristike:** *Fusha e Kishës, Lluga e Mel Kurtit, Qyteza e Poshtme, Qyteza e Epërme, Arrabregu, Kokorri, Fusha e Mar (k) Bushës, Kalaja e Jerinës, Kalaja e Madhe, Kalaja e Vogël, Shkoza, Shpella e Celisë, Prroni i Celisë, Shpati i Valës, Arza, Livadhi i Boçit, Koteci, Kodra Tabe etj.*<sup>37</sup>

Batusha, pra, është vendbanim i vjetër i fortifikuar parahistorik. Shtresa parahistorike do të duhej të kishte edhe Kalaja mbi Batushë, e quajtur Kalaja e Jerinës, në vendin e quajtur Shkozë, në jugperëndim të fshatit. Afër këtij vendbanimi është edhe Shpella e Celisë, shpellë

---

<sup>37</sup> Dr. J Osmani, *Vendbanimet e Kosovës, Gjakova 14*, Prishtinë, 2005 f. 97-98, (sipas autorit), Shënimet e dërguara me shkrim nga Ibrahim Koci, më 28. 01. 2003.



karakteristike e pagjurmuar. Anitkës së vonë i përkasin Kalaja e Madhe dhe Kalaja e Vogël në Batushë. Kësaj periudhe i takon edhe lokaliteti Gryka e Batushës tek Hereqi<sup>38</sup>. Popullata, sikurse edhe vendbanimet e tjera ishte shqiptare e fesë krishtere të rritit katolik, çka dëshmohet edhe me toponimet Kisha, Fusha e Kishës. Ndërsa më vonë e pranoi fenë muslimane. Nga krisobula e manastirit shihet qartë se me këtë aktdhuratë mbreti serb Stefan Dushani i jepte manastirit të Deçanit si pronë Batushën së bashku me kishën e Shën-Nikollës, që gjendej në këtë fshat. Edhe nga kjo krisobulë shihet qartë se vendbanimet shqiptare në arealin e Dukagjinit me gjithë kishat e tyre të rritit katolik u jepeshin kishave ortodokse sllave për t'i shfrytëzuar ekonomikisht. Shumë studiues e kanë dëshmuar, sidomos Gaspër Gjini, se shumë kisha katolike të Kosovës në mesjetë ishin uzurpuar nga mbretërit serbë, të cilët këto ua falnin kishave ortodokse sllave.<sup>39</sup>

Edhe pse gjatë sundimit serb, pjesa më e madhe e antroponimeve ishte sllavizuar, që nuk është ndonjë risi, sidomos për Kosovën, e preferuara e “Serbisë fqinje”, vetë toponomi na dëshmon se themeluesit e vendbanimit ishin banorët me përkatësi shqiptare. Të dy këto trajta të këtij toponimi, qoftë ajo **Batushë** apo **Botushë** janë me prapashtesën zvogëluese të shqipes **-ushë**, ndonëse në popullsinë e vendit mbizotëron shqiptimi me **-a: Batushë**. Në aspektin historik toponimi në fjalë lidhet me emrin iliro-dardan **Batoni**, antroponim i familjes mbretërore dardane. Ndërsa, forma tjetër **Botushë** paraprakisht me kuptimin “**dhé, tokë**”. Kështu që, asnjëra fjalë nuk gjen kuptim në gjuhët sllave.

Përpëlitjet e disa “shkencëtarëve sllav për ta quajtur këtë emërvend nga demunitivi **Bato** i **Bratislavit** janë të brishta, madje fëminore e më shumë se qesharake. Në toponomastikën shqiptare janë formuar edhe emra të tjerë tipik me prapashtesën-**ushë-a**, si : *Bardhushë* (lagje në Dibër), *Mokrushë* ( kullotë në Librazhd ), *Mirushë* (lumi dhe treva pranë tij në Malishevë), *Mirushë* (fshat afër komunës së Rahovecit), *Pagarushë* (fshat i Rahovecit), *Mamushë* (fshat i rrethit të Prizrenit), *Llaushë* (fshat i komunës së Skenderajt në Drenicë), *Orçushë* (katund i rrethit të Dragashit - tani të Sharrit ), *Kojushë* ( katund i rrethit të Prizrenit në Has).

<sup>38</sup> Rekognoscim i E. Shukriut në vitin 1988; Prof. dr. Edi Shukriu, *Trashëgëmia arkeologjike në kontekst të ndryshimeve të toponimeve. Tribuna-Toponomastika e trevës së Gjakovës*, Gjakovë, 04. 05. 2001.

<sup>39</sup> K. Komunal, *Toponomia e Gjakovës me rrethinë*, Gjakovë, 2002 f. 151.

Në vitin 1485 në defterin e Sanxhakut të Shkodrës regjistrohet me formën që mund të lexohet në dy - tri mënyra: ne e kemi lexuar **Botusha**, ndërsa prof. Selami Pulaha e ka lexuar si **Butosha dhe Botosha**. Mendoj se pa marrë parasysh trajtat e dokumentuara, forma e kryehershme e këtij toponimi do të ketë qenë **Batushë**, sikur vërtetohet nga emërvendet e tjera, **Batushë** ( Prishtinë ) dhe **Batushë** ( Prokupje ) të periudhës mesjetare. Mendoj që të dhënat nga mr. Iljaz Rexha janë më afër një argumentimi. Autorët serbë të veprës “Monumentet serbe në Kosovë”, botuar jomoti, këmbngulin se “Sipas regjistratit turk të vitit 1485 në Batushë kishte 47 shtëpi serbe që na “shoqëronin për mosmërzitje”, në mesin e tyre edhe shtëpia e popit, të birit të **Nenko-s**”. Këto të pavërteta sa qesharake po aq edhe ofenduese, se kishte 47 shtëpi serbe, as që është shënuar në këtë regjistër fjala ”serbe”. Edhe shtëpia e popit, të birit të Nenkos ishte shënuar si kryefamiljar e asesi si pop serb. Edhe emri i tij pop, mendoj se nuk paraqet profesion apo pozitë shoqërore, por paraqet emër vetjak, që ndeshet jorrallë në patroniminë shqiptare (khs.Popaj në Dukagjin).<sup>40</sup> Po të shënonte profesion apo pozitën e priftit, ai do të shënohej si pop Nenko ose Nenko pop, ashtu siç i gjejmë të shënuar në të gjithë regjistrat osmanë. Në këtë regjistër gjejmë të shënuar Nikollën, të birin e popit, që del me funksion patronomik. Në aspektin gjuhësor, mund të pajtohemi se prapashtesa-**ko** mund të jetë me origjinë sllave, por etimoni *Nen* nuk e dimë se mund të ketë ndonjë kuptim në këtë gjuhë. Si rezultat i hulumtimeve të dhëna nga prof. Pulaha vendbanimi në fjalë kishte 35 kryefamiljarë, që ishin të martuar, 10 kryefamiljarë, që ishin të pamartuar dhe 2 të veja. Pra, janë vetëm 35 shtëpi, e jo 47, siç thonë autorët e lartpërmendur ku si duket kemi një “gabim të zakonshëm matematikor”.

Prej 35 kryefamiljarëve, si zot shtëpie, 10 prej tyre mbanin antroponimi simbiotike shqiptare-krishtere dhe shqiptaro-sllave me forma karakteristike: Tomeniko-s (Domeniko), i biri i Ulku-t: i biri-emër i sferës latino-romane, i ati-një emër i vjetër i protoshqipes *Ulk* >*Ujku*; Gjura, i biri i Tomeniko-s (Domeniko-s). Është në lidhje gjaku me Ulkun, por tash Gjura nuk merr patronimin e gjyshit, por e merr atë të të atit; Tomeniko, i biri i Robit: i biri emër latin, i ati emër karakteristik, që është shumë i përhapur në patroniminë shqiptare (khs. Robaj); Nikolla i biri i Dab-s, Leka i vëllai i tij (Dabes); Nenko, i biri i Leka-s; Nikolla, i biri i Lek+aç-it; Gjura, i biri i Dab-es, Dimitri i vëllai i tij; Radosavi, i biri i Dab-es. Nëse

<sup>40</sup> K.Komunal, *Toponimia e Gjakovës me rrethinë*, Gjakovë, 2002, f. 152.

i analizojmë antoponimet e këtyre shtatë kryefamiljarëve, ata janë në lidhje gjaku apo farefisnie të ngushtë mes veti dhe me format e tyre të shqipes tregojnë se në pikëpamje etnike qenë jo sllavë, po shqiptarë. Patronimi *Dabë* konsiderohet si emër sllav, por me formë shqipe, që i lidh këta kryefamiljarë mes veti. Është e nevojshme të theksohet se nuk del si Dabzhiv, Dabisha dhe Dabko, por në formën shqipe *Dabë*. Kjo nuk do të thotë se edhe trajta sllave Dabzhiv në aspektin etnik na paraqet vetëm sllavin, sepse në fshatin Ponoshec të Gjakovës e hasim kryefamiljarin Bardo, i biri i Dabzhivit, formë tipike sllave, por i biri i Bardo-s, ruan një emër të pastër protoshqiptar.

Më vonë del Stepiani, i biri i Bardo-s, që e gjejmë në një vendbanim tjetër, Nenko, i biri i Bardo-s kurse këtu e kemi rastin Nenko, i biri i Lekës. Pra, edhe Pop, i biri i Nenkos, siç tregojnë këta shembuj, ka mundur të jetë lehtësisht i përkatësisë etnike shqiptare i besimit ortodoks.<sup>41</sup> Për shkak të mungesës së klerit katolik shqiptar, për çka ankohen me të drejtë relatorët e ndryshëm. Patriakana e Pejës, deri më 1776, kur ndërpritet veprimtaria e saj, bënte pagëzimin e fëmijëve të popullsisë shqiptare edhe të besimit katolik, duke u vënë emra sllavë.

Përfundimisht, pra, siç shihet, nga gjithë kjo që parashtruam, del se shumica e kryefamiljarëve ishin të besimit ortodoks, ndërsa 1/3 e besimit katolikë (kriptokatolikë). Edhe në këtë vendbanim si dhe në vendbanimet e tjera të rrethinës së Gjakovës në mesjetë nuk kishte pasur kurrë popullsi serbe, por kishte një popullsi etnike shqiptare, antroponomia e së cilës ishte sllavizuar dhe konvertuar në fenë ortodokse.

Dhe, së fundi, në përmbyllje të këtij parashtrimi nuk duhet parë me habi se “ndërhyrjet e tilla kirurgjikale” janë të paramenduara mjaft mirë për të përmbushur planin operacional të kolonizimit të shqiptarëve sipas etapave, meqenëse ky vendbanim dhe shumë të tjerë qenë shndërruar në feude të kohës ortodokse sllave.

## 11.7. Bardosana

Është vendbanim i tipit të shpërndarë, që shtrihet në bregun e djathtë të lumit Drini i Bardhë, rreth 10 km. në lindje të Gjakovës që e ka edhe qendër administrative, arsimore e

---

<sup>41</sup> K. Komunal Gjakovë, *Toponimia e Gjakovës me rrethinë*, Gjakovë, 2002 f. 153 -154.

kulturore në këtë qytet. I takon rajonit të Dushkajës. Bardosana kufizohet : me Drinin e Bardhë-në lindje, Doblbaren e Dushkajës-në veri, Marmullin-në jug dhe me fushat e Lugut të Bunarit e të Gjakovës-në perëndim. Ka një sipërfaqe prej 1.051 ha, 65 ari 90 m. Familjet që banojnë në këtë vendbanim: Berishë, Domgjon, Krasniq, Gjugje, Kuzhnin, Mirditë, dhe Bisak.<sup>42</sup>

### **11.8. Mikrotoponimet më karakteristike:**

Trojet, Arat e Trollit, Kodra e Thatë, Kodra e Sarajit, Livadhi i Sarajit, Livadhet e Bubit (Pronë e familjes Bubi), Livadhet e Bunarit (dikur në këtë livadh ka qenë i hapur një pus-bunar), Livadhet e Egra, Livadhi Rrotullak i Milicit (Gjendet në jug-lindje të këtij katundi, emri i mbetur sipas formës që ka, të rrumbullakët, dhe patronimit të pronarit-Milici), Vorret e Kqija, Lugu i Pashës, Mahalla e Begit, kurse nga hidronimia, është interesant emri i këtij përroi, Prroni i Qiqrit ( Është ky një përrua i vogël i cili mban ujë vetëm gjatë dimrit, ujë i grumbulluar nga prroskat që ka përreth ). etj.

Në toponiminë e katundit Bardosanë dhe të paralagjes Rezinë mbizotërojnë emërtime të gurrës shqipe, por nuk mungon edhe elementi i gjuhëve të huaja. Numri më i madh i toponimeve të këtij fshati janë emërtime të hershme, të sajuara nga sfera e bujqësisë dhe blegtorisë, veprimtari kryesore këto me të cilat, edhe sot, merret popullata e këtueshme. Toponimet e këtij katundi dalin si emërtime **njëgjymtyrëshe, dygjymtyrëshe dhe trigjymtyrëshe.**

### **11.9. Bardhaniqi**

Është vendbanim në rajonin e Dushkajës, që ka shtrirje kryesisht në një luginë në pjesën verilindore të Gjakovës, rreth 23 km. larg. Është vendbanim i tipit të shpërndarë, i ndarë në disa lagje si: Halilibisht, Rexhepferiztë, Demushimertë, Mustafisuftë, Tahirfazlijtë, Mulajt. Si pikë orientuese për shënimin e toponimeve e mikrotoponimeve morëm mikrotoponimin

---

<sup>42</sup> Dr. J. Osmani, *Vendbanimet e Kosovës, Gjakova 14*, Prishtinë, 2005 f. 96. Shënimet e dhëna (sipas autorit) nga një fshatar më 20.03.2002 nga Nikollë Llesh Gjoani , 75 vjeçarë, dhe Gjokë Gjoni, 63 vjeçarë.

**Kroni i Mrizit T'Madh**, icili, përafërsisht, gjendet në mes të fshatit, për të cilin thuhet se, dikur, tek ky krua, mrizonin delet e dy - tri fshatrave përreth.

### **11.10. Mikrotoponimet më karakteristike:**

Vorret e Kastratit, Ledina e Shkodrës, Lugu i Shkodrës, Qarri i Aruq Dodës, Grykat e Tahir Fazlisë, Lugu i Smailit, Gryka e Duboçakut, Shyteci, Kodra Kronit t'Mrizit t'Madh, Gryka e Smail Ahmetit, Lugu i Balës, Lugi i Alisë, Lugu i Rapotokit, Berdat, Kroni Kishës.<sup>43</sup>

Në lagjen e Halilibishëve ( Neziraj ), janë gjetur gjurmë të lokalitetit të vjetër, në Lugun e Rapotokut. Aty janë gjetur themele të shtëpive. Në vendet Varret e Bardhaniqit, kanë ekzistuar themelet e një kishe të vjetër. Në vendin Kroni i Kishës, afër Grykës së Smajlit, Te Qarri i Aruqit thuhet se ka ekzistuar kisha. Aty janë gjetur monedha të bardha, por në kontakt me ajrin janë shkatërruar. Në vendin Ledina e Shkodrës, aty afër janë Varrezat e quajtura të Kastratëve me rrasa të mëdha.

Ky toponim mesjetar, sipas mr. Iljaz Rexhës, mendohet se është sajuar me bazën e substratit iliro-arban nga **Bard** + **on** sufiks grek + **iq** prapashtesa sllave dhe kemi fituar trajtën sllave *Bardoniq*, ndërsa trajta greke ishte *Bardon* sikurse Damastion dhe Laberion, ku këtu nuk kemi të bëjmë me fjalën kompozitë, nga *Bard* + *Niko*, që disa studiues mendojnë se është sajuar nga dy emra vetjakë.<sup>44</sup> Është për t'u theksuar se studimi shkencor i emrave të vendeve të rrethinave të Gjakovës është me vlera të mëdha për gjuhësinë e për historinë shqiptare dhe për kulturën kombëtare, në kuptimin e gjerë të fjalës. Një studim, mendoj, mjaft të ngjeshur në këtë drejtim, sidomos, për 24 emërtime shqiptare të vendbanimeve të kësaj komune ka dhënë edhe prof. Latif Mulaku.

Në dokumentet e shkruara, ky vendbanim përmendet në vitin 1451-51 në defterin e Rumelisë, me emrin *Bardanji*.<sup>45</sup> Pastaj në defterin kadastral të Sanxhakut të Dukagjinit në

---

<sup>43</sup> Dr. J. Osmani *Vendbanimet e Kosovës, Gjakova 14*, Prishtinë, 2005. f. 93. Shënimet janë marrë gjatë vizitës së fshatit më 04. 07. 2004, nga Mark Dok Mula (1926).

<sup>44</sup> Mr. I. Rexha K. Komunal, Gjakovë, *Toponimia e Gjakovës me rrethinë*, Gjakovë, 2002 f. 146

<sup>45</sup> Dr. J. Osmani, *Vendbanimet e Kosovës, Gjakova 14*, Prishtinë, 2005 f. 94. Shënimet janë të marra nga dorëshkrimi i Mr. Iljaz Rexhës.

vitin 1571 përmendet fshatri *Bardonja* që mbase është katundi i sotëm Bardhaniqi me 10 shtëpi, 2 myslimanë e 1 beqar.<sup>46</sup>

Disa familje të hershme që kanë jetuar në këtë vendbanim janë shpërngulur, siç janë Kastratët të shpërngulur në Shkodër të Shqipërisë, Dodajt të shpërngulur para 300 vjetëve në Maznik të Deçanit etj. Përkitazi me këtë janë ruajtur edhe mikrotoponimet Vorret e Kastratëve, Qarri i Aruq Dodës etj. Ndërsa, banorët e sotëm disa janë ardhur nga disa vendbanime të afërta, si p.sh. Rexhepferiztë nga Çifllaku i Rahovecit, ndërsa, familjet Mulaj ishin të vendosur këtu, por kishin ikur në Shqipëri, ku edhe prapë janë kthyer etj.<sup>47</sup> Pas pushtimit malazias të këtyre viseve në vitin 1913, popullata kishte pasur trysni për ndërrimin e fesë, ku kishin pësuar disa persona dhe ishin shkatërruar disa shtëpi. Do të ndelemi për të dhënë disa argumente gjuhësore në përdorimin e emrit **Bardoniq - i** dhe **bardhaniq - i** -, fshat i rrethinës së Gjakovës, i banuar vetëm me popullsi shqiptare. Sa i përket formës së parë, patjetër kemi të bëjmë me sllavizmin a serbizimin e saj me anë të dhunës administrative, me shndërrim të tingullit shqip **dh** në **d** të gjuhës serbe, si dhe me të shtuar të prapashtesës sllave (serbe) - **ić** (lexo iq), e cila përdoret mjaft shpesh në toponimi. Ky kthim i ndërdhëmbore shqipe **dh** në dhëmboren **d** në gjuhët sllave është një rregull fonetike e njohur që dëshmon pikërisht varfërinë ose mungesën e fonemave ndërdhëmbore **dh**, **th** në sllavishten që ashtu si në të gjitha rastet e kontakteve të tilla dygjuhësore, vepron shtrembërimi ose identifikimi shpërdorues. Krahaso ndër të tjera edhe në kohët e reja, psh. **th** e anglishtes në gjuhët që nuk kanë fonemën (**th**) jepet me (**d**) p.sh. në italishten M. Thacher jepet pikërisht me (**d**). Kjo duket shpesh në rastin e onomastikës shqiptare kur kalon në përdorim të sllavëve. Për të ilustruar shëmtimet e tilla po sjell vetëm dy shembuj: shqip **Lumbardh** (fshat në komunën e Deçanit), serbokroatisht **Ljumbard** (a) dhe **Palabardh** (fshat afër komunës së Gjakovës), serbisht **Paljabard** (a). Edhe gjuhët tjera që nuk e kanë tingullin **dh**, turqishtja italishtja e rumanishtja, zakonisht zëvendësojnë me **d**, i cili, përndryshe, është i afërt me **dh** - në e shqipes. Në këtë mënyrë, pra, **Bardhani** i gjuhës shqipe u deformua në trajtën sllave, përkatësisht serbe **Bardoniq**. Për sa i përket formës së dytë të emrit të këtij katundi, pra, Bardhaniqit, të cilin e përdorin shqipfolësit, këtu është

<sup>46</sup> BV. A. *Tapu defterli*, defter nr. 499, f. 96 -172; Selami Pulaha, *Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shek. XV- XVI*, Tiranë, 1984, f.179 ( marrë nga Dr. J. Osmani *Vendbanimet e Kosovës, Gjakova, 14*, f. 94).

<sup>47</sup> Prof. S. Hoxha, *Toponimia e Dushkajës*, Jakova 2007 f. 18-19.

bërë një sllavizim më i vogël; në të vërtetë, popullsia shqiptare ruan trajtën e vjetër shqipe **Bardhan**, mirëpo e përdor me prapashtesën e imponuar sllave **-ić** (= - **iq**). Prandaj, mendoj që është një e drejtë normale të kthehet në përdorim administrativ dhe të përgjithshëm forma autentike dhe e vjetër shqipe **B a r d h a n-i**.

Në defterin e regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485 janë regjistruar shumë emra vendesh, personash (njerëzish) dhe mbiemra familjesh shqiptare me temën **Bard** (duhet të lexohet **Bardh**), si: *Bard, Barda, Bardi, Bardo, Bardosh, Braz* për *Bard*, të cilët në transkriptimin shqip do të ishin: *Bardh, Bardha, Bardho, Bardhosh, Bardh*; përkatësisht toponimet: Bardani, Bardon (lexo: *Bardhan-i, Bardhon-i*). Këta emra të vjetër personash, patronimesh e toponimesh edhe sot janë mjaft të shpeshtë ndër shqiptarë. Qysh në vitin 1416, në *Kadastrën venedikase të Shkodrës*, janë regjistruar toponimi dhe patronimi shqip *Bardhanj*. Kështu që në raportet e relatorëve shqiptarë dhe atyre të huaj (kryesisht italianë) të shek. XVII e XVIII, përmenden shumë shpesh toponimet e patronimet: *Bardhi* ( Gjergj *Bardhi*, Mikel *Bardhi*, Frang *Bardhi*), *Bardanj / Bardhanj* (fshat në Bregbunë), *Bardhoku, Bardha / Barda* (emër malesh), *Bardhajt* (familje nga Zadrima), Nikollë *Bardhi*, Pjetër *Bardhi*, Prend *Bardhi* etj. Edhe në këto relacione të shkruara italisht **dh** - ja shqipe është zëvendësuar me **d**.

Përveç emrave vetjakë dhe mbiemrave familjarë, edhe në toponiminë e sotme shqiptare hasim në emra vendesh të krijuar nga tema *Bardh* - zakonisht me ndonjë prapashtesë ose me kompozim, p.sh.: *Bardhaj* (fshat në rrethin e Mirditës), *Bardhoc* (fshat në rrethin e Kukësit), *Bardhet* (katund i Malësisë së Dukagjinit), *Palabardh* (katund në Malësinë e Madhe, tjetri katund në rrethinën e Gjakovës), etj. Nga pikëpamja thjesht gjuhësore, të gjithë këta emra njerëzish, mbiemrash familjarë dhe vendesh, pa dyshim kanë dalë, janë krijuar prej fjalës shqipe **i, e bardhë** (asesi me pjesëmarrjen e nyjeve të përparme) me prapashtesa përkatëse ose pa to. Nga kjo fjalë me siguri është krijuar edhe emri i fshatit të Gjakovës *Bardoniq* dhe *Bardhaniq* me prapashtesën përkatëse **-an + iq (-ić)**.

## 11.11. Zhabeli

Njëzet kilometra në veri të Gjakovës, shtrihet katundi Zhabel që gjendet në trevën e Dushkajës. Ky katund shtrihet në dy lugina dhe është i ndarë në dy lagje kryesore me grupe të shtëpive.

### **11.12. Zhabeli Plak:** Grupi i shtëpive-Maliqët.

*Mikrotoponimet më karakteristike:* Shpati, Grykat, Balltaqet, Ara e Madhe, Bishtaki, Kodra e Trimave, Përrooni i Vogël, Fangi, Kroni i Agës së Batushës, Lugina e Maliqëve, Varret e Hasallakut.

**11.13. Zhabeli i Ri:** Grupi i shtëpive-Morina dhe Berisha (Haziraj,Ukaj, Smajlaj, Delijaj). Familjet shqiptare të besimit të krishterë Kaçanukët (Nikajt) dhe Dedajt janë shpërngulur në fshatin Lugbunar të Gjakovës. Familja Idrizaj (romë) është shpërngulur para 25 viteve në Gjakovë.

### **11.14. Mikrotoponimet më karakteristike:**

Çarrishtat, Kugullarët, Livadhet e Gata, Çerhanet, Seishta, Lugu i Sokolëve, Livadhet e Mëdha, Kroni i Mllokës, Kodra e Malësorëve etj. Thuhet se banorët e këtij fshati para shumë kohësh kanë ardhur nga vise të ndryshme. Ata kanë jetuar në lokalitetin e Zhabelit Plak dhe në vendin midis këtyre dy Zhabeleve, në Kodrën e Malësorëve. Aty vërehen disa puse, pemë dhe dëshmi të tjera të vendbanimit. Aty bie një sëmundje që popullata në masë të madhe dëmtohet, përkatësisht vdesin dhe varrosen në vendin që sot quhen Varret e Hasallakut e disa shpërngulen në lokalitetin e ri që quhet Zhabeli i Ri.<sup>48</sup>

Në këtë vendbanim autokton shqiptar në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore, pushteti jugosllav me qëllim të ndërrimit të strukturës nacionale të popullsisë këtu vendosi 8

---

<sup>48</sup> Dr. J. Osmani, *Vendbanimet e Kosovës, Gjakova 14*, f. 264. Shënimet janë marrë gjatë vizitës së fshatit më 10.08.2003 nga Shaban Maliqi, arsimtar dhe Hajdin Maliqi; Instituti Albanologjik, *Toponimia e fshatit Zhabel* dhe më 4.07.2004 nga Xhevdet Deliu (veprimtari e autorit).



familje kolone serbe e malazeze<sup>49</sup>. Kolonët kanë qëndruar një kohë të shkurtur dhe ishin vendosur në fushat dhe malet përreth. Shumë banorë nga ky vendbanim janë shpërngulur në Pejë, Gjakovë, Lugbunar dhe Rogovë të Hasit (që edhe e mbajnë emrin Zhabeli).

### **11.15. Hidronimia ose emrat krojeve:**

*Kroni Ag's*, ndodhet në Grykën e Ag's, në lagjen Zhabeli Plak. *Kroni Halil Shal's*, ndodhet mu në Ledinë të Ag's, si pikë orientuese, buzë rrugës kryesore të fshatit. Këtë krua e kishte çelur dhe ndërtuar njëfarë Halil Shala, i cili si fakir (pa të afërm), s'kishte familje as trashigimtarë, kishte ardhur prej Shale, tash vonë, për të jetuar tek nipat e tij në Zhabel. Pas një kohe vdiq dhe shuhet familja e tij.

*Kroni i Lugit Linisht's* li - liri (bimë), që dikur kishte në atë lug, *Kroni i Lugit Xhepap's*, *Kroni i Mllak's*, ngase është në toponimi që kanë për bazë emrin mllak-u, që është lloj druri i përhapur nëpër malet e Dushkajës<sup>50</sup>.

### **11.16. Emrat e ujërave (hidronimet):**

*Prroni i Zhabelit*, është përrua që vjen kah perëndimi. Bie nëpër luginën ku shtrihet edhe katundi Zhabel. Pjesa e përroit, në territor të Zhabelit, quhet *Përroini i Zhabelit*, i cili vazhdon kah lindja në territorin e katundit Jabllanicë (Shqiponjë), që është në rajonin Dushkajës. *Përroini i Zhabelit Plak*, është përrua i vogël që bie nëpër *Zhabelin Plak* dhe me përroin tjetër që bashkohen në territor të Jabllanicës (Shqiponjë)<sup>51</sup>.

### **11.17. Plançori (Rajoni Rekë e Mirë)**

---

<sup>49</sup> Dr. M. Obradović, *Agrarna reforma*, f. 326. Marrë nga *Vendbanimet e Kosovës, Gjakova 14* f. 265.

<sup>50</sup> Prof .S. Hoxha, *Toponimia e Dushkajës*, Jakova, 2007 f. 333

<sup>51</sup> Po aty. 22, f. 338.

Është katund që i takon rajonit Rekë e Mirë ( Rekë e Vogël). Shtrihet 5 km. në veri të Gjakovës, në të dy anët e rrugës Pejë-Gjakovë. Është vendbanim i tipit të dendur. *Vëllazëria*: Gjidoda.

### **11.18. Mikrotoponimet më karakteristike:**

Sukollari, Arat e Vadës, Prroni i Zi, Ledina e Vogël, Vorri i Musli Agës, Drumi i Vokshit, Lugu i Ahit, Lugu i Shkozës, Kodra e Mujkut.<sup>52</sup> Vendbanimi i vjetër i fshatit është shtrirë në vendin e quajtur *Ledina e Vogël* dhe ka vazhduar përpjetë mbi të. Aty ekzistojnë edhe varrezat e moçme që nuk dihet se të kujt janë. Janë ruajtur toponimet karakteristike: *Varri i Mirë, Varri i Musli Agës, Drumi i Vokshit* ( këtu ka kaluar rruga e vjetër Voksh - Gjakovë).<sup>53</sup> Banorët e tanishëm janë të një vëllazërie Gjidoda, të ardhur dhe të vendosur këtu nga Mirdita. Para tyre këtu ka jetuar familja Gojani e cila me ardhjen e Gjidodëve është shpërngulur në Budisalc të Klinës.<sup>54</sup> Sipas një dokumenti arkivor kishtar të vitit 1890, dorëshkrimi i Don Tomës, Plançori kishte vetëm 5 familje me 70 banorë shqiptarë katolikë. Me emrin Plançor është i regjistruar në sallnamet e Vilajetit të Kosovës të vitit 1893 (1311h), të vitit 1896 (1314 h), dhe të vitit 1900 (1318 h).

Në vitin 1919 dy familje janë shpërngulur në Shqipëri, pastaj më vonë 4 vëllezër janë shpërngulur në Bjellovar të Kroacisë. Si në shumë rajone edhe në këtë vendbanim dhe afër tij, veçanërisht që nga viti 1923, u kolonizuan më se 26 shtëpi kolone sllave nga Mali i Zi e Dalmacia.<sup>55</sup>

Është për t'u theksuar se me rastin e kolonizimit dhe vendosjes së tyre në trevat tona etnike përzgjidhnin vendbanimet në pikëpamje të konfiguracionit që parapëlqenin duke pasë parasysh edhe strategjitë e tyre për çfarëdo rasti eventual si: vendbanimi të jetë afër xhadesë, i rrafshët, tokë pjellore, klimë malore, afër lumenjve, rreth kishave e mbi të gjitha afër

---

<sup>52</sup> Dr. J. Osmani, *Vendbanimet e Kosovës, Gjakova 14* Prishtinë, 2005, f. 212, sipas autorit shënimet janë marrë gjatë vizitës së fshatit më 15.08.2004 nga Kolë Frrokaj (1944).

<sup>53</sup> Dr. J. Osmani, *Vendbanimet e Kosovës, Gjakova 14* Prishtinë, 2005, f. 212, sipas autorit shënimet janë marrë gjatë vizitës së fshatit më 12.11.2001 nga Gjin J. Gjidoda ( 1918 ).

<sup>54</sup> Sikurse fusnota 25, me të dhëna të njëjta.

<sup>55</sup> AJ B. MAR, 96-51; Dr. J. Osmani, Lënda arkivore.....f. 383; Dr. Milovan Obradović, *Agrarna reforma i kolonizacije na Kosovu*, f. 323., Dr. J. Osmani, V. K., *Gjakova 14*, f. 212.

stacioneve policore e ushtarake të tyre, që, në rast të ndonjë “termeti politik” të ikin pa ndonjë “therrë në këmbë” si në shumicën e rasteve.

Këto ishin kërkesat e tyre për në Kosovë, se nuk po flasim për nostalgjinë dhe ëndrrën e tyre për në Adriatik, që në marsin e vitit 1981, me rastin e shpërthimit të demonstratave në Kosovë, duke u parë pretendimi i Serbisë, që të “vizitonte”, atëbotë, edhe Tiranën, në gazetën “Zëri i popullit” u tha: ”Kosova u ripushtua edhe njëherë, le të kenë kujdes republikat e tjera, se shkatërrimi i Jugosllavisë po fillon me Kosovën e do të përfundojë në Kosovë”. “Sa i përket ëndrrës shumëshekullore të Serbisë dhe miqve pas tyre që presin me një këmbë për të lagur këmbët në Adriatik, ata mund ta shohin vetëm me dylbi, se çelësin e Sazanit e kemi ne, mund të vinë këtu vetëm atëherë kur do të shkelin mbi trupat tanë përfundon artikulli.”<sup>56</sup>

Kolonët serbë në vitin 1941 janë largur nga ky katund, Plançori, dhe nga shumë të tjerë, gjithsesi, në mënyrë shumë të organizuar, edhe pse, në rrethana të vështira falë pozitave të tyre gjeografike kolonizuese, organizimit ushtarak e policor, ikën pa u gërvishtur, ndërsa vetëm shtëpitë e tyre u shkatërruan. Si zakonisht, vetëm, shqiptarëve historia u përsëritet shumëherë. Mirëpo, pas rikthimit të tyre përsëri, fjala është për këtë katund, por ka dhe shumë të tjerë, kur popullata vendase që e detyruar t’ua ndërtojë shtëpitë e tyre. Përkitazi me këtë, njëri që ia kishte ndërtuar “me hatër” shtëpinë malazezit, Tomë Gjidoda, kryetarit të Këshillit Popullor të Vendit, për atë kohë në Skivjan, Muharrem Shllakut ia reciton këto vargje:

**“Tomë Gjidoda prej Plançori**

**ja maroi shpinë cërnagorit,**

**jo me hater por me pikë të zorit,**

**jo ma larg se në derë të oborrit”.**<sup>57</sup>

---

<sup>56</sup> Koment i “Zëri i popullit”, nëpërmjet të Radio Tiranës, Mars, 1981.

<sup>57</sup> Shënimet e këtyre vargjeve janë marrë sipas interpretimit të Gjon Preçit, luftëtar i UÇK-ës nga fshati Ujë, Komuna e Gjakovës në shkurt, 2001 familje e nderuar e me vlera të larta patriotike, djali i Gjonit Marka Gjonit.

Këto vargje janë mjaft domethënëse për vuajtjet e popullit shqiptar në trojet e tyre etnike në Kosovë, që ndoshta sadopak e gjithësesi i përket edhe temës së mbarështruar, sepse nuk mund t'i ikim lehtë kësaj të vërtete, përveç temave nga historia, ashtu edhe onomastika shqiptare është e lidhur drejtëpërdrejt me të, dhe është e vërtetë që kjo do kohë, por nuk duron pritje, do vullnet e profesionalizëm të mirëfilltë për të pastruar këto mbetje që na lanë pushtues të ndryshëm e veçanërisht sllavizmi, pra, mendoj që pa humbur kohë toponomia shqiptare, pikërisht për arsye të lidhjeve të saj të ngushta me historinë dhe jetën ekonomiko-shoqërore e kulturore të çdo populli, parqitet një fushë studimi tepër të vështirë dhe që kërkon gjithmonë njohje të gjerë e bashkërendim të të dhënave ndërdisiplinare nga specialistë të kësaj fushe ashtu sikurse pemët në ditët e para të pranverës që domosdo duhet të krasiten nga pjesët që nuk i takojnë atij trunq, ndryshe nuk do të përparoj dhe nuk jep fryte, e kjo, patjetër, në vazhdimësi të krasitjes.

#### **11.19. Mogliku** (Moglica e rajon i Hasit)

Një çështje tjetër me interes për të dëshmuar mbijetesën dhe qëndresën e shqipes ndaj asimilimit edhe me emrat e trojeve është prania e emërtimeve dyfishe apo dygjuhësore, e ndonjëherë edhe trigjuhësore, domosdo, kjo një dëshmi e trysnisë asimiluese për emërvendet, që janë pjesë përbërëse e emërtimeve të huaja që lidhen me ardhjen e sllavëve (emë pas të turqëve) në Ballkan, me ç'rast siç dihet, harta toponomastike e këtij gadishulli, pjesë e së cilës edhe jemi, pësoi ndryshime të shumta. Shumë emërtime të vjetra u zëvendësuan me emërtime të reja, që një pjesë e madhe e toponimeve shqipe, të vjetra e të reja, kuptimisht të zbërthyeshme, u përkthyen ose u përshtatën simbas gjuhës së etnikumit sundues. Do të ndalemi së pari te katundi **Mogliq** (Moglica), emërtim i dyfisht që shtrihet në jug të Gjakovës, rrëzë maleve, kodrinave dhe në shpatije, shtëpi të ndara e në grupe, pastaj do të kapim edhe disa katunde tjera me emërtime të dyfishta. Fillimisht me familjet e katundit Moglicë: *Markprekajt, Dedajt, Nikollaj, Milici, Përlalaj, Ndreaj, Shuti, Allakaj, Zefaj etj.*

#### **11.20. Mikrotoponimet më karakteristike:**

*Kroni i Kadisë, Domasani, Kroni i Shkugësit, Rrezina, Lugu i Sanës, Arat e Shevejt, Livadhishta, Arrnica, Kodra e Tuqit, Kroni i Tuqit, Kroni i Perlalajve, Livadhi i Vogël, Shkugëza, Livadhet e Dushit*<sup>58</sup> etj.

Grumbull tumash të kohës së bronzit dhe të hekurit që janë zbuluar nga ana e Institutit Arkeologjik dhe Muzeut të Kosovës në vitin 2001<sup>59</sup>. Siç thuhet, vendosja e fshatit në këtë lokalitet kishte lëvizur disa herë. Në fillim ishte në pjesën e rrafshët, pastaj në kodër dhe prap në rrafsh. Rrëzë pjesës malore ka gjurmë të shumta të kaluarës materiale, si tjegulla, tulla, gurë etj.<sup>60</sup> Në dokumentet e shkruara përmendet në defterin kadastral të Sanxhakut të Dukagjinit të vitit 1571 me emrin Mogolec dhe kishte 19 shtëpi, 15 beqarë dhe 5 çiftë.<sup>61</sup> Në defterin e Sanxhakut të Prizrenit të vitit 1574 kishte 32 shtëpi.<sup>62</sup> Ndërsa, në defterin kadastral të Sanxhakut të Prizrenit të vitit 1591 po me këtë emër kishte 28 shtëpi, 6 beqarë, 5 çiftë.<sup>63</sup> Sikurse edhe në disa vendbanime edhe këtu ka pasur lëvizje të popullsisë. Kështu që numri i banorëve në kohë të caktuar ndryshon. Në një hartë austriake të vitit 1689 është i regjistruar si vendbanim me emrin **Moglinë**. Në dokumentet kishtarë të Kishës së Zymit të cilat janë ruajtur që nga viti 1842 ky vendbanim është i regjistruar.<sup>64</sup> Me emrin **Muglica** është regjistruar edhe në sallnamet e Vilajetit të Kosovës të vitit 1893 (1311 h), të vitit 1896 (1314 h), dhe të vitit 1900 (1318 h).

## 11.21. Sprovë për etimologjinë e disa toponimeve të Gjakovës

Në një prizëm tjetër, të filologut, toponimisë së Gjakovës i qaset prof. dr. Latif Mulaku në studimin *Mbi disa toponime të rrethinave të Gjakovës*, në të cilin përimton një nga një nga aspekti historiko-kulturor dhe etimologjik disa nga vendbanimet e rrethit të Gjakovës.

---

<sup>58</sup> Shënime janë marrë, sipas Dr. J. Osmani gjatë vizitës së fshatit më 06.07. 2004. nga Zef Nue Zefi (1927) në librin *Vendbanimet e Kosovës, Gjakova 14*, Prishtinë, 2005 f. 197.

<sup>59</sup> Sipas Dr. J. Osmani, Sipas shënimeve nga *Raporti i Orojektit hulumtues të Institutit Arkeologjik në Tiranë dhe Muzeut të Kosovës në Prishtinë*, 2000-2001

<sup>60</sup> Sipas Dr. J. Osmani, shënime janë marrë gjatë vizitës së fshatit më 9.12.2001 nga Krist Ndrecaj, prof. i gj. angleze.

<sup>61</sup> Dr. J. Osmani (sipas autorit) BV, *Tapu defterli*, defter nr. 499, f. 96 -172; S.Pulaha, popullsia f. 182-183

<sup>62</sup> Basbakanlik Osmanli Arsivi, 0368 *Numarah Tapu Tahrir Defteri* i vitit 1574, Fotokopje dhe CD-R, në Arkivin e Kosovës.

<sup>63</sup> TK. A , defter nr. 63; S. Pulaha, Popullsia..... f. 118

<sup>64</sup> N.Kërhanaj& At N.Kajtazi, *Zoja e Hasit*, f. 97.

Nëse, veçori e rëndësishme e kontributeve të studiuesve të tjerë në këtë vëllim është aspekti disiplinuar me të cilin i janë qasur toponimisë së Gjakovës dhe rrethinës së saj, veçori e studimit të prof. Mulakut është tërësia e plotë dhe e gjithanshme e shtrimit të problemit në nivelin e kërkesës pragmatike të Komisionit për standardizimin e emërvendeve të Kosovës. “Studimi shkencor i emrave të vendeve të rrethinave të Gjakovës është me vlera të mëdha për gjuhësinë e për historinë shqiptare dhe për kulturën kombëtare, në kuptimin e gjerë të fjalës”, shkruan prof. Mulaku, prandaj nga 24 vendbanime sa ka kjo komunë, autori trajton hollësisht dhe në mënyrë interdisiplinare dhjetë ojkonime.

Në këtë studim, autori merret me strukturën gjuhësore, prejardhjen etimologjike, shtrirjen gjeografike, të dhënat historike, ubifikimin etj., të ojkonimit *Bardoniq-i* ose *Bardhaniq-i*, të cilin e nxjerr nga fjala *bardh*, përkatësisht toponimi *Bardhan*, por që sllavët e patën deformuar në trajtën sllave, përkatësisht serbe *Bardoniq*, prandaj, autori i sugjeron Komisionit që këtij fshati t’i kthehet emri i vjetër shqip *Bardhan-i*. Autori e konsideron ojkonimin *Bardosan-i*, të formuar nga fjala shqipe (*i,e*) *bardhë* me bazë patronimike, *Bardhosh*, *Bardhoshan* etj., prandaj, edhe emrin e fshatit e propozon të këtillë. Ojkonimin *Batushë-a* ose *Botushë-a*, i cili shfaqet në dokumente që në shekullin XIII, e konsideron të formuar nga apelativi shqip *botë-a* (një lloj deltime dhe me ngjyrë të përhimtë në të bardhë) dhe prapashtesa *-ushë*.

Tek ojkonimi *Firajë-a* ose *Fierajë-a* autori gjen një emër të pranishëm përgjithësisht në fitoniminë shqiptare *fier* me prapashtesën *-ajë*. Po i kësaj natyre është edhe ojkonimi *Firzë-a* ose *Fierzë-a*, që është formuar nga emri i bimës fier dhe prapashtesa me kuptim zvogëlimi *-zë(a)*. Ashtu si ojkonimi *Botushë-a*, edhe ojkonimi *Mejë-a* shfaqet që herët në dokumente, siç është *Defteri i regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës (1485)*.

Këtë toponim autori e konsideron me prejardhje nga emri i bimës *mel-i*, që e karakterizon territorin e këtij katundi. “Përndryshe, shkruan autori, emri *mel* është huazim nga latinishtja *milium* ose është paralelizëm indoeuropian i shqipes”. Autori e konsideron etimologjinë e ojkonimit *Palabardh*, të përbërë nga emri *Pal* dhe mbiemri cilësor *i bardhë*, ndërsa etimologjinë e ojkonimit *Ujzë-a* ose *Ujzë-i* nga një apelativ i drurit të *ulzës*. Autori përjashton mundësinë e emërtimit të këtij vendbanimi nga një kompozitë *uji i zi*, duke dhënë një varg vendbanimesh me prejardhje të ngjashme fitonimike, përfshirë këtu edhe një vendbanim *Ulëz*, në rrethin e Matit.

Për prof. Latif Mulakun, rëndësia e toponimisë së Gjakovës dhe rrethinave të saj është e rëndësishme për disa arsye të natyrës gjuhësore, kulturore, historike dhe më në fund nacionale.

Toponimet e Gjakovës dhe rrethinave të saj, janë struktura gjuhësore të cilat shpjegohen me gjuhën shqipe, me strukturën e fonetikës dhe të gramatikës historike të shqipes, me ndërtimet e zakonshme të toponimeve dhe përgjithësisht onomastikës në gjuhën shqipe sipas emrave të bimëve, të drurëve, sipas emrit të një personi ose të një mbiemri familjar, sipas llojit të dheut, sipas emrit të një shtaze ose kafshe, sipas konfiguracionit gjeografik, sipas një pronari, sipas emrit të një shenjtori etj.

### **KREU III**

#### **12. Përpjekjet për standardizimin e emërvendeve në kuadrin e përgjithshëm të Kosovës**

Ngjarjet e para luftës dhe sidomos pas mbarimit të luftës së Kosovës, ishte një angazhim i përkushtuar studiuesve kosovarë në ndihmën e dhënë Këshillit për Standardizimin e Emërvendeve të Kosovës, në veçanti bëhet fjalë tashmë për studiuesin e mrëfilltë kosovarë Begzad Baliun i zgjedhur në Komisionet për emërtimin e Shesheve,

Rrugëve, dhe Vendbanimeve, në kuadër të asambleve komunale të Gjakovës dhe të Pejës, ku dha edhe kontributin e tij të vyer.<sup>65</sup>

Studimet e tij të kësaj kohe *Rreth harrjes dhe emërimit të disa toponimeve të krahinës së Dushkajës* dhe *Toponimia e Dushkajës* paraqesin një kontribut të ndjeshëm në standardizimin e oikonomisë së komunave: Gjakovë, Pejë e Deçan. Përtej një qasjeje të oikonomisë në shkallë komunale, kontributi i tij ka rrezatuar edhe për standardizimin e toponimisë dhe patronimisë së Rrafshit të Dukagjinit. Le të kujtohet këtu edhe kontributi i tij në tryezën shkencore *Toponimia e Gjakovës me rrethinë*<sup>66</sup>, ku Skënder R. Hoxha pati lexuar një studim, ndërsa në përmbledhjen e saj pati botuar edhe dy kumtesa të tjera. Po në këtë vëllim, në rubrikën e diskutimeve, Skënder Hoxha boton artikullin *rreth harrjes dhe emërimit të disa toponimeve të Krahinës së Dushkajës*, me të cilin plotëson kontributin e tij dhënë punës së Komisionit për Standardizimin e Emërvendeve të Kosovës. I motivuar prej punës shumëvjeçare në kërkimin e toponimisë së krahinës së Dushkajës, i nxitur prej aktivitetit të dendur të Komisionit për Standardizim, si dhe prej diskutimeve të shpeshta në shtypin ditor e shkencor, Skënder Hoxha që angazhuar edhe në diskutimin publik të shumë oikonimeve të Kosovës, duke u përqendruar në mënyrë të vaçantë për oikonominë e vendbanimeve të Komunës së Gjakovës dhe të Pejës. Nëse në studimin *Toponimia e Gjakovës me rrethinë* autori sillte një artikull për strukturën kryesisht gjuhësore të oikonimeve dhe mikrotoponimeve të krahinës së Dushkajës, në artikullin tjetër të botuar në rubrikën e diskutimeve do të kujdeset që oikonimet e kësaj krahine t'i trajtonte në aspektin mitologjik, duke u ndalur dhe kërkuar prejardhjen e secilit prej tyre më vete, për të dhënë më tej edhe propozimet e reja: Bardhaniq-Bardhan; Bec-Bec; Bërdesanë (propozimi i ri Kodërthanë); Cërmjan (Cërmok); Dashinoc (Dashaj); Doblbare (Kënetishtë); Gëgoc (Gurkuq); Janosh (Gjinaj); Kodrali; Kralan (Kështjellë); Llugaxhi (Rrahishtë); Marmull (Miraj); Maznik; Meqe (Gradishtë); Netic-i (Rogë-a); Palabardh; Radoniq (Radaj); Rakoc

---

<sup>65</sup> *Rreth harrjes dhe emërimit të disa toponimeve të krahinës së Dushkajës*, "Rilindja", Prishtinë, 29 janar 2000, f.17; "Të dhëna rreth toponimisë së Dushkajës" (kumtesë), në librin *Toponimia e Gjakovës me rrethinë*, Gjakovë, 2002, f. 211-223.

<sup>66</sup> Kumtesat e kësaj tryeze janë botuar në vëllimin *Toponimia e Gjakovës me rrethinë* (Tryezë shkencore, mbajtur më 4 maj 2001), Redaksia: Akad. Besim Bokshi, prof. dr. Qazim Lleshi, prof. dr. Edi Shukriu, prof. dr. Shefki Sejdiu, dr. Rexhep Doçi, prof. dr. Masar Rizvanolli dhe Mevlude Saraçi. Kryeredaktor: prof. dr. Masar Rizvanolli, Sekretar i redaksisë: Mevlude Saraçi. Botoi Kuvendi i Komunës së Gjakovës-Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Gjakovë, 2002, f. 283.



(*Rakaj*); *Rakovinë (Arrishtë)*; *Rashkoc (Qerret)*; *Ratishë e Epër (Luginë e Epërme)*; *Ratishë e Poshtme (Luginë e Poshtme)*; *Rezinë (Rrezinë)*; *Sapot (Skërkë)*; *Vlikobare (Ligatinë)*; *Vraniq (Vrahishtë)*; *Zhabel (Zabeli i Ri e Zabeli Plak)*; *Zhdrellë (Grykë)*,<sup>67</sup> (Gjysmë) pavarësia e Kosovës dhe (gjysmë) liria e popullit tonë duket sikur këto vitet e fundit i kanë dhënë shtytje të mirë hulumtimeve, studimeve dhe qortimeve të shumëllojshme përkitazi me ridimensionimin e historisë, traditës dhe kulturës sonë. Botimet shkencore të institucioneve tona, po edhe të individëve-studiuës të fushave të ndryshme, e dëshmojnë më së miri këtë. Këto botime objekt studimi e shqyrtimi kanë bërë një mori çështjesh që nga historia e lashtë, për të kaluar më pas në atë të mesjetës, e veçanërisht në atë të shekullit të kaluar, duke hedhur kështu më shumë dritë mbi të dhënat historike, gjuhësore, folklorike, etnografike, socio-psikologjike e fusha të tjera me shumë rëndësi për pasurimin e vlerave tona-sa herë të shtrembëruara dhe të nëpërkëmbura nga të tjerët.

Në vazhden e këtyre përpjekjeve bën pjesë edhe puna e pakursyer e onomastëve tanë për ndriçimin e shumë problemeve në fushën e onomastikës, një disiplinë gjuhësore relativisht e re dhe jo e studiuar sa duhet, sa për shkak të mungesës së specialistëve të kësaj fushe, e cila padyshim se ka një specifikë që kërkon njerëz me dije polivalente, po aq edhe për shkaqe të rrethanave historike-politike që mbretëronin në shtetet moniste, pra edhe në Kosovë, e që reflektoheshin sidomos kur ishte fjala për studimet në këtë fushë.

Megjithëkëtë, edhe në kushte të tilla pune e jete, janë bërë e po bëhen përparime të dukshme. Si dëshmi të kësaj janë dhjetëra vepra të shkruara e studime të bëra kryesisht nga studiuesit shqiptarë, të cilët kishin dhe kanë si gjedhe hullitë e mbara të mjeshtërive të albanologjisë: prof. Eqrem Çabej në Tiranë dhe akad. Idriz Ajeti në Prishtinë, me të cilat punime është pothuajse duke u plotësuar një areale e hapët, ndoshta gati edhe shteruese, e hetimeve dhe e përshkrimeve onomastike të trevave shqiptare në Kosovë. Ndër ato vepra e studime e do radha të veçojmë: *Kontribut për studimin e onomastikës mesjetare në territorin, e Malit të Zi, Bosnës e Hercegovinës dhe të Kosovës. A duhet bërë ndryshime në*

---

<sup>67</sup> B. Baliu, *Gjendja e toponimisë shqiptare në Ballkan*, "Era" Prishtinë, 2004, f. 112-113; Po kështu shih edhe bibliografinë e plotë të studimeve për standardizimin e emërve të Kosovës, ku mund të shihet më saktë edhe kontributi i autorit në këtë fushë. Për konceptet teorike dhe metodologjike të punës në standardizimin e emërve të Kosovës shih studimet e autorëve: Shefki Sejdiu, "Rreth disa parimeve më të theksuara në toponiminë e Kosovës", në *Sprova etimologjike, Era*, Prishtinë, f. 1, 8-9 dhe *Demetizimi dhe standardizimi onomastikës së Kosovës*, "Argeta – LMG", Tiranë 2006. Sintezë e plotë e regjistrit të oikonomisë së Kosovës është botuar në vëllimin *Regjistri I standardizuar I emërve të Kosovës*, "Era", Prishtinë, 2005.

*toponiminë e Kosovës?* etj. (dr. Idriz Ajeti); *Onomastika e Kosovës* (përmbledhje punimesh, IAP, 1977), *Çështje aktuale rreth toponimeve e antroponimeve të shqipes* (kumtesa e diskutime, IAP, 1987); *Toponimia e Gjakovës me rrethinë* (kumtesa e diskutime, IAP, 2002); *Disa çështje të onomastikës mesjetare* (dr. Rexhep Ismajli); *Toponimia e Llapit e emërtuar sipas fitonimive, Rreth disa problemeve emërtuese në oikonominë e Kosovës, Rreth disa parimeve emërtuese në toponiminë e Kosovës* (dr. Shefki Sejdiu); *Nga toponomastika e Kosovës, Toponime me prejardhje shqipe, serbokroate, arumune dhe turke* (dr. Latif Mulaku); *Toponimia e katundit Volljak, Toponimia e katundeve Divjakë dhe Kleçkë; Për një kujdes më të madh në shkrimin e emrave të vendeve, Të eliminohet kaosi në toponomastikën e Kosovës, Emërtime dualiste shqipe-sllave* (dr. Muhamet Pirraku); *Vendbanimet e Kosovës I-II...., Standardizimi i emrave të vendbanimeve, e drejtë qytetare dhe historike.* (dr. Jusuf Osmani); *Toponimia e fshatit Gmicë, Toponime te Llapushës (Prekorupës), Toponime kosovare si vendbanime të hershme të zhdukura të tipit të fortifikuar dhe baritor, Antroponimia e shqiptarëve të Kosovës I, Iliro-shqiptarët dhe serbët në Kosovë (sipas onomastikës), Onomastika e Drenicës I, Onomastikë ilire-shqiptare në Ballkan,* (dr. Rexhep Doçi); *Etimologjia e toponimit Markesh, Mikrotoponimia e katundit Gllgovicë, Onomastika e fshatit Bukovik, Onomastika e katundit Capar, Jo ndryshim i emërvendeve të Kosovës, por standardizimi tyre etj., veprat: Gjendja e toponimisë në Ballkan, Demitizimi dhe standardizimi onomastikës së Kosovës* (dr. Begzad Baliu); *Si ta shënojmë toponiminë tonë, Nga toponimia e Kosovës, Shtresa shqipe e etnonimisë dhe toponimisë së Gorës, Prania e shqiptarëve në krahinën e Gollapit, Moravës e të Serbisë Jugore në gjysmën I të shek. XV (1411-1438) në dritën e materialit onomastik, "Standaedizimi" I toponimisë së Kosovës, çfarë është ai?* (Skënder Gashi); *Kontribut për studimin e toponimisë së Dushkajës I, II* (prof. Skënder Hoxha); *Disa toponime e antroponime të Rugovës* (mr. Ahmet Kelmendi); *Topo-nimia e fshatrave Konjush dhe Plane* (dr. Abdullah Zymberi); *Hulumtime dialektologjike dhe onomastike* (dr. Latif Mulaku); *Toponimia e Gjilanit, Toponimia e kazasë së Vushtrisë, Toponimia e Prishtinës, Toponimia e Prizrenit, Kthimi i toponimeve të para, e drejtë e ligjshme* (Abdullah Konushevc); *Toponimia e fshatit Malishevë, Toponimia e fshatit Tërpezë* (Sali Krasniqi); *Mikrotoponimia e fshatit Rogaçicë, veprat: Onomastika e Hashanisë, Fjalor onomastiki Malësisë së Bujanovcit* (dr. Bahtijar Kryeziu); *Llojet e toponimeve të Rugovës* (Hasan Muja); *Mbi tipet dhe disa veçori të strukturave leksiko-*

*gramatikore të mikrotoponimeve të katundit Gmicë të Gollakut (Zijadin Munishi); Shtresa gjuhësore turke e toponimeve në rrethinën e gjerë të Prishtinës dhe në vende të tjera të ish KSA të Kosovës (mr.Sabit Uka); Fizionimia e toponimeve të komunës së Ferizajt të trajtohet mbi baza shkencore (mr.Fatmir Heda); Mikrotoponimia e fshatrave Obri dhe Tërdevc të Drenicës (Xhemal Bajrami); Për shtrirje të denjë të toponimeve autoktone (Behxhet Rexha), Toponimia e Hanit të Elezit (Fadil Curri) etj., etj.*

Në kuadër të këtyre hulumtimeve e shqyrtimeve onomastike në përgjithësi e të toponimisë në veçanti, mund të përmendet, pa dyshim, edhe projekti i ndërmarrë nga një grup ekspertësh, ai i Komisionit Qendror për Standardizim të emërvendeve të Kosovës që në qarqet tona shkencore vjen si një kumt i gëzueshëm, po aq sa edhe një pyetje e madhe shkencore e cila nuk mund të mbikalohet me një pëgjigje të shkurtër.

Komisioni Qendror për Standardizimin e Emërvendeve të Kosovës, i krijuar menjëherë pas luftës së fundit të këtij vendi (1999), i hyri një pune sa të vështirë po aq edhe me përgjegjësi-asaj të standardizimit të emrave të vendeve. Ky grup ekspertësh (15), në masë të madhe ka pasur parasysh, e kjo sigurisht se edhe e arsyeton punën e tij, që përveç standardizimit (përshtatjes) të disa oikonimeve, të ruajë “paprekshëm fondin e toponimeve paraindoevropiane, indoevropiane, ilire, trake, latine, bizantine, sllave, turke, shqipe etj...fondin e toponimeve sllave të vendbanimeve ku shumica e banorëve janë serbë ose malazez, duke rivlerësuar vetëm toponimet e imponuara kryesisht nga fillimi i shekullit XX, toponimet e stërkequra semantikisht, toponimet me etimologji shqipe ose jo sllave që pushteti i ka “riemëruar” me qëllim për të ndryshuar kuptimet e tyre, toponimet me etimologji sllave janë rezultat i leksikut sllav të përdorur nga shqiptarët, toponimet për të cilat banorët e vendbanimit kanë shprehur kërkesë dhe dëshirë që t’i ndryshojnë në interes të një emri më të pranueshëm për të gjithë banorët etj.”<sup>68</sup>, ngase ndryshe, me improvizime e imponime arbitrare nuk do të bënte. Komisioni në punën e tij ka pasur për synim të korrigjojë, pra, kryesisht atë korpus toponimesh që ishte dhe është i papranueshëm për popullin shumicë, dhe në këtë mënyrë të inicojë çmitizimin e çdo miti të ndërtuar në dëm të tjetrit, në rastin konkret të atij serb ndaj atij shqiptar. S’do mend se puna e palodhur e studiuesve të Komisionit Qendror për Standardizimin e Emërvendeve të Kosovës, të 1484 oikonimeve, në kuptim të propozimit, mbështetet edhe në faktin se në Kosovë, administrata serbe, pas vitit

---

<sup>68</sup> Dr. Begzad Baliu, *Demitizimi dhe standardizimi i onomastikës së Kosovës, Tiranë, 2006, f. 29*

1912, ka ndërruar disa emra të vendbanimeve të mëparshme shqiptare, ose ka krijuar vendbanime kolonësh me serbë e malalzez të ardhur kryesisht nga Serbia, Mali i Zi, Kroacia dhe Bosnjë Hercegovina. Këtu s'ka se si të mos përmenden oikonimet: *Serbobran, Veriq, Dobrushë e Kaliçan* (Istog), *Bellopojë* (Pejë), *Serboveci* (Zveçan), *Milloshëvë, Llaza-revë e Obiliq* (Obiliq), *Devet Jugoviq e Orlloviq* (Prishtinë), *Shumadi* (Prizren), *Petrovë* (Prizren), *Gjeneral Jankoviq* (Hani i Elezit), *Tankosiq* (Ferizaj), *Vidishiq* (Mitrovicë), *Hercegovë, Sfarçak* (Vushtrri), *Davidovci* (Shtimje) etj., të cilat toponime, që janë të imponuara, pra edhe duhet të rivlerësohen e ndryshohen. Përveç kësaj, rishikimin dhe rivlerësimin e një numri të caktuar të oikonimeve të Kosovës, e arsyetojnë edhe dy fakte të tjera:

-*së pari* një numër emërvendesh paraqesin jofunksionalite në përdorimin e tyre (sidomos nga bota femërore), si: *Gjylekar* (Viti), *Muçibabë* (Gjilan), *Karaçevë e Muçivërc* (Analum-Kamenicë), *Karashëngjergj* (Prizren), *Karaçicë* (Shtime), *Kaçibegu* (Podujevë), *Dragaqina* (Suharekë), *Leshnik* (Deçan), *Kurvelesh, Peçin*, (Shqipëri) etj.

-*së dyti*, me qëllim të vënies së një rregulle në përdorimin e tyre, nga më shumë përdorime, sidomos menjëherë pas luftës së vitit 1999, siç ishte rasti me oikonimet: *Suharekë - Sufrekë - Sukrekë - Sukrrk - Suhari* e madje edhe *Thatinë*, për të propozuar së fundi emrin e vjetër *Therandë*, si emër i lashtë i kësaj rrethine, ose: *Kamenicë-Gurasan-Gurash, Gurinë-Temal*, për *Dardanë; Bishtagjin-Bistrashhin-Bishtrashin*, për *Bishtashin* (Gjakovë) etj.

Nga të dhënat e paraqitura dhe ato të cilat, për shkak të natyrës së këtij shkrimi, kësaj radhe nuk po i vëmë në spikamë, del se sikurse studiuesve të tjerë të kësaj fushe, të cilëve sa herë që iu dha rasti të marrin në vështrim emra vendesh të këtij nënqielli, edhe komisioni në fjalë u përpoq të japë ndihmesën e tij në ndriçimin e shumë toponimeve, jo nga teke amatore e diletante, por të mbështetur në të dhënat shkencore që i pati në dorë e sipas parimit: “ më e hershmja në vend të më të resë”, ngase historikisht shqiptarët, në të dyja anët e kufirit, shfaqen të shkujdesur në lidhje me toponiminë, në hapësirat e të cilëve, veç fondit vendës, ndeshen me shumicë toponime antike greke, romake e hebreje; toponime bizantine e starosllave, osmane e arabe, kelte e gjermanike, franko-normande e italo-venete, shkurt: toponimi i cili i ngjan një palipsesti, ku çdo autoritet apo ushtri e huaj ka lënë gjurmën e vet<sup>69</sup>, kjo nga fakti se shqiptarët në Kosovë dhe në vise të tjera të Ballkanit, duke përfshirë edhe

---

<sup>69</sup> Prof. dr. Shaban Sinani, *Kur miti është ngritur në dëm të tjetrit* ( në vend të parathënies ), te botimi i Begzad Baliut, *Demitizimi dhe standardizimi*, Tiranë, 2006, f. 6.

shtetin etnik shqiptar (deri vonë), kurrë nuk e patën fuçinë e vendosjes, jo ndaj të tjerëve, por as për vetvetën, edhe pse fjala është për një popull të vjetër e vendës në trojet e veta. Në vitin 168 para erës sonë, Iliria u pushtua nga romakët; në shekullin VII trojet shqiptare u pushtuan nga sllavët, kurse në shekullin XV nga turqit osmanë, gjysma e të cilave troje, edhe pas largimit të këtij pushteti, për fat të keq, mbesin nën sllavët edhe deri në ditët e sotme.

Duke pasur parasysh këto fakte, duhet pranuar se të "bardhat" e rrjedhave historike dhe të përmbysjeve të mëdha të popujt ballkanikë e jo vetëm ballkanikë, asnjë popull dhe asnjë vend nuk ka mundur të mbesë "i virgjër" e pa ndikime nga një popull tjetër: në doke, në zakone, në gjuhë, po edhe në fushën e onomastikës-toponimisë dhe shih për këtë, shumë mikro e makrotoponimeve gjatë dekadave edhe u janë ndryshuar, si forma, ashtu edhe kuptimi, sidomos nga ata popuj që e kanë pasur pushtetin dhe administratën në duart e tyre, duke u dhënë onomave formën e gjuhës së tyre, pa marrë parasysh se a ju kanë takuar apo jo ato vende. Por nuk janë të rralla rastet të ballafaqjme edhe mjaft "rezervate" të tilla që dëshmojnë, sa për një ndërlidhje mentalitetesh tona, po aq edhe për një - të themi tolerance të popujve edhe në këtë fushë. Kjo dëshmohet edhe me sa makrotoponime joshqipe (sllave) që i ndeshim në Shqipëri (*Kamenicë, Berat, Dropull, Konispol, Velipojë, Zadrinë, Zagori, Qorovodë, Novoselë etj.*); sa të tjera josllave në Serbi (*Kalimegdan, Ada Cignalija, Skënderbegova ulica, Çair te Nishi e po deshët edhe Nishi*), pastaj *Çair, Saraj.. në Maqedoni; sa jobullgare (d.m.th. josllave) në Bullgari*, madje edhe *Sofja* është emër i etimonit josllav; sa jogreke-sllave e shqipe në Greqi (*Gardhiqi, Kriekuqi, Hundekuqi...*, të të cilat toponime, po të përjashtohet greqishtja, në vështrim vjen vetëm prejardhja shqipe e tyre<sup>70</sup>); sa toponime me etimologji sllave i ndeshim në Rumani (*Bistrica, Crasna, Lipovaj*), pastaj në Hungari (*Budin e Peshta, Peçuj, Velika Kanizha, Estergon, Dombovar, Solnik, Vesprem, Congrad, Çrn Grad, Crn Grad*), e madje disa toponime jogjermanike (sllave) i hasim edhe në arealin austriako-gjerman (*Feistritz Rudnik, nga Bistricë, Rudunec nga Rudnik, Leibnitz nga Lipovice*, ashtu si edhe emri i qytetit *Graz* që del nga një *Gradac* - sllav) etj.

Në kontekst të kësaj, të kalimit të kufijve etnikë e gjuhësorë, po përmendim se edhe emri *Ballkan* i gadishullit të botës mesdhetare përdoret kështu, edhe pse është fjalë turke që

---

<sup>70</sup> Akademik Idriz Ajeti, *Njësia brenda ndryshimev e ka vlerëabsolute*, Gjuha shqipe, nr. 1, Prishtinë, 1987, 7 - 8

do të thotë “mal- malësi” dhe nuk quhet *Stara Pllanina*. Edhe *Konstadinopoja*, ndonëse nuk është fjalë e etimonit turk, por grek (*Konstandinopolis*), turqit nuk ja kanë ndërruar formën në mënyrë arbitrare. Madje edhe emrat e kontinenteve të mëdha: *Azia*, *Afrika* (dhe *Evropa*) nuk janë të burimit të gjuhëve të tyre, por megjithatë ruhen si të tilla.

Për dallim nga këto raste, qëndron më afër mendsh dhe e pranueshme që ato emërvende të cilat në territoret tona janë më të frikshme dhe të imponuara nga pushtuesit, edhe të ndryshohen siç u shprehëm më lartë, por gjithësesi duke i matur gjërat me saktësi. Sepse, sa është i papranueshëm imponimi dhe arbitrariteti i emërtimeve të vendeve, po aq është i paparë edhe konvertimi, ta quajmë standardizim i çdo emërvendi me prejardhje të huaj, për gjuhën dhe popullin tjetër që ka jetuar ose jeton tani aty. Të dy ekstremet janë njëlloj të dëmshme, pra edhe ky i fundit, meqë janë disa toponime në trevat tona të cilat, edhe po të donim, vështirë se mund të “standardizohen”. Mund ta bëjmë, bie fjala, *Novobërdën - Artanë* ose edhe *Bërda e Re*, siç e ndeshim te “*Kosova në vështrim enciklopedik*”<sup>71</sup>, por emërtimi ndryshe i kësaj qyteze vështirë se do të pranohet. Si *Novobërdë*, shprehet me të drejtë studiuesi dr. Bahtijar Kryeziu, është vështirë se do të pranohet, se është shënuar në harta gjeografike, ka hyrë edhe në nomenklaturën botërore dhe nuk gjenden dot shpjegime fonetike, morfologjike a semantike për ta shndërruar në *Artanë*. Pavarësisht nga kjo që u tha, konsiderojmë se hetimet dhe gjykimet e herëpashershme të studiuesve tanë, si dhe kërkesat e popullatës shumicë aty ku ajo është, që disa toponime (kryesisht oikonime) të kthehen në gjendjen e më parshme ose të rimotivohen e të standardizohen, është një e drejtë e pamohueshme dhe e ligjshme e tyre, e cila nuk ka të bëjë me një lëvizje ultranacionale. Në frymën e këtij parimi janë kryesisht edhe mëtimet e onomaseistëve tanë e, edhe puna e Komisionit Qendror për Standardizimin e Emërvendeve, si një projektpropozim (me ndonjë vërejtje që mund t’i bëhet), e të cilat propozime e vlerësime është mirë t’i kenë parasysh, si strukturat shoqërore-politike dhe ato ekzekutive, me rastin e miratimit të vendimeve për korrigjimin e regjistrit të disa toponimeve, ashtu edhe ekspertët tanë të cilët, në sja të kësaj lënde të përfillshme toponimike do të mund të bënin studime edhe më të thelluara, me qëllim të ofrimit të ndihmesës së tyre të vyer, si sot ashtu edhe nesër.

---

<sup>71</sup> *Kosova në vështrim enciklopedik*, AShSh, Tiranë, 1999, 14 - 15.

## **KREU IV**

### **13. Historia e emrave familjarë ( patronimeve të Gjakovës )**

Zhvillimi i mbiemrave tek shqiptarët thuhet se është bërë nga shek. XII-XX. Në rreth 5-6 shekuj histori, procesi i vënies së mbiemrave ka ecur nga lart poshtë. Kështu, fillimisht janë pajisur me mbiemra shtresat e larta, më pas shtresat e hierarkisë fetare, ndërsa më vonë ka zbritur deri në shtresat e ulëta. Qëllimi fillestar i mbiemrave ka qenë për të dalluar njerëzit nga njëri-tjetri në drejtim të perjardhjes së tyre. Çlirim Bidollari në studimin e tij “Hulumtime onomastike” thotë se në periudhën para formimit të principatave feudale arbërore në shekullin e 12-të, vijon identifikimi i njerëzve sipas titujve e ofiqeve, veçanërisht kur bëhet fjalë për hierarkinë e lartë të kishës. Por, meqë zona jonë e interesit në këtë studim është zona

e Gjakovës, atëhere fokusin e përqëndrimit kohor duhet ta zhvendosim shumë shekuj më vonë sepse vetë Gjakova si vendbanim përmendet për herë të parë në 1594 kur përfundon së ndërtuari xhamia e Hadumit, hani, hamami dhe dyqanet përreth, ndërsa në vitet 1605 - 1606 asaj iu njoh statusi i Kasabhasë.

Me vendosjen e pushtetit turk dhe me procesin e islamizimit, gjithmonë dhe në një numër më të madh njerëzish, filloj të përhapet mënyra e identifikimit të vendasve si myslimanë-nënshtetas të perandorisë osmane, sipas formulës identifikuese: X i biri i Y, ku me kalimin e dekadave nën pushtim, edhe X edhe Y paraqiteshin gjithnjë e më tepër si emra islamikë: Sinani i biri i Hysenit, Bajrami i biri i Rrustemit. Po kështu fillojnë të shfaqen edhe titujt administrativë fetarë, feudalë ose ushtarakë si p.sh.: Ali Hoxha, Osman Beu, Hysen Spahiu.

Nga pikëpamja gjuhësore lënda që do trajtohet shfaq një interes të zgjeruar sepse bëhet fjalë për patronime të formuara në mënyra të ndryshme, të cilat i japin larmi emrave të familjeve-mbiemrave të banorëve të kësaj ane.

Duke u bazuar në klasifikime patronimesh të përdorura nga studiues të huaj dhe që po ashtu janë shfrytëzuar si model edhe nga studiues shqiptarë, edhe unë lëndën time në këtë drejtim do të përpiqemi që ta klasifikoj në katër lloje:

**a/.** mbiemra që lindin nga zona (qyteti a fshati) e prejardhjes;

**b/.** emra prindërisht të kthyer në mbiemra:

**c/.** mbiemra që tregojnë zanate, profesione, tituj e ofiqe;

**ç/.** mbiemra të formuar në formën e nofkave e llagapeve etj. Por meqë këto katër kategori nuk mund të shpjegojnë një sasi të mbetur, mbiemrash, atëhere kategoria e pestë do të duhej të ishte:

**d/.** patronime të pashpjegueshme, në të cilat do të përfshihen ata mbiemra për të cilët sistemi i sotëm gjuhësor nuk jep shpjegime.

Le t'i trajtojmë të gjitha këto me rradhë.

### **13.1. Patronime nga emërvende ( toponime ) të ndryshme**



## të Kosovës, Shqipërisë dhe Malit të Zi etj.

Në Gjakovë është shumë e pranishme kjo lloj mënyre e ndërtimit të mbiemrit i cili tregon vendin se nga ka ardhur fisi ose familja në historinë e saj para disa gjeneratash. Është një numër i konsiderueshëm i mbiemrave që janë formuar në mënyrë të tillë, pra kanë marrë emrin nga lokacioni a vendbanimi të cilit i ka përkitur a i përket familja. Për këtë arsye ata quhen **mbiemra prejtoponimikë**, si p.sh.: Ashta, Arbana, Brovina, Byci (Beci ), Batusha, Bellanica, Bishtazhini, Babuni, Barbullushi, Berdosana, Bytyqi, Brari, Bellaja, Belegu, Blinishti, Bushati, Bellacerka, Berani, Cermjani, Cahani, Carrabregu, Deva, Dajqi, Drishti, Dujaka, Dobruna, Devolli, Damjani, Dobra, Dajçi, Doblbarja, Doli, Drini, Dushku (zona e Dushkajës), Dobroshi, Fishta, Firza, Gola, Gexha, Gucia, Gurakuqi, Godeni, Gurkuqi, Gruda, Gërçina, Gashi, Glllogjani, Gërçari, Gradeci, Guska, Gjocaj, Gjonaj Hoti, Hereqi, Hasi (zona e Hasit), Haxhosaj, Isniqi, Irzniqi, Juniku, Jubani, Jahoci, Jasiqi, Kaçinari, Kakeli, Kopliku, Kashnjeti, Kallmeti, Keta, Kodheli, Këlleti, Kelmendi, Kusari, Kika, Kuka, Kopili, Korenica, Kosturi, Kraja, Kastrati, Kakarriqi, Karadaku, Kaçinari, Krushevci, Krusha, Kruma, Kabashi, Kralani, Kolonja, Kaliqani, Lipoveci, Letaj, Luma, Luboteni, Llapçeva, Lluca, Lloqani, Llohani, Molliqi, Mazreku, Mamusha, Mjeda, Morina, Mirdita, Maloku, Muhadri, Meqa, Mrasori, Nivokazi, Novosella, Oseku, Oroshi, Pjetershani, Ponosheci, Petrela, Peza, Popoci, Paçrami, Peqini, Pacaj, Pagarusha, Patoku, Pirana, Pnishi, Prilepi, Prushi (Qafa e Prushit), Qerimi, Qarri, Raqa, Repishti, Reçi, Rrjolli, Rogova (Hasit), Rugova (Pejë), Radoniqi, Rodotina, Romaja, Ratkoceri, Rakaj, (Rakoc), Ramosaj, Rakovina, Rakoci, Rastavica, Radosta, Rraci (Rracaj), Skivjani, Skenderaj, Smolica, Smaqi, Stublla, Strellci, Shipshani, Samadragja, Sopot, Shishmani, Shpuza, Shala, Sheremeti, Shllaku, Shupali, Sharra, Sheshi, Shkreli, Vora, Vokshi, Vaqari, Vrap, Shëngjergji, Temali, Tropoja, Trakaniqi, Xërxa, Zabeli, Zatriqi, Zadrime, Zhuri, Zhubi, etj. Shumica e patronimeve të sipërpërmendura janë mbiemra aktivë tek gjakovarët e sotëm, dhe prejardhja e këtyre mbiemrave nuk është gjë tjetër veçse rast i formimit të mbiemrit nga zona e prejardhjes së fisit, familjes a individit të vendosur kohë më parë në Gjakovë. Përveç këtyre emrave që i përkasin zonave të vogla si fshatra a lokacione të caktuara, janë të pranishëm edhe pse më rrallë:

Dibra, Elbasani, Fieri, Gostivari, Gjakova, Janina, Kaçaniku, Kavaja, Kumanova, Lezha, Mitrovica, Peja, Podgorica, Puka, Prizreni, Struga, Shkupi, Shkodra, Tropoja, Tetova, Tivari, Tuzi, Ulqini, Vlora, Vushtria ( ish Vuçiterna ) etj.

*Ndodh edhe që patronimi të shërbejë si saktësues për emrin vetjak, pra saktësues për* identifikimin e mëtejshëm të emrit. Në këtë rast patronimi vjen nga një etnonim: AXHEMI (në arabisht shenjon të gjithë ata që nuk janë arabë, pra janë të huaj), BOSHNJAKU ( familje emigrantësh nga Bosnja), GEGA ( i trevave veriore ), ÇERKEZI (përfaqësues i një kombi që ka ardhur tek ne si ushtar dhe ka mbetur aty), GRËZDA (Gjakovë, Tiranë, Shkodër, Kukës) nga një fjalë e shqipes *gres /ë-a, grezd /ë-a*, me burim nga italishtja *agreste* me kuptimin “rrush i papjekur, aguridhe”. Pra, kemi të bëjmë me një patronim nga një *nofkë*, sepse fjala *aguridhe* është përdorur në kuptim figurativ, madje haset edhe në këtë trajtë si patronim~ *Agurilli, ~Agurillja* në Berat e Vlorë. (Sipas “Fjalor i patronimeve të shqiptarëve” të autorit Çlirim Bidollari f.132). HORASÁNI (Gjakovë, Prizren, Tiranë) nga një fjalë e shqipes *harasan-i, horasan-i*, me burim prej turqishtes *horasan* “ilaç me gëlqere, rërë e pluhur tullash (në vend të çimentos)” që lidhet me emrin provincës më të madhe e të zhvilluar në verilindje të Iranit *Horosan*. Ka të dhëna për një origjinë të këtyre familjeve prej kësaj krahine të Iranit, të ardhur si misionarë të islamizimit të shqiptarëve, por nuk duhet përjashtuar krejt as mundësia e lidhjes me *horasanin* si material ndërtimi ( shtëpi horasan në Kosovë), duke e bërë kështu patronimin në shqyrtim të prejardhur, ose nga emri i materialit të ndërtimit, për të shenjuar tërthorazi profesionin e ndërtuesit, muratorit ~*Karasani* ( Dibër, Durrës) Sipas (“Fjalor i patronimeve të shqiptarëve” të autorit Çlirim Bidollari f.153).

MALOKU banor i Malësisë, veriore), MAXHARRI (familje e lidhur me Hungarinë). Për patronimet e fundit mbetet e diskutueshme nëse kanë të bëjnë me kombësinë e të shenjuarve apo me apelativët që motivohen nga emrat e këtyre kombeve. Në literaturën onomastike ky tip identifikimi përcaktohet si një formë përshkruese dhe në një farë kuptimi ai është konvencional. Çlirim Bidollari mban mendimin se shqiptarët i kanë shtënë në punë me lehtësinë më të madhe emrat e vendeve, që nga atdheu i largët e deri tek fshatrat më të vegjël. Megjithatë Bidollari mendon se ky lloj mbiemrash ka ardhur duke u rrudhur, pasi ka përjetuar disa kulme në shekullin 15-të, 19-të dhe vitet e para pas Luftës së Dytë Botërore,

pikërisht, në mesin e shekullit XX, që ky lloj patronimi hyri në modë. Megjithatë në gjendjen e sotme të sistemit patronimik shqiptar, ky tip konsiderohet i mbyllur. Përdorimi i tij i zgjeruar vihet re edhe sot e kësaj dite në Gjakovë. MUHAXHIRI (familje të shpërngulura), OSMANI (familje të lidhura me Turqinë osmane por jo domosdoshmërisht me origjinë osmane), SARAÇINI (që lidhet me saracenët).

### **13.2. Patronime nga emri i etërve me ose pa prapashtesa**

Në pasurinë e përgjithshme të patronimeve shqiptare, mbiemrat e formuar nga emri i paraardhësit, konkretisht i babës, përbëjnë rreth 40 përqind të numrit të përgjithshëm, dhe një tablo e tillë na del e pranishme edhe tek banorët e Gjakovës. Mbiemrat me zanafillë nga atësia kanë një arsye logjike të lindjes së tyre. Në këtë nënloj patronimesh mund të dallojmë dy areale:

**a/. areali katolik që shfaqet me trajtat karakteristike të emrave të krishterë dhe**

**b/. areali mysliman që përfshin emra dhe variante të tyre nga gjuhët orientale.**

AHMETI, ASLLANI, ALIA, ARIFI, AJDINI, AJETI, AVDIJA, AVDYLI, AZIZAJ, ADEMI, AGUSHI, BAFTIJA, BAFTIJARI, BAJRAMI, BEJTULLAHU, BEKA, BEKAJ, BEQIRI, BEQIRAJ, BEXHETI, BEZHANI, BEZHI, BIBAJ, BINAKU, BINAKAJ, BRAHA, DAUTI, DUKA, DULA, DELIJAJ, DEDA, DEDAJ, DEDUSHI, DODA, DEMIRI, DEMIRAJ, DERVISHI, DERVISHAJ, DILA, ELEZI, EMINI, FETAHU, FERIZI, FROKAJ, GEGA, GEGAJ, GJINI, GJERGJI, GJONI, GJELOSHI, GJOKA, HABIBI, HAJDARI, HAJREDINI, HAJREDINAJ, HAJRIZAJ, HALILAJ, HALITI, HASANI, HASANAJ, HAXHIJA, HAXHIU, HYSENI, IBISHI, (I)BRAHIMI, ISUFI, IBRUKA, ILJAZI, ISLAMI, ISLAMAJ, JETISHI, JASHARI, JAKUPI, JANUZI, KAMBERI, KADRIJA, KADRIJAJ, KASUMI, KOLA, KOLAJ, LIMANI, LEKA, LEKAJ, LULAJ, LULI, LUSHA, LUSHAJ, LLESHI, PREKA, MALA, MALAJ, MARKU, MARKAJ, MAXHUNI, MEHMETI, MURATI, MUSLIA, MUSLIU, MUSTAFA, NIKOLLAJ, NIMANI, NIKA, NDRECA, OSMANI, OSMANAJ, QUNI, QAUSHI, QEMAJLI, QERIMI, QUNAJ, RAMA, RAMAJ, RRUSTA, RRUSTAJ, SADIKU,

SADIKAJ, SADRIJA, SALIHU, SAHITI, SOKOLI, SYLA, SELIMI, SELIMAJ, SKËNDERAJ, SHYTI, TUNA, TUNAJ, UKSHINI, VELIU, TAHIRI, TAHIRAJ, ZEFI, ZENELI, ZENELAJ, ZEKA, ZEKAJ, ZENUNI, ZENUNAJ, ZYMBERI, ZYMERAJ, etj.

Vendi dhe roli i këtij lloji patronimesh është i rëndësishëm nga vetë prania e shtuar gjë e cila njëkohësisht tregon edhe dendurinë e përdorimit. Në të folmen e Gjakovës është karakteristikë fakti i thirrjes së frymorëve me emrin personal të cilit i bashkangjitet edhe mbiemri ose emri i familjes. Kjo sigurisht është një formë jashtë komunikimit formal e shkrimor, i përdorshëm në rrethe njerëzish e mjedise të ngushta. Trajta e emërores në numrin njëjës përdoret në gjinore njëjës, psh: X-si i Sahatçisë, ose Y-ni i Vulës, ku SAHATTÇIJA e VULA nuk janë emrat e prindërve por mbiemri i familjes. Tepër e pranishme në Gjakovë na del edhe ndajshtesa **-aj**, e cila në gjuhësinë tonë është pranuar si ndajshtesë e specializuar për formim patronimesh. A.Xhuvani dhe E. Çabej për ndajshtesën **-aj** vlerësonin se me këtë lloj prapashtese mundësohet formimi i patronimikave (DEDË-DEDA**J**, DEMIR-DEMIRA**J**) dhe formimi i emrave të viseve a krahinave të cilat mandej janë përdorur si material furnizues për patronime të reja (BARDHA**J**, ZOGA**J**). Rruga e formimit të patronimeve me **-aj** mendohet të ketë ardhur si rezultat i trajtës pas singularizimit të formës së shumësit: psh. Luzi i Dedajve > Luz DEDA**J**. Sipas përdorimit praktik të patronimeve në Gjakovë, vërejmë se pjesa më e madhe e atyre patronimeve që dalin me **-aj** rëndom i përkasin mbiemrave të banorëve në zonat rurale ndërsa në zonat urbane gjejmë gjithashtu të njëjtat patronime por pa ndajshtesën **-aj**. Kështu psh, gjejmë dy variantet LEKA-LEKA**J**, GJOKA-GJOKA**J**, MALA-MALA**J**, NIKA-NIKA**J**, MARKU-MARKA**J**, BAJRAMI-BAJRAMA**J**, ZENELI-ZENELA**J**, GOLA-GOLA**J** etj., gjë e cila jep të kuptohet se patronimet e krijuara në bazë të emrit të kryetarit të familjes janë përdorur pa dallim në zonat urbane a rurale por këto të fundit janë pajisur edhe me ndajshtrimin-**j**, **-aj**. Marrë në tërësi, ky lloj mbiemërformimi duket se e ka tendencën e identifikimit sa më të saktë të subjektit, duke e futur në punë emrin e të atit, gjë e cila gradualisht e kthen këtë të fundit në mbiemër të vetë individit. Po këtu na dalin edhe raste të mbiemrave të përngjitur:GJONKOLA**J**,MARKAGJONA**J**, GJONDEDA**J**, NDUELLESHI, PERKOLA, PERDODA, DEDNIKA**J**, MARAKOLA, LEKMARKU, BIBLEKA**J**, DEMALIJA, DEMJAHA, DOMGJONI, DYLPAJA, DONGJONI, DYLAUKA, DYLAZEKA, GURKUQI, GJONBALA**J**, HALILABA**ZI**, HAFIZADEMI, HAXHIAVDIJA, HAXHIAVDYLI, HAXHIJAHA, HIMTAHIRI,

HAXHISMAJLI,

KADRIQELI, KURTPALI, LAMABEGU, LAMAXHEMALLESHDEDA, MALAZOGU, MARAKOLA, MARKJAKAJ, METAHYSA, MULLAHASANI, MULLADEMI, MULLAEJUPI, MULLAHASANI, SALIUKA, MULLAXHELA, MUSHKOLAJ, NDUEPRENI, NIKOLLBIBAJ, NUZAMALA, SEFSALIHU, SYLMETAJ, SYLMANAJ, UKLLESHI, XHEMBALAJ etj.

Këto janë patronime dy a më shumë pjesëshe të cilët nuk mjaftohen vetëm me emrin e një paraardhësi por ndërtohen me emrat e përfaqësuesve të disa brezave. Kjo mund të ketë ndodhur si shkak i ndarjes nga trungu familjar dhe meqë ka sunduar familja e madhe patriarkale çdo ndarje duhet të sillte mbartjen e emrit të familjes së madhe. Por mund të ketë ardhur edhe si shkak i zvogëlimit të fondit të emrave fetarë kalendarikë. Kjo dukuri nuk ka ndodhur vetëm tek popullata e besimit të krishterë por edhe tek ajo myslimane. Mund të përmendim raste si: BEJTULLAHU, RAMAZANI, RAMADANI, SHAHSIVARI, AVDIU etj. Një vend të posaçëm zënë edhe trajtat e shkurtëra të patronimizuara, p.sh.: patronimi HIL-A vjen nga emri MËHILL, NIK-A nga NIKOLLË, NDUE ose NDOC-I nga ANTON, AVDIU ose AVDIAJ nga ABDULLAH, SULA nga SULEJMAN, RRUSTA nga RRUSTEM, etj. Në lidhje me këtë lloj formimi patronimesh që është i përhapur tek të gjithë shqiptarët dhe jo vetëm tek gjakovarët, Thimi Mitko tek *“Bleta shqiptare”* thotë se këta janë emra sikundër sikundër i kanë përdorur prindërit tanë që moti, pra duke ruajtur ermin e pararendësit ku ka lindur tendenca e mbiemërforimimit.

### 13.3. Patronime shqiptare me origjinë nga leksiku i zejeve popullore

Nga të gjitha ndarjet e onomastikës, më shumë ndikim nga ndikimi turk ka pësuar **antroponimia**, veçanërisht **patronimia** për arsye se procesi i saj nisi dhe mbaroi brenda sundimit osman. Për shkak të përfshirjes në sistemin feudalo-ushtarak, terminologjia orientale u shtri gjerë e gjatë në të gjitha fushat prandaj, edhe sot e kësaj dite ne trashëgojmë një ngarkesë të konsiderueshme orientale. Por është e çuditshme se si prapashtesat turke **-xhi**, **-lli** janë fare pak të pranishme në patronimet e Gjakovës: RIZVANOLLI, ÇARKAXHIU. Për këtë tip patronimesh që tregojnë zanate e tituj, Bidollari konsideron se fillimisht ka shërbyer si karakterizues shtesë që iu atribuoheshin njerëzve që ushtronin profesione të caktuara, zanate a

funksione. Me kalimin e kohës, duke pasur prirjen të bëhen të trashëgueshëm, kur ky profesion e arrinte këte trashëgëmi nga njëri brez në tjetrin, ai pasohej nga pasardhësit duke “detyruar” të njëjtën gjë edhe për patronimin. Meqë zanatet a mjeshtëritë monopolizoheshin, sidomos zanatet fisnike, atëherë edhe trashëgimi i mbiemrit konsiderohej si një vlerë me peshë. Për familje a anëtarë familjesh që për një kohë të gjatë ushtruan një zeje, emri i zanatit u shndërrua në patronim pasi filloi të shenjojë familjen e ushtruesit të zejës, qoftë edhe kur ai e kishte lënë së ushtruar atë profesion. Të tilla janë patronimet: TERZIU (rrobaqepës), BAKALLI (shitës i gjësendeve të ndryshme), TABAKU (lëkurëpunues), NALLBANI (mbathës i kuajve, gomarëve, qeve), SARAÇI (pajisje për kuaj), KAZAZI (përpunues i mëndafshit), KOVAÇI ( farkëtar ), SAHATÇIJA ( orëndreqës ), ÇARKAXHIJA, BARUTI, ( për punimin e armëve ), KAMISHI ( zeje për punimin e mjetit për thithjen e duhanit ), FURRA (bukëpjekës), KASAPI, (me therjen dhe shitjen e mishit), KOSAÇI (prerës i barit të livadheve, mjet pune *kosa* dhe prapashtesa-*çi kosaçi*. HARAÇIJA (taksambledhës), GËRÇARI ( baltëpunues ), BERBERI (rrojtar ), BINXHIJA ( kalorës ), KERRAXHIJA (qerrepunues), SEREMI, CINGU, ( me kuptimin e diçkaje të vogël – *cingël* ), SHALA (shalëpunues për kuaj), SADA ( lokal ku janë pirë kftë kryesisht pa sheqer), PAPUÇINI mbathje për vajza e gra, ndreqës i këpucëve, nga një emër profesioni), KOBURJA (armë brezi, me punimin e armëve), PUSHKA, BRISKU, NALLONEGJIA (mbathje prej druri për gjininë femërore), BUNARI (që është marrë me hapje bunarësh për furnizim me ujë), QYMYRI (lëndë e parë për ndezje zjarri), ZIDI (nga sllav. *Muri* mjeshtër për ndërtime të mureve, murator-sllav.zidar), JARGANXHIJA (zejtar në punimin e jorganeve), KODUMI (instrument muzikor oriental), LLULLUNI (zeje me burim nga turqishtja me kuptimin e njohur të “çibukut”mjet për të thithur duhanin), KOSHI ( zeje për thurjen e koshave me thupra), etj. Meqë në Gjakovë janë punuar dhe ushtruar me dhjetëra zeje të cilat janë trashëguar tek gjeneratat e reja, prej tyre kanë mbetur një numër i konsiderueshëm patronimesh. Por duhet cekur se jo çdo zeje a profesion ka lënë pas në ditët e sotme një patronim. Nga pikëpamja gjuhësore, kjo kategori paraqitet e pasur, me mbizotërim nga fjalët-rrënjë orientale. Në rastet më të shpeshta ato i takojnë jetës qytetare meqë zejet u zhvilluan brenda në qytet ku ishin rangjet e esnafëve.

Onomastika dëshmon se shqiptarët kanë parapëlqyer jo në pak raste të përdorin si antroponime dhe patronimet emrat e objekteve të mjediseve ku kanë jetuar dhe punuar. Në

këtë studim do të merremi me emrat e familjeve shqiptare, që e kanë burimin në leksikon që lidhet me zejet popullore.

Populli ynë kurdoherë e ka dashur punën dhe e do atë, ai ka punuar tërë jetën e tij dhe kjo e ka mbajtur gjallë. Prandaj, shekujt, mjerimet e regjimet skllavëruese nuk e kanë zhdukur atë. Për këtë fakt shkruajnë studiues shqiptarë e të huaj, udhëtarë e kronistë, që kanë vizituar viset e ndryshme shqiptare në kohë të ndryshme dhe, mes tjerash si dëshmi janë edhe emrat familjarë që lidhen me punën dhe zejet.

Studiues të ndryshëm, e veçanërisht J. G.Hani, L. Taloci, K.Jireçeku, M. Shuflai, Z. Shkodra etj., kanë vënë në dukje nivelin e ngritur të jetës qytetare, lulëzimin e forcave prodhuese në lëmin e zejtarisë, të artit dhe të tregtisë në periudha të ndryshme. Në sferën e prodhimit zejtar shekulli XVII shënoi fillimin e një periudhe të re të zhvillimit. Më të përhapura ishin zejet e punimit të lëkurëve, të metaleve, të ushqimeve dhe të ndërtimeve<sup>72</sup>.

Në Gjakovë, punimi i lëkurëve, përveç një numri të shumtë të zejeve që ushtroheshin në këtë qytet, ndër zejet e rralla që janë punuar është edhe ai i tabakëve (lëkurëpunuesit), gjë të cilën e dëshmon numri i madh i dyqaneve në Çarshinë e Madhe, e cila sipas raportit të Myllerit më 1838 “përbante 1100 dyqane, të cilat gati të gjitha janë të mbushura me mallra të ndryshme”

Nga kjo shumësi e zejeve mund të përmendim vetëm tabakët prodhuesit e lëkurëve të bardha dhe të zeza, sepse Gjakova ishte një qytet me burime të pasura uji që paraqiste një parakusht të rëndësishëm për organizimin e punishteve të tabakëve. Në gjysmën e dytë të shek. XIX në Gjakovë kishte 60 tabakhane që prodhonin sasi të mëdha sidomos **saftjani** dhe qosela e butë dhe e qëndrueshme (**Saftjani** = lëkurë dhie a deleje të hollë dhe e butë, e cila ngjyhet dhe lëmohej sa të shkëlqejë, këpucë saftjani, kolltuçe me lëkurë saftjani) . Këtë e dëshmon edhe prania e emrit familjar **Tabaku**, (veçanërisht në Gjakovë) i cili është aq shumë i përhapur, sidomos në qytetet që shquheshin për punimin e lëkurëve si: Shkodra, Gjakova, Prizreni, Elbasani e Shkupi. Po ky patronim, në shekullin XVI gjendet dhe në qytetet Dibër e Delvinë, ndonëse i kufizuar nga dy raste për secilin qytet)<sup>73</sup>. Lidhur me këtë zeje ka qenë e zhvilluar edhe gëzoftaria, nga fjalori i së cilës në shek. XVI kemi të dokumentuar patronimin **Çurçiu (Hasan Çurçiu nga Ak-Hisari)**<sup>74</sup>. Nga ky fond sot

<sup>72</sup> Z. Shkodra, “Esnafet shqiptare” ( shek.XV-XX ), Tiranë 1973, f. 59.

<sup>73</sup> RKSO, f. 41, DD, f. 20

<sup>74</sup> RKSO, f. 41.

përdoren ende patronimet Qyrkçiu ( në Shkodër **Çurçia**), dhe Qyrku, Ndërsa nga zeja e punimit të këpucëve, në Mesjetë, ka qenë në përdorim patronimi **Këpuca ( Gjergj Kipuci**, fshati Darshë, dhe **Gjon Kipuci**, fshati Kërash (në Vilajetin e Dibrës së Poshtme)<sup>75</sup> dhe **Kasem Kipuci** (fshati Zuman, Kazaja e Krujës)<sup>76</sup>. Nga zeja e endjes së pëlhurave vijjnë patronimet: **Kazazi, Masuri, Meçiku, Vega** etj. Në qytetet Shkodër, Elbasan, Tiranë, Prizren e Gjakovë, ku ka qenë e zhvilluar kjo zeje, emri familjar **Kazazi** takohet dendur edhe sot. Në kuadrin e qytetit mesjetar, në Shqipëri mori hov edhe zhvillimi i zejeve artistike, si rrobaqepësia, punimet prej mëndafshi, argjendaria dhe zbukurimi i armëve.

Nga leksiku i kësaj sfere kanë ardhur patronimet: **Argjendari, Kujxhia, Unaza, Vëthi** etj. Në Defterin e Dibrës (1467), për fshatin Bullaç dokumentohet: **Bogdan Zllatari** (sllavisht zllatar-argjendar) Patronimi Argjendari dokumentohet në ” Mukataa defter” të vitit 1479-1480 të minierës së Novobërdës Kosovë)<sup>77</sup>. Edhe rrobaqepësia u përhap mjaft në qytetet shqiptare të asaj periudhe. Dëshmi për këtë janë, mes të tjerash patronimet: **Çakshiri, Fistani, Jaka, Jeleku, Bërshimi, Terziu, Gajtani** etj. (Në ndonjë rast patronimi Gajtani është me origjinë toponimike, nga emri i fshatit Gajtan, rrethi i Shkodrës). Patronimi **Terziu** gjendet në Regjistrin e Ohrit të vitit 1580 (**Hysen Terziu**, banor i qytetit të Krujës, f. 41). Në qytetet shqiptare u zhvillua gjerësisht edhe zeja e përpunimit të metaleve, Mjeshtrit shqiptarë prodhonin mjete e vegla pune, orendi shtëpiake prej metali, gozhdë e, sidomos, armë. Prania e një numri të madh patronimesh me origjinë nga leksiku i kësaj sfere e vërteton më së miri këtë zhvillim. Kësisoj janë patronimet: **Arma, Bakri, Biçaku, Brisku, Çeliku, Demirxhiu, Dana, Farka, Huta, Kazanxhiu, Kosa, Kovaçi, Kondakçiu, Saxhaku, Spatari, Tagani, Thika** etj. Shumica e të cilave dokumentohen në të gjitha trevat e banuara nga shqiptarët në veri dhe jug. Patronimet **Kordha, Spata** dhe **Lata** (lloj sëpate ), dokumentohen edhe në Regjistrin osmano-turk të shqiptarëve të Peloponezit në shek. XV<sup>78</sup>.

Krahas zejeve të tjera u zhvillua edhe ajo e përpunimit të drurit. Nga emërtimet e kësaj sfere lindën patronimet: **Arkaxhiu, Qerraxhia, Djepaxhiu, Lundraxhia, Dërrasa, Kutixhia, kacaxhia, Nallonexhia, Zdrukthi** etj.

---

<sup>75</sup> DEVD, f. 26,28.

<sup>76</sup> RKSO, f. 75.

<sup>77</sup> S. Rizaj “Disa tëdhëna antroponimike të toponomastikës mbi popullsinë e Kosovës në shek. XIV - XV në dritën e burimeve osmane”, “Onomastikae Kosovës”, Prishtinë , 1979, f. 158.

<sup>78</sup> Thoma Kacorri-Stojkov, “Regjistri osmano-turk i shek XV ”, në “Studime historike”, 1966, Nr. 3, f. 156.



Zhvillimi i zejtarisë dhe tregtisë ndikoi në rritjen e qytetarëve që tërhiqnin gjithnjë e më shumë forca prodhuese, çka shtronte si kërkesë zhvillimin urbanistik, ndërtimin e shtëpive të banimit, të institucioneve sociale dhe të objekteve të kultit. Në punimet urbanistike dhe arkitekurore ndërtuesit shqiptarë dalloheshin për mjeshtërinë e ndërtimit të godinave qytetare, të rrugëve, urave çezmave etj. Rritja e numrit të ndërtuesve ndikoi, pa dyshim, në pasurimin e fondit të emrave familjarë me emërtime të reja. Të tillë janë: **Gjin Murati** (muratori)<sup>79</sup> dhe Gjergj Limaçi<sup>80</sup> në shek. XV Thimi Mitkoja ka regjistruar në shekullin XIX patronimet **Muri** dhe **Themeli**. Sot, emërtimet me fjalë nga leksiku i sferës së ndërtimit gjenden me shumicë. Është interesant se gjatë studimit të kësaj disipline gjuhësore që, ndoshta, shpeshherë nuk i kemi vu re shofim se më të përhapurat janë patronimet: **Çatia, Çekiçi, Çezmja, Gëlqerja, Harasani, Plumbini, Pullazi, Rruga, Themeli, Ura**, etj.

Përgatitja e mirë profesionale dhe puna plot shije e mjeshtërve tanë duket edhe në zhvillimin e artikujve ushqimorë. Zejet ekësaj sferë ishin tejet të zhvilluara, çka mund të vërehet edhe sot në numrin shumë të madh të familjeve shqiptare që mbajnë emra me prejardhje nga leksiku i kësaj sferë, si: **Furra, Furrxhiu, Hallva, Akçiu, Ekmekçiu, Ekmekçihone, Qebapi, Simitçiu, Sheqeri**<sup>81</sup>, **Sheqerxhia, Sheqerxhiu, Pogaçe, Kasapi, Buka**<sup>82</sup>, **Brumi**<sup>83</sup>, **Boza**<sup>84</sup>, **Gjiza**<sup>85</sup> etj.

Siç cekëm më lartë, nga shumë zona të ndryshme të Shqipërisë që zejtaria zhvillohej me një vrull të lartë të asaj kohe, pa dyshim, se i tillë ishte edhe qyteti i Gjakovës që kishte lidhje të ngushtë tregtare me Shkodrën dhe Shkupin gjë që zejtaria luajti një rol të shkëlqyer në zhvillimin ekonomik të këtij rajoni buzë kufirit me Shqipërinë dhe do të vërejmë se në ditët tona, shumica e emërtimeve të këtyre zejeve janë fiksuar në patronimi.

Të tillë janë patronimet **Papuçiu** (punues papuçes), **Saraçi** (punues objektësh prej lëkure), **Pashmakçiu** (këpucari), **Berberi**, (prerësi i flokëve), **Nallbani** (mbathtari), **Biçaku, Biçakçiu, Briskaçiu** (thikëpunues,briskëpunuesi),**Samarxhiu, Kasapi, Kafexhiu, Dylgjeri**

---

<sup>79</sup> RKSh,f,146.

<sup>80</sup> Dh. Shuteriqi ” Fjalë nga leksiku i shqipes para Buzukut ( 879-1553)” në ”Studime filologjike”, 1981, Nr. 3, f. 197.

<sup>81</sup> K.Kerçiku, “Zhvillimi I shëndetësisë në Shkodër gjatë shekujve XVII I- XX ” ,Tiranë, 1962, f. 216.

<sup>82</sup> Dh. Shuteriqi, art. i cit., f. 197.

<sup>83</sup> Po aty, f.197.

<sup>84</sup> “Shqipëria e veriut në shekullin XVIII”, vëll. II,Tiranë, 1975, f. 58.

<sup>85</sup> Dh. Shuteriqi, art. I cit. f. 158.

(patronim që shënon profesion-marangoz), **Çullhai, Bojaxhiu**, (leshpunuesi), **Bardaku, Bardakçiu** (shtanbapunuesi), **Gerçakqia** (enë e punuar dheu për ta mbushur me ujë të pijës), **Xhokaxhiu, Xherahu**, etj. Praktika e emërimit të familjeve me emrat e sferës së zejeve, meqë këto në shumicën e tyre emërtoheshin me fjalë të leksikut të turqishtes, shumë patronime që lindën nga këto emërtime kanë mbetur të ngurtësuar në formën e tyre të parë, pa iu nënshtruar procesit të pastrimit të gjuhës shqipe nga leksiku turko-arabo-persian, që filloi në kohën e Rilindjes e vazhdon edhe sot.

Me lindjen dhe zhvillimin e esnafëve shqiptarë, filluan të duken emërtime të reja familjesh nga fjalë të emërtesës së këtij institucioni, si: **Çiraku, Kallfa, Mjeshtri, Ustai, Myteveli**, etj., kryesisht të ngjuara në Shkodër, Tiranë e Krujë. Patronimin **Çausi** e gjejmë të përdorur në Gjakovë me rrethinë dhe në Prishtinë në shek. XVI<sup>86</sup>. Të kësaj periudhe janë edhe disa emra familjesh që vijnë nga emërtesa e peshëmbajtjes dhe e personave që kryenin këto punë, si: **Oka, Okaj, Derhemi, Ballanca, Bazhdari**. Patronimi **Bazhdári**, që sot shtrihet nga shumë familje në Shkodër e Tiranë (që rrjedh nga një fjalë e vjetëruar e shqipes *bazhdar-i* me burim prej turqishtes, *baždar* dhe me kuptimin e “nënpunësit që peshon mallin që futet në treg për t’u shitur si edhe të taksës së tregut”~ *Bazhdarxhiu* (Shkodër), që dokumentohet në shek. XVIII<sup>87</sup>.

Zhvillimi ekonomik i qyteteve shqiptarë në atë kohë në Shqipëri, por edhe në Gjakovë nxiti zhvillimin e tregtisë në këtë qytet, falë Shkodrës, që kishte lidhje të ngushta ekonomike e kulturore me të. Nga emërtesa e kësaj sfere kanë lindur disa patronime. Më i përhapuri në qytetin e Gjakovës është patronimi **Bakalli**<sup>88</sup>~ **Bakáli** (Gjakovë, Shkodër, Tiranë, Durrës, Elbasan, Gjirokastër). nga një fjalë e shqipes *bakall-i* me burim prej turqishtes *bakkal* “tregtar mallrash ushqimore dhe artikujsh shtëpijakë”, pra një patronim prej një emri profesioni.~ *Ballkabashi* (Durrës).

Onomastika jonë ka provuar se shqiptarët kanë parapëlqyer të përdorin si antroponime dhe patronime emrat e objekteve të mjediseve ku kanë jetuar e punuar. Në lidhje me këto lloje mund të flasim qartë rreth kuptimit që kanë por jo edhe për rrethanat në të cilat emërtimi është kthyer në mbiemër të individit-familjes. Çabej, që në Konferencën e

---

<sup>86</sup> RKSQ, f. 41.

<sup>87</sup> Shqipëria e veriu në shekullin XVIII”, Tiranë, f. 41

<sup>88</sup> S. Pulaha, Defteri i Regjistrat të Sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485”, Tiranë, 1974, f. 60; Z. Shkodra, vep. e cit., f. 203.

parë albanologjike pranon se parimi i emërimit të njerëzve, përgjithësisht meshkujve, me anë të emrave të shtazëve, si dhe prejardhja e emërtimeve prej ofiqeve, janë një nga kriteret e emërimit në shqipe. Këto lloj mbiemrash kanë marrë formën e epiteteve, me ngjyresa pozitive a negative të cilat me kalimin e kohës janë zbehur. Pas Beratit, mendohet se Gjakova është një nga qytetet që ka më së shumti “epitete” apo nofka. Për këtë arsye, këtë tip patronimesh dhe shumë të tjerave do ta shofim në vazhdim të studimit që do të trajtohen emrat e familjeve shqiptare që kanë origjinën nga leksiku i sferave zejeve, të cilat, lirisht, mund të grupohen në bazë të tipave të motivuar sipas procesit të punës, sepse çdo emërtim, përgjithësisht, i përmbahet një procesi pune të vaçantë dhe gjithmonë të lidhur me prodhimin, mjetin e sendin e punës. Prandaj, klasifikimi i patronimeve që kanë zanafillën nga leksiku i emërtesës së profesioneve, mund të bëhet në këtë mënyrë:

#### **13. 4. Patronime që vinë nga emërtimi i personit sipas punës që kryen:**

Arkaxhiu, Ëmbëltorxhiu, Berberi, Bojaxhiu, Bozaxhiu, Basmëxhiu, Briskaxhiu, Bashqexhiu, Cergaxhiu, Çorbaxhiu, Çibukxhiu, Çadraxhiu, Çakmakxhiu, Djepaxhiu, Defaxhiu, Dajrexhiu, Dërrasaxhiu, Dugojxhiu (Dyqanxhiu), Fasadxhui, Ekmeçiu, Hyzmetçiu, Hekraxhiu, Hallvaxhiu, Jorganxhiu, Kasapi, Kacaxhiu, Kafexhiu, Kerraxhia, Kundraxhia (këpuçtar), Kutixhiu, Kallajxhiu, Mullixhia (Mullisi) Maqinaxhiu (rrbaqepësi), Nallbani, Nallonexhiu, Pemaxhiu, Oxhakçiu, Opingari, (në Gjakovë- apongaxhija), Pëllumbaxhiu, Pontaxhiu (Bixhozaxhiu), Peshkaxhiu, Petaxhia (petëpunues për pite) Pajtonxhia, Llasterxhiu (Llamarinpunues), Qirinxhiu, Qymyrxhiu, Qebapçiu, Qylaxhiu, Qylymxhiu, Qerraxhiu (kerraxhiu), Sharraxhiu, Shotaxhiu (rosa), Samarxhiu, Sofraxhiu, Teneqexhiu, Tupanxhiu, Tezgaxhiu, (shitje mallrash në tavolina- në Pazar), Thikaxhiu, Ullukxhiu, Xhomaxhiu, Zhgunaxhiu etj.

#### **13. 5. Patronime që vijnë nga emërtime të mjeteve të punës:**

Bizi, Burgija, Çekiçi, Dana, Elmazi (mjete që e pret xhamin-qelqin), Gërshana, Lima, Mistria, Sharra, Shyti, Zdrukthi etj.

### **13.6. Patronime që vijnë nga emërtimi i lëndës së parë që punohet:**

Ari, Bakri, Gruri, Dërrasa, Hekuri, Plumbi, Krypa, Leshi, Pambuku, Sermi, Sheqeri, etj. Ahu, Arra, Dshku, Dudi, Bungu, Frashëri, Bagremi, Brehu, Lajthija, Mllaku, Plepi, Paja, Qarri, Qershija, Shkoza, (Lloje drunjësh, lëndë e parë për ndërtimtari dhe zejtarë (marangoz-zdrukthëtar dhe qerrepuues) për zhvillim të zejtarisë etj. Baruti, Çeliku, Guri, Mëndafshi, Peni, Qymyri, Zalli (rëra) etj. Arma, Boza, Buka, Byreku, Cerga, Çizmja, Hallva, Koburja, Pogaçe, Thika etj.

### **13.7. Patronime metaforike në të cilat trajtimi merr një natyrë të dyfishtë frymorësh:**

DASHI, DRENI, DACI, DERRI, GUCI, KNUSI, (kënduesi, gjeli, kokoshi) PULA, ZOGU, PËLLUMBI, BYLBYLI, KARRABISHTI ( insekt ), GUSA (PATA), GUSANI (PATOKU), SHOTA ( ROSA ), SHOTANI (ROSAKU), QUKANI, QUKA (GJELDETI), QAVA, SORRA (LARASKA), PLESHTI, KARCYLLI (KARKALECI), TURRECI, TERAKU, MAGARI (aktualisht mbiemër i shuar BULLI, HARDHUCI, MISKU (erëmirë).

Njohja dhe studimi i emrave familjarë, i prejardhjes dhe historisë së tyre është i lidhur ngushtë me historinë e gjuhës dhe kulturës materiale dhe shpirtërore të popullit tonë. Prandaj hulumtimet në këtë fushë, ashtu sikurse në lëmin e onomastikës në përgjithësi kanë rëndësi të madhe për historinë, gjuhësinë dhe etnografinë, sepse përmes emrave diktojmë prejardhjen e familjeve, shtresën shoqërore dhe sa e sa karakteristika të tjera interesante, shpesh me vlerë dokumentare.

Emrat familjarë që rrjedhin nga emërtime të sferës së profesioneve janë dëshmues të kushteve ekonomiko-shoqërore dhe paraqesin një material interesant për studimin etnografik të shtresave të ndryshme të popullsisë, veçanërisht të zejtarisë, nga kuadri i së

cilës sot janë zhdukur shumë zanate, kujtimi i të cilave ruhet vetëm në emrat familjarë të atyre që janë marrë me këto mjeshtëri<sup>89</sup>.

Në fondin e patronimisë shqiptare bën pjesë edhe një kategori emrash familjarë që vinë nga emërtime, të cilat kanë kaluar sferën e arkaizmave. Megjithatë, këto patronime kanë fituar të drejtën e qytetarisë dhe, ndonëse fjalët përkatëse nga kanë ardhur këto patronime kanë dalë nga fondi i leksikut të gjuhës së sotme shqipe, përdoren pa krijuar ndonjë keqkuptim në praktikën shoqërore. Por, krahas këtyre, sot gjenden edhe disa patronime që vijnë nga emërtime, të cilat kanë kaluar në shtresat leksikore stilistikisht keqësuese, çka u përcaktua nga kushtet e reja ekonomiko-shoqërore, kur shumë fjalë, jo vetëm që u pasuruan me kuptime të reja, por fituan edhe ngjyrimë emocionale, në përputhje me qëndrimin e ri shoqëror ndaj punës dhe njerëzve të punës. Kështu fjalët arkaxhiu, qymyrxhiu, bakalli, ajroni, krypa, sheqeri, daci, derri, guci, ufla, buza etj. padyshim që kanë fituar ngarkesa emocionale negative, përbuzëse. S'do mend se patronimet që vijnë nga këto emërtime bartin me vete nuancë që nuk përkojnë me ralitetin e sotëm shoqëror.

Nga fakti që zejtaria në shumë qytete, patronimet që burojnë nga leksiku i zejtarisë u takojnë më tepër familjeve qytetare. Për dallim nga këto, karakteristike për familjet fshatare janë patronimet që lidhen me bujqësinë, blegtorinë dhe bletarinë, ndërsa nga sfera e zejtarisë gjendet një numër i kufizuar, që lidhet me përhapjen e disa zejeve të zhvilluara edhe në fshat. Më tipike janë patronimet **Kasapi, Kovaçi, Mullisi** e ndonjë tjetër.

Përsa u takojnë patronimeve me origjinë nga leksiku u bujqësisë dhe i blegtorisë, duhet pranuar se jo gjithmonë këto patronime vijnë drejtë nga këto fusha. Ka raste kur ato vinë në rrugë të tërthortë, përmes antroponimeve. Kështu, emrat: **Ujk, Pëllumb, Ger, Terak, Dash, Cjap** etj., u përdorën fillimisht si emra njerëzish (antroponime); më vonë fëmijët e personave që u emërtuan me këta emra, duke ushtruar praktikën e shqiptarëve, sipas së cilës fëmija merr si patronim emrin e babait, i përdorin këta emra si patronime (bie fjala, **Martin Ujka, Fran Pëllumbi, Mic Teraku, Gjon Dashi, Ndrejë Cjapi, Lulash Gjeli**).

---

<sup>89</sup> K. Kerçiku, vep .e cit. f. 203.

Praktika e popullit tonë me emërtimin e familjeve me fjalë nga fondi i leksikut të profesioneve është e lidhur ngushtë me veprimtarinë prodhuese. Patronimet, gjithmonë më qartë se antroponimet pasqyrojnë gjendjen e shoqërisë në të kaluarën, nivelin ekonomik dhe pozitën shoqërore të mbajtësve të këtyre patronimeve ose brezave të tyre pararendës.

Patronimet me prejardhje nga leksiku i sferës së zejeve janë krijuar në të kaluarën dhe janë trashëguar brez pas brezi, ashtu siç janë trashëguar zakonisht edhe profesionet. Por sot, dhe në të ardhmen, patronime të tilla nuk krijohen më. Vetë rendi ynë shoqëror dhe zhvillimi i sotëm kulturor e bëjnë të panevojshme një gjë të tillë.

### **13. 8. Patronime me origjinë nga terminologjia e rendit fetar, ushtarak dhe administrativ e shtetëror**

Ofiqe të ndryshme administrative që iu akorduan personave të veçantë që nga mesjeta e këtij sipas studiuesit të mirëfillt Jusuf Shpuza, kanë mbetur të fiksuara në emrat e shumë familjeve shqiptare. Nga ofiqe që i takojnë periudhës para pushtimit gjithëshqiptarë nga turqit mund të përmendim patronimet: **Kavaljeri** dhe **Konti**. I pari, Kavaljeri, dokumentohet në “Regjistrin e kadastrës dhe të kocensioneve të rrethit të Shkodrës”, ndërsa i dyti, Konti, dokumentohet në veprën “Historia e Skënderbeut” të Marin Barletit<sup>90</sup>. Gjatë periudhës së sundimit osman disa nga përfaqësuesit e shtresave të pasura të qytetit dhe të fshatit, që u vunë në shërbim të pushtuesit, u nderuan me tituj, të cilët sipas praktikës shoqërore të kohës, përdorëshin përkrah emrit vetjak të mbajtësve të këtyre titujve.

Më të zakonshmit dhe më të përhapurit ishin titujt “*bej*” dhe “*aga*”, çka ka sjellë si pasojë përhapjen shumë të madhe të patronimeve e që rrjedhin nga emërtimet e këtyre titujve në gjithë hapsirën shqiptare. Më të përhapurat janë këto:

---

<sup>90</sup> Dhimitër Shuteriqi: “Fjalë nga leksiku i shqipes para Buzukut (879-1553) ” Studime Filologjike” Nr.1, 1981.

**Aga, Agaj, Agolli, Agovi, Agraj, Ali/aga, Daut/aga, Fadil/aga, dhe Hajdar/aga, Haxhi/agaj, Hysen/aga, Hazyr/aga, Malush/aga, Murat/aga, Naim/aga, Osman/aga, etj. Begu, Begaj, Begolli, Bejleri, Malobegu, Kurtobegu Gjylbegu, Gjylbegaj, Salobegu, Resulbegu, Alibegaj, Hysenbegas, Nexhatbegu, Nexhdetbegu, Halitbegu, Sulejmanbegu, etj.**

Po ashtu në qytet ishte i përqëndruar rendi administrativ, shtetëror, ushtarak e fetar. HOXHA, PRIFTI dhe SHEHU janë tre patronimet me burim nga tituj të hierarkisë fetare, më të përhapura tek shqiptarët.

Prej të treve, në Gjakovë hasim vetëm dy: HOXHA dhe SHEHU, që të dy të motivuar me përkatësinë fetare të patronimmbajtësit. Mandej vjen DERVISHI, MEJZINI, HAXHIU (vizitor i vendeve të shenjta), BAJRAMI (festë fetare), MYFTIU, (Myftija), BABAHI BAJRAKTARI, DEDEI (tituj të lartë bektashian), DAIJA, DELIJA. MULLA, VEZIRI, PASHA. Kthimi i emërimit të klerikut në emër familjar ka kaluar nëpër rrugën tradicionale të formimit të patronimeve shqiptare: fillimisht ky emër iu bashkua emrit vetjak të klerikut si emër dallues, për ta evidentuar atë midis personave që mbanin të njëjtin antroponim. Patronimi MEKA mund të ketë lindur nga praktika islame e haxhillëkut.

Si emra familjarë u përdorën edhe fjalë që i takojnë arsimit dhe jurisprudencës: MYDERRIZI, MYFTIU, QEHAJA ( sekretar, shkrues ). Është për t'u vërejtur se mes patronimeve në Gjakovë nuk shënohet asnjë rast i ekzistencës së patronimit PRIFTI. Kjo mbetet e pashpjegueshme për faktin se në këtë zonë jeton një përqindje e konsiderueshme e popullatës së krishterë, megjithatë patronimi PRIFTI (Në Kosovë) nuk gjendet në asnjë rast. Mbiemra të tjerë me ngjyrim fetar përmendim edhe: BABALIA, HAFIZI, DOMI, etj.

Jo të rrallë paraqiten mbiemrat që shprehin një gradë ose titull ushtarak: ÇAUSHI, VEZIRI, PASHA, IMAMI, AGA (J) - AGANI, GAZIJA, BEGU-BEGDUSHI (prej: bejlerë), YVEJSI, SPAHIU (kalorës në ushtri), ZAJMI (kreu i spahijve) por edhe EFENDIA - titull shoqëror, MYFTARI (kryeplak).

Interesant është fakti se titullin “sulltan” si shkalla më e lartë e hierarkisë qeverisëse osmane, nuk e gjejmë të pranishëm në Gjakovë, por as në patroniminë mbarë shqiptare. Kjo ndoshta për faktin se shqiptarët asnjëherë nuk u bënë dot Sulltanë, por maksimumi Vezirë. Ndaj emri Sulltan na del vetëm si emër vetjak femëror: SULLTANE. Ndërsa fjalët: VEZIR, SHAH i gjejmë edhe si emra personal femërorë, edhe si patronime. Në këtë tip patronimesh, vërehen raste të shumta të ndërtimeve kompozitë, ndërtimi i të cilave formohet në sajë të

bashkimit të ofiqit me emrin personal. Ky tip funksionon sipas skemës: **emër fetar** (që tregon titull) + **emër vetjakë**:

**AXHANELA, BABALIA, BEGDUSHI, DERVISHDANA, SHEHRAMA, YMERAGA, HAXHISMAJLI, HAFIZADEMI, HAXHIJONUZI, MULLAYMERI, HAXHIBEQIRI, HAXHIAVDYLI, MULLAADEMI, MULLAJUSUFI, MULLAHASANI, MULLA BEQIRI, SHEHDANJOLLI, HAXHIKADRIJA, HAXHIMIFTARI** etj.

Prania e këtij fondi në onomastikën e kësaj treve është dëshmi e rolit të madh që kanë luajtur këto besime fetare në jetën shoqërore të popullatës. Por, po ashtu ajo është shenjë treguese e respektit të shqiptarëve për besimet fetare që ushtrohen në frymën e tolerancës.

## **KREU V**

### **14. Emrat shpotitës në funksionin ptronimik**

Midis patronimeve që vijnë nga fjalë që emërtojnë cilësi, gjejmë edhe të atillë që mbartin nuanca keqësuese. Origjina e këtyre emrave duhet kërkuar në një praktikë mjaft të vjetër të popullit tonë, veçanërisht të popullsisë qytetare, sepse në fshat kjo praktikë ka qenë dhe është mjaft e kufizuar. Rastet e gjetura në popullsinë fshatare në shumicën e tyre kanë prejardhjen eufemike.

Sipas kësaj praktike njerëzit shpotiteshin, duke u ngjitur nofka që shprehnin cilësi fizike a psikike, të cilat, jo vetëm që i dallonin këta njerëz nga të tjerët, por mbartnin më vete nuanca emocionale keqësuese, si tallje, përbuzje, nënçmim e përçmim. P.sh.: Nga nënlloji i parë kemi: Patronime që vijnë nga fjalë që shënjojnë vetitë fizike e morale të njerëzve që i hasim edhe në Berat, veçanërisht në Gjakovë dhe në Shkodër, madje edhe sot janë mjaft të pranishëm në Gjakovë si:

#### **14.1. Patronime që vijnë nga fjalë që shënjojnë vetitë fizike a morale të njerëzve:**



AJRONI, BATALLI, BUZA, BUZANI, BARKU, BERKANI, BIRUCA, CICA, DANQELI, DACI, DUSHMONI, DUDUFENCI, DOGANI, DAJAKU, DHOMI, FONA, GUNGA, GAXHA, GAVRANI, GUCI, GOZA, GAVEDARI, GJYLGJYZARI, GRUSHTI, HUNDA, HARBUZI, HUMA, HUNDAÇI, JAKA, KOMTRASHI, KOKA(J), KUQI, KAJDOMQAJ, KAQANI, KURTI, KARRICA, KULLUKU, KUKA, KADAIFI, KASTRAVECI, KAKIÇKA, KALAVESHI, KOPILI, KAMISHI, KYÇYKU, LAMA, LUBOJA, LAPI, LAPOQI, LLAPAQI, LLASTYKU, MALLUTA, MAGARI, MOKAJ, MICI, MURRIZI, MINI, PARASHUMTI, PITAQAJ, PRUSHI, PENI, PAJA, PRONI, PROBJA, PANGJA, PIRAJKA, PILAFI, PIKALECI, PAPELLA, PARASHUTA, PLESHTI, PIKËSORRA, QORRI, QYRRI, QAFLESHI, QYNGI, QURRACI, QEBAPI, RAKETA, RADI, RRAKATELI, SEREMI, SURDARI, SARIÇKA, SADA, SHYTI, TULI, TODORZA, TUTKALI, TOPALLI, VESVESJA, VOGLI, XHIBIGJUKI, XHUXHA, ZALLI, ZORRA, ZIDI, ZHUTA etj.

Nga nënloji i dytë, kemi patronime që vijnë nga ofiqe/ nofka dhe emërtime kafshësh, përveç se kemi një prani të konsiderueshme të këtyre rasteve, mund të themi gjithashtu se në to janë të pranishëm kuptimi i drejtpërdrejtë dhe ai metaforik që do të flasim në vazhdim sipas natyrës së klasifikimit.

#### **14.2. Nofka të bazuara në emra shpendësh a kafshësh:**

ABRASHI (kalë me lara), DASHI, DEVJA, HUTI, BYLBYLI, BULLI, BRESHKA, GUSA, KËNDUSI, KARCYLLI, KINGJI, MAGARI, PULA, PLESHTI, QAVA, QUKA, SORRA, VREMÇI, ZOGU, ZOGIANI, TARAKU, etj.

#### **a/. Nofka të bazuara në elemente ushqimore:**

AJRONI, BIBERI, BURJANI, DUDI, GJIZA, HALLVA, KUMPIRI, KAKIÇKA, KOC(K)A, KEP(QEPA), KRYPA, KAJMAKU, LAKRORI, LIMONI, PILAVI, PURRINI, PASULI, RUVENIJA, SPECI, SULTJASHI (specialitet me qumësht dhe oriz të zier i kriposur ose sheqerosur) SHEQERI, TORTJA, TULLUMI ( Lloj ëmbëlsire ), UFLLA, etj.

### **b/. Nofka të bazuara sipas objekteve:**

BALLONI, BUNARI, FURRA, KUPA, QEREPI, TULLUMI (Mjet lehtësues për të nxjerrur ujin nga bunari) SOBA, (dhoma), ZIDI (muri) etj.

### **c/. Nofka me kuptim përbuzës:**

BULLICA, (femër me mbipeshë), BOLLA (femër e rrezikshme), BURGIIJA, BYTHECI, CICA (për ndonjë njeri me lyth në fytyrë apo në vesh), ÇAKALLI, (që flet shumë), DREDHANI, (që bënë lajka), DUDI, (njeri që nuk kupton) FTYRËTHIKA, (Fytyrë të mprehtë), FYTYRË PETULLA (fytyrë rrumbullakët), GOGLA E QERVISHIT (Për ndonjë person me trup shumë të shkurtër), GREJZA (insekt i padurueshëm që të pickon menjëherë nga familja e bletëve), GUZICA (Sebkroatisht- prapanica).

GJERPNI (person i rrezikshëm që të helmon), HAJNI, HITLERI, (i ashpër). KATILI, KASTRVECI (pa ndonjë vlerë), KRYHUDËR (Me kokë të vogël), KALAVESHI (për ndonjë njeri që s'të kupton fare), LIMONADA ( pije e lehtë jo me ndonjë vlerë të madhe ishte lemonade për ndonjë njeri), LUGATI, (figurë e besimeve të kota, njeri që ha shumë) LAPOQI, LOPA (e pa ditur), LAZDRANI, (i llastuari) LLASTYKI, LLAFAZANI (që flet shumë pa kontrollim), MINI UJIT (person depërtues që s'merret vesh - tinzar), MALECI (nga serbokr. i vogël), MICKOJA, MACA (femër e dobët, e vogël), MAÇORRI (Maçoku), MAGJUPI (Ndonjë fëmijë që është me lëkurë të zezë), NUSJA (Për ndonjë mashkull të tërhequr, përtac), PAÇAVRA, PASULI ( njeri pa ndonjë vlerë ), PEDERI, PELIVONI (akrobat), QUKI (Penisi i fëmijëve), QYRRI, QEBAPI, QALLAKI (që punon me dorën e majtë) QAFLESHI, QAFSHTREMTI, RRUDHANI, RUSI (Ndonjë fëmijë që është i bardhë), RUCANI (që kërkon të hajë çdo gjë), SUXHUKI ( njeri i pakuptueshëm i trashë ), SHURDHANI, TRUPESHKU (që nuk kupton fare), TIGRI (për njerëz të rrëmbyeshëm, që kapin çdo gjë që kanë përpara), THERRA (grua, vajzë ngacmuese), VIÇI (i pa vëmendshëm), XHUXHA, ZARARI, etj.

Një pjesë e mirë e patronimeve të lartshënuara, me kalimin e kohës janë zëvendësuar dhe po zëvendësohen me patronime të rinj, me arsytimin se pasardhësit e këtyre familjeve janë ndjerë të ofenduar në mentalitetin e ri të shoqërisë, kompleksive. Madje, në Gjakovë vlen thënia: “Më thuaj çfarë “llagapi” ke, të të them se kush je”.

Pjesën dërrmuese të këtyre nofkave, banorët ua kanë ngjitur njëri-tjetrit për t'i përqeshur ose fyer, në sajë të situatave të jetuara. Në përgjithësi këto emërtime që me kohë, një pjesë e tyre janë kthyer në llagape, sepse janë mjaft fyes e përqeshës dhe vetëm në ndonjë rast shumë të rrallë tregojnë cilësi a tentojnë të japin informatë të mirë: **BYLBYLI**, **DRENI**, **MISKU** etj.

Kjo nuk do të thotë se qytetet e tjera nuk kanë mbiemra karakteristikë por gjithsesi Gjakova shquhet dhe dallohet për mbajtjen e nofkave për mbiemër. Shumëkush e konsideron këtë si një pasuri të llojit të vet.

Megjithatë tek gjeneratat e reja, nga njëzet vitet e fundit e këtej, vihet re tendenca për t'i zëvendësuar nofkat e pahijshme me patronime më të dinjitetshme.

### 14.3. Patronime me zanafillë orientale

Patronimet me burim prej gjuhëve orientale të cilat mund të jenë të ardhura nga persishtja ose arabishtja, por që në shqipë kanë hyrë nëpërmjet turqishtes:

**ABRASH, ~i, ~ët;** emër (nga turqishtja *Abras* abrash; *laradash-i*, latinisht *pelicanus*, greqisht *pelekan*, në shqip ka hyrë *pelican*, *laraman*, *qimebardhë-i*, njeri me qime të verdha dhe të bardha, *pikalosh*.

**BAJRAKTARI-** (Shkodër, Kosovë, Berat, Tiranë, Dibër, Elbasan, Vlorë), nga një fjalë e shqipes *bajraktar-i* me burim prej turqishtes bayraktar “titull e funksion i trashëgueshëm në organizimin fisnor të krahinave tona malore të Veriut”, patronim edhe në trajtën *Bajraku* (Shkodër).

**HOXHA-** (Gjakovë, Tiranë, Berat, Vlorë, Gjirokastrë, Dibër, Durrës, Shkodër), nga një titull në herarkinë klerikale myslimane *hoxh/ë-a* që kryen shërbime në xhami. Pra një patronim profesioni *~Hoxhaj, Hoxhej, Hoxhanj, Hoxhati, Hoxhalli, Hoxhallari* i renditur në vendin e parë për nga denduria e përdorimit.

**KAZAZ, ~i, ~ët**, emër nga turqishtja *kazaz*; *përpunues mëndafshi, mëndafshpunues, emër njeriu*.

**KARAKÚSHI-** (Gjakovë, Kukës) nga një fjalë e shqipes *karakush-i*, me burim prej turqishtes *kara kus* dhe me kuptimin “zog i zi”, por edhe nga emri një “sëmundjeje të kyçit të këmbës së kalit”, pra, me gjasë të madhe nga një metaforë prej kuptimit të parë.

**KARÁXHA-** (Gjakovë, Kukës) nga një fjalë e turqishtes *karacá* “kaproll”, në shqipen (Pejë,Gjakovë) edhe “ka qimezi”, pra, një patronim prej një nofke, mbi bazën e një ngjashmërie të jashtme me kaprollin.~ *Karaxhia (Vlorë)*,~ *Karaxhiu (Tiranë)*.

**MUSTAFÁJ-** (Berat,Kukës, Gjirokastrë,Vlorë, Elbasan, Tiranë, Durrës, Kosovë) emër me prejardhje orientale *Mustafa - i*, prej arabishtes *Mustafa'* dhe me kuptimin ” i zgjedhuri”, që në shqipen ka dhënë *Muastafá* në Jug e *Mustáfë* në Veri dhe forma të shumta të shkurtuara: Muço, Mustë, Mujo, Fajë, Stafë, Tafë, Tagë, Caf, të cilat janë shndërruar në patronime. Kemi të bëjmë pra, me një patronim, që me të gjitha trajtat e tij identifikon dikë sipas birërisë.

**MUHAXHIRI-** (Tiranë,Berat,Kosovë,Durrës) nga një fjalë e shqipes *muhaxhir-i*,me burim prej turqishtes, *muhacir* nga *hixhra* “dyndje” e aty prej arabishtes me kuptimin e njohur të “atij që lë vendin e vet, emigrant, ardhacak”, pra, një patronim që identifikon dikë që është shpërngulur nga vendbanimi i vet ~ *Muhaxhir* (Kosovë, Durrës) ~ *Muhaxheri*, (Pejë) ~ *Muhaxhiri* (Kosovë).

**MAXHÚNI-** (Kukës, Gjakovë) nga një emër vetjak *Maxhun-i* e ky prej arabishtes nëpërmjet turqishtes *macun* “një lloj lëngu i trashë që përgatitej prej hoxhallarësh për mjekim”, pra, një farë emri deziderativ për fëmijën që të bëhet i ëmbël si ky lëng.

**MÁTI-** (Tiranë, Shkodër, Vlorë, Gjirokastrë, Dibër, Durrës, Kosovë-Gjakovë). Në Gjakovë janë disa familje me këtë patronim që daton nga një kohë e hershme. Ky patronim rrjedh nga emri i krahinës etnografike të Matit, që në vetvete është një konkordancë kelto-ilire-shqipe me kuptimin (kumzalli, rërë e imët), Patronimi identifikon dikë përmes prejardhjes nga një vendbanim i kësaj krahine. I dëshmuar si emër fisi në Mal të Zi në vitin 1330

(Peter Suma *Matagush*). **MÁRA-** (Kosovë, Shkodër, Tiranë ) nga një trajtë e shkurtuar e emrit vetjak femëror *Marie*, që për ndonjë arësye është shndërruar në emër familjeje e madje edhe, vëllazërie e fisi për shkak të ndonjë vlere të spikatur morale të një përfaqësueseje femër të atij fisi.

**MALLÓTA-** (Tiranë, Gjirokastrë dhe në Gjakovë) nga një fjalë e shqipes *mallot/ë-a*, me burim prej turqishtes *malluta*, por edhe në italishte *melota* e në greqishte *malloti* dhe me kuptimin “mantel i leshtë, gunë, brucë”. Patronimi mund të vijë nga një nofkë e patronimizuar për të identifikuar dikë përmes veshjes si bari, çoban, blegtor, pra një patronim profesioni, ~ *Malloti* (Berat), ~ *Malota* (Shkodër), ~ *Malluta* (Elbasan dhe Gjakovë).

**NEZÍRI-** ( Gjakovë, Kukës ), nga një emër vetjak *Nezir-i*, me burim oriental turqisht, *Nezir* < arabisht *Nādīr* “predikues; prurës i ngadhnjimit; mbikqyrës i pasurisë së jetimëve.

**PELIVÁNI** - nga një fjalë e shqipes *pehlivan -i*, me burim prej turqishtes, *pehlivan* < persisht *pehlevan* me kuptimin e njohur të “akrobatit”. Motivimi i këtij patronimi besojmë se ka të bëjë më shumë me kuptimin e mbartur të fjalës “njeri dredharak” që di ta vërtitë punën, sido që të vijë ~ *Pelivanaj* (Berat) ~ *Pelivanxhi* (Kosovë).

**PALLÁSKA-** (Gjirokastrë, Gjakovë), nga një fjalë e shqipes *pallask/ë-a*, me burim prej turqishtes, *palaská* me kuptimin e “rripit të fishekëve, fishektores”, por edhe “ spaleta gradash” e madje në shqipen edhe me kuptime të tjera.

**PANXHË, ~a ~at;** emër nga serbokroatishtja *pandža* ( kthetër); *kthetër, dorë e madhe, dorë e rëndë, shul dere*.

**RUSTÉMI-** (Kosovë, Berat, Kukës, Tiranë, Durrës, Vlorë, Dibër, Elbasan) nga një emër vetjak *Rustem-i* me prejardhje orientale, turqisht *Rustem*, por edhe emri i një heroi mitologjik persian që krahasohet me heroin po ashtu mitologjik grek Herkulin, pra një patronim birërie, ~ *Rustemaj, Rustemo, Rustemati, Rustem, Rusta, Rustaj, Rusti, Rusto, Ruste*. (*sipas vendbanimeve të lartëcituarra.*)

**SPAHÍU-** nga një ofiq në hierarkinë ushtarake të Perandorisë Osmane *spahi-u* “kalorës që merrte si shpërblim për merita ushtarake në sherbim të Portës një pronë, timar dhe vilte prej

saj taksën e së dhjetës. I përgjigjej për këtë Portës së Lartë me një numër të caktuar ushtarësh”.

**SARAÇINI-** (Shkodër, Gjakovë) nga një fjalë me burim prej turqishtes *sariça* “lloj shpendi gjuetie në një radhë me gjeraqinën, trumcakun, harabelin”, por mund të lidhet edhe me emrin etnik *saraçen-sarakaçen*).

**SHAHINI-** (Durrës, Elbasan, Berat, Tiranë, Gjirokastrë, Dibër, Shodër, Gjakovë.) nga një emër vetjak *Shain-i* me burim oriental *Šahin* dhe me kuptimin “skifter, ajkua, petrit”, emër që u përgjigjet tek shqiptarët *Petrit, Sokol, Skifter*, pra një patronim që shenjon birërinë, zanafillën në linjë gjaku. ~ *Shahinaj (Berat, Kukës, Dibër, Vlorë, Shkodër), Shahin, Kosovë, Vlorë, Shahinasi, Shahinllari (Kosovë)*.

**TOLLÚMI-** (Elbasan, Gjakovë) nga një fjalë e shqipes *tollumb/ë-a* me burim prej turqishtes *tulum* “rrëshiq lëkure, calik”, ndërsa në shqipe “këpucë të lehta vere që shkelen mbrapa e tërhiqen si pantofla”, kjo shërben edhe si nofkë për dikë që mban këpucë të tilla.

**XHÉMA-** (Me burim prej turqishtes dhe arabishtes, të cilët i bashkon kuptimi “i hijshëm, i pashëm, i bukur - nga trajta të shkurtuara të emrave vetjakë orientale *Xhemal, Xhemali, Xhemail, Xhemil*).

**XHOKA-** nga një emër i shqipes *xhok/ë - a*, emri i një “veshjeje si mantel i trashë leshi”),

**YMÉRI-** (*Ymerliu* -nga një fjalë e shqipes e *ym/ër-ri* me burim prej turqishtes *ömür* -“jeta e njeriut, të jetuarit”). Mund të përjashtohet lidhja e tij me emrin vetjak *Ymer-Ymë*, pasi prapashtesa-*li* nuk u bashkëngjitet temave të emrave vetjakë por atyre toponimike si: *Manastirili*, apo temave që me këtë prapashtesë tregojnë cilësi, si p.sh. *namusli, qejfli, sevdalli*.

**ZYBERI-** (Nga një emër oriental *Zyber-i*, me prejardhje arabe *Zubejr* me kuptimin “i tërë, i plotë”.)

**ZHÚRI-** (Kukës, Dibër, Tiranë) nga një fjalë e shqipes *zhur-i*, me burim prej latinishtes *saburra* “rërë, zhavor”, vedbanim afër Prizrenit. Këto lloj patronimesh i gjejmë në përdorim të shtuar. Pra vihet re se ashtu si në toponimi, edhe në patronimet e vendasve në Gjakovë

kanë lënë ndikimin e tyre gjuhët orientale si pasojë e sundimit të gjatë të Perandorisë turke ndërsa prania e ndikimit sllav vihet re në një masë shumë më të ulët. Në Gjakovë, ndikimi sllav është sadopak i vërejtshëm në toponimi, por edhe në emërtimet e familjeve a fiseve. Meqë në këtë zonë të Kosovës asnjëherë nuk ka patur më tepër se dy përqind të popullatës me përkatësi sllave, janë minimale rastet që reflektohen nga ndikimi i sllavishtes në patronimi.

#### **14.4. Patronime me burim sllav:**

DURAKU, DALLADAKU, DOBRA, BËRDONIQI (sllavisht, Kodër), BUQINCA, ELSHANI, FËRDULLI, KATONA, MILLA, MILICI, MANXHUKA, NIKOLIQI, POZHEGU (Slavonska Pozhega, Uzička Pozhega, qytete sllave), (sllv. mirë), PERJUCI, POZHARI (sllv. zjarr). Jo më kot e lashë për në fund edhe një tip patronimesh të cilat duke u nisur nga sistemi i sotëm gjuhësor, mbeten të pashpjegueshme. Pra këtu do të përfshij ata mbiemra për të cilët vetë emërtimi nuk jep shpjegime. PERJUCI, ROKA, VALLA etj. Sot, sistemi patronimik funksionon me një larmi trajtash, duke marrë përsipër të identifikojë banorët e Gjakovës, dhe jo vetëm kaq, por edhe të tregojë origjinën e prejardhjes familjare të tyre. Mbiemrat e sotëm kanë lindur, ndryshuar e përshtatur në një rrugë të gjatë evolutive, duke u fiksuar në gjendjen e sotme e cila siç e pamë na paraqitet me një shumësi tiparesh dhe cilësish.

#### **14.5. Emrat familjarë apo patronimet e përbëra dhe të përngjitura**

Është e një rëndësie të veçantë të studiohen e të paraqiten edhe emrat familjarë (patronimet) që kanë një vajtje-ardhje të pandërprerë e që si rrjedhojë kanë emrat vetjakë (antroponimet). Saktësisht, së pari, duhet të përmendim rrethanën që në traditën e hershme shqiptare.

#### **14.6. Emri vetjak i atit ka shërbyer si emër familjar.**

S' do mend se në krye të herës patronimi ishte në rasën gjinore ( Marku i Gjonit, Marta e Zefit, Anxhelina e Tomës, Vilsoni i Ndreçës, Filja e Dedës etj.) apo edhe në *trajtë trigjymtyrëshe* ( Marku i Gjon Gjergjit, Marta e Zef Lleshit, Anxhelina e Tomë Dedës, Vilsoni i Ndreçë Marjanit, Filja e Dedë Ndout, Lili i Prenkë Tahirit, Malushi i Xajës Halilagës etj). Me kalimin e kohës patronimet filluan të përdorën në: **Rasën emërore** (Mark Gjoni, Marte Zefi, Anxhelin Toma, Vilson Ndreca, File Deda, Pal Bajraktari, Istref Alija, Shkrel Pranushi, Hasan Prishtina, Mehmet Zajmi, Bedri Pejani Bibë Doda, Bajram Daklani, Bajram Curri, Eshref Frashëri, Beqir Vokshi etj), apo në :

#### **Tri gjymtyrë:**

Emri, emri i atit dhe i gjyshit Prenkë Bibë Doda, Shaban Mehmet Zajmi, Asllan Ymer Curri, Haxhi Adem Babai, Zef Kolë Ndoja, Sulejman Agë Vokshi, Dodë Nikollë Alija, Simon Gjokë Alija, Qun Dedë Tunaj, Franë Ndreçë Tunaj, Ndreçë Nikollë Marku, Zef Tuc Domxhoni, Mark Qun Hili, Mon Prekë Tahiri, Dedë Cufë Hoshi, Gjokë Nikollë Leka, Mehmet Agë Rashkoci, Gjin Bua Shpata, Tanush Muzak Topia, Malush Ahmet Stublla, Nazmi Xhevdet Luzha, Yll Avdulla Morina. Ndonjëherë emrat kishin edhe

#### **Katër gjymtyrë:**

Emri, emri i atit, i gjyshit dhe i stërgjyshit: **Gjoni Gjinit Marka Gjoni** (Ujëz-Gjakovë), Muhamet Fahri Ali Iljazi (Gjakovë), Avdullah Tafil Avdullah Morina (Gjakovë), madje, në disa krahina të Veriut nuk kanë munguar edhe emra njerëzish familjarë me:

#### **Pesë gjymtyrë:**

**Gjin Kola i Per Kol Gjinajve**, dhe në rrethinën e Gjakovës Zoja Lasku e Pjetër Mark Lleshve.

Përveç tyre, sidomos në Gjakovë e rrethinën e saj (Kosovë), janë edhe emrat familjarë patronimet, që përdoren si mbiemra të familjeve të formuar me anë *të përngjitjes* veçanërisht në Gjakovë si: V. **Damonaga**, B.**Aliaga**, E. **Nuzamala**, Gj.**Ukgjini**, N. **Mullahafizi**, B.



*Haxhiisufi*, B.*Tahirfejza*, L. *Mullazenuni*, S. *Nurihafizi*, E. *Nelrexhepi*, F.*Haxhikadrija*, B.*Mullaademi*, M.*Gjeladinaga*, Z.*Haxhiosmani*, M.*Shehrama*, F. *Salicana* A.*Mullaxhela*, B.*Haxhihoxha*, N.*Halilabazi*, B.*Muscenaj*, E. *Nexhmidinymeri*, Q.*Hafizguta*, D.*Shaniymeri*, Sh.*Halilhima*, Xh.*Hajdarhoxha*, F.*Haxhijaha*, G.*Mullahasani*, N.*Dervishdana*, Q.*Hajdaraga*, S.*Abazaga*, B.*Haxhibiqiri*, I.*Haxhiymeri*, N. *Mullatahiri*, F. *Haxhidauti*, S. *Januzrexhepi*, M. *Haxhishabani*, **Januznexhipi**, A. *Haxhiavdylit*, M.*Haxhishabani*, E.*Mullaisufi*, N.*Shabaquka*, N.*Kadriçeli*, **Markallesht**, **Prekpërlesht**, **Gjomarkt**, **Shabaseferajt**, **Iberhysajt**, **Osdautajt**, **Rexhademajt**, **Gjonedajt**, **Markaprekaj**, **Biblekaj**, **Smajlrexhept**, **Mullatahirt**.**Gjidoda** (Plançor), **Osmanajt**(Ponoshec), **Dodlleshet**, **Jakgjont** (Raça), **Demrexhët** (Radoniqi), **Nelmehmetët**, **Salirexhepët**, **Halilsylët**, **Musukshinët**,(Rashkoc), **Shabamusve**, **Elezdemëve**, **Brahimramëve** (Rogovë), **Ukshinmiftarët** (Skivjan) **Haxhitafa** (Smaç), **Selimramët** (Stubëll), **Tunëprenkaj**, **Nikollëprenkaj**, (Novoslla e Epërme), **Ademhasanët**, **Tahirsmajlt**, **Ahmezelt** (Shqiponja-Jabllanicë), **Hasallakt** (Zhabeli Plak), sepse Zhabeli ndahet në dy lagje kryesore me dy grupe të shtëpive: Zhabeli Plak dhe Zhabeli i Ri, **Lekpapaj** (Babaj Bokës), **Halilibisht**, **Rexhepferiztë**, **Demushimertë**, **Haxhisalitë**, **Tahirfazlijtë** (Bardhaniq), **Domgjont** (Bordosanë), **Biblekët**, **Ukërrustemët**, **Gjonpalusht** (Bec), **Juphajdart**, **Asllanhajdart**, **Monhaliltë**, **Nikmartinët**, **Delikolet**, **Sadikazemët**, (BeciEpërm), **Qeleshbanëve**, **Aliramëve**, **Isufmusëve**, **Ukrustemtë**, **Palqerimtë**, **Markhalilët** (Beci i Poshtëm), **Prendrecaj** (Bishtazhin), **Kelmehshit** (Blinisht-Lipovec), **Ukëlushaj**, **Hamzëmates** (Bitesh), **Nikollbibët** (Brekoc), **Prenkocaj** (Dallashaj), **Sefsalihtë** (Damjan), **Markgegajt** (Dol), **Salifetajt** (Dushnja), **Sylmetaj** (Gërçina), **Bajramshabanajt**, **Ramnimanajt** (Gërgoc), **Gjomarkët**, **Hajdarlekët**, **Dardhqorrët**, (Guskë), **Ukëcubi**, **Ukëpula**, (Hereç), **Bajramtahirët**, **Jakupibrajt**, **Bahtirzogët**, **Beqirrexhët**, **Isufcubeltë**, **Hysendervishtë**,**Nukfrrokët**,**Avdylkeqonët**, **Shabanzekëve**, **Aliferizëve**, **Hysenselmanëve**, **Brahimzenëve** (Kralan), **Prendrekaj** (Kushavec), **Kolhasanët**, **Koldelitë** (Meja), **Hysenmarkët**(Meqa), **Bajrammetët**, **Ramsmajlët**, **Selmanramët**, **Selimrexhepët**, (Molliq), **Numarkaj**, **Prengjokaj**, **Simonmhillët**, (Pashaj-OsekPasha), **Marvukaj**(Shkrel), **Vukpalaj** (Kastrat), **Permala** (Hot), **Lulashpepaj** (Traboin-Hot), **Buçpapaj** (Tropojë), **Ukgjini** (Mirditë), **Musëcenaj**, **Prendedaj**, **Prenrecaj** etj.

## 14.7. Emrat e njerëzve (antroponimet) dhe bigëzimi i tyre në forma zyrtare dhe jo zyrtare

Gëzimet në familje janë nga më të ndryshmet, por, ndër gëzimet më të bukura sidomos, ndër shqiptarë është edhe lindja e një fëmije e për këtë veçanërisht e një djali fillimisht. Këtij gëzimi i shtohet domosdo edhe pagëzimi me emër, i cili është edhe emër zyrtar. Nuk do të ndalemi në analiza fonetike historike të emrave vetjak për shembull se si ka ardhur emri **Alba** nga **Albulenë**, apo **Him** nga **Ibrahim** etj, sepse ato tashmë janë gjëra të ditura e janë të shqyrtuar nga disiplinat përkatëse; përkundrazi dhe gjithsesi, do merremi me trajtat e dyta të emrave vetjak, që janë të gjalla edhe sot e gjithë ditën, që na shfaqen ditë për ditë në të folurit e shqiptarëve, ashtu si edhe të popujve të tjerë dhe burojnë nga një dukuri jashtë gjuhësore siç është zbulimi apo perkëdhelia. Këto trajta të dyta, të cilat krijohen pa mbarim e në të gjitha mjediset qytetare e fshatare, vijojnë të kenë jetën e tyre të gjallë në gjuhën e folur, kryesisht në mjedise të ngushta familjare e shoqërore, krahas e në konkurrim me trajtat e para apo zyrtare përkatëse.

“**Emra të vjetër vendas**, të vënë mbi bazën e emrave të përgjithshëm të kafshëve dhe pemëve etj., sidomos në krahinat e Veriut, si: Pu:l-ia (< pulë), Ro:s-a (< rosë), Bieshk-a (< bjeshkë), Bo:r -a (< borë), Di:l-a e Diell-a (< diell), dash-i, Ujk-a (veriperndim), E Uk-a (< ujk) në Verilindje, Gjell-i e Gjellosh e Gjeli:n-a nga gjel (Malësi e Madhe) dhe Gjell-a në Mirditë, Lu:l-a (Veri) e Lule-ja (Jug), Sokol-i (Veri e Jug), nga Sokol “Skifter”, Zok-gu e Zo:g-a (Veri) nga zog, Pëllum-i në Veri e Pëllumb në Jug etj. Në këtë grup, mund të përfshihen edhe shumë emra njerëzish nga emra vendesh (toponime), të shpesh të sidomos në trojet shqiptare Verilindore (Kosovë, Maqedoni), por, që po përhapen gjithëkëndej edhe në mjediset tona”<sup>91</sup>, si: Berat, Myzeqe, Erzen Çamërie, Preveza, Erenik, Gjirokastrite, Tomor, Drin, Valdrin, Sazan, Shkelzen, Vlora, Korab, Shkumbin, Rubik, Valbona, Saranda, Ujëdhësa, Rozafa, Tirana, Korçare, Pashtrik, Dukagjin, Dea, nga (Vau i Dejës), Zana, Hana, Rudina, Rrezarta, Fjolla, Filloreta, Nora, Bleta, Arian, Ariana, Ardian dhe Adrian, Arbër, Arbëreshë, Albulenë dhe shumë emra të tjerë, që patën një shtrirje dhe, ishin bërë “modë patriotike”, pse edhe jo, sidomos, në Gjakovë, që nga viti 1969 emra të tillë dhe shumë të

<sup>91</sup> Prof. dr. Gj. Shkurtaç, *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, SHBLU, Tiranë, 2001 parag. 1. f. 119 .

tjerë në atë brez, përhapshin me të madhe gjë që i shihja gjatë gjithë kohës sa jepja mësim nëpër regjistra shkollash të ndryshme të Gjakovës. Një fond i tillë emrash sigurisht, që kishte ndikim pozitiv për ne, edhe si pikë më e afërt kufitare, por dhe me një popullsi më etnike nga qytetet tjera e me një arsimim pak më të hershëm, kundrejt vendbanimeve tjera të Kosovës. Kjo ka pasë një rëndësi të vaçantë për t'iu larguar emrave fetar dhe duke bërë një shkrirje dallimi mes dy besimeve, mendoj, që mbi të gjitha ka rëndësi që këto anë janë autoktone dhe me një qytetërim të hershëm dhe që **mbanë gjallë ndjenjën e shqiptarisë në gjuhë**. Sado që, brezit të ri i ka vërshuar ndjenja e pagëzimit me emra krejtësht të huaj dhe pa ndonjë domethënie e kriter në të dy anët e kufirit, që shumë herë, duhet menduar kur lexojmë ndonjë revistë apo gazetë në shqip, dhe shumë emra që lexojmë, pyes veten mos vallë bëhet fjalë për ndonjë ngjarje në Itali, në Greqi, Rumani..., apo ruajna zot, një ditë, të marrim emra edhe nga “Serbia mike”?!!, që ndoshta një ditë nuk do të na mungojnë edhe këta të fundit. Mendoj që, edhe pse është e “drejtë legjitime” e secilit prej nesh të bëjë çfarëdo zgjedhjesh, jo pse dikush do të rreshtohet më patriot e tjetri më pak, por pse këta emra tingëllojnë mjaft bukur në shqiptim si: Arbër, Ardian, Nora, Rudina, Zana, Hana,... etj. po janë edhe me prejardhje nga këto troje, emrat e tillë dhe mjaft të tjerë duket sikur i zbukurojnë edhe emërbajtësit, se mjaft u shqelmuam, u përbuzëm, na ndan nga trungu amë, pritëm e përcollëm pushtues nga më të ndryshmit duke u përpjekur të na ndryshojnë çdo gjë, edhe emrat e njerëzve, toponimet e vendbanimeve, të na imponojnë edhe besimin, të na sakatosin edhe gjuhën e në mënyrë të “modernizuar”, kjo e fundit, po vazhdon të sakatoset edhe më tej së pari nga vetvetja. Mendoj që nuk duhet të mbetet në mëshirën e kohës...Po citojmë, që jo rastësisht, dialektologu ynë shumë i njohur, akad. prof. dr Gjovalin Shkurtaç, citon këtë thënie:

”Popujt e qytetëruar dhe shtetet, e tyre, si p.sh. Franca dhe demokracia e regjur franceze, i kanë dhënë gjuhës kurdoherë rëndësi të dorës së parë. Kush do atdheun dhe kombin e vet nuk mund të mos shqetësohet për ruajtjen e gjuhës. Pjesë e gjuhës shqipe janë edhe emrat e përveçëm”<sup>92</sup>. Pas këtij citati, mendoj që nuk do të duhej ndonjë koment për të kuptuar se kujt duhet dhënë rëndësi, dhe, s’duhet të presim ndonjë sygjërim nga dikush, këtë duhet ta kemi gjithnjë në mendjet tona intelektuale, në mendjet e brezave dhe shtresave të tjera.

---

<sup>92</sup> Prof. dr. Gj. Shkurtaç, *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, SHBLU, Tiranë, 2001 f. 28, parag. 2.

Gjuha për një komb është çështje parësore për të sotmen dhe të ardhmen, e kjo, pa ndonjë pritjeje, jo muajsh e vitesh, por edhe as ditësh e të zë vendin e merituar në shoqërinë tonë.

Emrat fetarë, përgjithësisht të hershëm, që janë futur nëpërmjet ndikimit të besimeve të ndryshme, në të dy grupet, siç është vënë re edhe në studimet e mëparshme që janë përmendur, kanë edhe trajta të dyta, jozyrtare, të cilat në krahasim me trajtën e parë, dalin ose të zgjeruar, ose me prapashtesa zvogëluese a perkëdhelëse. Përveç këtyre trajtave ka edhe mjaft emra turko-arab që kanë pasë ndikim në popull, prap se prap, populli është përpjekë që këta emra, në përkthim të kenë të paktën, një përmbajtje shqipe si: **Hedije**, që në shqip do të thotë (**Dhurata**), **Sabah (Agim)**, **Nuriye (Dritë)**, **Demir (Hekuran)** etj. Kjo nuk mjafton, dhe, as që duhet të na shkoj mendja të kënaqemi se, shumë pak, ose aspak nuk kanë të bëjnë me gjuhën shqipe. Por, sidoqoftë kjo të përkujton kohën e një vetëdijesimi të së kaluarës, që të paktën, ai emër ta ketë një përmbajtje nga gjuha mëmë. Sa për ilustrim, për të vërtetuar moskënaqësinë e emrave të vjetër të gjeneratave, reletavisht, atyre të reja, sidomos atyre turko- arab kanë sjellë kompleksitet për ditët e sotit, pavarësisht a janë emra të trashëguar nga gjyshërit apo stërgjyshërit e tyre, të motrave apo të vëllezërve të tyre po sjellim disa dëshmi sipas gazetës së përditshme “Kosova sot” të datës 09.05.2011 me titull “**Të rinjëve s’u pëlqejnë emrat e vjetër**”. Pagëzimi është moment i rëndësishëm në jetën e njeriut, por edhe të familjes në përgjithësi. Sipas traditës emrat zakonisht janë trashëguar, që fatkeqësisht edhe sot e kësaj dite vazhdojnë që fëmijët të trashëgojnë emrin e babait, të gjyshit, të xhaxhait ose të një anëtari të familjes, por më shpesh të motrës ose vëllait të ndjerë, i cili ka humbur jetën tragjikisht. Emri kurrë nuk mund të zëvendësojë atë, mirëpo dikujt i duket se, kur e thërret me emër sikur i ka mbetë diçka nga ai në këtë botë, mendojnë një pjesë e qytetarëve, por një pjesë tjetër as që mendon për këtë, sidoqoftë është e drejtë personale e secilit të vendos për pagëzimin e fëmijës së tij. Tradita për emrat e trashëguar më pak ose më shumë edhe gjatë viteve kur shumë motra, vëllezër e prindër ranë në demonstrata të viteve 1981- 1999, ka vazhduar pagëzimi me emrat e të rënëve. Të këtyre motiveve janë edhe emërtimet e fundit, por kjo dukuri është theksuar mjaft, sidomos në rastet kur babai i të lindurit ka qenë ushtar i UÇK-së: Bashkim, Nuhi, Ramiz, Halim, Driton, Ismet, Haki etj. Në antropominë e Kosovës një sistem të veçantë paraqet familja Jashari, fëmijët e të cilëve (Adem, Shaban, Zahide etj.), vazhdojnë edhe më tej të pagëzohen me emrat e gjithë pjesëtarëve të vrarë nga sistemi ushtarak e policor i Serbisë millosheviste. Me rastin e

“liberalizimit”, të zbehtë, kundrejt republikave tjera të Jugosllavisë diku nga viti 1966 e këndeje, në Kosovë, por fatkeqësisht jo edhe në Maqedoni e më gjerë në ish Jugosllavi, fëmijëve filluan t’u vinin emra që tregojnë jo vetëm motivin historik (heronj, shkrimtarë e madje edhe emra të personazheve të veprave të tyre, piktorë etj.), por edhe me emra nga leksiku i gjuhës shqipe, që tregonin veçori të lëvizjes sonë të përgjithshme kulturore, historike dhe çlirimtare. Gjatë luftës së fundit, paradigma të tilla kanë dominuar shumë edhe në gjithë hapësirën kombëtare nga kanë lëvizur të përndjekurit dhe të dëbuarit e Kosovës, por kjo paradigmë do të dominojë sidomos për atë popullatë që do të mbetet në lëvizje të përditshme brenda kufirit të Kosovës: Abetare, Qëndresë, Yllka, Leutrim, Herolinda, Qëndrim, Teutë, Drilon, Taulant, Trinom, Kosovare, Malësore, Dardan, Çelik, Shkamb etj. Pagëzimi me emra është proces i pandalshëm, sidomos në këtë kohë. Pra, në ditët më të stuhishme të luftës dhe qëndresës popullore, shfaqen edhe emra tipik të motivuar gjithsesi nga paradigma e besimit në të ardhmen, dashuria për jetën, lirinë, dashurinë etj: Lirim, Jetëlira, Rilind, Pranvera, Rinor, Çlirim, Fitore, Krijona, Liridon, Agon, Endrit etj. M këtë tip të emrave familjet e përndjekura nga Kosovë i kanë nderuar edhe vëllezërit e tyre shqiptarë në Shqipëri, Maqedoni dhe Mal të Zi, si edhe ata të huaj, të cilët kanë ndihmuar luftën, përpjekjen tonë për liri, refugjatët e ndodhur në shumë vendstrehime të botës etj.

Tridhjetë vjetët e fundit, fondi i emrave të fëmijëve të Kosovës, që për paradigmë dominuese ka pasur emrat e motivuar nga qytetet, fshatrat, malet, lumenjtë etj. të Shqipërisë ka qenë i madh, për të mos thënë dominues në pasqyrën e përgjithshme të emërtimeve. Mund të thuhet se janë të pakta familjet që nuk kanë emërtuar së paku një fëmijë me bazë denominimi me një onoma nga Shqipëria. Nuk ishte e rastit kjo.

Në Kosovë gjenden shumë familje që brenda tyre kanë krijuar një sistem të tërë emrash të qyteteve: Shkodran, Berat, Labinot, Elbasan, Tirana, Vlora, Gjirokastra, Gjirokastrite; të maleve: Tomor, Shkelzen, etj.; të lumenjve: Drin e Drilon, Shkumbin, Vjosa etj. Ashtu siç kanë nderuar familjen, shoqërinë, Kosovën, luftën çlirimtare dhe Shqipërinë, familjet nga Kosova, me emrat e fëmijëve të tyre kanë nderuar edhe ata që kanë ardhur nga vendet më të largëta të botës, duke i marrë emrat e tyre si relikte historike, apo emrat ku kanë lindur.

Krahas kësaj mendojmë që duhet ditur se toponimia dhe antroponimia si krih të pandashëm më shumë se dy shekuj vazhdojnë të mbetën referenca historike dhe madje edhe pragmatike të së kaluarës sonë dhe veçanërisht të së ardhmes së hapsirës shqiptare. Kosova, njëra prej pjesëve të kësaj hapsire, madje vazhdon të mbahet ende peng pikërisht i kësaj trashëgëmie të rrëgjuar.

Sikur të mos mjaftonte gjendja aspak favorizuese e toponimisë në konsolidimin e hartës etno-historike dhe gjuhësore të hapsirës shqiptare, në kohën kur popujt fqinjë e bëjnë të pamundurën për të ruajtur vlerat gjuhësore, kulturore, psikologjike dhe etno-historike, mbështetur madje edhe nga mitet romantike mtë tyre, shpërbërësit e kujtesës dhe identitetit kombëtar, ka kohë që po përpiqen t'ia shtojnë edhe një identitet të ri: identitetin kosovar!

Është e ditur tanimë se gjuhët ndryshojnë kur ndryshojnë shoqëritë. Në Kosovë ndërkaq, ka ndryshuar jo vetëm shoqëria, por edhe koncepti mbi të. Ka ndryshar prandaj edhe toponimia e saj. Në të vërtetë, ajo vetëm ka plotësuar përbërësin kombëtar mjaft homogjen:antroponiminë.

Si përfundim i kësaj s'duhet harruar se toponimet nuk janë thjesht vetëm emra vendesh, ato janë gjuhë, histori, etnologji, kulturë, janë identitet, sepse në integrimet e reja evropiane, ne duhet të pretendojmë të hyjmë në Evropë si shqiptarë të evropianizuar e jo si evropianë të deshqiptarizuar.

## **KREU VI**

### **15. Emrat vetjakë me prapashtesa përkëdhelëse dhe zvogëluese**

Siç dihet onomastika përbëhet nga dy grupe të mëdha emrash:

**a/ emrat e njerëzve apo emrat vetjakë (antroponimet) dhe**

**b/ emrat familjarë përkatës të tyre (patronimet).**

Edhe pse deri vonë onomastika pat mbetur një disiplinë gati djerrë, gjuhësia shqiptare do t'i kthehej me mjaft përkushtim si mbledhjes ashtu edhe studimit të onomastikës, duke bërë qendër hulumtimit si emrat e vendeve (toponiminë), ashtu edhe lëndën që u përket emrave të njerëzve (antroponimet dhe patronimet).

Ne qëndrojmë me mendimin e shprehur edhe më parë se shtegu i lindjes së trajtave të dyta, qoftë kur marrin prapashtesa, qoftë kur përftohen nga shkurtime a cungime të shoqëruara edhe nga ndërrime tingullore apo edhe me prapashtesa si dhe me anën e riemërimeve ku nuk ka asnjë lidhje fonetike mes trajtës së parë zyrtare dhe trajtës së dytë, ka qenë dhe mbetet në radhë të parë faktori jashtëgjuhësor: zbunimi a përkëdhelia.

Shembuj të këtillë, pa dyshim, rrëfejnë qartë se kalimi i trajtave të dyta në të para dhe lindja e trajtave të dyta për zbatim, është një proces i vazhdueshëm që gjithsesi sjell pa prerë dalje e hyrje nga ligjërimi në gjuhë si:

Ag-ush(< Agë), Avn-ush(< Avni), Begr-ush (< Begri), Bedr-ush (< Bedri), Babu-sh (< Babë), Dan-çe (< Ramadan), Don-çe (< Ferdone), Drit-ush (< Drita), Daj-ush (< Dajë), Gan-ush (< Gani), Hazb-ush (< Hazbije), Hall-ush (< hallë), Lu-luc (< Lulzim), Ram-ush (< Ramë), Sabr-ush (< Sabrije), Sad-ush-e (< Sadije), San-ush-e (< Sanije), Sevd-ush-e (< Sevdije), Shan-ush (< Shani), Zen-ush (< Zenije) etj.

### **15. 1. Emra me prapashtesa zvogëluese:**

Shkurtimi i emrit prore krijon simpati dhe kënaqësi kur i thërrasim fëmijët qoftë si të vegjël apo të rritur, njëkohësisht që me këto prapashtesa përkëdhelëse domosdo edhe ruajmë kujtime të bukura nga fëmijëria e tyre, nga dëshira për t'i parë "të vegjël", vazhdojmë që edhe si të rritur t'i thërrasim ende me emra përkëdhelës si: Barlu-c për (Barlet), Gic-e (Nergize), Dilu-ce (Dilë), ose Dilu:k, Maru-ce (Marie), Lalu-ce (Exhlale), Begru-c (Begri), plaku-c, plaku-ce (plak-plakë), për ndonjë fëmijë që ka pamje të përafërt nga paraardhësit e tyre, Able për Arbër, Dad-ush për Dadë (grua, vajzë, e cila kujdeset për dikë...).

Nuk mungojnë, sot, thuajse një numër i shumtë emrash që kanë trajta të dyta, jozyrtare, të cilat në krahasim me trajtën e parë janë të shkurtuara, jo për qëllim zvogëlimi, por as edhe për qëllim përkëdheljeje, por thjeshtë për të shkurtuar "ekonomizuar" një emër të gjatë si: Lena për (Albulena), Nesha (Arbëresha), Dan (Ramadan), Tafë (Tafil), Mon, (Sulejmon), Done (Maklidon) Gjy:l (Gjylfidon), Mandi (Manduha), Petro (Petronin), Lah (Avdullah), Rrem (Muharrem), Lush (Malush), Meli (Melihate), Lume (Lumturie), Afa (Afijete), Resë (Resmije), Nel (Zenel), Him (Ibrahim), Hil (Hilmi) etj.

Meqë jemi, me theks të vaçantë, tek emrat që kanë trajta të dyta jozyrtare kjo kategori trajtash, në mesin e fshatarësisë, sidomos, nga e kaluara jo e largët nuk parapëlqeheshin,



ngase sipas tyre, trajtat e dyta jo zyrtare e “zhburrojnë personalitetin”. Ka shembuj mjaft pozitivë që në botën e civilizuar, personalitete në zë, i respektojnë emrat e dytë jozyrtar dhe kanë kënaqësi që t’i thërrasin me këtë trajtë, për çka mendoj, se duke shkëmbyer emra me këto trajta krijohet një klimë më e ngrohtë dhe hap rrugë miqësie dhe afrimi mes bashkëbiseduesve, veçanërisht në ditët e sotme po gjen shtrirje të dukshme te populli ynë. Vetëm po e ilustruj një shembull të një studenti në Studimet Pasuniversitare në Universitetin Amerikan të Kosovës, prof.dr. X për Politikë Kuadrosh, Anëtar i Senatit Amerikan dhe Drejtor Gjeneral i këtij Universiteti me emrin Kristholl, i kishte pas lutur studentët, pas prezantimit që kishte bërë, se dëshira ime është të më thërrisni shkurt Kristi, e jo me tituj e grada shkencore që kam. Mendoj që respektimi i trajtës së dytë të emrit jozyrtar, jo vetëm që nuk e zhburron, por, edhe e bën më të afrueshëm, më gjentil dhe e sistemon në krahun e mirëfilltë të një qytetërimi me traditë, duke paraqitur njerëz pa ngrakesa e paragjykime. Trajatat e dyta, trajtat jozyrtare, në të shumtën rasteve, njerëzve u japin epitete me vlera të përjetshme. Për shembull, në Gjakovë, Qamil Muhaxhiri, një ish këngëtar i njohur e më zë, i këngëve të vjetra gjakovare, i këngëve shkodrane e autor i tyre, ka qenë “anëtari më i ri” i Shoqërisë “Ymer Riza”. Në këtë shoqëri, kishte qenë edhe një burrë me emrin Qamil Fazlia, që e kanë quajtur **Qamili i Madh**. Njerëzit nuk e mendonin se **Qamili i Vogël**, do të përcillet gjatë gjithë jetës me një nam të madh deri në vdekje. Madje, me emrin e vërtetë Qamil Muhaxhiri, lëre që s’e njihte njeri, por edhe si fëmijë kur ishim, mendonim që **Qamili i Vogël** ishte me të vërtetë trupvogël, por ai ishte një burrë i gjatë dhe i pashëm. Duke qenë shumë i ri, synonte që në moshën tetëvjeçare t’i bashkohej me pasion kësaj shoqërie dhe duke u shquar si i talentuar për këngën, e quanin **Qamili i Vogël**. Ndërsa, Qamil Fazliu quhej, **Qamili i Madh**. Madje kudo që janë organizuar koncerte dhe ka kënduar nëpër dasma e ahengje të ndryshme, njerëzit më tepër kanë qenë kureshtarë ta shohin se kush na qenka ky **Qamili i Vogël**. Poashtu, në trajtat e dyta jozyrtare figuron emri i nderuar i patriotit “**Zefi i Vogël** (Zef Kolë Ndoja) luftëtar i shquar në çetën e Bajram Daklanit (Kosovë) i cili kishte hyrë në Shkup për shpalosjen e Flamurit kombëtar më 11.VIII.1912 d.m.th. para ngritjes së Flamurit në Vlorë”<sup>93</sup> Përfundimisht, pra, emrat e dytë jozyrtar janë mjaft simpatik dhe shqiptohen me kënaqësi, ata që mbajnë këta emra janë më të dashur për rrethin.

---

<sup>93</sup> Familja Zajmi, (Shkelzen dhe Blerim Zajmi), Shoqata e intelektualëve” Jakova”, Gjakovë, 2010, f. 134.

Sidoqoftë duhet të kemi parasysh se shkurtimi vepron pa u mbështetur fort në ndonjë kod, edhe pse dihet qysh kur zgjidhen këta emra për të emëruar një fëmijë, është e qartë se ata, gjithsesi, do të shkurtohen, dhe, sado të shkurtër qofshin ata si: Zek për Zeki, Land për Roland, Hil për Hilmi, Zeq për Zeqir, Ben për Arben, Lan për Luan, Lah për Avdullah etj.

Në këtë kuadër të emrave vetjakë nuk kanë munguar pa u prekur edhe emrat me shtrembërime tingullore të gjuhës fëminore, kur personi në moshë shumë të mitur nuk shqiptonte ende qiellëzoret dhe në vend të **gj** nyjëtonte **d** p.sh. **Gjelosh- në Devosh, Xhelal në Delal, Xhavit në David, Xhemile në Demile, Gjeshit në Demshit, Xhafer në Dafer, Nagjije në Nadije**, etj.

Këto zbulime janë gjetur kryesisht në rrethin familjar e miqësor, të ngritura, gjithashtu, mbi bazën e “Baby talk”<sup>94</sup>. Për shembull po shpalos disa nga kujtimet që kam ruajtur nga fëmijët e rretheve familjare që shumë shpesh qeshemi e kënaqemi duke i ngacmuar për mënyrën e të folurit në moshën e tyre sa ishin të vegjël si: **sarëm** në **rasëm** (lloj gatese me mish të bluar), **pasaportën** në **shapaportën**, **Zyhraja** në **Rozaja**, **leshi** në **leci** etj. Theksojmë se është me interes e vlerë të depërtohet në arsyet që kanë ndikuar në krijimin e trajtave të tilla për zbulim. Pra, nëqoftëse nuk ka interes për gjuhësinë në kuptimin e ngushtë, ka shumë interes për sociolinguistikën, porse, përderisa pranojmë që zbulimi është shprehje e qëndrimit subjektiv të folësve të ndryshëm ndaj një njeriu të afërm, atëherë është shumë e vështirë t’i dilet zot zbulimit të të gjitha arsyeve e motiveve që qëndrojnë në bazë të zbulimeve, qofshin ato në trajtën e nofkave a riemërimeve pa lidhje a ngjashmëri tingullore me trajtën e emrit zyrtar, qofshin në trajtën e formimeve nëpërmjet shkurtimeve të plotësuar edhe me ndërrime tingujsh të ndryshëm a me anë prapashtesash zvogëluese<sup>95</sup>.

Me që jemi te trajtat e dyta të emrit vetjak, si nëpër fshatra ashtu dhe në qytete, krahas emrit zyrtar, kanë edhe një emër të dytë që përdoret si nofkë sharëse. Është shumë e vërtetë kjo, e po të kërkosh ndonjë njeri me emrin zyrtar, p.sh. të thuash se ku e ka shtëpinë Përparimi, domosdo do të të pyesin **a mos e ki fjalën për “Lapoqin?”** Pra, emrin sharës (emrin e dytë) ia dinë gjithkujt, kurse emrat e parë mbeten pothuajse të panjohur. Emra të

<sup>94</sup> Prof. dr. Gj. Shkurtaç, *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, ShBLU, Tiranë, 2001, f. 123 - 124.

<sup>95</sup> Prof. dr. Gj. Shkurtaç, *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, ShBLU, Tiranë, 2001, f. 123 - 124.

tillë në Gjakovë, çuditërisht, ka mjaft dhe me një shtrirje të gjerë, por, natyrisht këta emra sharës, (ndonjëherë edhe i kalojnë kufinjt), në të shumtën e rasteve, janë emra për njerëz me aftësi të mira profesionale si: **Te Lapoqi** - mjeshtër i hollë për autoelektronikë, **Te Çopa** (tapalli) - mjeshtër i TV-ës, **Te Leshkuqi** - mjeshtër për ndërtim, **Te Çorri i Sahatçisë**, orëndreqës i hollë e me zë, **Te Sy s'gurdhani** - kallajxhi i njohur për enë, **Te Barkmadhi**, **Te Spirrani**, **Te Gojëqarapa**, (gojëmadhi) **Te Dhompaça**, ( me dhëmbë të dalë jashtë), **Te Zgatoja** (i gjatë), **Te Spirra** (i dobët, i hollë), **Te Veshpreni** (me defekte në vesh të kafshuar nga një kalë që punonte me të), **Te Hundpatuci** (me hundë të shtypur), **Te Çeli** (pa flokë), **Te Musteqja**, **Te Gogla** (njeri vogël), **Te Xhuxha**, **Te Gërrbani** (me gungë në shpinë), **Te Qallaki** (që punon me dorë të majtë), **Te krykali** (kokëmadh, që s'merr vesh), **Te Qafshtrëmti**, **Te Bulli**, **Bulleci** (i trashi), **Te Fona** (teneqepunues i besimit katolik), **Te Komshtremti**, **Te Plaki** (për ndonjë burrë relativisht të ri, por që ka viza të theksuara si të ndonjë plaku). **Te Qurraci**, **Te Tutkalli**, **Te Hundaçi**, **Te Pirajka**, **Te Qosja**, **Te rrafshulla**, etj.

Emrat e lartpërmendur dhe të tjerë me kalimin e kohës për të gjithë ata që i thërrasim në këtë mënyrë nuk kanë ndonjë kompleks (edhe pse mjaft ofendues), i pranojnë shumë lehtë, por ata persona që nuk i njohin dhe i thërrasin me këta emra i pranojnë me vështirësi këto nofka, dhe me një kompleksitet, natyrisht se disa nga këta janë mjaft ofendues, por që me kalimin e kohës fillojnë të pajtohen dhe s'u lënë përshtypje, përveç atyre që kanë karakter zvogëlues, pranohen më lehtë si: Bullec, Turrec (njeri që s'pushon së foluri), **Malec** që rrjedh nga serbokroatishtja **mali** (d.m.th.njeri i vogël) ky zbunim përkëdhelës përdoret shumë shpesh në Gjakovë, veçanërisht për persona që janë trupshkurtër, pavarësisht nga mosha që kanë, mirëpo, ky emër jo rrallë zëvendësohet edhe me emrin tjetër, **Hardhuc**.

Kjo dukuri, në Gjakovë, është më e theksuar për imagjinatën e nofkave të një kategori njerëzish, por nuk mungojnë edhe ato parapëlqyese dhe mjaft simpatike e të qëlluara saktësisht.

## **15.2. Ndërtimi i toponimeve të çiftëzuara sipas cilësimeve ( Tipi i Epërm - i Poshtëm )**

Me shumë vlerë është edhe studimi i fjalëformimit të emrave gjeografikë, fushë ku studimet e reja po sjellin përherë e më shumë të dhëna e ndihmesa me rëndësi, sepse vetëm ashtu mund të merren parasysh lidhjet midis toponimeve, marradhëniet e kundërvënies sipas tipareve të ndryshme: Çarshia e Madhe - Çarshia e Vogël, Medreseja e Madhe-Medreseja e Vogël (Gjakovë), Drini i Bardhë - Drini i Zi, Reka e Mirë - Reka e Keqe, mirë (i, e) -keq, (i,e), bardhë (i) - zi /zezë / (i), Novosella e Epërme - Novosella e Poshtme (Gjakovë), Qamili i Vogël - Qamili i Madh (Gjakovë), Zefi i Madh - Zefi i Vogël, Kalaja e Madhe - Kalaja e Vogël (fshati Batushë Gjakovë), Krusha e Madhe - Krusha e Vogël (Në mes rrugës Gjakovë - Prizren), Qyteza e Poshtme - Qyteza e Epërme (Batushë), Kodra e Dudit - Ara e Dudit (Brekoc-Gjakovë), Prroni i Kishës - Ara e Kishës - Mali i Kishës (Blinisht - Gjakovë), Suka e Madhe - Suka e Vogël (Cermjan - Gjakovë), Suka e Madhe-Suka e Vogël (Damjan - Gjakovë), Suka e Madhe - Suka e Vogël (Gërgoc-Gjakovë), Kodra e Godenit - Livadhi i Godenit (Pnish-Gjakovë), Vorret e Projës-Malet e Projës (Dobrosh-Gjakovë), Guri i Kishës-Qafa e Kishës (Goden- Gjakovë), Qafa e Osekut-Guri i Osekut-Blinat e Osekur (Hylaj-Osek Hylaj), Lisi i Begut-Arat e Begut (Kastriot Novosella e Poshtme), Damjani 1 Damjani 2, Strellci i Epërm-Strellci i Poshtëm, Kodra e Kishës – Kroni i Kishës (Meje-Gjakovë), Kroni i Mahallës së Epërme-Kroni i Mahallës së Poshtme (Molliq-Gjakovë), Fusha e Epërme-

Fusha e Poshtme (Qendresa ose Smolica-Gjakovë ), Fusha e Raçës-Ulica e Raçës (Raçë-Gjakovë), Vorret e Epra-Vorret e Poshta (Stubëll- Gjakovë), Livadhet e Egra-Livadhet e Buta (Vogovë-Gjakovë), Gryka e Dubçakit të Madh -Gryka e Dubçakit të Vogël (Bardhaniq-Gjakovë), Beci Epërm-Beci Poshtëm (Bec- Gjakovë), Brija e Madhe-Brija e Vogël, Kodër e Madhe-Kodër e Vogël (Bërdosanë- Gjakovë), Mahalla e Epërme-Mahalla e Poshtme (në verilindje të Bërdosanës- Gjakovë), Livadhet e Lugit Përpetjetë-Livadhet e Lugit Teposhtë (Dashinoc-Gjakovë), Grykat e Epra-Grykat e Ulëta (Gërgoc-Gjakovë),Jabllanica e Madhe-Jabllanica e Vogël(Shqiponjë- Gjakovë), Mrizet e Dyta-Mrizet e Para (Shqiponjë ose Jabllanicë e dikurshme-Gjakovë), Zhabeli Plak-Zhabeli i Ri (Gjakovë), Rruga e Re-Rruga e Vjetër (Janosh-Gjakovë), Arat e Epra-Arat e Poshta (Radoniq-Gjakovë), Livadhi Nër Breg-Livadhi Nër Shpi (Rakoc- Gjakovë), Ratishi i Epërm- Ratishi i Ulët (rajoni Dushkajës Komuna e Deçanit), Livadhi i Madh-Livadhi i Vogël (Sopot-Gjakovë), Guri i Kuq-Guri i Zi etj.

Midis problemeve të shumta që shtron studimi i toponimisë, përherë para studiuesve del edhe një problem i përgjithshëm: si ta bëjmë sa më mirë përshkrimin e materialit onomastik. Lidhur me këtë, qysh në krye doli problemi i klasifikimit të toponimeve, antroponimeve dhe llojeve të tjera të emrave që përfshihen në onomastikë. Por, le të kthehemi në çështjen që është kryesorja për temën tonë: studimi i toponimisë nuk ka për qëllim vetëm gjetjen e formës së parë të emrave të viseve, kuptimin e tyre origjinal. Kjo është një anë me vlerë dhe mbetet përherë në rendin e ditës, por gjithnjë duke mos harruar se realiteti i toponimisë është para se gjithash një realitet gjeografik. Sigurisht, mali apo fusha, lugina apo kodra, përroi apo lumi, burimi apo kroi, liqeni apo deti nuk emërohen vetvetiu. Atyre ua vë emrin njeriu, ai që banon në mjedisin përkatës të tyre. Por duhet të theksojmë se njeriu, para se t'i vërë emrin një vendi, një rrjedhe ujore etj. i shikon ato, njihet me pamjen dhe cilësitë a bukuritë e tyre dhe merr si bazë për t'i emërtuar ndonjë nga tiparet a dukuritë e tyre më përfaqësimitare ose që, bazën e një motivi të caktuar emocional, mund të merret si përfaqësimitare. (Le të kujtojmë toponime të tilla si: Guri i Kuq - Guri i Zi, Qafa e Malit, Qafa e Prushit, Qafa e Morinës që kemi përmendur më lartë).

## **16. Përbërja morfologjike e fjalëformuese e toponimisë shqiptare**

Ashtu si semantika e toponimisë, madje edhe më tepër se ajo, e parë në tërësinë e vet, përbërja morfologjike e fjalëformuese e toponimisë shqiptare na jep mundësi të shohim aty një sistem që karakterizohet nga uniteti strukturor, nga zotërimi në të i kryetipave dhe kryestrukturave të shqipes, të njëjta dhe të shtrira gjerë e gjatë në të gjitha trevat shqiptare. Mund të përmendim, ndër të tjera, se Norbert Jokli, në studimin e tij “*Mbi toponiminë e Shqipërisë*”, ka nxjerrë përfundime të rëndësishme edhe për fushën e morfologjisë e të formimit të fjalëve në shqipen.

Në kuadër të shqyrtimeve të gjera mbi bashkëpërkimet shqiptaro-ilire dhe shqiptaro-trake, ai vuri re pjesëmarrjen e elementeve të ndryshme në formimin e toponimeve të Shqipërisë së Veriut. Tek toponimi *Niksh,-i* (fshat e fis në Kelmend) Jokli vëren ekzistencën e një prapashtese të zvoglimit-**sh** në një kategori apelativash të shqipes<sup>96</sup>.

Mendojmë se në një grup me Nikshin nga anët veriore mund të përfshihen edhe toponimet me-**ç**: *Kolçi e Qafa e Kolçit* (Kelmend), *Egçi i Bregut e Egçi i Lugut* (Rrjoll-Mbishkodër), si dhe *Dajçi* që na del si oronim në fushat midis Shkodrës e Lezhës (*Dajçi i Bregut të Bunës, Dajçi i Zadrimes*), përderisa kemi të bëjmë me të njëjtën prapashtesë-**sh**, por me një ndërrim fonetik nën veprimin e një asimilimi, pra të një sonorizimi të **sh** në **ç** nën ndikimin e bashkëtingëlloreve të zëshme ose të tingullta. Pra *Kolçi* < *Kolshi*, *Egçi* < *Egshi* (mbase nga një formë më e vjetër *Egërshi*), dukuri që, në fakt, e kemi ndeshur edhe te vetë shembulli i studiuar nga Jokli: në Kelmend, Nikshi na dëshmohej sot në formën *Nikçi*.<sup>97</sup>

Në fushën e mikrotoponimisë është e nevojshme të bëhen edhe më tej shqyrtime lidhur me ndryshimet semantike që eventualisht kanë pësuar toporrenjë të përkatëse, siç është p.sh. rasti i toponimeve që përmbajnë fjalën **burg**.

Nga të dhënat e kërkimeve tona në anët e Shqipërisë, mund të sjellim edhe disa toponime e mikrotoponime të tjera si: *Burgu i Kurrecit, Burgu i Haxhe, Burgu i Rrogomit, Burgu i Kalet* (që të gjitha në Kastrat), *Burgjet* (Këllezën-Ulqin), ku fjala *burg* ka kuptimin

“kodër shkëmbore, majë mali si kështjellë ose kështjellë e vjetër”, po edhe *Burgu i Hutit, Maje Burgu Hutit* (po në Kastrat), ku fjala *burg* ka kuptimin “vrimë, guvë a shpellë në

---

<sup>96</sup> Shih : Nobert Joki, *Zur Ortsnamenkunde Albanienes...në "Zeitschrift für Ortsnamenforschung"*, X, pp. 181 - 206.

<sup>97</sup> Shih: punimin tonë: E folmja e Kelmendit, në DSh, III, Tiranë, 1975, f.11.

shkëmb”. Prandaj, shpjegimet që ka bërë N. Jokli lidhur me fjalën burg qëndrojnë plotësisht dhe mbështeten edhe nga faktimet më të reja.<sup>98</sup>

## 16. 1. Toponime të formuara drejtpërdrejt nga emra të përgjithshëm

Një numër i mirë toponimesh janë formuar drejtpërdrejt nga emra të përgjithshëm (apelativë) të shqipes, pa ndonjë ndryshim strukture. Të tillë janë emrat e vendbanimeve apo oikonimet e vëna mbi bazën e emrave të bimëve, drurëve etj. si: *Arrni, Arrëzi, Arra e Madhe, Kodra e Arrës, Ardhishta, Qafardhia, Bathore, Bathës* (Elbasan), *Dardha, Mollasi, Thana, Lajthia, Qershiza, Murrizi, Fishta, Gështeja, Gorrica, Shkoza, Shkozeti, Qarri, Qerreti, Driza, Ferrasi, Frashëri, Dushku* etj.

Në një numër të mirë rastesh, emërtime të tilla do të kenë dalë nga ndërtimet parafjalore të përbëra nga parafjala (zakonisht **te, mbas, nën, mbi**) + **emrin** (apelativin) përkatës, siç na dëshmojnë edhe rastet e përngjitjeve si *Temali, Teranat, Temuret* (Këllezën-Ulqin), *Nënbregu, Nënsuka* (Këllezën), *Mbasbregu, Nërpusa* (Këllezën), *Mimegja e Pimegja* (Kastrat), *Nardrumet* (Kastrat), *Narvneshtat* (Kastrat), *Narvathna* (Kastrat) dhe sidomos togjet e lira si: *Te Varret, Te Lisat, Te Tre Pusat* etj.,<sup>99</sup> *Te Mullini*. Të dendura janë në mikrotoponiminë shqiptare të Shqipërisë Veriore edhe togjet e tipit: parafjala **në** + **emër të rasës gjinore**, që vijnë nga elipsa e një togu më të gjerë që përmbante edhe fjalën ara, toka: *N’eLeks* (= në arën e Lekës), *N’e tanën* (= në arën tanë (tonë)), *N’e Hotes* (= në arën e Hotes), *N’e Markut* (= në arën Markut). Nga FEGJRSH shtojmë edhe: Formime me **tej-**, **-përtej** + **emër hidronima toponim**: *Tejbunë,-a* lagje në Shkodër. *Tejdrinë,-a* krahinë në Kukës. *Tejdrinë,-ia* krahinë në Kukës. Fusha e *Tejdrinit* (ose e Zadrimës) në Lezhë e Shkodër. *Tejkodër,-a* qendër e banuar në Pukë. *Tejmallë,-a* qendër e banuar në Kukës. *Telumë,-a* (Telumë-Klllogjën) fshat në Shkodër. *Temal,-i* në Shkodër. *Përtejujë,-a* krahinë në Mat. *Përroi i Përtejujes* në Skrapar.

<sup>98</sup> Shih edhe: Androkli Kostallari, *Contribution...* f. 44 - 54

<sup>99</sup> Shih: M. Halimi, *Mbi disa toponime të tipit perifrastik*, në OK, Prishtinë, 1979, f. 24 - 253.

Formime me parashtesën **-pas/-mbas**: *Paskuqan,-i* fshat në Tiranë. Përroi i *Pasmajës* në Tiranë. Pylli i *Pasmajës* në Tiranë. *Mbaslith-i* pyll në Pukë. *Mbasbranik,-u* shpat në Shkodër. *Mbasdejë,-a* pllajë në Mat. *Mbaskollatë,-a* qendër e banuar në Tropojë. *Mbaskollatë,-a* luginë në Tropojë. Formime me parashtesën **-mbi-**: Maja e *Mbiliqenthit* në Shkodër. *Mbishkodër-a* krahinë në Shkodër. Formime me parashtesën **-ndër-**: *Ndërfanë,-a* fshat në Mirditë. *Ndërfanë,-* azonë ndërmjet dy Fanave në Mirditë. *Ndërfushas,-i* fshat në Bulqizë. *Ndërfushaz,-i* fshat në Mirditë. *Ndërfushë,-a* fshat në Shkodër. Liqeni i *Ndërgoshtës* në Elbasan. Maja e *Ndërgoshtës* në Elbasan. *Ndërlisë,-a* fshat në Shalë të Shkodrës. *Ndërmajë,-a* varg kodrinor në Vlorë. *Ndërmajna-t* maja në Shkodër e Tropojë. *Ndërmjetëz,-a* fshat në Tiranë. *Ndërmollas,-i* fshat në Shkodër. *Ndërnënas,-i* fshat në Fier. Pylli i *Ndërstanës* në Pogradec. *Ndërshenë,-a* fshat në Dibër. *Ndërshenjë,-a* fshat në Mirditë. Formime me parashtesën **-nën-**: *Nënnavriq,-i* fshat në Shkodër. *Nënshat,-i* fshat në Shkodër. *Nënshajt,-i* fshat në Mirditë. *Nënshkodër,-a* krahinë në Shkodër. Toponime me fjalën **-buzë**: *Buz,-i* krahinë në Tepelenë. *Buz,-i* fshat në Tepelenë. Buza e Bredhit mal në Tepelenë. *Buza e Dede* livadhe në Dibër. *Buza e Lumit* në Vlorë. *Buza e Ujit* fshat në Rranxat e Mbishkodrës. *Buzahisht/ë,-a* fshat në Pogradec. *Buzëliqen,-i* fshat në Devoll. Shkalla e *Buzëliqenit* në Devoll. *Buzëmadh,-i* fshat në Fier. *Buzëmadh/e-ja* fshat në Kukës. Përroi i *Buzëmadhes* përrua në Kukës. *Buzëgarë,-a* fshat në Librazhd. Mali i *Buzit* mal në Tepelenë. *Buz-Kalemaj* fshat në Tepelenë. Toponime me fjalën **-bisht**: *Bishqem,-i* fshat në Peqin. *Bishqem-Fushë* fshat në Peqin. *Bishqem,-i Kodër* fshat në Peqin. *Bishqeth/ëm,-i* fshat në Lushnjë. Laguna e *Bishtarakës* në Lushnjë. *Bishti i Barbaut* kodër në Kavajë. *Bishti i Bredhit* shpat në Vlorë. *Bishti i Gogles* kodër në Lushnjë. *Bishti i Gurit* kurriz mali në Librazhd. *Bishti i Iqindisë* në liqenin e Shkodrës. *Bishti i Malit* pjesë e Shpiragut në Berat. *Bishti i Malit* pllajë në Vlorë. *Bishti i Pallës* kep në Durrës. *Bishti i Shpërdhetit* kodër në Shkodër. *Bishti i Zhurit* në Kavajë. *Bisht-Kamz/ë,-a* fshat në Durrës. Toponime me fjalën **-bjeshkë**: *Bjeshka e Canit* në Kukës. *Bjeshka e Kokës* në Kukës. *Bjeshka e Madhe* në Shkodër. *Bjeshka e Radit* në Pukë. *Bjeshka e Preshit* në Dibër. *Bjeshka e Vorfën* në Dibër. *Bjeshka e Zonjave* në Dibër. *Bjeshkët e Nemuna* në Tropojë e në Malësi të Madhe. *Bjeshkët e Oroshit* (ose Mali i Shejtit) në Mirditë. Toponime me fjalën **-breg**: *Breg,-u* fshat në Pukë. *Bregas,-i* fshat në Berat. *Bregas,-i* fshat në Korçë. *Bregas,-i* fshat në Delvinë. *Breglum/ë,-i* fshat në Kukës. *Breglum/ë,-i* fshat në Tropojë. *Bregor/e,-ja* mal në Elbasan. *Bregovend,-i* kodër në Mallakastër. *Breg-shkozë,-a*



fshat në Tiranë. *Bregu i Detit* krahinë në Sarandë e Vlorë. *Bregu i Bunës* krahinë në Shkodër. Toponime me fjalën **çukë**: *Çuka e Ahut* majë në Skrapar. *Çuka e Arrës* majë në Gramsh. *Çuka e Frëngut* majë në Skrapar. *Çuka e Gjatë* majë në Korçë. *Çuka e Korbit* majë në Përmet. *Çuka e Kunjzës* majë në Gramsh. *Çuka e Liqerit* majë në Skrapar. *Çuka e Mëllëzs* majë në Gramsh. *Çuka e Shullërit* majë në Kolonjë. *Çukas i Ri* fshat në Lushnjë. *Çukas i Vjetër* fshat në Lushnjë. Toponime me fjalën **gur**: *Gurabardh,-i* (Lushnjë, Korçë), *Gurakuqi* (Librazhd), *Guramëdhej* (Mirditë), *Gurazez* (fshat në Skrapar), *Gur-Lurë* (Dibër), *Gur-Përrenjas* (Përmet), *Gur-Reç* (Dibër), *Gurshqipe* (Korçë), *Gurtop,-i* (Gramash, Skrapar), *Gurkusar* (Mokër) etj. Toponime me fjalën **gurrë**: *Gurras* (Elbasan), *Gurrëgeg/ë,-a* (Librazhd), *Gurrëmuja,-i* (Korçë), *Gurëshpat,-i* (Librazhd) etj. Toponime me fjalën **shpat**: *Shpat,-i* krahinë në Elbasan. *Shpat,-i* fshat në Kukës. *Shpat,-i* fshat në Tiranë. *Shpat,-i* fshat në Elbasan. *Shpat,-i i Poshtëm* fshat në Elbasan. *Shpat,-i i Sipërm* fshat në Elbasan. *Shpatmal-i* fshat në Korçë. *Shpatanj,-i* fshat në Skrapar. *Shpatadoll,-i* grykë në Librazhd. *Bregu i Shpatarovës* kodër. Toponime me fjalën **shpellë**: *Shpella e Akullit* në Mirditë. *Shpella e Bukur* në Skrapar. *Shpella e Dragobisë* në Tropojë. *Shpella e Dhive të Egra* në Mat. *Shpella e Pëllumbave* në Lezhë. *Shpella e Pëllumbave* në Mirditë. *Shpella e Pëllumbit* në Përmet. *Shpella e Pëllumbit* në Tepelenë. *Shpella e Pulëbardhave* në Vlorë. *Shpellae Skënderbeut* në Kukës. *Shpella e Shënmarens* në Sarandë. *Shpellëz,-a* qendër e banuar në Malësi të Madhe. *Qafa e Shpellëz* në Tiranë. Toponime me fjalën **shteg**: *Shtegu i Dshve* qafë në Malësi të Madhe. *Shtegu i Dhenve* qafë në Malësi të Madhe. *Shtegu i Keq* qafë në Malësi të Madhe. *Shtegu i Keq* qafë në Dibër. *Shtegu i Pelës* qafë në Përmet. *Shtegu i Verbër* luginë në Elbasan. *Shtiq/ën,-i* fshat në Kukës. *Qafa e Shtiqnit* qafë në Shkodër. Toponime me fjalën **shullan**: *Shullan,-i* zonë në Bulqizë. *Shullan,-i* qendër e banuar në Bulqizë. *Shullan,-i* fshat në Dibër. *Shullan,-i* i Rrjollit zonë në Onomastikë dhe etnolinguistikë Rranxat e Mbishkodrës. *Shullaz,-i* fshat në Kurbin. Toponime me fjalën **pyll**: *Pylla e Vogël* kullotë në Tropojë. *Pyllë,-a* qendër e banuar në Pukë. *Qafa e Pyllës* në Shkodër. *Pylli i Buronjave* monopat në Vlorë. *Pylli i Divjakës* monopat në Vlorë. *Pylli i Gurtë* në Pogradec. *Pylli i Kosheres* në Përmet. *Pylli i Kulmaqes* në Librazhd. *Pylli i Lajthizës* në Mat. *Pylli i Shparthit* në Tepelenë. *Pylli i Shtarit* në Librazhd. *Pylli i Zi* në Dibër. *Pylli i Zi* në Gramsh. *Pylli i Zi* në Mat. Të dendura janë emërvendet e formuara nga fjala **qafë + emër të rasës gjnore**: *Qafa e Agrit* në Dibër, *Qafa e Ahut* në Tropojë, *Qafa e Buallit* ose *Qafëbuall* në Në Bulqizë e Mat etj. dhe janë rreth 235

togfjalësia të tillë nëtrevat shqiptare<sup>100</sup>, si: *Qafa e Kruathit* në Sarandë. *Qafa e Mrethit* në Tropojë. *Qafa e Sythit* në Lushnjë. *Qafa e Shënmërisë* në Pukë. *Qafa e Shënepremtes* në Gramsh. *Qafa e Shëngjergjit* në Vlorë. *Qafa e Shënkollit* në Mat. *Qafa e Shënthanase* në Sarandë. *Qafa e Tëthores* Shkodër. Me rrënjën **qafë**, dalin, gjithashtu një numër jo i vogël emërvendesh me përngjitjen e qafë me emrat përcaktues, si: *Qafëbar,-i* bjeshtë në Pukë, *Qafë-Benë* (ose *Qafa e Benës*), *Qafë-Botë* (ose *Qafa e Botës*), *Qafëbregore,-ja* në Elbasan, *Qafë-Burrel* në Mat, *Qafëcokë* në Tiranë, *Qafëçelë* në Shkodër, *Qafë-Dardhë* në Berat; *Qafëdardhë* në Delvinë, *Qafë-Draj* në Dibër, *Qafë-Gojor* në Librazhd; *Qafë-Gradë* në Rranxat e Mbishkodrs, *Qafëhardhi,-a* lagje në Shkodër, *Qafëkashtë,-a* në Gramsh, *Qafë-Kërrabë* në Tiranë, *Qafëkishë-a* qafë në Mirditë, *Qafëkryq,-i* në Shkodër, *Qafëshakull,-i* në Mat, *Qafështamë,-a* qendër turistike Krujë, *Qafështyllë,-a* në Tiranë, *Qafëthanë,-a* Librazhd, Pogradec. *Qafëbar,-i* Pukë. *Qafë-Benë* ose *Qafa e Benës* në Dibër. *Qafëbotë,-a* ose *Qafa e Botës* në Sarandë. *Qafëbregore,-ja* në Elbasan. *Qafëbuall,-i* (ose *Qafa e Buallit*) Bulqizë, Mat. *Qafë-Burrel,-i* qytezë në Mat. *Qafëcokë,-a* Tiranë. *Qafëçelë,-a* (ose *Qafa e Çelës*) në Shkodër. *Qafë-Dardhë* fshat në Berat. *Qafë-Dardhë* në Delvinë. *Qafë-Draj* fshat në Dibër. *Qafë-Gajor,-i* (ose *Qafa e Gajorit*) në Librazhd. *Qafë-Gradë,-a* fshat në Rranxat e Mbishkodrës. *Qafëhardhi,-a* lagje në Shkodër. *Qafë-Hoxhaj* qafë në Berat. *Qafëkashtë,-a* në Gramsh. *Qafë-Kërrabë* (ose *Qafa e Kërrabës*) në Tiranë. *Qafëkishë,-a* në Mirditë. *Qafëkryq,-i* qafë në Shkodër. *Qafë-Kus* (ose *Qafa e Kusit*) në Tiranë. *Qafëkumbull,-a* në Mirditë. *Qafë-Lamë* në Bulqizë. *Qafëmal,-i* fshat në Pukë. *Qafëmashë,-a* qafë në Mirditë. *Qafëmesë,-a* qafë në Mat. *Qafëmollë,-a* fshat në Tiranë. *Qafëmollë,-a* pyll në Mirditë. *Qafëmollë-a* pyll në Mirditë. *Qafë-Mejdan,-i* qafë në Tropojë. *Qafë-Mejdan* qafë në Tropojë. *Qafë-Munaz* qafë në Mirditë. *Qafë-Murrë,-a* fshat në Dibër. *Qafëshakull,-i* në Mat. *Qafëshkallë,-a* në Elbasan. *Qafëshkallë,-a* në Shkodër. *Qafëshkallë,-a* në Mat. *Qafëshkozë,-a* në Skrapar. *Qafështamë,-a* në Krujë. *Qafëzez,-i* fshat në Kolonjë. Toponime që kanë si gjymtyrë të parë fjalën **majë**: Togfjalëshat toponimikë të formuar nga **majë + emër të rasës gjinore** (që nisin me *Maja e Ali Hilës* në Vlorë dhe mbyllet me *Majat e Zeza*, *Majëgjatë,-a* fshat në Kurvelesh, *Majkosh,-i* vend në Tepelenë) ose **majë + mbiemër që tregon cilësinë** e vendit përkatës, si **ngjyrën** (*maja e zezë*), **formën** (*maja e thatë*, *maja e çarë*, *maja e madhe*, *maja e vogël*, *maja e gjatë*)

<sup>100</sup> Shih: Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Fjalor i emrave gjeografikë të Republikës së Shqipërisë, hartuar nga E. Lafe e Nikolla Cikuli, Tiranë, 2002, f. 231 – 237.

dhe në hapësirat shqiptare janë të shumta dhe gjenden kryq e tërthor Shqipërisë; vetëm në listën e emrave gjeografikë të Republikës së Shqipërisë, janë rreth katërqind emërtime të tilla<sup>101</sup>. Po ashtu të dendura janë emërvendet e formuara nga fjala **ma+emër tërasës gjnore** (*Mali i Arunit, Mali i Bushit* etj.) ose me **mal+mbiemër që tregon cilësi të vendit përkatës**, si **ngjyrën** (*Mali i Bardhë, Mali i Zi, Mali i Kuq*), **cilësitë ndryshme**, si (*Mali i Thatë, Mali Gjerë, Mali i Gjatë, Mali i Madh* etj.). Të shumta dhe me interes për nga ana e hershmërisë dhe e fjalëformimit janë edhe formimet prapashtesore me fjalën **mal**, si ato me **-th-** (*Malth-*, *i* në *Bulqizë; Kodra e Malthit* në Malësi të Madhe, *Kodra e Malthit* në Tiranë, *Maja e Malthit* në Mirditë, *Maja e Malthit* në Mat, *Maja e Malthit të Keq* në Mat); me **-isht** (*Malisht-*, *i* në Kolonjë) dhe sidomos me **-(ë) si: malësi** (*Malësi a e Gjakovës ose Malësia e Vogël, Malësia e Krujës, Malësia e Madhe, Malësia e Mirditës, Malësia e Tiranës, Malësia e Peqnit*); formimet me përngjitjen e togfjalëshave **mal+mbiemër**, si *Malzi*, *-u* në Kukës, *Malplak*, *-u* në Kukës; *Malthikë*, *-a* në Berat; *Malqenë*, *-a* fshat në Kukës etj. Të shumta janë hidronimet a emrat e rrjedhave ujore të formuara me fjalën **përroi+emër të rasës gjnore** (*Përroi i Arapës, Përroi i Ariut, Përroi i Dhelprës, Përroi i Gjarpnit, Përroi i Gjoleksë, Përroi i Lerishës* etj.); **përroi+mbiemër që tregon ngjyrë** (*Përroi i Zi* në Peqin, *Përroi i Zi* në Pukë, *Përroi i Zi* në Shkodër), **përroi+mbiemër që tregon cilësi të tjera, si i thatë, i thellë, i turbullt** (*Përroi i Thatë* në Mallakasatër, *Përroi i Thatë* në Gramsh, *Përroi i Thatë* në Malësi të Madhe, *Përroi i Thatë* në Fier e Mallakastër; *Përroi i Thellë* në Korçë, *Përroi i Thellë* në Skrapar; *Përroi i Turbullt* në Korçë, *Përroi i Turbullt* në Vlorë). Të dendura dhe me përhapje të gjerë gjeografike janë hidronimet me fjalën **pus+emër të rasës gjnore** si : *Puset e Hithit* në Burbi; *Puset e Rupës* në Tropojë, *Puset e Shtogut* në Shkodër etj. ose mbiemera që tregojnë cilësi, si: *Puset e Zez* pyll në Pukë, *Pus i Thatë* në Has etj. Po ashtu, mbi fjalën **përrua** janë edhe jo pak emra vendesh të formuar me prapashtesa, si *Përrenjas*, *-fshat* në Librazhd, *Përrenjas*, *-i* fshat në Tepelenë, *Fusha e Përrenjasit* në Librazhd.

## 16. 2. Toponimet antonimike

<sup>101</sup> Shih: Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Fjalor i emrave gjeografikë të Republikës së Shqipërisë, hartuar nga E.Lafe e Nikolla Cikuli, Tiranë, 2002, f. 168 - 178.

Në shumë vende, që nga Jugu deri në skajet më të tejme të Veriut e të trojeve Verilindore të shqipes na shfaqen me denduri toponimet me togfjalësha të përbërë nga një emër që tregon **konfiguracionin e terrenit+mbiemër cilësor**, që tregon ngjyrën, formën ose ndonjë cilësi tjetër të tij, si dhe ngjyresa të ndryshme ekspresive. Mjaft prej toponimeve të tilla janë të lidhura me çifte të kundërvëna sipas antonimisë së tiparit që shënohet: **i bardhë - i zi, i madh - i vogël, i epërm - i poshtëm / i sipërm - i ulët**: *Drini i Bardhë-Drini i Zi, Fandi i Madh-Fandi i Vogël, Krusha e Madhe, Krusha e Vogël (Prizren), Kopluku i Sipërm, Kopluku i Poshtëm, Morava e Epërme-Morava e Poshtme; Sollnje e Poshtme-Sollnje e Epërme, (Karshiakë e Shkupit), Koliçan i Epërm-Koliçan i Poshtëm (Karshiakë e Shkupit); Vladar i Poshtëm- Vladar i Sipërm, Fush' e Poshtëme- Fush'e Sipërme (Filat -Çamëri). Qyteza e Poshtme, Qyteza e Epërme (Gjakovë), Novosellë e Epërme, Novosellë e Poshtme (Gjakovë), Strellci i Epërm, Strellci Poshtëm (Deçan)*

Sidoqoftë, toponimia e përbërë nga apelativ + mbiemër cilësor që tregon ngjyrën është shumë e dendur në shqipen. Natyrisht, më të hershme aty do të jenë ato që, me kohë, edhe janë ngurtësuar, duke u ngjitur aty dy gjymtyrët në një emërtim të vetëm (të përngjitur) siç janë: *Gurakuqi, Gurabardhi, Guraziu, Ujbardhi, Barzezi, Darzeza, Kryeziu, Mëzezi, Mëziu, Malziu, Mjekërrbardhë, Mjekërrzi, Mjekërrthinjur, Lëkurëzezë, Lëkurëbardhë, Qafëzezi, Brungzeza, Lumbardhi, Malbardha, Malibardhë, Shkallabardha, Buzëbardha, Krabardh, Kujbardh, Dushkakuqi, Shkamkuq, Botëkuqe, Faqekuq, Hundëkuq, Kryekuqi, Vithkuq, Fushëkuqe, Faqekuq, Faqebardhë, Faqezi, Flokëzi, Flokëkuq, Flokëverdhë, Fushëzezë, Bokëbardha, Dhezeza, Gojbardha, Kamkuq, Syzezi, Syekaltër, Shkozbardha, etj.* Prania kaq e dendur e fjalëve të përngjitura dhe të përbëra në toponiminë shqiptare jep mundësi të shihet se në gjuhën shqipe **ka ardhur duke u forcuar e vazhdon të forcohet prirja përformime të kompozuar** dhe se, siç theksonte me të drejtë prof. A. Kostallari, “*kompozitat kanë një peshë specifike jo më të vogël se toponimet me togfjalësha*”<sup>102</sup>. Megjithatë, duhet të shënojmë se gjithandej vijnë të jenë të dendura edhe toponimet me togfjalësh të lirë (emër + mbiemër cilësor që tregon ngjyrë). P.sh. në “Fjalorin onomastik të Epirit” ndeshim toponime të tilla: *Grav'e Kuqe (Dishat), Bot' e Bardhë (Galbaq, Pandalejmon), Prroi i Bardhë (Koskë), Prroi i Kuq (Koskë), Kroj i Zi (Smërta), Guri i Bardhë (Sollop), Gur' i Zi*

<sup>102</sup> Shih: Androkli Kostallari, *Kontibut për klasifikim të tipave kryesorë të kompozitave në fushën e mikrotoponimisë shqiptare*, në SF 1971, nr. 3, f. 51 - 59.

(Spatar), *Buz' e Kuqe* (Shalës), *Bokërrimat e Kuqe* (Shqefar), *Gur' i Kuq* (Xarrë e Çiflig), *Shkëmb' i Kuq* (Salicë), *Hjeja e Zezë* (faqemali në Pllotare), *Kodra e Bard* (Arvenicë), *Dërras'e Bardhë* (Skopjonë), *Guri i Bardhë* (Shulash) etj. Nga FEGJRSH shtojmë formimet me rrënjë antonimike: **madh-e (i,e) - vogël (i,e)**: *Ada e Vogël* (ose Ishulli i Franc Jozefit) në Ulqin. *Arrëza e Vogël- Arrëza e Madhe* fshatra në Tropojë. *Babica e Madhe-Babica e Vogël* fshatra në Vlorë. *Ballenja e Madhe-Ballenja e Vogël* vend e pyll në Bulqizë. *Batra e Madhe-Batra e Vogël* fshatra në Mat. *Boriçi i Madh-Boriçi i Vogël* fshatra në Shkodër. *Bozhmillja e Madhe-Bozhmillja e Vogël* përrenj në Has. *Çermenika e Madhe-Çermenika e Vogël* krahina në Librazhd. *Çezma e Madhe, Çezma e Vogël* fshatra në Pogradec. *Çenica e Madhe-Çenica e Vogël* shpat në Librazhd. *Fani i Madh-Fani i Vogël* lumenj në Mat. *Farka e Madhe-Farka e Vogël* fshatra në Tiranë. *Frakulla e Madhe-Frakulla e Vogël* fshatra në Fier. *Garunja e Madhe-Garunja e Vogël* fshatra në Peqin. *Gërmenji i Madh-Gërmenji i Vogël* fshatra në Lushnjë. *Gllava e Madhe-Gllava e Vogël* fshatra në Tepelenë. *Gojani i Madh-Gojani i Vogël* fshatra në Pukë. *Kalaja e Madhe, Kalaja e Vogël* (Gjakovë). *Golemi i Madh-Golemi i Vogël* fshatra në Lushnje. *Gorica e Madhe-Gorica e Vogël* fshatra në Kolonjë. *Gosa e Madhe-Gosa e Vogël* fshatra në Kavajë. *Goska e Madhe-Goska e Vogël* përrua në Pukë. *Grykëshi i Madh-Grykëshi i Vogël* fshat në Peshkopi. *Kallmeti i Madh-Kallmeti i Vogël* fshatra në Lezhë. *Kallmi i Madh-Kallmi i Vogël* (ish *Kallmi Shahin*) fshatra në Fier. *Kaptina e Madhe-Kaptina e Vogël* mal në Bulqizë. *Karburnara e Madhe-Karburnara e Vogël* fshatra në Lushnjë. *Kartha e Madhe-Kartha e Vogël* majë në Mat. *Kosova e Madhe-Kosova e Vogël* fshatra në Lushnjë. *Kostreni i Madh-Kostreni i Vogël* fshatra në Berat. *Krasta e Madhe-Krasta e Vogël* kodra në Elbasan. *Kuvendi i Madh-Kuvendi i Vogël* qafë në Mat. *Labova e Madhe- Labova e Vogël* fshat në Gjirokastrë. *Larëza e Madhe-Larëza e Vogël* gji në Kavajë. *Liseci i Madh-Liseci i Vogël* majë në Korçë. *Luz i i Madh-Luzi i Vogël* fshat në Kavajë. *Mazhja e Madhe-Mazhja e Vogël* fshatra në Krujë. *Mnela e Madhe-Mnela e Vogël* fshat në Shkodër. *Myzeqeja e Madhe* (ose *Myzeqeja e Lushnjës*) krahinë në Lushnjë-*Myzeqeja e Vogël* (ose *Myzeqeja e Fierit*) krahina në Fier e Vlorë. *Ngurrëza e Madhe-Ngurrëza e Vogël* fshat në Lushnjë. *Okshtuni i Madh-Okshtuni i Vogël* fshat në Bulqizë. *Ostreni i Madh-Ostreni i Vogël* fshat në Bulqizë. *Peshtani i Madh-Peshtani i Vogël* fshat në Fier. *Peza e Madhe-Peza e Vogël* fshat në Tiranë. *Plashniku i Madh-Plashniku i Vogël* fshat në Berat. *Priska e Madhe-Priska e Vogël* fshat në Tiranë. *Qerreti i Madh-Qerreti i Vogël* fshat në Lushnjë. *Rusi i Madh-Rusi i Vogël* lagje në

Shkodër. *Sevrani i Madh-Sevrani i Vogël* fshat në Skrapar. *Sënoi i Madh-Sënoi i Vogël* mal në Bulqizë. *Sohodoll i Madh-Sohodolli i Vogël* fshat në Dibër. *Stupja e Madhe-Stupja e Vogël* përrua në Shkodër. *Shala e Madhe-Shala e Vogël* majë në Pukë. *Sharra e Madhe-Sharra e Vogël* në Librazhd. *Sheqi i Madh- Sheqi i Vogël* fshatra në Fier. *Sheza e Madhe-Sheza e Vogël* fshatra në Peshkopi. *Shëngjin i Madh-Shëngjin i Vogël* fshatra në Tiranë. *Tërnova e Madhe-Tërnova e Vogël* fshatra në Bulqizë. *Vendresha e Madhe-Vendresha e Vogël* fshatra në Skrapar. *Vitalina e Madhe-Vitalina e Vogël* përrua në Tropojë. *Zmeja e Madhe-Zmeja e Vogël* lumë në Mirditë. *Zhitomi i Madh- Zhitomi i Vogël* fshat në Berat.

### **16. 3. Toponime antonimike mbi bazën e mbiemrave:**

( epërm, - e ( i, e ) / sipërm, - e - poshtëm, - e ( i, e ) :

*Arapaj i Epërm-Arapaj i Poshtëm* fshatra në Dibër. *Berisha e Epërme-Berisha e Poshtme* (ose *Berisha e Vogël*) fshatra në Pukë. *Bllata e Epërme-Bllata e Poshtme* fshatra në Dibër. *Bogdani i Sipërm-Bogdani i Poshtëm*, fshatra në Berat. *Brest i i Epërm-Bresti i Poshtëm* fshatra në Dibër. *Cingari i Sipërm-Cingari i Poshtëm* fshatra në Gramsh. *Curraj i Epërm-Curaj i Poshtëm* fshatra në Tropojë. *Çerma e Sipërme- Çerma e Poshtme* fshatra në Lusnjë. *Çerenci i Epërm-Çerenci i Poshtëm* fshatra në Bulqizë. *Dibra e Epërme-Dibra e Poshtme* krahina në Dibër. *Dropulli i Sipërm-Dropulli i Poshtëm* krahinë në Gjirokastrë. *Dush i Epërm-Dush i Poshtëm* fshatra në Pukë. *Gojani i Epërm* (sot *Gojani i Madh*) *Gojani i Poshtëm* (sot *Gojani i Vogël*) fshat në Pukë. *Gomsiqja e Epërme –Gomsiqja e Poshtme* fshatra në Pukë. *Goskova e Sipërme-Goskova e Vogël* fshatra në Korçë. *Grabova e Sipërme-Grabova e Poshtme* fshatra në Gramsh. *Griqani i Sipërm-Griqani i Vogël* fshatra në Elbasan. *Iba e Sipërme-Iba e Poshtme* fshatra në Tiranë. *Kaptina e Madhe-Kaptina e Poshtme* (ose *Kaptina e Vogël*). *Karbunara e Sipërme* (ose *Karbunara e Vogël*)-*Karbunara e Poshtme* (ose *Karbunara e Madhe*). *Karma e Epërme* fshat në Pukë - *Karma e Poshtme* fshat në Shkodër. *Kërçishti i Epërm-Kërçishti i Poshtëm* fshat në Dibër. *Kurdaria e Poshtme* (sot *Kujtim*) - *Kurdaria e Epërme* fshat në Mat. *Kurveleshi i Sipërm-* krahinë në Sarandë e Vlorë - *Kurveleshi i Poshtëm* krahinë në Gjirokastrë e Tepelenë. *Labova e Sipërme-Labova e Poshtme* fshat në Gjirokastrë. *Leshnica e Sipërme-Leshnica e Poshtme* fshat në Sarandë. *Lishani Epërm-Lishan i Poshtëm* fshat në Dibër. *Lohja e Sipërme* (vendësit e shqiptojnë *Sirme*)-*Lohja e Poshtme* krahinë në Rrënxa të Mbishkodrës). *Luftinja e Sipërme-Luftinjë*

fshat në Tepelenë. *Malbardhi i Sipërm-Malbardhë* fshat në Kurbin. *Oblika e Sipërme-Oblika e Poshtme* fshat në Shkodër. *Orostosi i Sipërm-Orostosi i Poshtëm* breg në Sarandë. *Peshkëpia e Sipërme-Peshkëpia e Poshtme* fshat në Gjirokastrë. *Përlat i Epërm-Përlat Qendër* fshat në Mirditë. *Poroçan i Sipërm* (sot *Holtas*)-*Poroçan i Poshtëm* (ose *Poroçan i Zi*) fshat në Gramsh. *Preça e Sipërme-Preça e Poshtme* fshat në Elbasan. *Rodokal i Sipërm-Rodokal i Poshtëm* fshat në Pogradec. *Rrasa e Sipërme-Rrasa e Poshtme* fshat në Elbasan. *Selca e Sipërme-Selca e Poshtme* fshat në Pogradec. *Selishta e Epërme-Selishta e Poshtme* fshat në Dibër. *Stragu i Epërm-Stragu i Poshtëm* fshat në Mat. *Stror-i Sipërm-Strori i Poshtëm* fshat në Gramash. *Suku i Sipërm-Suku i Poshtëm* fshat në Fier. *Sulova e Sipërme-Sulova e Poshtme* fshat në Elbasan. *Shpati i Sipërm-Shpati i Poshtëm* krahinë në Elbasan *Taçi i Sipërm* (ose *Taçi lartë*)-*Taçi i Poshtëm* (ose *Taçi Poshtë*) fshat në Kolonjë. *Topotoku i Epërm Topotoku i Poshtëm* llajë në Tropojë. *Vodëza e Sipërme-Vodëza e Poshtme* fshat në Berat. *Zhabikoka e Sipërme* fshat në Tepelenë.

#### **16.4. Toponime antonimike mbi bazën e mbiemrave:**

##### **ri (i) / re (e) - vjetër (i, e):**

*Afrmi,-i* (ish *Qenas*)-*Afrimi i Ri* (fshat në Fier). *Barbulloja e Re* fshat në afërsitë Lezhës. *Bardhaj i Ri* fshat në Berat. *Biçakaj i Ri-Biçakaj i Vjetër* fshat në Lushnjë. *Borshi i Vjetër* fshat në Sarandë. *Cakrani Ri* fshat në Fier. *Çifligu i Ri* (sot *Jeta e Re*) fshat në Lushnjë. *Çukasi i Ri-Çukasi i Vjetër* fshat në Lushnjë. *Dajlan i Ri* vend peshkimi në Vlorë. *Gomsiqja e Re* përrua në Pukë. *Gruda e Re* fshat në Shkodër. *Karavastaja e Re* fshat në Lushnjë. *Karpeni i Ri* fshat në Kavajë. *Katundi i Ri* fshat në Dibër. *Katundi i Ri* fshat në Durrës. *Katundi i Ri* (ish *Mozgë*) fshat në Elbasan. *Katundi i Ri* fshat në Kurbin. *Katundi i Ri* fshat në Tiranë. *Katundi i Vjetër* fshat në Mirditë. *Lifaj i Ri-Lifaj i Vjetër* fshat në Lushnjë *Plazhi i Ri-Plazhi i vjetër* qendër e banuar në Vlorë, *Qerreti i Ri-Qerreti i Vjetër* fshat në Lushnjë. *Samrishi i Ri* fshat në Shkodër, *Semani i Ri* fshat në Fier. *Shtoji i Ri-Shtoji Vjetër* fshat në Shkodër.

Të shumta dhe, gjithashtu, të shtrira gjerë në trevat shqiptare janë edhe toponimet në togefjalësha emërorë si: *Kodra e Ujkut, Maja e Derrit, Suka e Shqarrit, Shkrepi i Drethit, Prroj i Vjetullës, Qafa e Kolçit, Balli i Dilmeres, Shpella e Pllumave, Vërat e Bufit, Hund' e*

*Drërit* etj. Edhe në këtë kategori togfjalëshash, më të hershëm do të kenë qenë ata që, me kohë, janë bërë fjalë të përngjitura, si: *Rrasfiku, Katërlisi, Shtegvasha, Qafmolla, Balldushku, Balldreni, Dushkakuqi* etj. Sidoqoftë, po të ndjekim në ballë të gjerë makro-dhe mikrotoponiminë e trevave shqiptare, mund të shohim se në pjesën e parë të togfjalëshave toponimikë (që zakonisht janë emra = apelativa) na **janë fiksuar pothuajse të gjithë emrat që tregojnë kategoritë topografike apo gjeologjike e agrare**. Denduri më të madhe kanë aty fjalët: **ara** (*Ara e Gjatë, Ar' e Kroit Plak, Arat e Nike*), ashta/ ahishta (*Ashta e Skrobotushs*), balta (*Baldovi, Bëltoja, Balta e Makërgjenit*), **bari** (*Baret e Pashs, Qafa e Barit, Lugu i Bari Qieve*), **bahçe/ bafçe** (*Bafçallëk/Barçallëk*) **bashtë, bashtinë, bira** (*Bira e Hutit, Bira e Dhelprës, Bira e Gurit Kuq*), **bjeshka** (*Bjeshkt e Kastratit, Bjeshka e Rumisë*), **boka** (*Bokat e Stolit, Narbokat*), **bokërrima** (*Bokërrim' e Kuqe, Bokërrim' e Bardhë, Bokërrimat e Dushkut*), **bota** (*Bot'e Kuqe, Bot' e Bardhë*), **bregu e brigjet** (*Bregu i Bukur, Bregu i Margics, Brigjja e Hotit, Brigjeza, Bregu i Birthit*), **brekthi e brekthat** (*Brekthat e Uldede-Kastrat Brikthi-Çamëri*), **bishti** (*Bishti i Jushit, Bishti i Rrogomit, Bishtëlat-Çamëri*), **bostani** (*Bostanet e Hale*), **brima/ vrima, brinja / brija** (*Brija e Ferrkuqes, Brija e Jeranit, Brinjat e Gumbit*), **burimi** (*Burimet e Ninës, Burim i Mërzimit*), **buza** (*Buzae Cemit, Buza e Ujit, Buza e Gurrës*), **çairi, çifligu, çuka** (*Çuka e Ajtojt, Çukëz e Mulla Aliut*), **derrpi** (*Derrpi i Toshit, Maja e Derrpit*), **faqja** (*Faqa e Ngushtë, Faqa e Kupucës*), **fusha** (*Fusha e Myzeqesë, Fusha e Domosdovës, Fusha e Kosovës dhe Fushë-Kosova, Fush' e Poshtëme*), **fundi** (*Funnat e Kuçit, Fundrat*), **fshati, gërmadha, grava** (*Grav' e Daminit, Grav' e Kuqe*), **gropa** (*Gropa e Luc Ujks, Mali me Gropa*), **gryka/ grika** (*Gryka e Dërfurçe, Grykas, Gryka e Manatisë, Grik' e Paganësë*), **guri** (*Guri i Zi, Guri i Bardhë, Gur' i Shpuar, Gurabardhi, Gurakuqi*), **gurina** (*Gurinate Curre*), **gurishta, gurra** (*Gurrat e Plakës, Gurrat e Begut, Gurra, Gurrëza*), **gjoli** (*Gjoli i Poradecit, Gjoli i Paganësë, Gjolet e Asimit*), **gjolla** (*Gjollat e Dele, Te Gjollat*), **hani** (*Hani i Hotit, Hani i Salo Kalit, Hani i Elezit, Hani i Stavros*), **hunda** (*Hund'e Drërit, Hund' e Palokalasë*), **hurdhja/ hurdhana** (*Hurdhanat e Virit, Hurdhana e Love*), **kaça** (*Kaçaj-Kastrat, Kaçaj-Zadrimë*), **kanali** (*Kanali i Reçit*), **kalaja** (*Kalaja e Dods, Kalaja e Shkodrës, Maja e Kalas*), **këmba** (*Këmb' e Zhiqes, Këmbëprerë*), **kisha/qisha/ klisha** (*Kisha e Bajzs, Klish' e Koleve, Maja e Kishës, Kishëza, Qishbardha*), **kodra** (*Kodra e Kuqe, Kodrat e Tepes, Kodrat e Gramozit*), **konizma, kopshti** (*Kopshti i Madh, Kopshtijet*), **kroi/ kroni** (*Kroi i Nartës, Kroi i Ri, Kroni i Bogs, Kruathi-*



Çamëri), **kulla** (*Kull' e Koçit, Kulla, Kullasi, Narkullat*), **ledhi** (*Ledhet e Muratit*), lera (*Lera e Likojanit, Lera e Arave Drejta*), **lëmi/ lami** (*Lami i Elbit, Lëma e Qafës Vogël, Lëma e Bërdhënjës, Lëm i Rrihërës*), **livadi/ livadhi/ luadhi** (*Livadet e Shkodrës, Livadi i G-jat, Luvedhet*), **luca** “lluca” (*Luca, Luc' e Butanje, Luc' e Vjetër, Llucast*) **lugu, lugjet** (*Lugu i Zi, Gryka e Lugjeve, Lugu i Baranit, Lukthi-Çamëri*), **lugina** (*Lugina e Matit*), **lumi** (*Lum'i Gurrës, Luma*), **llaka** (*Llak' e Merxhanit, Llak'e Shurisë*), **maja** (*Maja e Madhe, Maja e Zezë, Maja e Hekurave*), **mali** (e *Dimali i hershëm*, po edhe *Anamali*, në trojet shqiptare në Mal të Zi, *Temali* (fshat në anët e Krajës), *Mali i Miraçit, Malasi, Malsia e Madhe, Malsia e Gjakovës*), **manastiri** (*Manastiri i Ardenicës, Manastiri Shën-Naumit*), **meraja** (*Meraja e Sykajve*), **monopati, mrizi** (*Te Mrizat* si toponimi artistike *Mrizi i Zanave* te Gj.Fishta), **mullini/ mulliri** (*Mullini i T. Baculit, Mulliri i Bobos*), **muri, murrizi, përralli, qyteti/ qiteti/ qiteza, pllaja, pylli/ pylla/ pilli** (*Pill' i Arvenicës, Pill' i Lolos, Pilza*), **prroni/ prroi/ përroi** (*Prroni i That, Prroi Karavaït, Përroi i Thellë*), **pusi** (*Pusat e Mollës, Puset e Ferrulit*), **qafa** (*Qafa e Malthit, Qafa e Gelqeres, Qaf' e Koshovicës*), qeta (*Qetat e Gjone*), **qepuri** (*Qepurri i Smajlit*), **rrahu / rrahi / rraqi** (*Rrihnat e Jeranit, Rrahi i Kaçele, Rrahët e Shtratit, Rraq' i Bulgjerit*), **rrëza / rranxa** (*Rranxat e Bushatit, Rraxa e Razes, Rrëz' e Mollës*), **rrëkeja** (*Rrëkej' e Sqinshit, Rrëkej' e Malshinjit, Rrëkej' Shesheve*), **rripi / rrypi** (*Rripat e Dushanit, Rrip' e Kroit*), **rruga** (*Rruga e Maline, Rruga e Re, Rruga e Gjanë*), **stani** (*Stan' i Prroit Qelbësit, Stan' i Seferate, Stanthi*), stena, sterra (*Sterra, Sterreza,* ) **sheu** (*Sheu i Rrjollit, Ndërshena*), **sheshi** (*Shesh i Kroit, Shesh' i Kartës, Sheshi i Thanave*), **shkalla** (*Shkalla e Tujanit, Shkall' e Drizave, Shkall' e Grikohorit*), **shkami/ shkëmbi** (*Shkami i Kuq, Shkëmbet e Liqesë, Shkëmbënjt e Hjesë, Shkëmthi*), **shtegu** (*Shtegu i Dhene, Shteg-vasha, Shteqqerr, Shtegthi*), **shtufi** (*Shtufet Çamëri*), **shpella** (*Shpella e Dhene, Shpella e Piratve, Shpella e Janinës*), **shpia/ shtëpia, shtrunga** (*Shtrunga e Rraqit, Shtrung' e Shkallës Thekrës*), **uji** (*Uji i Ftohtë-Vlorë, Uji i Ftohtë-Tepelenë, Ujt e Qelbt-Mamurras, Uji i Qelbur - Çamëri*), **ura** (*Ura e Fshejt, Ura e Artës*), **vada** (*Vada e Reçit*), **valanidha, vau/ vaja** (*Vau i Denjës, Vau i Flakës, Vaj' e Argëlesë, Vaj' e Nënëshkëmbes*), **varri/vorri, vorret, verret, varrezat** (*Vorri i Paps, Vorret e Rrmajit, Varr i Plakës, Verrete Qikës*), **vathi/ vatha** (*Narvathna, Te Vathnat, Vathnat e Vathure (Këllezën)*), vija (*Vija e Matorrit, Vij' e Llapit*) vir, -i / virua, -oi (*Viri i Kastratit, Viroi i Guvës*), **zalli** (*Zalli i Prronit, Zajet e Kosanit*) etj.

## 16.5. Struktura fjalëformuese e toponimeve të trevave shqiptare.

Me interes të madh nga pikëpamja e unitetit që bie në sy në të është edhe **struktura fjalëformuese** e toponimeve të trevave shqiptare. Nga apelativa të njëjtë, kryesisht nga emra që tregojnë konfiguracionin, florën ose faunën që rritet në to, janë formuar toponime të shumta, me prapashtesa si dhe me parashtesa të ndryshme. Më kryesoret dhe njëherazi më tipiket për t'u përmendur për shtrirjen e tyre të gjerë na duken:

## 16.6. Emërtimet e formuara me prapashtesën - *th*:

Emërtimet e formuara me prapashtesën-**th**: *Ukthi, Shqathi e Sharthi* (besojmë nga shqarthi), *Krytha, Drethi, Lepthi, Kuzithi, Bishqemthi, Kryezjarrthi* (Elbasan), *Pllumthi, Hutthi, Ferrthi, Qarrthet*. Në Postripë e Gruemirë të Mbishkodrës na janë dëshmuar shumë toponime me -**th**: *Ballthi, Maja e Cukthit, Maja e Gurthit, Maja e Kakithit, Lamthe, Fusha e Lithit, Gryka e Lqethit, Lukthi, Maja e Mprajthit, Bokat e Murthit, Kroj i Pusthit, Sjapthi, Shkamthi*;<sup>103</sup> po ashtu edhe në anët e Kurveleshit toponimet me -**th** janë të dendura: *Shtokthi, Gomarthi, Kamthi, Kulmakthi, Bëmthi, Limthi, Marithi, Mërajthi, Njerithi, Qaf e Shtrethit, Valthi, Vasillojthi* etj.<sup>104</sup> Edhe në Golëm ndeshim: *Qafa e Gomarthit, Fusha e Valthit*. Po të tilla formime dalin gjithandej në Jug e në Veri: *Maja e Sukthit* (Kelmend-Malësi e Madhe), *Gropat e Shkamthit* (Kelmend), *Bakdrethi* (Plavë-Prizren), *Kuvethi* (Has-Prizren), *Fikthat* (Marshej-Kastrat), *Qafa e Malthit* (Hot-Malësi e Madhe), *Mërkurth,-i* (Mirditë) etj. Nga FEGJRSH mund të shtojmë formimet me prapashtesën -**th**, si: *Maja e Alojthit* në Mat; *Maja e Arithit* në Bulqizë; *Blithi* majë në Pukë; *Gurth-Spaç,-i* fshat në Mirditë. *Ferth,-i* qendër e banuar në Pukë; *Fusha e Liqenthit* në Shkodër; *Fushë-Lumthi* fshat në Mirditë; *Mali i Gjëmthit* e *Maja e Gjëmthit* në Gramsh; *Maja e Hithit* në Kurbin; *Maja e Hithit* në Kolonjë; *maja e Kamthit* në Mat; *Maja e Kalthit* majë në Mat. *Kusarth,-i* fshat në Elbasan; *Lepërth,-i* kodër në Pukë; *Limth,i* mal në Kukës; *Limuth,-i* prrua në Tiranë; *Fusha e Limuthit* në Tiranë;

<sup>103</sup> Shih: F.Luli, art. cit., në SF.1, f. 122.

<sup>104</sup> Shih: A.Dhrimo, art. cit., në Sf. 3. 1974, f.63.

*Liqeth*, -i bjeshtë në Shkodër; Fusha e *Liqenthit* në Shkodër, *Liqeth*, -i fshat në Krapar; *Liqethe*, -t toka buke në Skrapar; maja e *Lnerthit* Malësi e Madhe; majae *Lopthit* në Dibër; *Lumth*, -i fshat në Lushnjë; *Lumth*, -i përreth në Mirditë; Maja e *Gjemthit* në Librazhd; Maja e *Hithit* në Kurbin, Maja e *Hithit* në Mat e në Tiranë; maja e *Malthit* në Mat; maja e *Malthit* në Mirditë; maja e *Malthit të Keq* në Mat; kodra e *Malthit* në Malësi të Madhe, qafa e *Malthit* në Malësi të Madhe; Mali i *Marthit* në Kukës; *Maskarth*, -i fshat në Elbasan; përroi i *Melinthit* në Elbasan; *Mërkurth*, -i fshat në Mirditë; zalli i *Mërkuthit* përreth në Mirditë; *Murth*, -i fshat në Tiranë; *Njerith*, -i vend në Vlorë; Qafa e *Pëllumbthit* në Mirditë; Guri i *Planthit* shkëmb në Librazhd; Pylli i *Shparthit* në Tepelenë; Qafa e *Gomarthes* në Tepelenë; Qafa e *Kruathit* në Sarandë; Qafa e *Mrethit* në Tropojë; Qafa e *Pëllumbthit* qafë në Mirditë; Qafa e *Sythit* në Lushnjë; *Sukth*, -i fshat në Durrës; *Sukth i Ri* fshat në Durrës; *Sukth-Vendas*, -i fshat në Durrës; Përroi i *Shkathit* në Shkodër, pylli i *Shparthit* në Tepelenë; bregu i *Shurthit* në Pukë; *Rmath*, -i fshat në Gramsh; *Shpukth*, -i qendër e banuar në Bulqizë; *Shqath*, -i fshat në Dibër; Rreth *Fikth* (sot *Bashkim*) fshat në Fier; Maja e *Plakthit* në Mat. *Ukth*, -i fshat në Pukë; *Valth*, -i shesh në Gramsh; *Vrith*, -i fshat në Pukë; *Vrrith*, -i fshat në Shkrel të Malësisë së Madhe; *Vrith*, -i mal në Mat. Shtrirje të gjerë dhe denduri rastesh kanë toponimet e prejardhura me prapashtesën **-isht (e)**, porse për to është shkruar mjaft dhe nuk na duket e nevojshme të zgjatemi<sup>105</sup>. Për këto toponime është rasti të theksojmë lidhjen e trajtave të ilirishtes me **-e -ste (-sta, -sto)**, si: *Tregeste*, *Sagesta* etj. me ato të toponimisë shqiptare me **-sht**, si *Bukureshti* (Dibër e Poshtme), *Blinishti*, *Delbnishti*, *Gureshë*, *Thashtë* (nga *thanë+shtë*), *Breshtë* (nga *breth+shtë*) etj.<sup>106</sup>

Këtu, mendojmë, e ka vendin edhe toponimi *Gushta* (besojmë nga një *gur-shtë*). Të dendura dhe me shtrirje të gjerë në toponiminë e trevave shqiptare janë edhe formimet me prapashtesa të tjera, si ato me **-et/ -ete**: *Kashnjet*, *Bardhet*, *Frashnjet*, *Qerret*, *Shelqet*, *Shpërdhet* (besojmë nga *shpardh+ et*), *Mokset*, *Sauqet*, *Farret*, *Shkozet* (Durrës), *Mullet* (Tiranë) etj.; **-(ë)z**: *Bardhëz*, *Qyteza*, *Kalza*, *Zojzi*, *Arrëza*; **-as**: *Drenas*, *Qenas*, *Ferras*, *Gështenjas*, *Fikas* (Elbasan), *Grunas*, *Drithas*, *Mamurras*; **-aj**: *Bardhaj*, *Çorraj*, *Delaj*, *Dushkaj*, *Sykaj*, *Kalaj*, *Zogaj*, *Pelaj*, *Martinaj*; **-ar**: *Kuqar*, *Pëllumbar*; **-at**: *Progonat*, *Zhulat*,

<sup>105</sup> Shih edhe: H.Kelmendi, *Rreth emërimit dhe përbërjes strukturore të toponimisë së lokalitetit të Turiçevcit, në OK*, Prishtinë, 1979, f. 291.

<sup>106</sup> Androkli Kostallari, *Contribution a l'histoire recherchée onomastiques dans la domaine de l'albanais*, SA, 1, 1965, f. 53.

*Filat* etj. për të cilat nuk na duket e nevojshme të zgjatemi, duke qenë se ato janë vënë në dukje e analizuar gjerë në mjaft artikuj e studime kushtuar toponimisë shqiptare.

Nga toponimet me parashtesa meritojnë të përmenden sidomos ato me me parafjalën **te** që në disa raste është përngjitur me toporrënjën, si *Temali* (toponim i anëve të Krajës dhe patronim i njohur në qytetin e Shkodrës). Shtjellimet dhe shembujt përkatës që u sollën më sipër, natyrisht, nuk përfaqësojnë një pamje të plotë e aq më pak shteruese të problemit që kemi rrokur.

Çështja mbetet e hapët dhe për t'u thelluar e zgjeruar më tej në të ardhshmen. Sidoqoftë, sa parashtruam më sipër, besojmë se ndihmon për të parë se toponimia shqiptare, e kundruar qoftë në aspektin semantik, qoftë në aspektin strukturor (morfologjik e fjalëformues) na **dëshmon për përbashkësi e vijimësi**.

Kudo në trevat shqiptare, objekte të ngjashme nga konfiguracioni, flora e fauna etj. kanë emërtime të njëjta ose të një rrënje. **Edhe nga ana e mjeteve fjalëformuese dhe e strukturës morfologjike toponimia shqiptare shfaq përbashkësi të shumta e të dukshme.**

*Së pari*, meriton të theksohet se shumica e togfjalëshave toponimikë si dhe e emërtimeve të përbëra a të përngjitura janë ndërtuar me elemente leksikogramatikore të shqipes dhe shpjegohen me anë të gjuhës shqipe.

*Së dyti*, duhet të vëmë re se në toponiminë shqiptare të të gjitha trevave, krahas atyre të ndërtuara me togfjalësha, kanë denduri të madhe edhe formimet me anë të përngjitjes si dhe toponimet e kompozuar. Përngjitja, siç dihet, vjen si pasojë e frytit të një përdorimi të gjatë, madje shumë të gjatë, të togjeve të lira emër + mbiemër apo emër + emër në rasën gjinore, çka merr vlerë sidomos për hershmërinë e vjetërsinë e formimeve të tilla.

*Së treti*, theksojmë se toponimia shqiptare, e kundruar në aspektin semantik dhe strukturor të saj, tregon për vijimësi me toporrënjët e qëmoçme, jo vetëm me emërtime semantike të zbërthyeshme nëpërmjet apelativave të shqipes (drejtim ku shkenca jonë ka gërmuar me mjaft sukses), po edhe nëpërmjet elementeve të shumta, të pamotivueshme sot, siç janë, në radhë të parë emërtimet e lashta (hidronime, oronime, oikonime) të pazbërthyeshme semantike, por të përligjshme plotësisht nga ligjësitë e zhvillimeve fonetike të shqipes.

## KREU VII

### 17. Veçori stilistiko-sintaksore

Ndërtimi i frazës dhe i fjalisë në këtë të folme ndjekë rregullësit e përgjithshme sintaksore të mbarë shqipes, si përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën, rendi i lirë i gjymtyrëve në fjali etj.

Ndaj këtu do të hedhim dritë në disa veçanti sintaktiko-stilistike të saj.

1/. Përdorimi mbiemrave dhe numërorve rreshtorë para emrave, kur folësi do t'i japë më shumë theks dhe përforsim kuptimit logjik e sintaksor të tyre si përcaktorë të emrit. Për *t'madh gazep* kish folë ashtu ai. I bëna be për *t'madhin* zot. Ngatrhoen me njëni-tjetrin përma *t'voglen* gjâ. E porosita për *t'dyten* her. U bë *e pesta* dit që e pres.

2/. Rendi i anasjelltë i trajtës aspektive i kohës së tashme i formuar prej pjesës ka (*kah*)+folje që bartë kuptimin kryesorë, në mënyrë dëftore, koha e tashme + folja ndihmëse *jam*. *Kah shkoj jam* fill. *Ka punon asht* prapë. *Kah msojn jan*.

3/. Në këtë të folme dhe ato të Kosovës, bien në sy dhe ndërtimi i një togfjalëshi karakteristik: :mbiemër i landëzuar në emër + mbiemër, që kanë të njëjtin burim si fjalë të parme. Hej, pusani i pusavt.

4/. Ligjërimi i figurëshëm, proverbial e frazeologjik. Kuvendi i popullit në bazë fshati dhe më gjerë ka sherbyer edhe si institut e laborator gjuhësor për të krijuar, përpunuar e ruajtur fjalë të shumëkuptimshme, shprehje proverbiale e metaforike. Ai kandikuar në formimin, ngulitjen dhe trashëgimin e një kulture dhe të një kumtimi gjuhësor të pasur të ligjëruarit e kësaj të folmeje. Kështu për ta bërës a më të gjallë kumtimin, folësi u jep fjalëve kuptim të figurëshëm, bën përjasjen e sendeve dhe të dukurive ndërmjrt tyre, duke sajuar met, fora e simbole. Një gruajë tinzare i thot *tenjë*. He, ç'është ni *tej* ajo! Ndërsa kur është epaçiltër,

i thot *grizhëz*. Njënjeri dyfytërësh e karakterizojnë me shprehjen: *fytyrëlulë e zemërand*. Ashtu paraqitet ai, po është *fytyrëlul e zemërand*. Për një njeri të lig thuhet *është për me ia përvlue shkamin*. Për një llafazan: *flet për Shkup e për Shkoder*, për një mendjemadh : *me i ra hunda në tokë, nuk ndalet me e marr*. Ndërsa një vajzë a një grua e bukur cilësohet: *Ajo ban drit n terr*, pra është e bukur si yll, saqë ndriçon në errësirë. Ose *është për me marr bleta n tâ është e bukur si lule*. Për t'i dhënë peshë e thellësi mendimit, përdoren fjale të urta apo shprehje proverbiale, veçanërisht nga folësit e moshuar. Ja një tekst i shkurtër:

“Njeriu është musafir n’ket bot, prandaj lum ai që nuk koritet, po bahet çoban i vetit e i familjes vet. Mâ mir me dek i varfen e me nder, se i pasun e me marre. Lakmia e tepërt për mall e pasuni ta grrye shpirtin, nuk t’len nder as burrni. E, pasunia, si i thonë ni fjale, është rrugaqe. Ajo shkon e vjen, po nderi e burrnia shkojnë niher e s’kthehen mâ”.

*Elez Isuf Sulaj, 102 vjeq  
autodidakt, Begaj, maj 1997.*

5/. Kumbtimi eufemik. Kemi vënë re se folësit e pjekur në moshë dhe të kulturuar, për ta bërë sa më të çiltër bisedën apo për të mos krijuar keqkuptime e fyerje, përdorin shpesh edhe eufemizma, ose shprehje eufemike. Kur tjetrit i ndërpritet fjala a i ndërhyhet kur flet, i thuhet: *-T’u preftë me mjaltë* (kuvendi), se...! Ose: *- Mos ta preftë anmiku...* (fjalën)! Ndërkaq, kur kundërshtohet bashkëfolësi, i thuhet: *-Nuk është ashtu*, në vend që t’i thuhet: “Nuk është e vërtetë”, ose “po gënjen”. Kur një person fërkohet e nxehet me një tjetër, sidomos në fshat, i drejtohet atij: *- Shko kumar n’pun tande!* Apo: *Shko t’paça kumar!*, edhe kur nuk e ka të tillë. Këto shprehje përdoren edhe për t’iu drejtuar gjarprit, kur përballen me të për ta zbutur sipas botëkuptimit eufemik e besëtytnor.

Kësisoj, në funksion të kumbtimit eufemik përdoren tabu edhe eufemizma të shumta, si prej përemrash: *ai (ajo), ata (ato)*, kur bashkëshortët nuk duan t’ia zënë në gojë emrin tjetrit. Kah shkoi *ai, zo? Ç’u bâ ajo?*

Për orët e zanat përdoren: *t bardhat, t lumet, fatmirat, t mirat*; për djallin: *brigrremçi, briperdredhuri, kambkputuni, kambmallkuemi, kambtersi, punharami, punligu,*

*punmbrapshiti, puntersi, punziu; për ujkun a gjarpërin: gojndrymi, gojnguruemi, gjeja; gojhelmti, kutullaçi etj. Apo shprehje eufemike, për Zotin, thuhet: Ai që na ka dhanë mishin e shpirtin (që na ka krijuë, që na ka fal ), Ai që ka krijuë shtat pal tok e shtat pal qella (qie,) Ai që na past n dorë! Dasht ai që vran e kfejll! Për të paudhin: Ai që kopt si bagla e kalit! Ai q mos iu zant emni n goj! Ai që mos past gojë! Ai që mos past hise! Kafsha e lig ( e zez).*

**6/.** Të folurit me rrotlla, duke sjellë shembuj rrëfenja a shprehje të tërthorta .

Po sjellim ndonjë tekst të shkurtër për atë konkretizim.“Kishin pas shkue dy djel musafir te ni ship. Mas darke e kish zan gjumi njënin prej tyne n’margez, pa ra hala n’tesha. I zoti i shipsë i thot njënit prej mashkujve t’vet:-I pata ngjit dy mzet n’laver, po njani ma zuni gjumi n’braz. Djali qe ish çuet e kuptoi se e kish fjalën per t’vllan, t’cilin e kish zanë gjumi e ja kthen aty për aty: Po merre e çoe n’aher te lopt, se është hala i ri per lavër.

Pra, ja kthen alltias pergjigjen per talljen qe u bëni i zoti i shpis, tuj i than rrotull që “n’koft se vllan tem po e que mizat, ather çoe n’oden tjeter te lopt e mshtjerrat, pra te nuset e te çikat”. ( Sipas autorit Avdyl Sulaj” *Shkrime dhe hulumtime gjuhësore*”f.154-158. Tiranë, 2012.

*Ali Rama, 80 vjeq, me arsim fillor,  
Begaj, 1998*

## KREU VIII

### 18. Leksiku

Gjatë gjurmimeve e hulumtimeve shumëvjeçare që i kemi bërë në të gjitha fshatrat e Malësis së Gjakovës, kemi vjelë dhe përpunuar një lëndë të pasur leksikore prej disa mijëra fjalësh të pabotuara. Botimi dhe studimi i kësaj lënde të çmuar është i shumëvlershëm. Pjesa dërrmuese e fjalëve janë të burimit të shqipes, çka përbëjnë një gurrë të freskët për pasurimin e gjuhës letrare e kombëtare, shfrytëzimin e shumë prej tyre në letërsinë artistike dhe në publicistikë, si dhe për studime gjuhësore-dialektore. Ato plotësojnë zbrazëti dhe mungesa në Fjalorët e shqipes së sotme për fjalë antonimike burimore, si: *dofarë, mendjemashkull, kryevogël, bukëhallall, gjallnik, vërritar, hajelëhtë, paburrëshmërisht, kundrejt njëfar, mendjefemër, fikan, kryemadh, bukëharam, bjeshkëtar, llupës, burrërisht*, etj. Njëherësh kjo lëndë leksikore shpalos një sinonimi të larmishme me fjalë të figurshme, me ngjyresa emocionale, me fjalëkrijime të zhdërvjellta e të shumpkuptimshme, si *skurrjel, pip* për curril, çurg: *capërdak, vaster, ratë, topër, remc* për mashkull; *gojëshosh, gojëçakallë*, për *llafazan*; *kobndjellës* për *ndjellakeq*; *barkkulshedër, planckulshedër, gojëkulshedër, syhapët, syunët, syshqyer, sykulshedër, sytangimë*, për *i pangopur, i babëzitur, lakmues, i madh* etj.

Kjo e folme ruan një numër fjalësh të huazuara, të cilat, në mënyrë të grupuar paraqiten kryesisht në dy nënshtresa, përkatësisht prej turqishtes si: *razi, hajgare, masllahat, dallash, sbet, ahmak, dalladak*; prej sllavishtes, si: *otkos, zahaq, preznyak, pokojit, opet, orok*. Rrallë haset ndonjë prej greqishtes si: *drum*, e prejardhëset e saj *drumit, drumtar*, apo prej gjuhëve neolatine si: *faculetë, sperdut*, p.sh., prej italishtes *focoleta*, shami dhe *i humbur*.

Veçori e këtyre huazimeve është se, përveç ndryshimeve tingullore për ato turke, që i ndriçuan më lartë, disa janë bërë prodhuese, duke dhënë fjalë të reja me mjetet fjalëkrijuese të shqipes, si: *i takatashim* > takat+shëm, *i patakatshim* > pa+ i takatshim, *i pamilet* > pa + millet, *açikoj* > açik + oj, *syçeker* > sy + çeker, (Çakërr), *qeskinoj* > qeskin + oj. Ndërsa për ato që nuk janë bërë prodhimtare, vihet re kufizimi gjithnjë e më i madh i tyre. Kurse fjalët e rralla, që dalin në pah në këtë të folme, përgjithësisht përdoren në të gjithë hapësirën



ligjëruese të saj, madje ato dëgjoen edhe në Kosovë, në Malësi të Madhe, Has, Pukë, Mirditë etj. Ndërkohë vërehet dhe një hapsirë e rrudhur e përdorimit për disa prej tyre. Në Çerem dhe Valbonë dalin disa fjalë të tilla, që nuk ndeshen në viset e tjera, si *plasmall, kersanez, osojna, nyshull, rogush*. Po kështu, në Nikaj-Mertur dëgjoen disa sosh, si: *katafiq, gjyskoshiqe, zedaf, koshoj, kablleç, larzroj* e të tjera. Ka dhe të tjera, si: *meçit, oberlan, galesh*, që hasen vetëm në një fshat, në Begaj.

Sa u përket fushave të këtij leksiku, bie në sy përdorimi i gjerë i tij në lëmin e bujqësisë, të blegtorisë, të bimësisë etj. Ndërkaq fjalët nga zejet, mjeshtëritë etj. janë të rrralla. Duke qenë se inventari i këtyre fjalëve është botuar i plotë në librat e studiuesit Avdyl Sulaj *Visare gjuhësore-kulturore nga Malësia e Gjakovës I*, Tiranë, 2000, dhe *Fjalorë fjalësh dhe shprehjesh popullore* Tiranë, 2009, Këtu po japim vetëm një grupim të vogël prej tyre, për të krijuar një paraftyrim për fushat e përhapjes së tij.

### **18. 1. Fjalë nga fusha e bujqësisë :**

**Boçillë/ë,-a** f. Fruta e arrës me shark, arrë e pabërë ruk: sharku i arrës.

**Bushtáj/ë,-a** f. Lëpusha e kallirit të misrit.

**Çepúr, i** m. Kallame, kakutë.

**Galínxh,-i**, m. Kalli misri me kokërra të rrralla e të vogla, rrallesh, kaçaberr.

**Kajz,-i**, m. Kallëz.

**Mahún/ë,-a**, f. kryes sh. Bishtajë.

### **18. 2. Fjalë prej sferës së blegtorisë**

**Bardhokán,-i**, Dash bardhok.

**Bostán/e, ja** f. Lopë me qime të kuqe të theksuara si shalqini.

**Édhez,-a** f. Femra e edhit; kece, edhe.

**Gurój,-a** m. Ka me qime të murrm.

**Laréc,-i**, m. Qen i larmë.

**Larój -m.** Ka i larmë, larua.

**Surój,-a** m Ka i surmë, i murrmë.

### **18. 3. Fjalë nga fusha e bimësisë**

**Badigúc,- i** m. Bar që rritet në tufë, me rrënjë të bashkuara dhe fije si halat e pishave.

**Bréz/ë,-a** Mështeknë

**Bylbylbardhë,-a** f. Bimë barishtore, që përdoret në mjekësinë popullore.

**Dúshk/ël,-la** f. Gjethe dushku e vogël.

**Fíz/ë,-a** f. Bimë barishtore e ngjashme me fierin, që mbin pyejeve në pranverë të hershme dhe nxjerr lule ngjyrë manushaqeje.

**Gurgalém,-i** m. Bimë që formon në rrënjë një kokërr të madhe si patate; brukth.

**Krípëz,-a** f. Gram.

**Kulpnák,-u** m. Kulpër e trashë

.

### **18. 4. Fjalë që shënojnë shpendë**

**Ferrácak (ferran,ferrác),-i** m. Ferrak, inxami.

**Grízhëz,-a** f. Laraskë me pendë shumëngjyrëshe, grizhël.

**Milicák,-u**, m. Zog i vogël i përhimë, melacak.

**Nork,-u** m. Lejlek.

### **18. 5. Fjalë që emërtojnë kandra**

**Brámull,-i** m. Mashkulli i bletës, brumbull 2.

**Bubác,-i**, m. Brumbull.

**Mrrél /ë, a** f. Zekth, murrjelë.

**Mizác,-i**, m . Krimb a larvë, që zhvillohet në brendësi të drurëve etj.

**Kímëz,-a**, f. Krimb shumë i gjatë e i hollë, që rri zakonisht në ujëra të turbullta.

### **18. 6. Fjalë që shënojnë sende, mjete pune orendi etj:**

**Fémëz,a** f. Fëndyell.

**Hirám,-i** m. Lloj batanije, Strugë.

**Kullójs / ë, a** f. Kullore.

**Mlójs/ë-a** f. Mbulesë, mbulojë.

**Ndërshtëjz/ë, a** f. Barrë e vogël, që u vihet kafshëve të ngarkeses mes barrëve të mëdha.

**Paád/el-la** f. Leckë, zhele.

**Rrafshór,-i** m. Zdrukth i madh e i gjatë: plan II.

### **18. 7. Fjalë që emërtojnë koncepte dhe cilësi abstrakte.**

**Alltías** ndajf. Rrufeshëm, flakë për flakë: radhazi, rend.

**Arritím,-i** m. Grimë, grimcë, thërrime.

**Ashtthátë** mb. I bërë kockë e lëkurë.

**Barrëvrámë/ -ë,-e** mb. Orëvvarë.

**Bat'húq,-e** mb. Hutaq, i marrë, guhak.

**Buzëçerép,-e** mb. Buzëmadh.

**Cipërcullák** ndajf. Zhveshur, krejt lakuriq.

**Deracák,-e** mb. Që bredh derë në derë.

**Fjalëtopúz,-e** mb. Fjalërendë.

**Hijeník,-e** mb. Që intrigon prapa krahëve.

**Hjekësój** kal. Mashtror dikë dhe e qes në pritë, tradhëtoj, pres në besë.

**Mendjeshúl** mb. Kokëbosh, mendjefyell.

**Mirashéjtas**, ndajf. Drejtëpërdrejt, haptazi; pa të keq, çiltas.

**Mundtrétun** mb. Mundimhumbur, mundzi.

**Shatatfýell**, mb. Stërhell, skërfyell,

**Zezán,-e** mb. Fatzi, i humbur, qyqarë.

## **Përmbyllje**

E folmja e Malësisë së Gjakovës flitet në një hapësirë të gjerë gjuhësore. Ajo është në fqinjësi me të folmet e Kosovës, të rrethit të Hasit, të Pukës e të Malësisë së Madhe. Kjo shtrirje e fqinjësi ka ndikuar që ajo të mos jetë e njësuar sa u përket tipareve dhe dukurive gjuhësore. Kështu në viset e Gashit, të Krasniqes, të Bytyçit e të Berishës së Brigjeve ajo përkon më shumë me gegërishten verilindore, kryesisht me të folmen veriperëndimore. Ndërkohë në katundet në anën e Kosovës, si në Botushë, Morinë, Koshare etj. vërehen ndikime të së folmes së Kosovës, si *o* e zgjatur në ndonjë fjalë: *Poo,a?* Ruajtja e *l*-së në vend të *j*-së: si “*S’qan* (çan) kokën”. “*Â* met *gjugj* (xhuxh)”. Formimi i shumësit me *e* të ndonjë emër, në vend të *a*-së, si *binek*. Ata janë *binek*.

Kjo e folme karakterizohet nga prirja konservuese për të ruajtur veçoritë e trashëguara, të cilat janë zotëruese dhe nga prirja afruese e njëjtësuese me gjuhën letrare standarde. Këto më qartë dalin në pah në fushën fonetike.

## Prirja e parë vihet re:

Në ruajtjen e **â**-së hundore në vend të **ë**-së, e cila përgjithësisht nuk shqiptohet fare, ose zëvendësohet me **e**.

Përdorimi i **n**-së së parotacizuar në vend të **r**-së. Shqiptimi me timber të zbutur i grupeve të bashkëtingëlloreve **nd** e **ng**, si dhe reduktimi i togut **mb** në **m** etj.

Ndërkaq prirja afruese në gjuhën letrare të njësuar shfaqet: Shndërrimi i **g**-së në **gj** të një kategori fjalësh dhe shqiptimi i këtij grupi bashkëtingëlloresh në pajtim me normën e përgjithshme, si: i **gatë**-i **gjatë**, **gobë**-**gjobë**, **guhë**- **gjuhë**, **guni**-**gjuni** etj.

Shqiptimi i **q**-së sipas normës letrare dhe jo i zbutur në një varg fjalësh, që kanë hyrë prej toskërishtes apo nga ndikimi i gjuhës letrare, si: **qumësht**, **qeveri**, **qytetërim**, **qofte**, **quhem**. Shumëformësia dhe pasuria fjalëkrijuese e trajtëndërtuese, çka bie në sy në gjedhet e mjetet e larmishme të krijimit të fjalëve të reja, në motorëzimet e shumta të ndërtimit të kohëve të foljeve, sidomos me foljet ndihmëse **kam** dhe **jam** etj.

Prandaj, folmja e Malësisë së Gjakovës, domosdo spikat një leksik të pasur, karakteristik, të gjallë dhe plot muzikalitet e mbi të gjitha me përdorim aktiv, që nuk haste në gjuhën letrare. S'ka dyshim se kryesisht është i brumit të shqipes dhe shpalos visare të çmuara për pasurimin e gjuhës letrare të përbashkët me fjalë të reja, për pasurimin e sinonimisë e të antonimisë së saj, si dhe për hulumtime dialektologjike dhe gjuhësore në tërësi. Në këtë përmbyllje, për të dhënë një sqarim më të hollësishëm lexuesve më poshtë po paraqesim: *Çështjen gramatikore, veçanërisht, në qytetin e Gjakovës*: E folmja e Gjakovës, e cila karakterizohet si dialekt i gegërishtes verilindore, njihet si njëra nga të folmet më të pastra të gegërishtes dhe të gjuhës shqipe që shtrihet në Kosovë. Tiparet e saj morfologjike përafrohen shumë me pjesën veriore të Shqipërisë, konkretisht me të folmen e Shkodrës. Siç e përmendëm më lart, folësit e trevës së Gjakovës kanë pasur kontakte të shumta tregtare që gjatë shekujve të kaluar, ku kanë spikatur veçanërisht ato ekonomike. Gjithashtu, kanë pasur kontakte edhe nga ana administrative me shumë vende të Shqipërisë, si me Shkodrën, Tropojën dhe fshatrat përreth. Dimë që Tropoja me fshatrat përreth quhet ndryshe dhe Malësia e Gjakovës. Prandaj, dhe në pikëpamje dialektore kanë mjaft veçori të përbashkëta

me këto vise, por, natyrisht, kanë edhe disa elemente apo tipare të vogla dalluese. E folmja e Gjakovës është nëndialekt i gegërishtes, prandaj në studimin tonë për këtë të folme do të bëjmë shtjellimin e elementeve dialektore nga ana e morfologjike, ku do të vëmë në dukje dallimet dhe ngjashmëritë dialektore në krahasim me shqipen standarde. Në këtë të folme kanë ndikuar e vijojnë të ndikojnë shumë faktorët shoqërorë, kulturorë, ekonomikë, politikë dhe gjeografikë. Krahas sa u përmend më lart, dihet se një nga faktorët më me rëndësi është edhe ndikimi dhe përhapja e mjeteve të informacionit, sidomos tani me zhvillimin e teknologjisë moderne përmes programeve elektronike, konkretisht të digjitalbit, i cili është një rrjet elektronik i përhapur edhe në Kosovë, por edhe kontakti apo lëvizja shumë e shpeshtë e folësve gjakovarë në trevat e Shqipërisë politike. Zhvillimi i hovshëm i infrastrukturës, si një element shumë i rëndësishëm i lëvizjes së banorëve tek njëri-tjetri, martesat e shumta midis Gjakovës dhe qyteteve të ndryshme të Shqipërisë, po më të përhapura me qytetet e Shqipërisë Veriore. Mund të thuhet se kanë ndikuar si një element i zhvillimit, stilit dhe ndërlidhjes së grupeve shoqërore të një faktori situativ në procesin e komunikimit, komunikim ky që dikton një shtysë për ruajtjen e pastërtisë së gjuhës shqipe në këtë trevë.

## KREU IX

### 19. Veçori semantike dhe strukturore rreth përformëzimit të

#### ” Patronimeve të shqiptarëve”

me theks të veçantë, zgjidhja alternative: njëjësi i shquar / prapashtesa -AJ

Si ndërkombëtarizëm, termi **patronim** etimologjikisht shpjegohet, si kompozitë me prejardhje greke: patronimik/os *pater* - babai + *onoma* emë (*patronimikos* edhe *mbiemër*, nga emri i babait), por si koncept **patronimia** i takon një disipline shkencore si nëndegë e fushës së **antroponimisë**, e cila studion emrat e përveçëm të njerëzve e kjo bashkë me toponiminë bëjnë pjesë në kuadër të **onomastikës**-degë e gjuhësisë, cila studion **tërësinë e emrave të përveçëm**.

Sipas historikut të kësaj disipline (**patronimisë**) thuhet se zanafillën e ka që në Kinën e lashtë, kur fëmija, sipas traditës mijavjeçare (matrialkatit) thirrej në emër të nënës, por që në epokën e matriarkatit, nga dinastia **Shang** (1600 - 1040 p.e re), ndryshon dhe tani bëhej në emër të babait. Me sa dihet edhe në klanet, (dinastitë) perandoritë e vendeve të tjera edhe të Europës emrimi i fëmijës bëhej fillimisht në emër të nënës por në ndërkohë, kryesisht në emër të babës, gjithsesi në emër të prindërve, por më vonë edhe me mbiemra të tjerë, varësisht nga organizimet e organizmat shoqërorë, fetarë e shtetërorë.

Kështu edhe rreth emërtimeve të mbiemrave familjarë (patronimeve) kishte dhe ka përkime, por ka edhe dallime në mes të popujve, që ne gjatë analizës lidhur me antroponimet në krahasim me gjuhë të tjera mund të përmendim në gjuhën tonë ndonjë karakteristikë gjurmëlënëse që nga epoka pellazgo-etruske-ilire, gjithsesi paraantike, si dhe më vonë, siç janë konkordancat ndërndikuese helene, romake, bizantine, sllave, turke dhe të mëvonshme e aktuale.

Është konstatuar se që në epokën paraantike disa onoma, qoftë si matronime, qoftë patronime, jo dhe aq hamendjesisht, shpjegohen me anë të shqipes, siç janë fjalët hebr. *h/elloh* ose arab. all *-lah* ( sot Hyll \*h / ll), pellaz**de** a pellazg (pjella-dhe(u)), si dhe Adam (a/d-de sot *dhe*), *Zeus* (sot *Zot*), *Ili* (sot *ylli*) etj.

Onomastikanët tanë dhe të huaj kanë konstatuar se në Greqinë antike praktikohesh që në shenjë patronimi për identifikim emrit vetjak i bashkëngjitej emri i vendit të prejardhjes,

si p.sh. *Herakliti nga Efesi, Aleksandri i Maqedonisë* etj. Edhe në Perandorinë Romake flon të praktikohet “by onoma”, d.m.th. emërtimi dy gjymtyrësh: “i biri” i ... (të jatit) ose “personi i prindit+vendi”!, por ndërkohë zunë të përdorëshin tri emërtime: **1. preanomen** (i biri i ... (emri) të jatit), **2. gens** (i biri i + (emërtim me identifikim klani (farefisi) me elemente të patronimit të sotëm) dhe **3. cognomen** (me kuptimësi kryesisht llagapi, (tej) emër (tim) sipas pozitës shoqërore etj.). Ndërkohë e në kohë regjistrimi me patronime bëhej nga ungjillorët për interesa fetare e klanore, sidomos kjo u imponua në kohën e kryqëzatave (*noms de guerre*). Kjo praktikë me ndonjë modifikim vazhdoi edhe në Perandorinë Bizantine dhe do të kalojë edhe në Perandorinë Osmane.

Sipas dokumentacionit ekzistues në administratën turke janë ruajtur regjistrat (defterat) përkatës, ku shënohej: **1.** emri personal, **2.** emri i prindit, zakonisht i babait, ose në raste, i nënës dhe **3.** vendi. Edhe në gjuhët sllave u ndoq pothuaj një praktikë e tillë lidhur me identifikimin e mbiemrave, madje si në gjuhë të tjera u identifikuan edhe formante speciale për një destinim të tillë. Kështu, p.sh. në Europë thuhet se për shënimin e patronimisë prijnë irlandezët të cilët si formant të parë identifikimi për të posalindurit fillimisht shënonin një “**O**”... (\*ou) me kuptimin “nip”, pinjoll i familjes, ndërkohë shënohej Mac ose Mc, me kuptimin “*i biri i ...*” ose Nic: “*e bija e...*”. Theksohet gjithashtu se në Danimarkë dhe në mbarë Skandinavinë si patronime prijnë që moti emërtimet me formantin fundor “...**sen**” që ka kuptimin “...*djalë*” ose *i biri*.

Në gjuhët sllave për konceptin e patronimit prijnë trajtat e mbiemrave - **OV** dhe - **EV** si p. sh. Jovan**ov** që do të thotë ... *i Jovanit*, Radiç**ev** që do të thotë ... *i Radit*, por ndërkohë në këto gjuhë (sidomos në serbishte) u shtua prapashtesa diminutive - **IQ**, dhe kështu mbiemri shënohej me dyfishim formanti si: Jovan**oviq**, Radiç**eviq**, por në kohë të vona shihet një thjeshtëzim, duke u hequr formantet e pronësisë - **OV** e - **EV** dhe kështu mbetet vetëm diminutivi tash formant i specializuar për këtë destinim: -**iq**: Jov**iq**, Rad**iq**. Në gjuhën turke për konceptin “i biri” del \**oglu* – *o(g)llu* (-**OLLI**), në arabisht –*bin-*, hebr. –*ben-*, mirëpo formante ose finesa të tilla të specifikuar për këtë destinim ndeshim edhe në gjuhë të tjera.

E pamë të nevojshme të bëjmë këtë si hyrje, sepse populli ynë ka pasur fatin që të ketë bashkëndërlidhje e ndërndikim jetese me popuj të tjerë edhe sa i përket ndërndikimit të patronimisë që nga paraantika, d.m.th. që nga epoka pellazgo-ilire-estruske, pastaj nga antika, epoka helene, latine dhe në vijimsi, siç u cek më sipër, duke u ballafaquar për këtë



segment edhe me format bashkëkohore të gjuhëve të sotme fqinje: sllave, greke, italiane, por edhe të popujve të tjerë si të gjuhës gjermane, franceze, ruse, angleze etj. si dhe me të gjitha rrymat ideologjike e fetare të atokohshme, të pak mëhershme dhe të sotme. Sido që të jetë, siç e pamë paksa nga të dhënat e mësipërme, dihet, nga zhvillimi jetësor bashkëkohor i çdo shoqërie njerëzore e gjuhësore se çdo mbiemër i fëmijës fillon e rrjedh nga emri i prindit (babës ose nënës), por nuk mbetet me aq në rrjedhë, sepse siç kuptohet nga praktika e mbiemrave patronimi del i shtrirë së paku si trajtë përfaqësuese jo vetëm të një familjeje të ngushtë, por edhe më gjerë me tendencë vijimsie.

Së këtejmi, tema “**Veçori semantike dhe strukturore rreth përformëzimit të “Patronimeve të shqiptarëve”**” në raport me antroponimet është mjaft komplekse. Kështu në punimin tonë kemi për qëllim të zbardhim pikërisht: **zgjidhjen alternative** me theks, formantet patronimformuese, por para se të thellohemi në analizë, fillimisht e shohim të arsyeshme të sqarojmë tri gjëra terminologjike:

**a/.** termin **patronim** ne gjithsesi e përdorim me kuptim të konceptit përfaqësues për të dy prindët: emri i babait (patronim) dhe emri i nënës (matronim), por edhe më gjerë si **emër familjar**, i cili mund të jetë as mbi bazë të emrit të të jatit as të së ëmës, por të një gjyshi e stërgjyshi, por edhe mbi bazë të ndonjë burimi tjetër, që mund jetë bazë e një toponimi, ose të një ofiqi, nofke apo ndonjë veçorie karakteristike njerëzore,

**b/.** edhe pse e pamë se nocioni i antroponimit shtrihet jo vetëm te emrat vetjakë të prindërve, por edhe te ndonjë rangu tjetër, qoftë si patronim ose matronim, ndërkaq ne për arsye thjeshtëzimi e stili në raste fjalë-termin antroponim e përdorim vetëm për emrat vetjakë të gjymtyrës së parë ose në raste të tjera si koncept edhe për emër-mbiemrin bashkë dhe

**c/.** këtu po shtojmë edhe një sqarim tjetër, që më tepër vlen për shkollarët fillestarë, të cilët e kanë të freskët nga mësimet në shkollë për termat **emër** e **mbiemër** si kategori të veçanta gramatikore. Po sqarojmë se me fjalë - termin “**mbiemër**” ose “**patronim**” e kuptojmë jo si një mbiemër, që *si pjesë e lakueshme e ligjëratës cilëson emrin dhe përshtatet me të në gjini, në numër e në rasë*, por kemi të bëjmë me një emërtim, që bën pjesë në kategorinë e emrit, madje të **emrit familjar** (si llogarit etj.) që *vihet pas një emri vetjak të njeriut* (Shih FGJSH 2006 f. 604), përkatësisht me “*patronime të shqiptarëve*”, kuptojmë *emrat e familjeve përkatëse* në gjuhën tonë të regjistruara ose të njohura që kanë

bartur, bartin dhe do të bartin si trashëgim shqiptarët, ndërkaq sot si kriter kryesisht kemi parasysh emërtimet zyrtare.

Sido që të jetë, për të pasur një ide më të qartë rreth kuptimisë dhe rëndësisë që ka studimi i shquarsisë dhe shumësit të emrave të përveçëm për historinë dhe gjuhën tonë kombëtare, ku bëjnë pjesë, pra, edhe patronimet, ne, veç tjerash lidhur me emrat familjarë (mbiemrat) konsultuam lëndën e përfshirë në dy vepra të autorëve tanë, së pari, përmendim veprën shumë cilësore, për kohën kur u botua, të studiuesit **Jusuf Shpuza** “*Vëzhgim për emrat familjarë të shqiptarëve*”, Shkodër 1998 (në tekstin e mëtejshëm VEF) dhe së dyti, veprën po ashtu cilësore të **Çlirim Bidollarit** “*Fjalor i patronimeve të shqiptarëve*”, Tiranë 2011 (në tekstin e mëtejshëm FP).

I quajmë vepra cilësore që të dyja burimet sepse në to veç fondit të shembujve të tillë të grumbulluar në numër të konsiderueshëm ndeshim gjithsesi edhe konstatime me interes praktik e teorik rreth patronimisë shqiptare, megjithatë, siç do të shihet edhe nga ky punim, kjo çështje në kuadër të gjuhësisë shqiptare, në mos qofsha i gabuar, na duket se për disa pika ende ka ngelur në hapat e parë studimorë, kur kihen parasysh çështjet si: shquarsia, përzgjedhja e trajtës përfaqësuese në kuadër të sinonimisë, si dhe trajtimi nga pikëpamja përformëzuese me theks **zgjdhja alternative e emërtimit të mbiemrave** (emrave familjarë) në raportin: **njëjësi i shquar/ prapashtesa -AJ**.

Ç’është e drejta, ne për arsytet e mësipërme e vlerësojmë lart veprën VEF, por e quajmë nismëtare për pikat e mësipërme, edhe pse, siç e thotë vetë autori, atë vepër e botoi: *pas studimeve më të gjera, më të thella dhe më sistimore rreth emrave të familjeve (patronimeve), duke përmbledhur shembuj e duke nxjerrë në dritë fakte brenda - e jashtëgjuhësore, me të cilat, sipas tij: janë ndriçuar aspekte të patronimisë, ku, më së miri vihet në pah origjinaliteti i kombit tonë në pikëpamje etnolinguistike dhe etnokulturore, të cilat me dashje o padashje, janë keqinterpretuar nga autorë të huaj.*

Po ky qëllim shprehet edhe në veprën e Çlirim Bidollarit *Fjalor i patronimeve të shqiptarëve* (emra familjesh mbiemra, llagape), ku përfshihet një numër mjaft i madh i *mbiemrave të shqiptarëve*, kryesisht nga dhjetë qarqet administrative të Shqipërisë, pas L2B. Sidoqoftë, meqë këto konstatime dhe të tjera të autorëve të nderuar të sipërcekur nuk përputhen me objektivin e temës sonë, por gjithsesi e njomështojnë dhe e plotësojnë përmbajtjen e titullit të këtij kreu, ne i kemi shfrytëzuar edhe konstatimet edhe vënerimet

tona për këto dy vepra, me theks: **zgjidhja alternative** e mbiemrave “*patronimeve të shqiptarëve*” në **raport** ndërkëmbyes: **njëjësi i shquar/ prapashtesa -AJ**, ku do të kihet parasysh specifika e shquarsisë dhe e shumësit të emrave të shqipes, do t’i zbërthejmë në këta gjashtë nënkrerë:

*së pari*, disa konstatime të nëpërdukshme rreth patronimeve të përfshira kryesisht në këto dy vepra;

*së dyti*, faktografi rreth rëndësisë shkencore - historike kombëtare e aktuale me interes të lëndës së përfshirë këtu dhe përgjithësisht;

*së treti*, vënerime rreth lloj llojshmërisë së imponuar jouniformëshe të shembujve për të njëjtin emërtim-koncept patronimi dhe ofrimi i **zgjidhjes alternative** lidhur me formimin e përdorimin e patronimeve në gjuhën tonë.

*së katërti*, konstatime rreth kompleksit të formëzimit të patronimeve me theks në argumentimin **rreth prapashtesën -AJ si formant i specializuar patronimformues** që qëndron në raport alternativ me një-mbaresat e emrit në njëjësin e shquar në funksion patronimi dhe në raport me prapashtesat e tjera vendëse si dhe ato me burim të huaj destinuar për këto emërtime;

*së pesti*, konstatime dhe vënerime rreth disa emërtimeve me fundore të imponuara dhe zgjidhja alternative mbrenda për mbrenda tyre dhe në raport me prapashtesën - **AJ** dhe

*së gjashti*, konstatime e veprime rreth thjeshtëzimit dhe konsolidimit të përdorimit të *patronimeve të shqiptarëve* kryesisht sipas zgjidhjes alternative: **njëjësi i shquar / prapashtesa - AJ**.

## **19.1. Konstatime paraprake rreth patronimeve në veprat :**

**VEF/ Vëzhgime për emrat familjarë të shqiptarëve të J. Shpuzës (1998) / dhe FP / Fjalor i patronimeve shqiptare të Ç. Bidollarit (2011) /.**

Ne, kur formuluam temën e kreut të mëparshëm “*Rreth vlerës kombëtare e shkencore të studimit, përzgjedhjes dhe kodimit të emrave të përveçëm të njerëzve në shqipen e sotme standarde*”, patëm parasysh jo vetëm antroponimet (emrat vetjakë), por edhe patronimet (emrat e familjeve) në gjuhën shqipe, po meqë shtjellimi i patronimeve nga pikëpamja e **zgjdhjes alternative** sipas temës sonë (për shkak të specifikave jo të pakta që ka) na mori hapsirë mjaft të gjerë, atëherë e pamë të arsyeshme që këtë temë ta trajtojmë si krye më vete.

Në të vërtetë, ne edhe më përpara, por sidomos ne kreun e kësaj pjese të këtij punimi e kemi përshoshur paksa këtë temë, ku veç tjerash përmendëm rastet emër-mbiemër bashkë që shprehin konceptin lidhur me individualizimin e personit që i përkiste një familjeje ose vëllazërie të caktuar, dhe se kjo është arsyeja që emri e mbiemri në korniza të atij nocioni shkruhen me shkronjën e madhe, sepse ashtu si me emra vetjakë (antroponime) edhe me mbiemra ose emra familjesh (patronime) kemi të bëjmë me emra të përveçëm. Të kujtojmë rregullën e parë nga DGJSH 1973, ku në raportin: *përdorimi i shkronjës së madhe / emrat e përveçëm* del rregull-formulimi i njohur:

***Shkruhen me shkronjën e parë të madhe emrat dhe mbiemrat e personave, epitetet ose ofiqet (nofkat) që janë pjesë përbërëse të tyre.***

Madje, ç’është e vërtetë çështja e patronimeve është prekur mbase jo aq kalimthi edhe në krerët e tjerë të këtij punimi, por në rastet e tilla nuk u ndalëm aq në hollësi rreth veçorive të tyre në gjuhën shqipe, siç do të bëjmë tani gjatë analizës së përmbajtjes së lëndës që na ofrohet nga veprat: VEF (1998) dhe FP (2011), të cilat, edhe pse viti i botimit i ndan për mb15 vjet distancë, edhe sot na duket se në aspektin studimor sjellin material të freskët, gjithsesi aktual. Në të vërtetë, ne, këto dy burime edhe pse nuk i përshtaten plotësisht temës sonë bosht: “**Rreth shumësit dhe shquarsisë së emrave në shqipen standarde**”, i konsultuam mjaft në hollësi, por që këtu do të përpiqemi që nga përmbajtja e tyre fillimisht t’i përmendim vetëm disa nga konstatimet dhe vënerimet tona. **Disa konstatime dhe vënerime rreth veçorivetë “patronimeve të shqiptarëve”**. Në vijim do të përpiqemi jo vetëm t’i përmendim, por edhe t’i qartësojmë disa konstatime e vënerime tona lidhur me patronimet e shqipes, siç janë:

**E para**, vetë patronimi (mbiemri) sipas natyrës fillimishtë që ka si pjesë përbërëse të emrit vetjak, të cilin e passhoqëron dhe që të dyja gjymtyrët (antroponimi dhe patronimi) bashkë individualizojnë personin e caktuar, po tash nënkuptueshëm me zgjerim kuptimi plus jo vetëm si individ, por plus edhe si anëtar të një njësie më të gjerë, siç është familja, vëllazëria, farefisi etj.

**E dyta**, me nocionin e patronimit kuptohet nocioni i shumësisë dhe njëherazi semantikisht kuptohet lehtë, përveç konceptit të emrit parashoqërues edhe koncepti i shquarsisë së ngurosur të emrit përkatës vetjak në numrin njëjës dhe nga të dyja gjymtyrët shprehet nocioni i emërimit në funksion të ri tash: si *emërtim familjeje a llagapi*.

**E treta**, në të vërtetë, koncepti i vet personit i emërtuar në njëjës si patronim, por me kuptimësi shumësi dhe shquarsia del i analizueshëm si antroponim vetëm në ato raste kur emri përkatës zhvishet nga funksioni i patronimit, duke u kthyer, nëse natyra e konstruktit lejon, në funksion apelativi ose të emrit vetjak me kuptim fillestar, zakonisht në njëjësin e emrit me shquarsi normale në rasën emërore, siç vepruam ne në kreun e këtij studimi me mbiemrat e 87 firmëtarëve të Rezolutës së Kongresit të Drejtshkrimit (1972).

**E katërta**, në të vërtetë në zanafillë mbiemri (*patronimi*) i emrit të përveçëm (antroponimit) në shqipe më natyrshëm dilte (ashtu siç praktikohet jozyrtarisht në stlin e lirë edhe sot) jo në emërore po në rasën gjinore sipas devizës: X-i i Y-it (djali i filanit) ose X-ja e Y-it (vajza e filanit). Po i improvozojmë dy shembuj:

**1.** Agimi i Gjinit ose Agimja e Gjinit,

**2.** Doniku i Kastriotit ose Donikja e Kastriotit,

madje në raste patronimi (si emërtim familjeje të gjerë, vëllazërie, fisi) dilte në numrin shumës:

**1.** Doniku i Kastriotëve ose Shpresa e Kastriotëve,

**2.** Agimi i Gjinëve ose Agimja e Gjinëve, por për nevoja shoqërore administrative (universale) si në gjuhë të tjera të zhvilluara edhe në administratën shqipe që nga viti 1912 filloi individualizimi ose regjistrimi i emër-mbiemrave zyrtarisht sipas shembullit: *Agim (ose Donik) Gjini*, përkatësisht *Agime (ose Shpresa) Gjini*. Megjithatë në VEF dalin të regjistruar 42 raste me mbiemra në gjinore, 4 në gjininë femërore (matronime) dhe 38 në gjininë mashkullore që karakterizohen me nyjën e përparame **e** ose **i** të gjinisë përkatëse. Te shuma 42 e emrave mashkullorë si patronime dalin 6 mbiemra (gramatikisht të vërtetë) të

paranyjësuar në funksion patronimi në trajtën e pashquar, si: (X- i) *I Çalë, I Vogël, I Zi, i Gjatë, I Bardhë* dhe dy shembuj në trajtën e shquar: *I Madhi, I Larti*, të cilët (si të substantivuar) kërkojnë qartësim, ngase mund të zërthehen ndryshe-ndryshe. Në të vërtetë, si patronim mjafton trajta pa nyjën e përpame (X- Madhi, X- Larti), ose **X+Y-ia** - e Madhja, ose **X+Y-i** - i Larti, si Gavril Dara - i Riu. Pikërisht ky fenomen i paranyjësimit ia vlen të gjurmohet më tej edhe në raport me zgjidhjet në gjuhët e tjera europiane etj., ngase nuk është pa bazë vënerimi që bën prof. Shaban Sinani, kur thekson:

*Do të meritonte një vëmendje më vete hetimi i mbijetesës së një nyjeje në funksion aristokratik (nyjës së fisnikërisë), sikurse “de” në frëngjisht, “von” në gjermanisht, “van” në hollandisht etj., që del ende në ligjërime etnografike në shprehje të tilla, si i Hot, i Gjemark etj.*

Sepse:

*Rruga historike e përveçimit të popujve përmes etnonimeve kalon tek patronimet ... dhe prej patronimit tek etnonimi.*

Sido qo të jetë, në FP nuk ndeshim raste të tilla të shënuara në gjinore.

**Shënim:** Po sjellim këtu një fakt nga praktika jonë që zgjon interes, është fjala për identifikimn e parë me I- (“**i biri i...**”) ose E (“**e bija e...**”), që si gjurmë del e vëneruar që në lashtësi (Shaban Sinani), por që rasti ynë nuk ka të bëjë fare me “një identiteti të fisnikërisë” por me një veprim praktik lidhur me identitetin e gjinisë dhe njëherazi të personit të posalindur. Kemi vënë re, (së paku me fëmijët e mi) që në lindtore (maternitet) të Prishtinës, (infirmjerja shqiptare asokohe) për identifikim foshnjes së posalindur në bylyzyk të dorës ia kishte vënë një rreth-shirit, kuptohet me emër të nënës, ku ishte shënuar: për djalë: **i+...** (**emri i nënës**), ndërsa për vajzë: **e+ ...** (**emri i nënës**), kështu, si me thënë që në “regjistrimin e parë” *koncepti i patronimit* dilte i sforcuar me një: **i +...** për djalë, ndërkaq i matronimit me një **e +...** për vajzë. Kuptohet në shtëpi përhajrimi bëhej: për djalë: (I biri) **i+...** (emri i babës), për vajzë: (e bija) **e +...** (emri i babës), por nga kujtesa e kam të freskët sipas rrëfimit të një miku se në shpi të madhe, kur lindja e djalit ose lindja si bijë dëshiri (hasreti) përshpallej dhe me të shtënë të armës, në odë (burrash) përhajrimi, shoqërohej me cigare, kafe e ndonjë gotë, bëhej si i biri **i ...** ose **bija e ...** (e shpisë, në emër të kryefamiljarit (zotit të shtëpisë, vëllazërisë, bajrakut, fisit), po ashtu emërtimi përdorej në rasën gjinore. Ndërkaq tash në regjistrimin zyrtar respektohet procedura tri e më tepër gjymtyrshë emri i fëmijës /+ emrat e

prindërve /+ *patronimi* (*emërtimi familjar*, por gjithnjë emri patronimit shënohet në njëjësin e emërores së shquar.

**E pesta**, ndërkohë, (ende flasim për të kaluarën), jo veç për shkak të zyrtarizimit që tashmë praktikohet mbiemri (patronimi) në rasën emërore, por edhe për nevoja të tjera, kur emri i prindit nuk mjaftonte, ngase familja krijonte histori trashëgimie më vete, siç thuhet, së paku mbi tre breza, doli e nevojshme që emrit të prindit në funksion patronimi t'i shtohet zakonisht ndonjë shenjzim tjetër ose ndajshesë vendëse ose e huaj. Ç'është vërteta, thuhet se një shenjzim i tillë dallues si patronim, si te popujt e tjerë, edhe në gjuhën tonë së pari dokumentohet te disa familje të mëdha fisnike kombëformuese që njihen që nga Mesjeta, siç ishin familjet: Kastriotët ose Kastrioti, Gropët ose Gropa, Bushatët ose Bushati, Zenebishët ose Zenebishi, Muzakët ose Muzaku, Blinishtët ose Blinishti, Gjinët ose Gjini etj., mirëpo meqë këto emërtime shumësi nuk mund të cilësoheshin kështu, as atëherë as sot në gjuhën shqipe, si patronime funksionale të mirëfillta individësh, atbotë si tash dolën, siç u tha edhe shenjzime si formante në vetë emrin si emërtim përkatës.

Sipas studiuesve si më autoktonë atbotë, së paku, që nga shekulli V të e.r. dokumentohet e përfutur në gjuhën tonë për këtë destinim prapashtesa - **AJ**. Ne shembujt me këtë formant, në nënitull të veçantë dhe në raport me nyjëmbaresat e emrit në njëjësin e shquar, do t'i trajtojmë më në hollësi më poshtë. Mirëpo, megjithatë edhe tani po këtë prapashtesë, e cila, si më e përshtatshme dhe vërtet e sukseshme (simbolike) që ofrohet për këtë destinim, do ta përdorim edhe ne si studiuesit e tjerë, për zëvendësimin e mbaresave të shumësit ose të njëjësit të shquar të emrave të familjeve të sipërcekura si: Topiaj/t, Muzakaj/t, Gropaj/t, Gjinaj/t, Kastriotaj/t, Blinishtaj/t etj., duke thjeshtësuar dhe njëzuar funksionalisht me konceptin e shumësit dhe njëherazi duke kapërcyer e afruar sinonimin, siç u tha, me njëjësin e ashtuquajtur prej nesh si *zgjidhje alternative*, d.m.th. me nyjë-mbaresat e njëjësit të emrit të caktuar. Kështu sot, siç do të shohim më në hollësi kjo prapashtesë (- **AJ**) paraqitet në bashkëjetesë alternative me nyjëmbaresat e emrit në njëjësin e shquar të të dy gjinive, tanimë të patronimizuara: - **I**, - **U**, - **A** ose - **JA** si p.sh. ( Iks ) Gjini ( Iks ) **Gjinaj**, ( X ) Muzaku ( X ) **Muzakaj**, ( X ) Topia ( X ) **Topiaj**, (Ikse Gropa ( X - e ) **Gropaj**) ( X - e ose *Kastriote* ) **Kastriotja** ( X - e *Kastriota j*) etj.

**E gjashta**, siç po shihet nga konstrukti i jashtëm, por edhe nga vetë logjika e brendshme gjuhësore doli e nevojshme që çështja e shquarsisë dhe e shumësisë të

normalizohej në alternativë, si b.f.: Agim (Agime) Gjini, ose Agim (Agime) Gjinaj. Kështu kjo rregullsi alternative si zhvillim mund të përgjithësohet si: *emër vetjak + patronim (me nyjëmbaresë shquarsie)* ndaj *emër vetjak + patronim (me prapashtesën – AJ)*. Vihet re se emri vetjak si gjymtyrë e parë në alternativë del në *trajtën e pashquar* njëjës (*Agim ose Agime*), ndërsa mbiemri (patronimi) del në *trajtën e shquar* po njëjës (Gjini). Pra ky fakt, që po e përsërisim, ka rëndësi të theksohet në mënyrë të veçantë, sepse është një specifikë karakteristike vetëm për gjuhën tonë, e cila është e pajisur me kategorinë e shquarsisë së emrit (që disa gjuhë nuk e kanë). Këtë fakt si rregull po e përsërisim:

**Antroponimi** (si emër vetjak) si rregull del në **njëjës**in e emërores së pashquar, ndërkaq :

**Patronimi** (si emërtim familjar) del si emër në njëjësin e emërores së shquar.

Në të vërtetë, siç e pamë, tek emra shqiptarësh, kjo rregull lëkundet pa të drejtë apo jo, tek disa emra të gjinisë mashkullore, por më fort po praktikohet edhe tek ata të gjinisë femërore, nëntipi: Shpresë - Shpresa etj.

**E shtata**, në disa gjuhë praktikohet që me radhë së pari të shkruhet mbiemri e pastaj emri, ashtu siç po veprohet në referenca shkencore (literatura) edhe në gjuhën tonë, në të vërtetë, siç është vepruar edhe në *Listën telefonike të Shqipërisë*, por edhe në ato raste shquarsia sipas rregullit nga pika e mësipërme në gjuhën tonë nuk ndryshon, tipi: Agim Gjini ose Gjini Agim. Sidoqoftë, meqë në këto dy vepra, siç e theksojnë autorët, kemi të bëjmë kryesisht a vetëm me *patronime shqiptarësh*, çdo lexues ka mundësi ta konstatojë sa del e respektuar rregulla rreth gjinisë e shquarsisë në ato burime, apo jo? Nëse ndeshim, në ato burime patronime në trajtën e pashquar, vallë, a mund të jenë raste të paqortueshme, le ta gjykojnë vetë autorët, por le t'i gjykojnë me seriozitetin e duhur dhe paanësi studiuesit me standardologët tanë në krye.

**E teta**, u përmend më sipër se rregulli në fjalë rreth shquarsisë vlen për të dyja gjinitë, andaj as shquarsia e matronimit (mbiemri në gjininë femërore) nuk diskutohet, si b.f. (X ose X- e) *Kastriotja (Shota, Nora, Shpresa, Hasimja, Hasija etj)*, mirëpo, vlen të sqarohet, rasti, kur është fjala te trajta e patronimit me prapashtesën - **AJ**, sipas mendimit tonë, meqë kemi të bëjmë me trajtën e formuar me prapashtesën e specializuar patronimformuese - **AJ**, me të cilën formohen patronimet pa shquarsi ose me shquarsi të ngurosur, atëherë edhe mbiemri i gjinisë femërore neutralizohet sa i përket gjinisë gramatikore e natyrore, d.m.th. emërtimi alternativ i patronimit i të dy gjinive duhet me dalë njëtrajtshëm: Kastriotaj, Gjinaj (jo



Kastriotjaj, jo Gjin/iaj). Krahaso, sipas nesh, zgjidhjet e pranueshme alternativisht: *Donik ose Donike Kastriotja* - zgjidhje me një-mbaresë, alternativë e parë, ndërsa *Donik ose Donike Kastriotaj* - zgjidhje me prapashtesën e specialituar - **AJ**, alternativë e dytë.

Së këtejmi, po ritheksojmë mendimin tonë, se kur është fjala te patronimet dhe matronimet zgjidhja sipas alternativës së dytë me prapashtesën - **AJ**, mjafton, sepse kjo trajtë, më mirë mbiemri me - **AJ**, siç u tha, përfaqëson të dyja gjinitë, por këtë si rregull duhet ta vlerësojnë dhe rekomandojnë patjetër edhe standardologët tanë kompetentë, ngase në burime të ndryshme si edhe në këto që i kemi në konsultim, siç e pamë, paraqiten lëkundje.

**E nënta**, sipas natyrës së patronimit, siç konstatohet nga hartuesit, në këto dy burime në parim, pasi nuk kemi të bëjmë me raste emrash të vetmuar ose të veçuar, por kemi të bëjmë me “*përzgjedhje të repertorit me synim për të qenë sa më përfaqësues*”, siç e cek në mënyrë të veçantë, autori i veprës së dytë, por nuk dimë mu ky kriter sa është respektuar aty, andaj është një çështje që kërkon sqarim, apo jo?! Sidoqoftë, edhe pse emri si patronim shënohet në njëjës in e shquar (Agim Gjini ose Shpresa *Kastrioti*), shumësia e tij kuptimore (familjare) paraqitet ose përfaqësohet si në planin vertikal (së paku tre brezash) ashtu edhe në atë horizontal me perspektivë të pakufizuar gjallimi (me tendencë trashëgimie), andaj pikërisht kjo pikë lypset sqaruar metonimisht në burimet e ardhshme me shembuj konkretë edhe në varësi nga komponentet jashtëgjuhësore.

**E dhjeta**, ç’është e vërteta, si për ne e për çdo të interesuar mund ta jetë vënë re edhe një veçori tjetër e patronimeve me - **AJ**, të cilat në krahasim me formimet me prapashtesa e mënyra të tjera, paraqitet më e qëndrueshme. Kështu të gjitha trajtat me formante të tjera kanë mundësi të pakufizuar shumimi, por njëharazi edhe thjeshtëzimi e shpërndërimi e rishikimi në kuptim përmirësimi përmbajtësor e praktik, qoftë me elemente shquarsie, qoftë me prapashtesë çfarëdo (përveç asaj me - **AJ**), ndërkaq vetëm trajta me -**AJ**, nuk ka as nevojë as mundësi të tillë. Me fjalë të tjera të gjitha rastet e tjera paraqesin mundësi të hapur për ta modifikuar ndonjë emër në funksion patronimi të imponuar në kohë-hapësirën përkatëse, andaj bartësi mund edhe ta ndryshojë, ta bëjë atë më shqip, ndërkaq trajta me prapashtesën - **AJ**, meqë e mbart cilësinë e natyrës së gjuhën shqipe për këtë nënfushë semantike, nuk ka nevojë ndryshimi.

**E njëmbëdhjeta**, e shohim të arsyeshme ta sqarojmë faktin pse ne zakonisht në vend të termit *formim*, në kontekste të caktuara e përdorim termin, **formëzim** ose

edhe *përformëzim* të patronimeve, sepse *formim* quajmë vetëm formimet përkatëse të patronimeve me prapashtesim, sidomos me prapashtesën - **AJ**, ngase vërtet emërtimi i patronimit si emër në shumicën e rasteve del i formuar në një fushë tjetër semantike, qoftë si apelativ, emër i përgjithshëm, emër i përveçëm vetjak, madje mundet me ardhë edhe si huazim transfer nga ndonjë gjuhë e huaj, ndoshta edhe jo me kuptim patronimi etj., andaj kur shembulli i patronimit vjen si formë e gatshme në fushë të emrit familjar, ai tani formëzohet ose shndërrohet në patronim në gjuhën tonë, pra merr një semantikë të re (emër familjar). Pra, emri i tillë nga kuptimi i parë, kalon ose formëzohet në kuptimin e shkallës së dytë ose të tretë që tash si patronim nuk përfaqëson më nocionin zanafilles (apelativin), madje as vetëm personin (antroponimin) nga i cili vjen, por zakonisht përfaqëson nënkuptueshëm vetëm emrin e personit plus të familjes (farefisit, vëllazërisë) që i takon, përkatësisht përfaqëson paraardhësit e bartësve të emërtimit përkatës, duke respektuar kështu, përkatësisht: birërinë tashëguese antroponimike, prejardhjen toponimike ose veçorinë morale, gradën, profesionin ose ndonjë tipar të jashtëm fizik karakteristik nga trashëgimia, qoftë si llagap, nofkë etj., si p.sh.: afrim - i / Afrimi/ Afrimaj, topall - i/ Topalli/ Topallaj, Lorik - u/ Loriku/ Lorikaj, e kështu me radhë.

Andaj në këtë kompleks vetëm rastet me prapashtesa, siç është edhe prapashtesa -**AJ** i shtrohen procesit të fjalëformimit.

**E dymbëdhjeta**, sidoqoftë, edhe pse ne në pikën e mësipërme cekëm në parim mënyra të ndryshme se si u lindën ose edhe lindin dhe formëzohen ose formohen patronimet, tashti do të shohim po sipas FP - së se si përftohen patronimet sipas prejardhjes, pothuaj ashtu siç ndodhë edhe në të gjitha gjuhët indoeuropiane. Është fjala për katër burime prejardhjeje shembujsh, që mund të jenë:

**1. prejantroponimikë**, d.m.th. emra personalë që kryesisht shërbejnë si tema përfaqësuese, duke përfshirë jo vetëm trajta të plota, por edhe të shkurtuara hipokoristike (përkdhelëse) dhe diminutive (zvogëluese), si: (Sinan) Sinani, (Sami) Samiu (Shotë) Shota, (Marte) Martja; Cimi, Meti, Kate, Kato, Buli. Bula, Erëza, Valëza, Naze, Nazo, Nazi, Tini, Tina etj.;

**2. prejtoponimikë**, nga emra vendesh, si oikonime (vendbanime) e runonime (emra fshatrash): (Reç) Reçi, (Frashër) Frashëri, (Prekaz) Prekazi, (Mazrek) Mazreku, (Mborje) Mborja, (Mjedë) Mjeda etj.; urbonime (emra qytetesh), si dhe emra njësisish territoriale më të

vogla ose më të mëdha: si (Tiranë) Tirana, (Dibër) Dibra, (Prizren) Prizreni, (Prishtinë) Prishtina, (Shijak) Shijaku; (Lumë) Luma, (Muzeqe) Muzeqeja, (Drenicë) Drenica etj.;

**3. patronimizime titujsh, ofiqesh, profesionesh** etj. të ndonjë pararendësi të familjes përkatëse, si: (Prift) Prifti, (Hoxhë) Hoxha, (Efendi) Efendiu, (Pashë) Pasha. (Defatore) Defatorja, (Sazexhije) Sazexhija, (Bostanxhi) Bostanxhiu etj. dhe

**4. patronimizime nofkash e llagapesh** që pjesa më madhe e tyre me sa pamë rridhnin prej fjalësh të huazuara ose të përvetësuara, si: (Topall) Topalli, (Qos) Qosi, (Maçok) Maçoku, (Sorrë) Sorra, (Skile) Skilja, por disa prej tyre me burim nga turqishtja ose përmes turqishtes, të cilët në *shqipen* (e sotme) kanë rënë në shtresën e leksikut me status të *cenuar emocional-stilistik*, thuhet në atë burim.

Njëherazi shihet edhe një tendencë tjetër që familjet përkatëse, përveç nofkave jo aq të përshtatshme, të emërtohen edhe me të ashtuquajtur **mbiemra zbukurimi** dhe një dukuri e tillë në botën shqiptare do të vijë mbase gjithnjë duke u shumëzuar, ashtu siç po shumëzohen edhe emrat e bukur të fëmijëve, sipas natyrës së gjuhës shqipe, si Bukuroshi, Engjëllusha, Urtaku, Flamuri etj. Edhe në veprën e J. Shpuzës respektohen po këto katër kriteret e sipërcekura universale, por shtohen edhe të tjera, madje aty këto mënyra rrahen e shpjegohen më në hollësi, deri në 18 fusha vëzhgimi, dhe për secilën nga ato ka çka sheh e vëren si risime vrojtuesi, siç është b.f. edhe prejardhja e patronimeve nga “*emërtimet e pjesëve të trupit të njeriut*” që ilustrohen me afro 30 shembuj, pastaj janë shënuar 35 *shembuj mbiemra grash* (matronime) etj.

Sidoqë të jetë, ne përveç këtyre 12 veçorive që hetuam gjatë analizës e përvojës sonë, edhe pse, për çudi, në veprën e Bidollarit nuk ceket si literaturë e konsultuar vepra e J. Shpuzës (!!!), do të cekim fakte e veçori të tjera që na duken të arsyeshme nga të dyja veprat, edhe pse jo gjithherë të padiskutueshme. Në të vërtetë, nga konsultimi i materialit të grumbulluar në këto dy vepra, lidhur me këtë nënfushë diturie, ne verifikuam, përforcuam por edhe zgjeruam njohuritë tona parazotëruese. Së këtejmi, sipas lëndës së shënuar në këto dy vepra, përveç rasteve e konstatimeve të shumta që përputhen, ka jopak edhe aso që nuk përkojnë plotësisht me konstatimet, synimet e kriteret tona të shprehura më përpara, por që do të shprehen edhe tashti në këtë punim, sepse ne sipas rasteve mund të shprehim madje edhe guximtarisht mendime e sugjerime rreth shquarsisë, përzgjedhjes së trajtës përfaqësuese, rreth përparësisë së radhitjes etj., të cilat autorët nuk i kanë pasur objekt trajtimi

në hollësi. Sido që të jetë, ne autorëve u shprehim falenderim dhe sidomos të dytit i dëshirojmë punë të mbarë e suksese në vepra të tjera të kësaj natyre, siç i ka paralajmëruar vetë.

Gjithsesi, siç paralajmëruam, në vijim, gjatë analizës do të ballafaqohemi me çështje të veçanta ndoshta paksa më të ndërlikuara të natyrës patronimformuese e formëzuese në gjuhën shqipe, por që pragmatikisht e shkencërisht tërheqin vëmendjen. Së këtejmi, ndonjëherë nga të dhënat më karakteristike që dalin nga analiza edhe tash menjëherë që do të *imponohen* si risi në këtë krye do të përmendim, por edhe do ta shfrytëzojmë sipas rastit edhe në punime të tjera.

## **KREU X**

### **20. Mendime faktografike rreth rëndësisë historike - kombëtare dhe studimit të patronimeve në gjuhën shqipe**

Studiuesit kanë konstatuar me të drejtë se nga pikëpamja e shpërndërrimit të substancës kuptimore dhe jetëgjatësisë së përdorimit patronimet ashtu si edhe toponimet kanë qëndrueshmëri më të madhe në kohëhapësirë, andaj studimi i tyre si në aspektin sinkronik e aq më tepër në atë diakronik del sheshit se ka rëndësi të padiskutueshme etno-historike kombëtare.

Dihet, siç e thekson studiuesi Jusuf Shpuza se patronimet ose *“emrat familjarë, si fond i rëndësishëm i onomastikës, paraqesin interes shkencor për gamën e gjerë të problematikës dhe për ndihmesën që mund ta japin për sqarimin e shumë çështjeve që lidhen me gjuhësinë, historinë, etnografinë dhe etnogjenezën etj.”*

Andaj, nga konsultimi i të dy veprave në fjalë, ne që të dyja i quajmë dhurata pune për gjuhësinë shqiptare e sidomos nga kjo e fundit mësojmë gjëra me interes, jo vetëm për fushat përkatëse të dijes, por edhe për gjëra praktike, siç është preardhja e formave të caktuara sipas trevave, që ne edhe atë ta shfrytëzojmë si ndihmesë për njohje rreth shpërndarjes ashtu si edhe të ecjes më të mirë e të mbarë të emërtimeve drejt konsolidimit të tyre sot e nesër në tërë shoqërinë shqiptare.

Duke u bazuar në këto dy vepra, pa shfrytëzuar burime konkrete e hipotetike më të hershme, siç është periudha, para e ajo pellazgo-ilire që shkenca më e re po nxjerr në shesh gjithnjë e më shumë fjalë antroponime e toponime të protoshqipes që shpjegohen me brumin e shqipes më mirë se me çdo gjuhë tjetër, por që disa i takojnë funksionalisht edhe patronimisë, ne nga këto të sotmet kryesisht në përdorim e sipër mësojmë se të gjitha emërtimet e regjistruara (të diskutueshme ose jo) që cilësohen si *patronime të shqiptarëve*, konsiderohen fjalë shqipe, sepse emërtimet e tilla, qoftë vendëse, qoftë ato me prejardhje të gjuhëve të huaja, përdoreshin e po përdoren edhe sot nga vetë goja e shqiptarit dhe secili patronim ka historinë e shpjegimin e vet si nga pikëpamja e prejardhjes ashtu edhe sipas gjallimit të tij nëpër kohë e hapësirë. Së këtejmi, konstatojmë se në FP janë shënuar afro 400 patronime me origjinë të qartë vendëse, prej tyre më së paku 130 i ndeshim të dokumentuara para disa shekujsh, siç janë regjistrat me emra shqiptarësh edhe para atij italian të vitit 1431, atij turk 1465 etj. Ndërkaq, në përdorim të përditshëm vetëm ato me origjinë vendëse prejtoponimike kalojnë 250-shin. Në të vërtetë Fjalori në fjalë i Bidollarit përmban rreth 1500 artikuj bazë, kushtuar lemave përkatëse, por që brenda tyre jepen 6 fish më shumë

ose afro 7 mijë trajta shembujsh sinonimikë. Konsiderohet se në gjithë territorin shqiptar përdoren aktualisht rreth 25.000 mbiemra (Shih në internet: *Forumi shqiptar*). Në këtë vazhdë për të ilustruar rëndësinë e tyre historike edhe atë aktuale po i sjellim:

**së pari**, disa nga shembujt e dëshmuar, shoqëruar me vitin e dëshmimit, me të cilët argumentohet disa shekuj më përpara autoktonia e vetë shqiptarëve dhe e gjuhës së tyre në këto troje, dhe

**së dyti**, për hir të rëndësisë aktuale shoqërore që kanë do të jepen edhe disa shembuj (pa datë dëshmimi) po të formëzuar si patronime më parë dhe që njëherazi cilësohen si fjalë të qarta, të kuptueshme nga përditshmëria jonë dhe si të tilla mund të frymëzojnë edhe motivojnë aktualisht ripërtëritjen e tyre dhe të ngjashme në stile të caktuara.

## **20.1. Patronime me shembuj faktik nga vepra e studiuesit Çlirim Bidollarit të dëshmuar shekuj më parë.**

**Pranë shembujve është shënuar edhe viti i dëshmimit:**

**Bacani** 1443; **Bala** 1467, **Balashi** 1417, **Bardhyli** 1417, **Gjini** 1355, **Besarku** 1279,1431,1461,1467, **Blinishti** 1272, **Bukli** 1485, **Bunga** 1510, **Burri** 1330, 1335, **Bushasti** 1335, **Buza** 1467, 1555, **Bej** (Skënderbej) 1448,1457,1460, **Berisha** 1348, **Birko** 1467, **Cerga**, 1417, **Cubi**, 1417, **Curri**, 1330, **Dardha** 1417, **Dashi** 1485, **Derri** 1330, **Dreni** 1485, **Dukagjini** 695,1281,1387, **Gruri** 1485, **Gryka** 1417, **Guri** 1485, **Gurra** 1485, **Gjana** 1304,1526, **Gjata** 1393,1417, **Hoti** 1414, **Uka** 1485, **Katundi** 1322,1421, **Kripa** 1461,1497, **Leti** 1273, **Lushi** 1417, **Lëkurësi** 1431,1461, **Lleshi** 1330, **Madhi**, 1424, **Malaj** 1236, 1330, 1417, **Mati** 1330, **Mazi**, 1274,1333,147, **Muzaka** 1274, **Pashko** 1315, **Rafti** 1461, **Skura** 1201, **Lopari**, 1393,1481, **Suma** 1332,1425,1330, **Shyti** 1348, **Suta** 1417, 1467, **Tanushi** 1223, **Toska** 1533, **Trasha** 1330, **Thana** 1467, **Trimi** 1383 etj.

Nga shembujt që ne i shënuam rastësisht rezulton se sipas një-mbaresave ose fundoreve përkatëse që kanë: prej **54** shembujve, **30** raste dolën me - **i** fundore, **18** me - **a**, **1**me - **u**, **2**me-**o**, **1**me-**aj** dhe **1**me-**ej**. Po shtojmë vetëm edhe këta 2 shembuj nga vepra e J. Shpuzës: *Shpata* 1417, *Kordha* 1461 me vërejtjen se jo vetëm aty, por edhe në burime të tjera ka dëshmi që disa fish kalojnë numrin e shembujve të mësipërm, patronime këto që

mund të jenë në moshë të njëjtë përdorimi e dokumentimi si dhe të kenë rëndësi të njëjtë dëshmimi. Mirëpo ne nuk shënuam data, ngase besojmë se edhe kështu e kaq mjaftojnë që lexuesi i nderuar të bindet ose të sjellë në kujtesë shembujt nga trashëgimia lahtënore përkatëse, por që gjallojnë edhe sot si fakte historike-gjuhësore në të mirë të etnisë shqiptare shekuj e shekuj më parë në këto troje, por që edhe mund të ripërtërihen si të tilla, sikurse edhe këto që po i shënojmë në pikën vijuese.

## **20. 2. Shembuj patronimesh nga përditshmeria jonë të cilët edhe kanë gjurmë historike, por edhe motivojnë krijime të reja të ngjashme**

Po i shënojmë në vijim edhe disa patronime të formuara nëpër kohë nga fjalë tona të përditshme, të cilat edhe kanë gjurmë historike, si: *Arra, Ashta, Baca, Baçi, Bardhi, Beci, Bufi, Bulku, Byku, Cungu, Demi, Çuni, Çarku, Çerepi, Çika, Driza, Dhelpra, Dhëmbi, Dhija, Ferra, Fisheku, Flaka, Garo, Gega, Gonxhe, Laze, Guraziu, Gjiza, Kokoshi, Kotherja, Kroi, Lundra, Llaveshi, Mani, Manari, Qafa, Pite, Qypi, Shkaba, Mishi, Mjalti, Mjekra, Shtylla, Tufa, Vegshari, Veshi, Xhoka, Ylberi, Ylli, Xhufka, Zdruktari, Zogu, Zhguni etj.*

Nga FP (Fjalori i patronimeve) shënuam pa përzgjedhje vetëm 53 shembuj, që sipas fundoreve rezultati del kështu: me - **i** fundore - 22 raste, me - **a** - 18, - **u** -7, - **e** -3, - **o** -1, dhe me - **ja** 2 shembuj dhe i lamë pa shënuar po thuaj 3 fish më shumë. Siç po shihet asnjë shembull nuk e shënuam me prapashtësë-fundoren - **AJ** po me fundore të tjera dhe këtë e bëmë me qellim, ngase të gjitha ato fundore, siç do të shohim në vijim mund të zëvendësohen alternativisht me prapashtësën - **AJ**.

Kur është fjala te diskutimi, gjithsesi përtheksojmë një vërejtje serioze që paksa u cek më sipër dhe kjo vlen jo vetëm për autorët e veprave që konsultuam, por edhe për studiuesit e tjerë, që para se të botojnë ose ribotojnë material të tillë, patjetër duhet të konsultojnë të dhënat dhe të harmonizojnë shifrat, ngase me sa pamë, nga dy veprat që konsultuam ka mospërputhje vitesh, madje edhe ndonjë mospërputhje shkrimi (teksti)

Sido që të jetë, besojmë se vetë dokumentimi i paraqitur këtu flet mjaft për rëndësinë historike, shkencore e shoqërore që ka studimi i patronimeve, qoftë për të kaluarën, qoftë për të tashmen dhe sidomos për të ardhmen e kombit dhe të shkencës shqiptare.

Së këtejmi, sido që të jetë, kemi bindjen se lexuesi, që ndjen me vesh dhe i prek me zemër në përditshmërinë tonë jo vetëm nga këta shembuj, por edhe nga të tjerë, e kupton, veç tjerash, edhe rëndësinë edukuese kombëtare që ka edhe krijimi, përvetësimi edhe përdorimi i patronimeve të ne, ku duhet të mbizotërojë parapëlqimi që patjetër fjalët a elementet e mirëfillta fjalëformuese e formëzuese të jenë sa më të përfaqëshme shqiptarisht, andaj ne pikërisht në vijim do të bëjmë fjalë për çështje shquarsie e drejtshkrimo - fjalëformuese të emrave të shqipes të formëzuar ose të konvertuar në funksion patronimi, natyrisht duke u pozicionuar në të mirë të elementeve të natyrës së gjuhës sonë.

## **KREU XI**

### **21. Rishqyrtime rreth zgjidhjes alternative: nyjë - mbaresat e shquarsisë / prapashtesa - *AJ***



Në kreun e kësaj pjese të këtij punimi kur bëme fjalë rreth katërvariantëshit të shquarsisë të emër-mbiemrave, përmendëm rregullën që në raste të tilla emri vetjak, si element i parë, siç e kërkon rregulli, duhet të jetë në trajtën e pashquar, ndërsa mbiemri (patronimi), si element i dytë me radhë, në trajtën e shquar, konstatim ky si rregull i shprehur edhe në veprën e J. Shpuzës, andaj kur rastet e tilla nuk përputhen edhe ne si të tjerët këtë dukuri e quajtmë çështje të hapur. Pra, gramatikisht e logjikisht e quajmë të diskutueshëm, jo vetëm emrin (antroponimin) në trajtën e shquar, por aq më tepër edhe patronimin në trajtën e pashquar.

Pikërisht për të pasur me të qartë problemin, për ilustrim, po i përsërisim shembujt e diskutueshëm të patronimeve, në trajtën e pashquar, që u shënuan në kreu V të kësaj pjese të punimit, duke e dalluar me italice barasvlerësin në trajtën e shquar që sipas rregullit gramatikisht lypset parapëlqyer:

**a/.** me fundoren - **I:** Jazexhi (*Jazexhiu*), Qermixhi (*Qermixhiu*);

**b/.** me fundoren - **O:** Mero (*Meroja!*), Vreto (*Vretoja!*), Malo (*Maloja!*);

**c/.** me fundoren - **E:** Tare (*Tarja!*);

**ç/.** me fundoren - **AJ:** Mekaj, Lekbibaj, Cakaj, Metaj.

Siç mund të shihet për tri pikat e para me të pjerrta shënuam trajtën e shquar përkatëse (me pikëçuditëse), ndërkaq për pikën ç/. nuk shënuam asgjë me italice, ngase trajta me - **AJ** konsiderohet trajtë e padiskutueshme, sepse vlerësohet si trajtë *me shquarsi të ngurosur ose si trajtë pa shquarsi*. Siç e pamë kështu ndodh edhe tek emrat gjeografikë. Po kjo çështje bashkë me të tjera të kësaj natyre reflektohet edhe në Fjalorin e Ç. Bidollarit ashtu si më parë edhe në veprën e J. Shpuzës, çështje këto e të tjera, të cilat, kur është fjala për patronimet, ne do të përpiqemi, dhe jo aq shkel e shko, duke i trajtuar nëpër disa pika:

**Së pari**, për të pasur ide më të qartë rreth laramanisë ose sixhunglës së trashëguar lidhur me trajtat e emrave në funksion patronimi që paraqitet si trashëgimi imponuar në gjuhën tonë aktualisht nga pikëpamja drejtshkrimo-fjalëformuese përgjithësisht dhe për të vënë në pah rëndësinë pragmatike e shkencore që ka studimi i materialit të tillë për thjeshtëzim e konsolidim, për fillim analize, shkëputëm për ilustrim nja 6 (5 +1) shembuj nga FP:

1. (*Gegë*) Gega: **Gegaj**, Gegalli, Gegëprifti, Gegës!, Gegi!, Gego!, Gegoli!, Gegollari, Gegolli, Gegushi.
2. (*Ukë*) Uka: **Ukaj**, Ukja (*Uke!*), Ujkaj, Ujkja (*Ujke!*), Ujkani, Ujkanej, Ujkashi, Uci!, Ucaj.
3. (*Shyt*) Shyti: **Shytaj**, Shytanji!, Shyta, Shytja (*Shyte!*), Shytani(!).
4. (*Rrustem*) Rustemi: **Rrustemaj**, Rrustemati, Rrustemo, Rrustem(!), Rrusta, Rrustaj, Rrusti(!), Rrusto!, Rruste! (*Rrustja!*).
5. (*Pjetër*) Pjetri: **Pjetraj**, Pjetrushia, Petro, Petraj, Petri, Petre(!), Petrej, Petraqi, Petrollari, Petromilo, Peci, Peçi, Peti, Pepo, Pepaj, Pepe(!) (*Pepja!*), Peposhi, Pepivani, Pepkola, Pepkolaj, Pepleka, Pepmarku, Tuku, Tuçi, Tushi.
6. (*Zog*) Zogu **Zogaj**, Zogolli, Zogollaj, Zogi!, Zoga, Zog'ja (*Zoge!*), Zogo.

Në VEF mbi të njëjtën bazë emrash ndeshim këto trajta patronimesh:

1. Gegë, Gegëprifti dhe Gegprifti;
2. Ujka, Ujkaj, Ukasheviq, Ujku, Uka, Uklesha (uk+lesh), Ukleshaj;
3. Shyta;
4. Rrustemi;
5. Pepa, Pepaj, Pepiq, Pepitone;
6. Zoga, Zogu.

**Ndërkaq si antroponime për emrat përkatës hasim këto trajta:**

1. Gegë; 2. Ujk, Ukan, Uk; 3. -; 4. - ; 5. Pjetër, Pepa, Petar, Petr, Petro, Petrus, Pietro;
6. Zoga, Zogë, Zogza, Zogjet, Zogjeta, Zogla.

Mbështetur në realitetin tonë gjuhësor mund të themi pa mëdyshje se numri i shembujve të regjistruar në temat e cekura, as si patronime as si antroponime, asesi nuk mund të quhet shterues dhe një shumësi e tillë asesi nuk tregon pasuri, por mishmash a sixhungëlzim, i cili kërkon trasim rrugë, thjeshtëzim e mbarështrim nga studiuesit. Sido që do të jetë, ne edhe pse bolduam ose nënvizuam apo vumë ndonjë pikëçuditje e ndonjë rast e shënuam me kursiv, këtu nuk do të ndalemi në sqarime të çështjeve të hapura që janë aq shumë, sepse disa nga sqarimet e sugjerimet, sa ka qenë e mundur, janë shtjelluar gjatë analizës së antroponimeve e bashkë me to është prekur edhe çështja e patronimeve, por diçka-diçka do të jepet më poshtë edhe këtu. Ndërkaq, tash menjëherë nuk mund të përmbahemi pa e përmendur një çështje me shumë rëndësi, e cila, sipas nesh, do t'i ndihmojë çdo lexuesi për të kuptuar më mirë dallimin rreth shquarsisë e shumësit të emrave në raportin: *emër i*

*përveçëm vetjak (antroponim) emërtim patronimi (mbiemër familjar), andaj kërkohet, nga lexuesi i nderuar, edhe njëherë që shembujt e mësipërm t'i vështrojmë së bashku me kujdes të shtuar. Jo pse mund të dyshohet në funksionalizimin e ndonjë trajte sinonimike të shënuar si patronim, por të vihet re se autori i FP-së ka bërë mirë (edhe pse nuk ka vepruar kështu në të gjitha temat) që shembullin përfaqësues e ka shënuar në njëjës in e shquar: *Gega, Uka, Shyti, Rustemi, Pjetri*, ndërkaq menjëherë pas temës e ka shënuar si *zgjidhje alternative*: patronimin e mirëfilltë me prapashtesën e specializuar patronimformuese - **AJ**, si: (*Gega*) **Gegaj**, (*Uka*) **Ukaj**, (*Shyti*), **Shytaj**, (*Rustemi*) **Rustemaj**, (*Pjetri*) **Pjetraj**, (*Zogu*) **Zogaj** (Këtë e shtuam nga realiteti ynë, për hir të fundores - **U**).*

Sido që të jetë, edhe pse nuk e sjellim në dyshim, pra, shndërrimin e shembullit të parë në patronim. (iks ose ikse) **Gega (Uka, Shyti, Rrustemi, Pjetri, Zogu)**, siç e kemi parë ose siç do të shohim edhe më tej, por po theksojmë *se emri i tillë si emër i përveçëm i numrit njëjës në trajtën e shquar (Gega, Zogu etj.) ende ruan elemente antroponimi të mirëfilltë*, ngase si antroponimi përkatëse zërthehet lehtë eptimisht ose e bën shquarsi mirëfilli si dhe shumësin me - **ËT**, si *Gegët, Ukët, Shytët, Rrustemët, Pjetrët, Zogët(!)*.

Ndërkaq patronimi më - **AJ**, ndryshon nga shembujt e tjerë, sepse, ndonëse mund të konsiderohet se është në numrin njëjës **Gegaj, Ukaj, Shytaj, Rrustemaj, Pjetraj, Zogaj**, njëherazi joformalisht tregon shumësi, shumësinë e familjes (farefisit, vëllazërisë) dhe nuk mund të kthehet (zërthehet) si rastet e tjera si emër vetjak (njeriu), sepse kjo trajtë me -**AJ** fundore në realitet mbetet e specifikuar me mirëfillësi më të madhe, si me thënë, në shkallën më të lartë vetëm si patronim, dhe si e tillë vetëm si patronim ka lidhshmëri alternative në krahasim me rastet e emrit në funksion patronimi me një-mbaresën përkatëse të njëjësit të shquar: - **i** (Shyti), - **u** (Zogu) ose - **a** (Uka) apo - **ja** (Kastriotja).

Për ta kuptuar më mirë këtë që sapo e thamë, për ilustrim, po e improvizojmë një shembull, i cili mund të shërbejë si gjedhe sinteze që kuptimësinë e saj do ta vërtetojë edhe analiza në rrjedhë e sipër:

**Familja e gjerë me emërtimin Gega (Uka, Shyti, Rrustemi, Pjetri, Zogu, Kastriotja) ka mbi 100 e sa anëtarë, të ndarë në disa familje të ngushta dhe të gjithë Gegajt (Ukajt, Shytajt, Rrustemajt, Pjetrajt, Zogajt, Kastriotajt) e asaj familjeje të gjerë, edhe pse jetojnë në disa vendbanime, për mos me harrue njëri tjetrin si kushërij**

**që janë, e kanë bërë zakon që së paku njëherë në vit të takohen në një datë të caktuar të emnueme si ditë feste familjare për ta.**

Pra nuk thuhet dot të gjithë Gegët (Kastriotët apo Kastriotet), por Gegajt (Ukajt, Shytajt, Rrustemajt, Pjetrajt Zogajt, Kastriotajt e asaj familjeje (farefisi, fshati, qyteti ose të disa vendbanimeve)... Po përsërisim faktin, se vetëm emri me prapashtesën - **AJ** semantikisht i përgjigjet më së miri konceptit të patronimit të mirëfilltë përkatës familjar në shqipen e sotme dhe, siç do të vërtetohet, qëndron si barasvlerës i plotë konceptor në krahasim me shembujt përkatës të gjuhëve të huaja.

Natyrisht edhe kjo çështje, meqë këtu, kështu si konstatim a kërkesë e prerë, me sa dimë, po plasohet për të parën herë, kërkon mirëkuptim e implementim, por edhe sqarim përforcues paraprak nga studiuesit e veçantë, por edhe nga institucionet tona përkatëse sidomos me standardologët tanë në krye.

Kemi bindjen se kjo që u tha si rregull do të jetë e pranueshme dhe e zbatueshme nga të gjithë studiuesit dhe standardologët tanë, e në veçanti nga shqipfolësit si të kuptohet më mirë, sepse siç do të argumentohet në analizën që pason, ky si rregull vlen për të gjitha trajtat e patronimeve në alternativë me trajtën me - **AJ**, por sidoqoftë, ne po vazhdojmë me konstatime të tjera.

**Së dyti**, ç'është e vërteta, dihet se secili emërtim patronimi në trajtën e caktuar, qoftë i diskutueshëm për shkak origjine ose për kritere të tjera, sot për sot, siç u cek më lartë, kishte dhe ka historinë e vet, madje edhe e ka kryer ose është duke e kryer funksionin përkatës patronimik, por njëherazi dihet e vërteta tjetër se vetëm një trajtë ose dy në alternativë, siç i shënuam pak më sipër, mjaftojnë për atë destinim. Fundi i fundit, kjo problematikë rreth patronimeve, përzgjedhjes së trajtës së caktuar është vetëm një pjesë e çështjes që rëndon në shkencën tonë gjuhësore për këtë fushë ditunore, sepse aq më tepër shqipja ka çështje të tjera të hapura problemore jo mjaft të studiuara, jo vetëm në fushën e patronimisë, por edhe më gjerë, çështje këto që nuk kanë të bëjnë vetëm rreth shumësit dhe shquarsisë së emrave të përveçëm në përgjithësi, por edhe për patronimet, ku bën pjesë edhe çështja drejtshkrimo - fjalëformues dhe përzgjedhja tyre në harmoni me rregullsitë gramatikore të shqipes standarde. Sidoqoftë, edhe për këtë temë, të cilën ne e morëm në shqyrtim si krye më vete, do të përpiqemi të vëmë në pah sipas mundësive që kemi, jo vetëm pasqyrimin sadopak të gjendjes ekzistuese të patronimeve, por kemi ambicje për të përcaktuar ose sugjeruar qoftë

edhe guximtarisht edhe ndonjë zgjidhje ose të pikasim ndonjë prirje drejt zgjidhjes që na ofrohet nga analiza.

Gjithsesi, përpjekjen tonë, studiuesit e standardologët tanë edhe nëse e vlerësojnë si përpjekje të guximshme ose vetëm si nismë të mbarë nuk duhet ta lënë si hap të parë, siç është, por duhet ta shpiejnë më tej, ngase ata fundi i fundit e kanë për detyrë të punojnë për *disiplinimin* ose edhe *normëzimin* e patronimeve krahas antroponimeve në kuadër të onomastikës së gjuhës shqipe.

Së këtejmi ne kërkojmë që pa prekur në lirinë universale të përzgjedhjes individuale të patronimit, studiuesit duhet t'i ndihmojnë çështjes që njeriu ynë të dijë ta përzgjedhë e ta drejtshkruajë si trajtën e emrit vetjak, ashtu edhe atë të mbiemrit familjar në harmoni me kriteret e shëndosha të gjuhës e të shoqërisë sonë kombëtare.

**Së treti**, nga shembujt e mësipërm kemi vërejtur variante të ndryshme për të njëjtin koncept që silleshin nga 5 - 24 shembuj, tash po cekim edhe ndonjë *statistikë* tjetër. P.sh. për patronimin *Aliaj* në FP dalin 45 variante patronimesh (llogaritur edhe si kompozitat), *Mehmeti* 36, për *Aja* 30 shembuj etj. Ndërkaq, ne me qëllim po shtojmë edhe një rast tjetër: variantet për patronimin *Dema*, trajtë e shkurtër e formuar me aferezë nga emri Adem (\*Adamh adham -*njeri i lindur nga dheu*) që është i njohur sipas shkallës fetare në përmasa botërore, por edhe në realitetin tonë që nga protoshqipja e deri më sot. Por, para se të sjellim shembuj nga veprat në shqyrtim, ngase zgjon shumë interes për temën e shembullin tonë, po shënojmë konstatimin e onomastikanit tonë të njohur prof. Doçi, i cili në studimin: *Fjala pellazge – ilire - shqiptare da - del dhe në funksione onomastike*, Veç tjerash, na bën me dije se ka *qindra e mija antroponime e patronime me bazën AD -*, ndërkaq ky autor vetëm trajtën **Adam**, pa kaluar në trajtat shqipe me DH: Adham, Dhame, Dhamo, e jep të shënuar në afro 30 variante. Sidoqoftë, autori na bën me dije se pikërisht në këtë emër ka hise protoshqipja me fjalën **Da - DE** ose **Dha** / m - Dhe (dheu-sot) dhe që në mesjetë (shek XIV) te shqiptarët dokumentohet antropomimi **ADAM**... dhe së andejmi konstaton se ky fakt për kombin e gjuhën tonë:

*Ka rëndësi shumë të madhe ngase antroponimi Adam është përdorur tek ilirët dhe shqiptarët e krishterë mesjetarë, para se të futej në shqipe me trajtën Adem (përmes turqishtes) dhe se kemi arsye të kërkojmë tek emri vetjak Adam – Adem rrënjorin - da (de -DHE), me a - në protetike dhe me - m-në fundore. (Shih. Bota sot, 11.12. 2014 f. 23.)*

Sidoqoftë, ne në “*Fjalor emrash*” të V. Zotos (f.7) ndeshim këto variante antroponimesh mbi këtë emër: *Dem, Demë, Demush, Demlush*, pastaj: *Dhame, Dhamo, Adam, Adame, Adamje, Ademia, Ademt, Ademta, Ademin, Ademina*.

Ndërkaq në **VEF** (Vëzhgime për emrat familjarë) në cilësi *patronimi shqiptar* ndeshim këto trajta: *Ademi, Ademovi, Ademovski, Ademi, Dema, Demalia, Demolli* dhe si antroponim: *Adem, Dem*.

Konstatojmë se në Fjalorin e Bidollarit trajtën Adem si patronim nuk e ndeshim fare, por vetëm Dema, me variantet: *Demai, Demaj, Demalia, Demallari, Demollari, Demanj, Demçe, Demço, Demçolli; Demeti (Dem+Meti), Demollaraj(!)*. Ndër ne ndeshim edhe trajtat: *Demaçi, Demaku, Demi, Demiqi, Demnushi, Democi, Demoviqi, Demovitët(!)*. Pra, ndeshim 20-30 e sa raste mbi këtë bazë, ndërkaq, gramatikisht e logjikisht për të përfaqësuar konceptin përkatës patronimik të një nocioni, siç u cek më sipër, do të mjaftonte vetëm një trajtë ose në alternativë dy, siç e konstatojmë ne: **Dema / Demaj**.

Na kujtohet rasti kur Adem Demaçit në ribotimin e veprave iu ndryshua mbiemri nga *Demaçi* në **Dema**, gjatë promovimit të librave referuesve u shkonte goja, dikuj me qëllim e dikuj spontanisht, me të drejtë, te trajta **Demaj**, me prapashtesën - **AJ**, e cila, pra, jo vetëm sipas nesh, por ka gjurmë e traditë përdorimi me shekuj si formant i specilizuar për emërtime të tilla, sepse trajta Dema gramatikisht shkon sipas emrit femëror. Sidoqoftë, edhe pse ne trajtën **Demaj** e quajmë mirëfilli më të mbështetur shkrimisht si patronim, trajtën *Dema* nuk e quajmë të qortueshme vetëm pse shkon sipas formës së emrave femërorë, ngase trajta e tillë *Demë Dema* u bashkohet emrave malësorë të shqipes që kanë traditë shekullore, siç është tipi *Ukë Uka, Dedë Deda, Dodë Doda* etj., dhe në anën tjetër asnjë emër femëror paralel nga ajo kohë e deri tani mbi këtë bazë për këtë tip emrash nuk ka formë homonime paralele me - **Ë** / - **A**, ngase emri në femërore merr fundore tjetër shquarsie, siç e pamë në shembujt e mësipërm, si b.f.: *Ukë / Uke Ukja, Ukije Ukija; Dedë/ Dede Dedja, Dedijë Dedija; Dodë/Dode Dodja*. etj.), e vërtetë kjo që del e sqaruar edhe nga analiza e antroponimeve. Sido që të jetë, ne alternativën: *Dema Demaj*, si variant e quajmë të mbështetur dhe si koncept, për një njeri konkret të gjitha rastet e tjera mund të jenë të panevojshme, madje disa edhe jofunksionale, siç do të përpiqemi ta argumentojmë më poshtë po në këtë punim.

**Së katërtri**, në pikën e mësipërme trajtën e patronimit me prapashtesën - **AJ** si te rasti Demaj kundrejt trajtës Dema (edhe pse trajta Dem Demi gramatikisht del më e gjinisë) e sugjeruam si alternativë të tolerueshme, gjithsesi jo të qortueshme, ngase e konsiderojmë mbiemrin **Dema** si trajtë tashmë stabile si patronim nga tradita, edhe pse kjo trajtë, si me thënë, ashtu si edhe barsvlerësi i mundshëm **Demi** nuk i ka ndëprerë tërërisht raportet me shkallën e parë kuptimore, siç ndodhë me trajtën me - **AJ**: **Demaj**.

Kjo dukuri kuptohet, ngase shembulli i rastit *Dema*, i cili mund të kthehet po në atë trajtë si antroponim i rëndomtë (Demë Dema), ndërsa trajta me -**AJ** jo. Së këtëjmi emrat e formuar me prapashtesën - **AJ** në gjuhën shqipe i quajmë plotësisht të qëndrueshëm formalisht e semantikisht si patronime të mirëfillta. Mirëpo kjo që e thamë ka nevojë të përforcohet me fakte, ngase aktualisht mund të themi se prapashtesa - **AJ** konkurrohet në temë nga mëse 30 - 50 formante të tjera që ne disa prej tyre i quajmë konkurruese si alternativë, siç janë fundoret - *i*, -*u*, -*a*, -*ja* (si fundore shquarsie), disa i quajmë të diskutueshme, si: - **O**, - **E**, - **I**, e - **A** a - **AJ** e disa edhe të qortueshme, përfshirë si raste disa *diminutiva*, *rastet me ndërrim të temës prodhuese fjalëformuese* etj., si dhe formimet me *fundore ose me prapashtesa të imponuara e ndonjë përfitim spontan*, si rrjedhojë nga shtytës të brendshëm ose të jashtëm. Nga shembujt e mësipërm shkëputëm fundoret konkurruese në temë ndaj formantit - **AJ**, të cilat po i shënojmë më poshtë, por në këtë rast shtrojmë kërkesën që vetë lexuesi, nga tema e secilit emër të shënuar pas fundores përkatëse ta provojë sa pëlqen apo jo, ndërtimi i patronimit përkatës me ndërrimin e cilitdo formanti konkurrues me prapashtesën - **AJ**, si p.sh: Geg/**alli** ose Geg**S** etj. me **Gegaj** etj dhe kështu ta bindë veten se zgjidhja më e mirë të këtij kaosi, është mbështetja në prapashtesën e specializuar- **AJ**.

## 21. 1. Shembujve me formantet fundore konkurruese:

**1. - a/LLI:** Gegalli, **2. - S:** Gegës, **3 - I:** Gegi, Zogi!, Rusti, Demi, Tuki, Tuçi, Tushi, **4. o/LI:** Gegoli, **5. o/LLARI:** Gegollari, Petrollari, **6. -a/LLARI:** Demallari, **7. - USHI,** Gegushi, Petrushi, **8. a/NI:** Ujkani, Shytani, Pepivani(!), **9. - EJ:** Ujkanej, Petrej, **10.a/ SHI:** Ujkashi, **11. - ANJ:** Shytanj, **12. -A:** Shyta, Rusta, **13. -ATI:** Rustemati, **14. zero:** prapashtesë: Rustem, Dem, Adem, **15. - E:** Ruste, Petre, **16. -T:** Ademt, **17. - AQI:** Petraqi, **18. -AÇI:** Demaçi, **19. - OSHI:** Peposhi, **20. -LUSHI:** Demlushi(!), **21. - LIA:** Demalia, **22. - OLLI:** Demolli, Zogolli, **23. - ÇOLLI:** Demçolli!, **24. - a/KU:** Demaku, **25. - OCI:** Democi, **26. - IQI:** Demiqi, **27. - O/VIQI:** Demoviqi, **28. - ÇO:** Demço, **29. - ov/ ITËT:** Demovitët, **30. - JA:** Zog'ja!...

Siç mund të shihet shumica e formanteve janë prapashtesa, qoftë vendëse, qoftë të huazara. Dhe që të gjithë shembujt në këto 30 pika në njëfarë mënyre sfidojnë zgjidhjen me prapashtesën - **AJ**. Pa dyshim në realitetin tonë gjuhësor, ashtu edhe në veprat që konsultuam këtij mishmashi fjalëformues i shtohen edhe ndajshtesa e mënyra të tjera në numër të hapur, mbase të pakufizuar, gjithsesi shumica të diskutueshme për formimin e patronimeve të mirëfillta, andaj ne për mos me humbë në këtë farë sixhungle a mishmashi drejtshkrimo-fjalëformues do të marrim në shqyrtim më poshtë vetëm disa nga këto raste konkurruese, por edhe do të shtojmë të tjera që na duken me interes. Kështu pas përforcimit të rasteve në alternativë me prapashtesës - **AJ** do të trajtohen edhe patronime me formante të tjera.

## **KREU XII**



## 22. Shqyrtime në drejtim të aspektit drejtfjalëformues me formante shquarsie dhe prapashtesim

Në të vërtetë, para se t'i rreshtojmë më poshtë disa mendime tona të tjera konkretisht lidhur me **zgjidhjen alternative** të patronimeve të shqipes në aspektin drejtfjalëformues me formante shquarsie dhe me prapashtesim përkatës, tash menjëherë po e përmendim numrin e shembujve sipas prapashtesave përkatëse që për këtë tip emërtimelesh i ka pasur në konsideratë studiuesi Jusuf Shpuza, siç janë prapashtesat: - **AJ**, - **EJ**, - **OJ**, - **RAJ** me origjinë vendëse, si dhe ato me prejardhje të huaj: - **LER/I**, - **LLAR/I**, - **OLL/I**, - **OV/I** dhe - **EV/I**. Ja pasqyra e numrit të krijimeve të tilla sipas **VEF - it**, që ne po shtojmë edhe numrin që qëmtuam nga **FP**:

<u>Vepra</u>	<u>Numri i</u>	<u>P r a p a s h t e s a t</u>								
		<u>shembujve</u>	-aj,	-ej	-oj	-raj	-ler/i,	-llar/i,	-oll/i,	-ov/i
<b>VEF</b>	1337	1062	162	4	8	1	40	22	31	7
<b>FP</b>	626	460	40	15	8	2	110	50	1	1

Të dhënat që i nxorëm ne nga FP edhe ato nga VEF-i, e mësipërm përgjithësisht nuk e shohim aq larg realitetit të rastit, por megjithatë ne këtë kompleks shohim gjëra që kanë mundësi të plotësohen, andaj së këtijmi lëndën në vijim do të shtjellojmë në tri pjesë:

**Së pari**, rreth raportit alternativ: njëj-mbaresat e njëjësit të shquar/formanti - **AJ** si prapashtesë e specializuar për formimin e patronimeve.

**Së dyti**, formimet me prapashtesat vendëse dhe

**Së treti**, formimet me prapashtesat me prejardhje të huaj.

a/. **Shembuj me fundore - prapashtesën - AJ si formant i specializuar në raport alternativ me njëmbaresat e njëjësit të shquar**. Lidhur me formantin - **AJ** Xhuvani-Çabej në monografinë e tyre mbi prapashtesat e gjuhës shqipe shprehen kështu:

*Me këtë prapashtesë janë formuar:*

1. *Patronimika: Gjinaj (Gjin), Gjellaj (Gjel), Kolaj (Kolë), Llukaj (Llukë), Nikaj (Nikë).*

2. *Emra visesh e krahinash të Jugut e të Veriut të dalë nga patronimikat:*

*Bardhaj, Çorraj, Lekaj, Memaliaj, Sinanaj, Zogaj.*

Pra, edhe pse nuk i shënojnë shembujt në alternativë, si me thënë, këtë prapashtesë e cilësojnë të specifikuar për emërtimin e *patronimikave*, përkatësisht të *toponimeve të dala nga patronimikat*. Ndërkaq, siç e pamë nga pasqyra në FP dalin mbi 450 shembuj, ndër ta afro 40 janë lema bazë të bollduara, kurse studiuesi Jusuf Shpuza shënon mbi 1000 raste, i cili lidhur me mirëfillsinë e kësaj prapashtese, 13 vjet para botimit të veprës së Ç. Bidollarit shprehet kështu:

*Siç vihet re nga pasqyra e mësipërme prapashtesa - **AJ** është më e përhapura. Me ndihmën e saj janë formuar patronime, kryesisht nga antroponime, por jo rrallë edhe nga toponime.*

Së këtëjmi, pa u hamendur shumë mund të konstatohet fakti se pothuaj të gjithë studiuesit e kësaj teme e përmendin formantin - **AJ** si prapashtesë të specifikuar, madje disa e cilësojnë edhe të specializuar për formimin e patronimeve në gjuhën shqipe, dukuri e gjallë kjo specifikuese, e cila si e tillë imponohet që nga tradita lashtënore paradokumentuese e sipas dokumentimeve të para të shqipes (P.sh. D. Luka konstaton se onomasti **Devoll** më parë quhej **Eordai**) dhe njëherazi ndërkohë formanti - **AJ**, pothuaj praktikisht u cilësua si formant i specializuar për këtë destinim. Që është kështu aktualisht, apo jo, pa përmendur emra të tjerë studiuesish të huaj e vendës, po përmendim faktin se tash së voni (2014) këtë të vërtetë mjaft shkurt e shqip, e ka shqiptuar me penën e tij, doktoranti **Isuf Bazaj** me fjalët: **Që tash më është provuar se ndajshtesa - AJ del e specializuar për formimin e patronimeve.**

Edhe pse edhe ne në punimet tona, madje edhe pak më sipër, e kemi përmendur një fakt të tillë, konstatimin e doktorantit **Isuf Bazaj** e theksojmë në mënyrë të veçantë, ngase është thënë në tezën e doktoratës të këtij studiuesi, të cilën e ka punuar nën udhëheqjen shkencore të prof. Ç. Bidollarit, njëri ndër njohësit më të mirë të kësaj problematike në Shqipëri e më gjerë. Por, ç'është vëreta, edhe pse edhe ne mendojmë ashtu, deri më sot nuk kemi pasur rast të lexojmë ndonjë arsyetim të plotë: **“për që ky specializim është provuar tash më”**, ashtu, siç e thotë autori.

Edhe studiuesit e tjerë nuk e mohojnë këtë, por dikush e sheh më sipërfaqësisht e dikush më në thellësi. P.sh. studiuesi **Ramadan Asllani**, duke e parë të vërtetën rreth shtrirjes

në kohë e hapësirë të këtij formanti si në toponime, ashtu edhe në patronime, po pa mohuar përparësinë e saj të specifikuar parësisht në formime patronimesh, lëvron pak më gjerë:

*“Prapashtesa e sotme shqipe - AJ vjen nga një trajtë e hershme - ANJ, e cila ende vazhdon të jetë e pranishme, sidomos në patronime dhe toponime, përkatësisht: “prapashtesa - AJ është shumë prodhuese në mbarë truallin shqiptar, sidomos “në patronime është e shprehur në të gjitha zonat e viset shqiptare”.* Kështu sipas tij: *Toponimi Bunjaj dëshmohet në krisobulat e Deçanit (1330). Dhe po të asaj periudhe janë edhe mbiemrat Vanaj, Zataj apo Zotaj (1411, 1438). Madje, si në Çamëri e Labëri edhe në Serbinë Jugore, dëshmohen patronimet me - AJ, si: Rrapaj, Bubanj, Banjaj-t Gjakaj-t, Lepajt, Devcajt, Dallkajt, Bajrajt, Arnautajt, Nicajt, Rracajt, Pllanajt, po ashtu edhe në Kosovë dëshmojnë mbi 30 raste. Vetëm në vitin 1938 në Shqipëri janë evidencuar rreth 260 emra fshatrash me prapashtesën - AJ (me prejardhje patronimie), si: Likaj, Rrapaj, Demiraj, Hysenaj etj.*

Ndërkaq ndër të tjera edhe studiues të tjerë të përqëndruar në patronimet aktuale të Gjakovës me rrethinë, shikuar nga këndvështrimi i tyre shprehin mendime me interes, si: *Rruga e formimit të patronimeve me - AJ mendohet të ketë ardhur si rezultat i trajtës pas singularizimit të formës së shumësit (Petriti i Dedajve) - Petrit Dedaj.* Dhe kështu vazhdon së komentuari: *Sipas përdorimit praktik të patronimeve në Gjakovë, vërejmë se pjesa më e madhe e atyre patronimeve që dalin me - AJ, rëndom u përkasin mbiemrave të banorëve në zonat rurale, ndërsa në zonat urbane gjejmë gjithashtu të njëjta patronime, por pa prapashtesën - AJ. Kështu p.sh. gjejmë dy variantet: Leka Lekaj, Gjoka Gjokaj, Mala Malaj, Nika Nikaj, Marku Markaj. gjë që na jep të kuptohet se patronimet e krijuara në bazë të emrit të kryetarit të familjes janë përdorur pa dallim në zonat urbane e rurale, por këta të fundit janë pajisur me ndajshtesën - j, - AJ.*

Për ne, mendimi rreth përfuturit të trajtës me - Aj nga singularizimi i formës së shumësit zgjon interes si konstatim i mbështetur, gjithashtu edhe konstatimin pse në qytet trajta me - AJ dalka më e modifikuar me zgjidhjen me njëmbaresë se në fshatra, ku del më e konservuar, ka arsye e vet të shpjegueshme. Me fjalë të tjera prapashtesa - AJ, siç konstatojnë studiuesit ishte e pranishme në gjuhën shqipe, pikërisht për emërtim patronimesh, që para se shqipja të kontaktonte me gjuhën sllave si dhe me atë turke. Prapashtesa - AJ thuhet se mund të ketë dalë nga trajta \*- *anj*, ose trajta latine - *“anius”*, po ne shtrojmë një pyetje tjetër rreth përfuturit të këtij formanti, pa kundërshtuar hamendjet e

sapocekura: Sa ka pasur hise vetë nyja e përparme **-I** ose **-E** e përftuar edhe si mbaresë, siç ishte rasti **i biri i...ose e bija e...** (**përkatësisht e = e bijA, fundorja A e dalë nga E+Ë**, nënkupton: **i +...**(emri i prindit) ose **e+...**(emri i prindit)...Kujto edhe shembullin **i HOT** sot **Hot + i (i = i biri), i Arbresh (i) Arbresh + I Arbreshi, ose (...) I Gjakovs** ose (...) **E Gjakovs; (i) Gjakovs+I, (e) Gjakovs+ja** (që dëgjohet deri në ditët tona, para se me dalë trajta me **-AR** (gjakovar ose gjakovare), andaj kujto ngjashëm: **e Mal(ë)+E, (e) Malë(E), Malë + e (a) sot Malë Mal +A -Mala**. Pra, njëmbaresa - **A**, është formuar nga **Ë + E**, ngase sipas historianëve të gjuhës shpjegohet se **Ë** - ja (dikur si mbaresë i takonte gjinisë asnjësore ose asaj mashkullore). Andaj, sa mund të ketë pasur hisen e vet të ndikimit ky fakt **ë + E**, prej nga del krasisi: - **A** mbetet të hulumtohet. Më konkretisht të shquarët e emrave mashkullorë malësorë e të tjerë edhe pse të gjinisë mashkullore natyrore, që dalin në numër të konsiderueshëm me - **A** fundore dhe eptohen si emrat femërore sipas gramatikës aktuale, ka shpjegimin e vet. Pyetja jonë është: njëmbaresa - **I** bashkë me krasisin: **ë + e = A** si njëmbaresa fundore, patën hise në formëzimin e prapashtesës - **AJ**. Kur këtij sugjerimi: **A + I - AJ** dhe rreth konstaminimit të mbaresave - **I, - A (Ë + E)** me prejardhje nyjore mbiemërore i shtohet edhe një fakt tjetër. Le të krahasohet varianti i shquarsisë së emrit mashkullor me **-a** të theksuar fundore: tipi, Thoma **Thomaj**, Isa **Isaj**, trajtë që ofrohet si zgjidhje alternative **patronimie**, krahas versionit me - **JA** (**Thomaja, Isaja**) ashtu si edhe trajta **Thomaj, Isaj** me prapashtesën - **AJ** e konvertuar në patronim. Dhe kështu, tani në kohën tonë, pikërisht emërtimi me prapashtesën - **AJ** shërben në patronime për të dyja gjinitë në alternativë me fundoren mashkullore - **I** (...) edhe - **A (e+ë)** për femërore-mashkullore. Sidoqoftë për **raportin - AI ndaj - AJ**, le ta vrasin mendjen etimologët. Dhe për këtë është mirë, siç u tha të gjurmohet më tej. Aty, te shembujt konkretë, në të vërtetë, kemi të bëjmë me prapashtesën e sotme - **AJ**, e cila si e tillë kur i bashkëngjitet temës me zanore, vokalin fundor të saj e elidon, siç ka ndodhur konkretisht me njëmbaresat e shquarsisë të njëjësit: - **i, - u, - a**, që i shënon si duhet vetë autori, siç dëshmojnë shembujt konkretë: *Bardh/i Bardh/aj, Mark/u Mark/aj, Mal/a Mal/aj*, formante këto të cilat R. Asllani i quan, me të drejtë apo jo, prapashtesa, ngase vërtet funksionalisht kryejnë një veprim të tillë. Por sidoqoftë është mirë që dalin me zgjidhjen alternative *dyvariantshe* që po e theksojmë edhe ne në mënyrë të veçantë: *Leka Lekaj, Bardhi Bardhaj, Marku Markaj*, dukuri kjo që do të përforcohet mbase edhe spontanisht edhe nga autorë të tjerë. Pikërisht këtë fakt

e cek jo aq kalimthi edhe studiuesi **Ramadan Asllani**, i cili duke konstatuar lashtësinë e prapashtesës - **AJ** për këtë destinim *në të gjitha trojet shqiptare* shënon për ilustrim edhe këto raste alternative: Bici Bicaj, Ceka Cekaj, Vrana, Vranaj. (Shih: *zsh*, 29.09.2008.)

Në të vërtetë, shembuj të tillë rreth zgjidhjes alternative dëshmojnë edhe në punimet e studiuesve të njohur të kësaj problematike, si: Rexhep Doçi, Begzad Baliu, Bahtjar Kryeziu, Rami Memushaj etj, por për ne më dallueshëm se të tjerët këtë alternativë qoftë edhe të përgjysmuar e fut në përdorim **Jusuf Shpuza**, në kapitullin *Ngjyrimi sllav në formën e disa patronimeve shqiptare* të veprës së tij. (Shih, f. 131-140.) Aty autori shënon afro 40 patronime të vjetra shqipe me prapashtesë ose fundore shqipe tash të sllavizuara nga trajta e serbishtes - **IQ** (me variante), si b.f. : Martinaj - **Martinoviq**, Kada - **Kadiq**, Qosja - **Qosiq**, Ulaj - **Ulaviq**, Lulani - **Lulanoviq**, Mekuli - **Mekuliq**, por edhe në alternativë: Gashi e Gashaj - **Gashiq**, Sadiku e Sadikaj - **Sadikoviq**.

Edhe pse autori nuk e cek, nga vetë forma e patronimit me - **IQ** na bëhet e kuptueshme se familjet e tilla tashmë kuptohet se janë sllavizuar plotësisht, ose janë në rrugë sllavizimi edhe pse rrënjori i emrit i takon qartë gjuhës shqipe.

Pikërisht kjo temë është trajtuar edhe nga studiuesi **Ismet Ajvazi**. Edhe ky në punimin *Patronimet në Sanxhak*, pasi konstaton se disa familje me prejardhje shqiptare që ende bartin temat (rrënjorët) e patronimeve të shqipes, përmes prapashtesës të shartuar me specien - **IQ** (me variacione) të serbishtes. Së këndejmi, familjet e tilla tashmë edhe gjuhësisht konsiderohen të shkombëtarizuara, si: *Kastratoviq - ish - Kastrati*, *Gjinoviq - ish - Gjini*, *Gjonoviq - ish - Gjoni* etj., por ndeshëm aty edhe nja tri raste alternative nënkupto: **Duka Dukaj të shndërruara në Dukiq, Zogu ose Zogaj në Zogoviq, përkatësisht Leka ose Lekaj në Lekiq.**

Po si mund të kuptohen rastet kur një familje përkatëse shqiptare, edhe pse ka qenë e detyruar me pranue një prapashtesë të tillë ( - **V/IQ**), gjuhësisht ose edhe patronimisht dëshmon se nuk është sllavizuar?

Besojmë se shumica e lexuesve e di përgjigjen e pyetjes së mësipërme, por për të kuptuar më mirë ne do ta përmendim një veprim të studiuesit të nderuar **prof. Skënder Hoxha**, i cili duke bërë fjalë në një artikull për disa patronime të shqiptarëve të Krajës (Mali i Zi), ka vënë re se krajanët mbiemrave me - **IQ** i kishin shtuar **I** - në shqese si te emrat e shqipes: - **IQ/I** dhe për këtë sjellë afro 30 shembuj. Mirëpo edhe pse një prapashtesë e tillë -

**IQI**, vërtet tingëllon paksa hibride, autorin e iriton edhe ky fakt, ngase sipas tij *shartimi* i mbiemrave të shqiptarëve me formantin - **IQ**, bërë me qëllim asimilimi të tyre në Krajë ishte, pothuaj ende i freskët, ngase dihej ose ndihej së paku me zemër, njerëzisht e shkencërisht, sepse me formantin - **IQ**, ishin zëvendësuar trajtat alternative barasvlerëse të shqipes, përkatësisht, qoftë me - **AJ**, qoftë me trajtat e një-mbaresave të njëjësit të shquar: - **I**, - **A**, - **U**, - **JA** të emrit përkatës. Prof. Skënderi në atë artikull shënon afro 30 shembuj emërtime familjesh me - **IQI**, pra jo me - **IQ**, siç ndodhi te rastet e dy studiuesve të mësipërm. Në atë artikull veç tjerash autori kërkon me ngulm që zyrtarisht t’u rikthehen familjeve shqiptare patronimet në gjendjen e mëparme, në trajtën e plotë të shqipes, dhe trajtat e shqipes i shënon sipas **zgjidhjes alternative**, qoftë me - **I**, - **U**, - **A**, - **JA** fundore, qoftë me prapashtesën - **AJ**, sipas skemës:

<u>Është</u>	-	<u>Duhet</u>
Aruçeviqi	-	Aruçi ose Aruçaj,
Bardiqi	-	Bardhi “ Bardhaj,
Gjinoviqi	-	Gjini “ Gjinaj,
Koliqi	-	Kola “ Kolaj
Ramusheviqi	-	Ramushi “ Ramushaj
Durakoviqi	-	Duraku “ Durakaj
Markoviqi	-	Marku “ Markaj
Zeneloviqi	-	Zeneli “ Zenelaj
Dinoviqi	-	Dina “ Dinaj etj.

Kuptohet lehtë nga gjithkushi se autori kërkon që fundorja - **IQI** si b.f. Aruçeviqi të zëvendësohet alternativisht me fundoret e shqipes ose - **I** ose - **AJ**: Aruçi ose Aruçaj, e kështu me radhë.

**Shënim.**

E shohim të arsyeshme ta komentojmë paksa dy konstatimet e mësipërme rreth trajtave - **IQ** dhe - **IQI**:

**Së pari**, te shembujt e shënuar nga J. Shpuza dhe Ismet Ajvazi emërtimet dilnin me - **IQ** fundore, ngase kishim të bënim me raste plotësisht ose në rrugë sllavizimi të plotë, si

p.sh, trajta shqipe ishte shndërruar tashmë në atë sllave, kështu nga: - **i**: Mekuli në Mekuliq, Kastrati - Kastratoviç, Gjini - Gjinoviç, Gjoni - Gjonoviç, - **a**: Kada - Kadiq, - **ja**: Qosja - Qosiq, ose duke zëvendësuar të dyja versionet alternative të shqipes, si nga: -**i** ose -**aj**: Gashi, Gashaj në Gashiq, Sadik, Sadikaj në Sadikoviç, ose vetëm -**AJ**, si Martinaj në Martinoviç, - **a** ose - **AJ**: Duka-Dukaj në Dukiq, Leka - Lekaj në Lekiq, - **u** ose - **aj**: (Sadiku Sadikaj-Sadikoviç, Zogu, Zogaj në Zogoviç.

**Së dyti**, shembujt të Skënder Hoxha, sipas formës së shënuar të prapashtesës sllave - **IQ**, me një -**i** fundore shtesë dolën me - **IQI** dhe pikërisht nga kjo - **i** fundore shtesë nënkuptohet se kemi të bëjmë me familje shqiptare (shqipfolëse), të cilat edhe pse ishin të detyruara me pranue, ndryshimin e fundores së mbiemrit, megjithatë atë e kodifikuan sipas natyrës së vet, duke e shquar emrin me prapashtesën e huaj si të ishte emër autokton i tyre.

Ne pikërisht të rastet me - **i** fundore tek: - **IQI** shohim forcën atavike të gjuhës shqipe që përkundër dhunës e presioneve ajo me sistemin e vet e ka mbrojtur vetveten. Me fjalë të tjera strukturat ligjërimore të shqipes kanë aftësi, atavike që huazimet e çdo gjuhe t'ia përshtatin vetvetes, kështu me -**i**-në shtuese trajtës - **IQI**, sadopak i është zbutur elementi i huaj. Kështu, ne pa hyrë në etimologjinë e formantit të serbishtes - **IQ**, si diminutiv ka të bëjë me elementin **\*ik** apo **\*iki** (të lanishtes apo të protoshqipes, që shqiptarët këtë rast i shtuan atavikisht elementin e vet - **i**, në njërin anë dhe që dihet në anën tjetër kemi shumë emra familjesh shqiptare me formantin - **IQI**, si: Koliqi. Menxhiqi, Mjekiqi, Plakiqi, Duriqi, Vuniqi etj. etj. e sidomos atë Krasniqi, që këtë mbiemër e mbajnë pinjojë të një fisi të njohur shqiptar (Krasniqe Krasniqja), megjithatë, ne kurrsesi nuk parapëlqejmë patronime të reja me këtë formant, madje dhe ato të vjetrat të pangulitura nuk qortohen nëse zëvendësohen me formante të qëndrueshme më shqipe, siç është specializuesja - **AJ**. Po përsërisim, **përkrahim pa rezervë kërkesën e prof Skënderit për rikthimin e trajtave fillimishte pa - IQ-in serb, sipas zgjidhjes alternative dy trajtash ose ose, siç e propozon ai**, por njëherazi bëjmë me dije lexuesin tonë të nderuar se po këtë zgjidhje me - **i** fundore shtuese shqipfolësit e praktikuan edhe ndaj prapashtesave po ashtu të imponuara nga gjuha turke e gjuhë të tjera, siç do t'i shohim në vijim. Duke përfunduar këtë pjesë analize rreth zgjidhjes alternative në raportin: një - mbaresat e njëjësit të shquar prapashtesa e specializuar - **AJ**, e sforcojmë mendimin tonë edhe me 6 shembuj, nga tre në të dyja gjinitë, së pari me njëmbaresat e njëjësit të shquar si zgjidhje e parë më afër konkretizimit kuptimor dhe në anën tjetër

zgjdhjen me prapashtesën e specializuar - **AJ** me elemente paksa më abstrakte që ka të bëjë jo me emërtim prindi a të një personi plotësisht të njohur, por me një emërtim të një familje të gjerë, një vëllazërie, fisi ose llagapi a ndonjë veçori jo individuale por simbolikë për brezet e asaj familjeje:

*Donik (Donike) Bardhi* – *Donik (Donike) Bardhaj,*

*Donik (Donike) Marku* - *Donik (Donike) Markaj*

*Donik (Donike) Mala* - *Donik (Donike) Malaj*

*Donik (Donike) Filja* - *Donik (Donike) Filaj*

*Donik (Donike) Shkurtja* - *Donik (Donike) Shkurtaj*

*Donik (Donike) Rrushja* - *Donik (Donike) Rrushaj*

Pra kjo zgjidhje (3+3 shembuj, sipas gjinive) nuk kontestohet, përkundrazi, por ne konstatojmë se po një mënyrë e tillë zgjidhjeje alternative mund të zbatohet edhe në raste të tjera, madje edhe kur emërtimi ka fundore tjetër përveç katër një-mbaresave të shquarsisë, në funksion prapashtese.

Por, pa marrë parasysh ndonjë ndryshim të vogël që mund të shfaqet gjatë analizës gjithsesi një mundësi të tillë zgjidhjeje e ofron prapashtesa - **AJ**, e cila, siç është konstatuar, jo vetëm prej nesh, në gjuhën shqipe historikisht e aktualisht e ka të fituar atributin me u konsiderue si prapashtesë e specializuar për emërtimin e patronimeve (mbiemrave), zakonisht të familjeve me histori disa brezash. Dhe si dëshmi e kësaj që thamë del e vërteta, se sikurse bashkëjeton prapashtesa - **AJ** në alternativë në raportin me një-mbaresat - **I**, - **U**, - **A** , - **JA** të emrit në njëjës in e shquar në funksion patronimi, po këto elemente do të bashkëjetojnë, në alternativë edhe me prapashtesa të tjera, qoftë

vendëse, qoftë me burim të huaj, edhe pse ato nuk kanë cilësi specializimi, të cilat madje edhe vetë ato mund të zëvendësohen ose edhe të përforcohen me prapashtesën -**AJ**.

Prandaj, kërkojmë nga lexuesi që të ndiqet me vëmendje të shtuar edhe analiza që pason tash menjëherë në dy nëntituj vijues, siç e kemi përmendur, duke filluar me trajtimin e shembujve me prapashtesat vendëse e pastaj edhe ato me prejardhje të huaj.



## 22. 1. Formimet për temën përkatëse me prapashtesa të tjera vendëse

Edhe pse Jusuf Shpuza theksonte se “*prapashtesat - ar, - tar, - njan etj. shërbejnë për të formuar emra banorësh dhe nuk duhen konsideruar si prapashtesa patronimformuese*”, megjithatë në veprat e konsultuara, siç do të shohim më poshtë, ndeshëm emërtime patronimesh me këto e prapashtesa të tjera vendëse. Së këndejmi, si prapashtesa të tjera vendëse (përveç asaj - **AJ**), edhe pse pothuaj shumica e tyre të specifikuar ose të specializuara për nënfusha të tjera semantike, por që jo në pak raste shërbejnë edhe si formante patronimformuese si më të dalluara, po i marrin në trajtim shembujt me këto formante: - **EJ**, - **OJ**, - **RAJ**. - **ANJ** / i, - **Ë/SI**, - **ASI**, - **J/ANI**, - **TARI**, - **ARI**, - **ORI**.

## 22. 2. Shembuj me fundore-prapashtesën - **EJ**

Xhuvani e Çabej mendojnë se nga - **AJ** doli - **EJ** (kur **a**-ja nga palatalizimi u kthye në **e**). Nuk dimë që profesorët e nderuar Xhuvani e Çabej e kishin parasysh faktin se siç e pamë në pjesën e dytë të këtij punimim me formanti - **EJ** i ndeshim 10 emërtime fisesh ilire, andaj sipas konstatimit të këtyre duajenëve të shkencës sonë gjuhësore, formanti - **AJ**, do të ketë pasur moshë edhe më të hershme se epoka e gjallimit të fiseve ilire.

Sidoqoftë, në FP ndeshëm këta shembuj më - **EJ** fundore: *Abdulej, Alibej, Allajbej, Bej, Alibej, Bardhej, Brahej, Dedej, Filej, Canej, Hysej, Hoxhej, Hysenej, Gjonej, Lakej, Martinej, Dodmasej, Halilej, Haxhirej Kukej, Jakej, Llukaçej, Ndojej, Nuzej, Osmane, Petrej, Skënderbej, Sulqebej, Symbëdhej, Topallej, Ujkanej, Ungrej, Zefej, Zotej, Zhej.*

Në të vërtetë, këta 35 shembuj argumentojnë faktin se edhe patronimet me - **EJ** si ata me - **AJ** nuk i shtroheshin shquarsisë, mirëpo, është konstatuar se ky formant në konkurrencë me prapashtesën- **AJ** e ka të humbur gjallërinë si dhe aftësinë e prodhimtarisë, jo vetëm për shembuj të rij, por edhe për ata ekzistuesit tashmë kanë mbetur pa motivim. Së këtëjmi, siç e ka konstatuar J. Shpuza: *Prapashtesa - EJ, e cila sot ka një përdorim relativisht të kufizuar, dikur ka qenë më e përhapur. Këtë na e vërteton numri më i madh e patronimeve me këtë*

*prapashtesë në regjistrat e vitit 1923, si p.sh: Dërvishej, Osmane, Juknej, Kukej Hallunej, Lluqaqej, Alivadej, Turkej, të cilët në regjistrat e viti 1930 janë regjistruar me këtë prapashtesë të humbur.*

Ndërkaq, në FP me prapashtesën - **EJ** ndeshëm vetëm këto patronime: *Gjonej, Simonej, Hadrej*. Madje rast i *Gjonej* shenohet si njëri ndër 35 variante të lemës *Gjoni* (Gjonaj) Së këtejmi mund të konstatohet se edhe këta shembuj në raste kur duam të identifikohet emërtimi i një familjeje të veçantë mund të zëvendësohen pothuaj normalisht me prapashtesën - **AJ** ose nëse një formë e tillë me - **EJ** del tejet e ngulitur ndoshta edhe me ndryshim nuancash kuptimore, atëherë, si shtesë përforcuese mund t'i shtohet konstruktit përkatës me - **EJ** fundore plus formanti - **AJ**, si b.f. (familja) Abdylejaj, Çabejaj, Lafejaj e kështu me radhë. Kjo mundësi plus mund të jetësohet sidomos për familjet e reja.

### **22.3. Shembuj me fundore-prapashtesën - OJ**

Në FP ndeshim këta shembuj me fundoren - **OJ**: *Dulloj, Bardhoj, Çipçoj, Hankoj, Kroj, Kuko, Hysenkoj, Përndoj, Rukoj, Sakoj, Surroj, Teztoj*. Xhuvani - Çabej, për destinim patronimi këtë formant nuk e kanë shënuar fare, ndërkaq, Jusuf Shpuza po, por e shoqëron me këtë konstatim: *Përdorim shumë të kufizuar ka prapashtesa - OJ. Në regjistrin e Shkodrës gjenden sot vetëm katër patronime: Bitroj, Bukloj, Rexhoj dhe Shetoj*. Është interesant se asnjëri nga këto emërtime nuk dalin të shënuara në fjalorthin FP si patronime, madje edhe në fjalorthin e J. Shpuzës shembulli *Bitroj* del jo me - **Oj** fundore, po me - **AJ**: *Bitraj*. Sidoqoftë, edhe këta mbi dhjetë shembuj tregojnë prirjen që edhe patronimet me këtë fundore, sikurse ato me - **AJ** dhe - **EJ** të mos i shtrohen shquarsisë. Në të vërtetë, edhe për këto raste vlen konstatimi se në rast nevojë mund të zëvendësohet formanti - **OJ** me sinonimin paralel - **AJ** si: *Bardhoj* - *Bardhaj*, *Kuko* - *Kukaj* etj., por në raste të ngulitjes thellë në përdorim të një forme të tillë, atëherë trajta e emrit me - **OJ** mund të marrë si shtesë prapashtesën - **AJ**, sidomos në rastet kur toponimi dhe patronimi krijojnë homonimi të vrazhdë, si b.f.: fshati *Surroj*, familja *Surroj*, fshati *Bukjoj* patronimi *Bukloj*, prandaj patronimi mundet me dalë fare natyrshëm *Surraj, Buklaj*, ose në trajtën me - **AJ** shtesë: *Surrojaj, Buklojaj*, e kështu me radhë. Nëse tentohet që mbiemri *Bukloj* për t'i ikur homonimisë me fshatin *Bukloj* me marrë shquarsinë me - **i** *Bukloi* ose *Surroi* (si të ishte

fundore e theksuar!), mund të thuhet se është: *bidat i ri në katund të vjetër*. Sidoqoftë, zgjidhja me - **AJ** mund të shfrytëzohet fare natyrshëm edhe në këso rastesh.

#### **22. 4. Shembuj me prapashtesën - RAJ**

Në formimin e patronimeve janë disa raste që kur përputhet tema me - **A** të theksuar me prapashtesën - **AJ**, atëherë si element kundër hiatit është përftuar një -**r**- dhe kështu formohet si me thënë një prapashtesë e re - **RAJ**, siç e ka vënë re J. Shpuza, i cili edhe e emnon si prapashtesë më vete.

Në të vërtetë, J. Shpuza shënon numrin 8 të rasteve, por në fjalorthin e tij dalin vetëm 5 shembuj: *Agaraj, Hamzaraj, Musaraj, Mustafaraj dhe Memisharaj*, ndërsa në FP ndeshëm të shënuara plus: *Allaraj, Isaraj, Thomaraj*, që vërtet arrin numri 8, mirëpo kur kemi parasysh edhe katër raste të tjera: Musaraja dhe pjesë e prapashtesës), atëherë mund të themi se me formantin - **RAJ**, që del i përftuar vetëm në zonat jugore të Shqipërisë, në shqipe janë formuar nja 10 shembuj patronimesh, përkatësisht 12 raste nëse merret për bazë elementi shtues antihiatizues -**r**-.

Ne lidhje me këtë formant konstatojmë se Xhuvani e Çabej nuk e shënojnë fare si prapashtesë, andaj mund të themi se për raste të reja patronimie nuk besojmë se gjuha shqipe do të ketë nevojë për të, madje edhe ato që kanë mund ta humbin konkurrencën kundrejt specializueses - **AJ** shprehet dr. Nuhi Veselaj.

#### **22. 5. Shembuj me prapashtesën - ANJI**

Po i trajtojmë shembujt me mbaresën arkaike - **ANJ**. Pa hyrë në historizëm, konstatojmë se sot për sot shembujt e tillë nuk e kanë atributin as destinacionin e plotë siç e ka prapashtesa - **AJ**, madje mendojmë se duhet rishikuar fakti se mos ka ndryshim prejardhjeje e zhvillimi në raportin - **ANJI** ndaj - **AJ**, sepse shembujt e shënuar me - **ANJI** në burimet përkatëse paraqiten edhe në trajtën e shquar dhe në trajtën e pashquar, fakt ky që

nuk ndodh me formantin - **AJ**. Sidoqoftë, kjo që sapo thamë rreth shquarsisë do të ilustruhet me shembujt konkretë që i ndeshëm në FP:

**a/. Shembuj në trajtën e shquar:**

a/. prejantroponimikë: *Ahmetanji, Gjinanji, Jorganji, Kukanji, Priftanji, Xhaferanji, Feudanji;*

b/. prejtoponimikë: *Bozhanji, Bracanj, Irmanji, Kalëtanji, Vishanji dhe*

c/. një rast me shquarsi me mbaresë femërore - **A** *Isufanja.*

Gjithsej 13 (7+ 5 + 1) raste.

**b/. Shembuj të shënuar në trajtën e pashquar:**

Në trajtën e pashquar i ndeshëm këta prejantroponimikë, por që emërtimi përkatës i tyre më mirë stabilizohet në fushë të patronimisë nëse pajisen me fundoren - **i**:

*Bardhanj, Brahimanj, Hasananj, Guranj, Halilanj, Habibanj, Hoxhanj, Hysenanj Ibranj, Idrizanj, Islamanj, Januzanj, Kalemanj, Karafilanj, Muhametanj, Muratanj, Murtezanj, Myrtanj, Sadikanj, Shytanj, Ymeranj, Zeqiranj.*

Gjithsej 22 raste.

**Shënim:**

Konstatohet, edhe pse kuptimisht ndryshon raporti i treshes së tillë: **antroponim /toponim /patronim**, formalisht njëjës in e shquar e bëjnë njësoj, por kur është çështja te shumësi u ndryshon mbaresa, kështu shumësi i emrit toponimik (gjeografik) merr mbaresën - **A/t**, antroponimikët e mirëfilltë marrin - **Ë**, ndërsa patronimikët marrin - **AJ**, po e ilustrojmë me shumësin e shembullit të parë përkatës: dy) Bozhanja ose dy Bozhanjat (emra fshatrash), (disa) Ahmetanjë ose Ametanjët (emra të përveçëm njerëzish), ndërkaq si patronime (mbiemra familjesh) dalin: (familja) *Bozhaj ose Bozhanjaj, Ahmetaj ose Ahmetanjaj*. Po përsërisim s'ka arsye që trajta - **ANJ/I** të mos zëvendësohet me trajtën e specializuar për këtë destinim - **AJ**, por nëse konstatohet se emri përkatës qenka aq fort i ngulitur me **i** (- **anj/i**) fundore të shquarsisë ose jo, le të qëndrojë, por në rastet e reja ekziston mundësia t'i shtohet prapashtesa speciale - **AJ**, si Ahmetanjaj, Sadikanjaj, e kështu me radhë.

## 22.6. Shembuj mbi temë në - ËSI

Edhe pse prapashtesa - **Ë/S** del e specifikuar për emrat e vepruesit, përkatësisht për formëzimin e emërimit të njeriut sipas profesionit etj. mbi bazë pjesoreje kryesisht, ndeshim këtë formant edhe në disa patronime (mbiemra familjarë). Ja disa shembuj mbi bazë toponimi, si: (Xks) *Kukësi, Durrësi, Dredhësi, Gegësi, Lopësi, Lllupësi, Damësi, Helmësi, Kudhësi, Lëkurësi.*

Edhe këtu në rast përforcimi të emrit si patronim trajtës së emrit të pashquar mund t'i shtohet si zgjidhje alternative prapashtesa - **AJ**: (familja) *Kukësi Kukësaj, Kudhësi Kudhësaj, Durrësi, Durrësaj*, e kështu me radhë.

## 22.7. Shembuj mbi temë në - ASI

Prapashtesa - **AS** është formant i specializuar për emërtimin e banorëve ose të njerëzve sipas prejardhjes, por e ndeshim edhe te disa emërtime patronimesh, si: *Drenasi, Kagjinasi, Arbanasi, Selenicasi, Hasanbegasi, Malasi, Vllamasi, Stërmasi, Llazasi, Gjolekasi, Gjikasi* e të tjerë, madje dhe mbi bazë toponimike si: *Bregasi, Alibejasi, Aranitasi, Lumalasi, Përrenjasi, Stërmasi*, e ndonjë tjetër.

Edhe në raste të tilla, sidomos për t'i ikur homonimisë me emërvendin përkatës prapashtesa - **AJ** ofrohet si zgjidhje alternative. Kështu emërtimet e tilla mund të përforcohen si patronime në alternativë me këtë element, si p.sh.: (familja) *Arbanasaj, Përrenjasaj, Stërmasaj*, e kështu me radhë.

## 22. 8. Shembuj me temë në - J/ANI

Me - **JANI (-ANI)** fundore në FP janë regjistruar një mori emërtime të njerëzve mbi bazë etnonimi, emërtime banorësh zakonisht mbi bazë toponimike, si:

a/. me prapashtesën – **JAN**

*Çipjani, Damjani, Derjani, Cerjani, Dojani, Dhuvjani, Brabjani, Lumjani, Kukësiani , Shkupjani, Shaljani etj.*

**b/.** me prapashtesë-fundoren - **ANI** :

*Cakrani, Gajtani, Gosturani, Grazhdani, Jubani, Jarani, Melqani, Shkodrani, Troshani, Tropojani etj.*

**c/.** me prapashtesën - **ANA** ose - **ANIA**:

**1.** *Bardhana, Ulpiana, Artana, Arbana, Besiana*

**2.** (Pejane) *Pejania*, (Shkodrane) *Shkodrania*, (Shabane) *Shabania* etj.

Edhe shembujt mbi këtë bazë mund të sforcohen në alternative me prapashtesën - **AJ**: (familja) *Shkupjanaj, Lumjanaj, Gosturanaj, Jubanaj, Troshanaj, Shabanaj, Bardhanaj, Shkodranaj*, e kështu me radhë.

## **22. 9. Shembuj me fundore - prapashtesat -TARI (- DAR/ I )**

Në veprat që konsultuam gjetëm emërtime me prapashtesën shqipe - **TAR/I**, dhe atë me prejardhje persiane: - **DAR/I** , ja disa shembuj:

**a/.** - **TAR/I**: Bajraktari, Magji(s)tari, Peshkatari, Zylyftari;

**b/.** -**DAR/I**: Silihdari, Çohadari, Haznedari.

Shembujt e tillë i ndeshim me zgjidhje alternative pothuaj normalisht me prapashtesën - **AJ**, si: Bajraktari Bajraktaraj. Ndërkaq ato me - **DARI**, nuk janë aktive, ose dalin të përvetësuara me barsvlerësin e shqipes - **TAR/I**.

## **22. 10. Shembuj me prapashtesën - ARI**

Me prapashtesën - **ARI**, shënuam këto patronime:

*Argjendari, Behari, Beqari, Lushnjari, Bahtiari, Gjyzari, Jenisari, Jorgari, Kashari, Kolari, Llapari, Pinari, Pronjari, Qibari, Muzeqari, Bujari Korçari, Manari Mokrari, Tuxhari, Vegshari etj.*

Edhe për raste të tilla si zgjidhje alternative, për t'i ikur homonimisë, ofrohet prapashtesa -**AJ**, si p.sh.: si: **Bujar - Bujaraj, Muzeqari-Muzeqaraj, Bahjtjari-Bahtjaraj, Behari-Beharaj etj.**

## **22. 11. Shembuj me prapashtesën - ORI:**

Me prapashtesën - **ORI** nga burimet volëm këto emërtime patronimesh:

*Zaganjori, Mulori, Llogori, Nestori.*

Edhe këta shembuj mund të kenë zgjidhje alternative me prapashtesën - **AJ**, si:

*Zaganjori-Zaganjoraj, Nestori- Nestoraj etj.*

### **c/. Shembuj mbi temë me prapashtesa me prejardhje të huaj.**

Shembuj me prapashtesa me prejardhje të huaj, sipas shembujve të regjistruar në burimet që

konsultuam i kemi ndarë në tri pjesë:

**a/.** Shembuj me prapashtesa turke,

**b/.** shembuj me prapashtesa sllave dhe.

**c/.** shembuj me prapashtesa greke.

### **a/. Shembuj mbi temë me prapashtesa turke**

Nga pasqyra që jepte J. Shpuza ishin në konsideratë këto dy prapashtesa me prejardhje nga turqishtja - **LER/I** dhe - **LLAR/I**, Ndërkaq ne sipas burimit FP dhe të tjera, veç këtyre do të trajtojmë shembuj të imponuar edhe me prapashtesa të tjera me origjinë nga turqishtja: - **OLLI**, - **a/ XHI**, **XHIJA** (- **ÇIJA**), **A/LI**, -**A/LIU**, -**A/LIJA** dhe - **i** - ja.

## **22.12. Shembuj me prapashtesën - LER/I**

Prapashtesa - **LER** në turqishtes tregon shumësin e disa emrave, nga ky ndikim edhe del e huazuar për këtë destinim si: *shehler/ë*, *dervishler/ë*, *bejlerë* etj. Ndërkaq J. Shpuza e cek si prapashtesë patronimesh në shqipe, edhe pse në VEF del e përfaqësuar vetëm me një shembull *Bejleri*. Sipas FP - se kjo prapashtesë nuk del aspak prodhuese për patronimet e gjuhës shqipe. Aty ndeshim të shënuar edhe një shembull: *Koçileri*.

Ndoshta më mirë do të ishte që ky formant të mos shënohej fare si prapashtesë patronimformuese e shqipes, kur ofrohen zgjidhje më të përshtatshme alternative, si: Shehu Shehaj, Dërvishi Dërvishaj, e kështu me radhë.

## **22.13. Shembuj me prapashtesën - LLAR/I**

Edhe prapashtesë-mbaresa turke - **LLAR**, si edhe ajo - **LER** në atë gjuhë del si formant i specializuar për formimin e shumësit të emrave përkatës. Ndërkaq, në shqipe u trasformua ose u imponua si prapashtesë mjaft prodhuese për formimin e patronimeve. Në të vërtetë, në veprën VEF emrat e tillë nuk arrijnë as numrin 10 të përfaqësimit, ngase studiuesi i ka vjelë nga ndonjë regjistër dhe nuk ka pasur mundësi t'i shënojë në fjalorthin e tij të gjithë shembujt që mund të ndeshen në realitetin tonë gjuhësor, megjithatë ai mjaftohet me faktin, duke e cekur të vërtetën se emërtimet e tilla kryesisht *janë aktive në viset jugore*



të *Shqipërisë*, e vërtetë kjo që dëshmohet pikërisht me numrin aq të madh në veprën FP që kalojnë 100 - shin.

Sidoqoftë ne mendojmë se një prapashtesë e tillë dikur e imponuar ose e pranuar mbase spontanisht nuk është mirë jo vetëm të përsëritet po është mirë të zëvendësohet, nëse jo menjëhershmerisht, atëherë së paku nga brezat e rinj. S'do mend se si zëvendësim i saj paraqitet barasvlerësi i shqipers - **AJ**, por nëse ndonjë emër del aq i ngulitur nuk prish punë që konstruktit të atij emërtimi t'i shtohet prapashtesa - **AJ**. Kështu në vend emërtimit b.f. Kostallari, mund të dalë emërtimi në alternativë: (Kosta) Kostaj ose Kostallaraj, në vend Çaushallari me dalë: (Çaushi) Çaushaj apo Çaushllaraj, në vend Pashallari: (Pashai) Pashaj ose Pashallaraj, në vend Ramallari me dalë (Rama) Ramaj ose Ramallaraj, e kështu me radhë. Së këtëjmi, do të ishte e këshillueshme që familjet e tilla ta ndryshojnë vetë një prapashtesë të tillë me origjinë të huaj, sot fare të panevojshme.

## 22. 14. Shembuj me prapashtesën - OLLI

Në krahasim me dy prapashtesat e sipërcekura, prapashtesa - **Oll/i** (\*oglu) është formant i mifëfilltë në patroniminë e turqishtes. Ka kuptimin, siç është cekur më sipër: *biri i-*, ngjashëm si arabisht - *bin-*, *sllavisht* - *ov+deminutivi* - *iq*, *-sen* në gjuhët skandinave etj., formante këto që tregojnë prejardhje birërie. Së andejmi, pra nga ndikimi i turqishtes me këtë formant në gjuhën shqipe, paksa të ndryshuar në shqipe -**OLLI** (\*OGLLU), si në veri si në jug pa dallim janë formëzuar disa patronime. Në **VEF** i ndeshim të shënuara 22 raste, ndërsa në FP dalin afro50 shembuj,si: *Afëzollli*, *Afëzollli*, *Ndreçollli*, *Likollli*, *Liçollli*, *Canollli*, *Pacollli* etj.

Edhe lidhur me këtë po theksojmë se formime të reja me këtë prapashtesë, e cila tashmë për emra shqiptarësh as nuk imponohet as nuk motivon, jo vetëm nuk del e këshillueshme, por edhe ato që janë s'ka arsye të mos zëvendësohen me prapashtesën - **AJ**, si: (Aga) Agaj, (Deva) Devaj, (Dema) Demaj, (Paci) Pacaj, (Hoxha) Hoxhaj, por në raste ngulitjeje të mbiemrave të tillë familjarë si Agollli, Devollli, Demollli, Kasapollli, Pacollli, Hoxhollli etj. mund t'i shtohet konstruktit prapashtesa e mirëfilltë shqipe - **AJ**, si Agollaj, Devollaj, Demollaj, Hoxhollaj, e kështu me radhë.

## 22.15. Shembuj me prapashtesën - XHI - XHIU (- ÇI - ÇIU)

Me prapshesën -**XHI** (-**ÇI**) që me sa dimë në turqishte del e specilizuar për formimin e emrave vepruesish, më fort të profesioneve, por ajo ka shtrirje për një destinim të tillë jo vetëm në shqipe, por edhe në disa gjuhë të tjera. Madje në gjuhën tonë del e shtrirë edhe në numër të konsiderueshëm edhe në nënfushën e patronimisë. Në burimet që konsultuam ndeshëm mbi 40 shembuj mbiemrash familjarë me këtë prapashtesë, madje përveç emrave të huazar nga turqishtja, me këtë formant ndeshim edhe emërtime mbi bazë të temave shqipe, si: *qerrexhi- qerrexhiu, qirixhi - qirixhiu* etj. Në të vërtetë, në realitetin tonë gjuhësor pati përpjekje që ende vazhdon që formanti - **XHI** për profesione të zëvendësohet me prapashtesën - **TAR** të shqipes (tipi Jorganxhi - Jargantar, Sahatçi - ortar etj., megjithatë disa prej tyre ende ndeshen në arenë konkurrence e ndonjë ka mbetur si i domosdoshëm në përdorim, sidomos në nënfushën e patronimisë.

Sidoqoftë edhe këto që kanë mbetur në përdorim, sidomos për patronime rekomandohet përshtatja e krejt fjalë-emrit me këtë formant sipas zgjidhjes alternative: së pari, gjithsesi me shquarsinë e njëjësit me - **U**, si b.f.: (Hanxhi) Hanxhiu, (Bostanxhi) Bostanxhiu dhe së dyti, duke pajisur emërtimin me prapashtesën - **AJ**, (*Hanxhi - Hanxhiaj, Bostanxhi-Bostanxhiaj*). Kështu në alternativë del zgjidhja patronimike e emrave të gjinisë mashkullore: *Hanxhiu - Hanxhiaj, Kondakçiu - Kondakçiaj, Bostanxhiu - Bostaxhiaj* etj., ndërkaq për patronimet (emrat e gjinisë femërore) për këtë tip emrash me prejardhje orientale, shquarsia ndryshon. Kujto rastin *Shefki -Sefkiu* ndaj *Shefkije - Shefkija* dhe meqë në gjuhën dhënëse me dallim gjinije (m. Shefkij, f. Shefkije) emrat e tillë dalin pothuaj të përtafërt me trajtat e gjinisë femërore të shqipes (*Shefkij-Shefkije*), atëherë në realitetin tonë gjuhësor ngatërrohen trajtat e shquarsisë që anojnë nga trajtat e gjuhës dhënëse, përkatësisht të gjinisë femërore të shqipes, andaj kjo dukuri rreth lajthitjes së shquarsisë del edhe në patronimet e përfshira në veprën FP që konsultuam.

Po përsërisim se emërtimet e gjinisë mashkullore kurrsesi nuk duhet toleruar me dalë si trajtat e gjinisë femërore. Pra jo: (Haxhi) Haxhia ose Haxhija, (Hallvaxhi) ose Hallvaxhia por vetëm në alternativë (Haxhi) Haxhiu Haxhiaj, (Hallvaxhi) Hallvaxhiu Hallvaxhiaj,

(Sahatçi) Sahatçiu Sahatçiaj, e kështu me radhë. Ndërkaq, siç u pa, vetëm për emrin e gjinisë femërore në trajtën e pashquar del fundorja /- **E**, ndërkaq në trajtën e shquar del - **A**: (Haxhije) Haxhija, (Hallvaxhije) Hallvaxhija, apo jo, por edhe në këto raste zgjidhje alternative për të dyja gjinitë mjafton trajta me - **AJ**, si:

1. **gj. m.:** (Haxhi) Haxhiu - Haxhiaj, (Hallvaxhi) Hallvaxhiu - Hallvaxhiaj;

2. **gj. f.:** (Haxhije) Haxhija - Haxhiaj, (Hallvaxhije) Hallvaxhija - Hallvaxhiaj,

e kështu me radhë. Kështu na mëson rregullla gramatikore. Sidoqoftë, presim që standardologët ta sqarojnë më mirë këtë çështje.

## 22. 16. Shembuj me prapashtesën - LI/u, - LIJ/A

Prapashtesa - **LI** në turqishte, më sa dimë, del e specializuar për formimin e mbiemrave të substantivuar, po edhe në shqipe reflekton diçka të tillë, por në shqipe me këtë prapashtesë të imponuar janë pëftuar edhe disa patronime që në FP dalin mbi 30 shembuj. Rreth formimit të tyre në shqipe vlen konstatimi i mësipërm që u tha për emërtimet me - **XHI**. Kështu për emrat e gjinisë mashkullore del fundorja - **LIU**, ndërkaq për gjininë femërore - **LIJ/A**. Së këtejmi, për ilustrim, po japim tani në dy rubrika, nja gjashtë shembuj në të dyja gjinitë:

### Gjinia mashkullore

### Gjinia femërore

- |     |                    |             |   |            |           |                |
|-----|--------------------|-------------|---|------------|-----------|----------------|
| 1/. | (Sojli) Sojliu     | ose Sojliaj | - | (Sojlje)   | Sojlja    | ose Sojliaj    |
| 2/. | (Qoseli) Qoseliu   | “ Qoseliaj  | - | (Qoselje)  | Qoselja   | “ Qoseliaj     |
| 3/. | (Sevdali) Sevdaliu | “ Sevdaliaj | - | (Sevdalje) | Sevdalja  | “ Sevdaliaj    |
| 4/. | (Nishli) Nishliu   | “ Nishliaj, | - | (Nishlje)  | Nishlijna | “ Nishliaj     |
| 5/. | (Ymerli) Ymerliu   | “ Ymerliaj  | - | (Ymerlje)  | Ymerlija  | “ Ymerliaj     |
| 6/. | (Tepeli) Tepeliu   | “ Tepeliaj  | - | (Tepelje)  | Tepelja   | “ epeliaj etj. |

## 22.17. Shembuj orientalizmesh me - I fundore

Po ashtu nëpëmjet gjuhës turke në gjuhën tonë kanë hyrë një serë antroponimesh me -I fundore, Siç e kemi vërejtur në analizat e mëparshme rreth emrave të përveçëm me origjinë orientale, numri i tyre në të dyja gjinitë është i konsiderueshëm. Kujto tipin: Avdi e Avdije, Sami Samije Shefki Shefkije, Nuri Nurije etj. Disa prej tyre sipas burimeve që konsultuan dalin të formëzuar edhe si patronime.

Edhe këta sikurse dy tipat e mësipërm me prapashtesat - **XHI** dhe - **LI** u shtrohen rregullave të njëjta të zhvillimit e zgjidhjes. Pra, jo në gjininë mashkullore në trajtën e shquar Avdia ose Avdija, Alia ose Alija, por vetëm me -U shquese: Avdiu, Aliu, ashtu si edhe Kadiu, Myftiu, Efendiu etj., ngase sipas normëzimit të shqipes shquarsia me - **IJA** ose - **IA** asocionon gjininë famërore sepse në gjininë femërore emrat e tillë në njëjës in e pashquar marrën fundoren - **JE** Avdije, Alije, Shefkije, ndërsa në trajtën e shquar marrin - **A**. Pra, sipas rregullit emrat e tilla në asnjërën gjini nuk marrin fundore as - **IA** as **IJA**, por - **U** në gjininë mashkullore dhe - **A** në gjininë femërore.

Së këtëjmi duhet ngulmuar në këtë rregull-zgjidhje dhe asesi ndryshe, pa marrë parasysh trajtat e përfutuara aktualisht sipas shqiptimit të gjuhës dhënëse ose praktikës së përzierjes së trajtave.

### Përmbledhje

Për mendimin tonë del e nevojshme të përsëritim vërejtjen që e kemi cekur veç e veç për shembujt me - **XHI**, - **LI** dhe - **I** fundore me prejardhje orientale, ngase në realitetin tonë ashtu si edhe në FP nuk është respektuar shquarsia dhe dallimi i gjinisë, siç rekomandohet gramatikisht, që shprehet me të drejtë studiuesi dr. Nuhi Veselaj. Studiuesi në fjalë me delikatesë e profesionalizëm paraqet disa mangësi të Bidollarit që duhet bërë përmirësime në drejtim të shquarsisë dhe dallimit të gjinisë. Pikërisht për këtë fakt e cek jo edhe kalimthi edhe studiuesi Ramadan Asllani, i cili duke konstatuar lashtësinë e prapashtesës - **AJ** për këtë

destinim në të gjitha trojet shqiptare shënon për ilustrim edhe këto raste alternative: Bici - Bicaj, Ceka - Cekaj, Vrana - Vranaj (shih: zsh. 29.IX.2008.)

Ç'është e vërteta, në realitetin tonë gjuhësor, në kontekst të caktuar ndikimi i gjuhës turke-arabe, është tejet i ndjeshëm për këta tipa emrash, sidomos lidhur me gjininë mashkullore, ngase kemi të bëjmë me faktin se trajtat e tilla në gjuhën dhënëse marrin fundoren “- **IJ**” në gjininë mmashkullore, që në gjuhën tonë fundorja e tillë reflektohet me - **i** të theksuar në trajtën e pashquar: *Hanxhi, Bostanxhi, Kondakçi, ose Ymerli, Sevdali, Nishli, ose Nuri, Bafti, Kadri*, e cila nën ndikimin e gjuhës dhënëse në realitetin tonë kemi raste të mosdallimit as të gjinisë as të shquarsisë, kështu po përdoret eptim i ngjashëm për të dyja gjinitë si për patronimin në gjininë mashkullore ashtu edhe për atë femërore.

Me fjalë të tjera, në realitetin tonë gjuhësor një formë e tillë shquarsie po përdoret dy mënyrash me - **IA** ose - **IJA** fundore: (Haxhi) Haxhia ose Haxhija, (Sevdali) Sevdalia ose Sevdalija, (Nuri) Nuria ose Nurija, në vend se të shquhen me - **U** fundore: Haxhiu, Sevdaliu, Nuriu, etj.

## **KREU XIII**

### **23. Patronimet me fundoret e imponuara: - E, - O, - I, dhe -A, e - Aj dhe zgjidhja alternative me shquarsi ose me prapashtesën - AJ**

Një ndër çështjet që kemi vënë re dhe i kemi prekur në analizë si të diskutueshme lidhur me emrat në funksion patronimi është edhe dukuria që ka të bëjë me imponimin e fundoreve - **E, - O, - I** edhe -**A** e - **A/J** në funksion shquarsie. Në të vërtetë, shembujt me këto fundore imponohen si trajta të pakonsoliduara sa i përket gjinisë dhe shquarsisë. Me sa

hetuam një dukuri e tilla që ishte më e theksuar në viset jugore të Shqipërisë sot nuk ka mbetur më shtrirje lokale, andaj ne po i trajtojmë paksa shembujt e tillë me këto fundore si trajta me shquarsi të imponuar.

### **23.1. Shembuj me fundoren - E në temë**

Kur është fjala te ky tip emrash zakonisht në dukje të natyrës femërore, që në FP dalim me dhjeta shembuj të imponuar si patronime dy trajtash të shkallës së parë, që ne i ndamë në tri grupe, **së pari** ato me **-E** fundore (trajtë e pashquar), **së dyti**, ato me **-JA** (trajtë e shquar) dhe **së treti**, shembuj e shënuar në të dyja trajtat e shquarsisë:

#### **a/. Shembuj me - E fundore (trajtë e pashquar):**

*Çamçe, Jaçe, Gongje, Tole, Babe, Begzade, Dane, Pepe, Babe, Baçe, Dale, Dajçe, Dane, Çamçe, Dre, Late, Mile, Saçe, Kopaçe, Çylçe, Shuke, Çule, Edike, Sulçe, Vançe, Zote, Duke, Bashe, Cele, Tode., Teme, Goge, Kame, Lale, Sine, Muhe, Naçe, Stase, Rodhe, Gonxhe, Pogaçe, Qole, Qyqe, Tole, Zeze etj.*

#### **b/. Shembuj vetëm në trajtën e shquar si:**

*Shytja, Ujkja, Jekja, Qordja, Ndocja, Baçja, Dakja, Çerpja, Çezmja, Dulja, Brahja, Ibrja etj.*

**c/. Shembuj të shënuar në dy trajta shquarsie, si:** *Braçe Braçja, Gjoke Gjokja, Cufe Cufja etj.*

Kjo dukuri që nuk është e re edhe pse vjen nga tradita, mbetet çështje e diskutueshme, jo pse trajta e tillë me **-E** fundore si temë emërore shërben për të dyja gjinitë, por për faktin se trajta e shquar, sipas burimeve që konsultuam del e shënuar në numër të konsiderueshëm dhe e ndihmuar nga rregulla gramatikore, mendohej se do ta mbizotëronte, por, si duket një praktikë e tillë e përdorimit të trajtës së shkurtër nuk është pakësuar, përkundrazi ndërkohë edhe është shumuar.

Kështu jo vetëm në FP, por kemi vënë re edhe burime të tjera të ditës si në *Listën e kontabilitetit të miratuar* (Tiranë) ndër 503 emra patronimesh me **-E** fundore ndeshëm afro 10 shembuj patronimesh, si p.sh. *Bege, Dule, Kore, Jançe, Mane, Take, Mançe, Qojle,*

*Saqe, Sheme* që asnjëri nuk përkon plotësisht me shembujt e mësipërm, por edhe aty (në atë listë) ndeshëm po ashtu trajtat me -JA: *Çurbja, Dedja, Zenja, Benja, Xhija, Daja, Resnja*.

Së këtëjmi, edhe pse mendohej se trajta e shquar e emrave të tillë do të mjaftonte për arsyen që e shprehëm më sipër, faktet na bëjnë të mendojmë se zgjidhja e kësaj çështjeje nuk është aq e thjeshtë, andaj standardologët duhet të kërkojnë zgjidhje më të përshtatshme. Për të pasur edhe më të qartë problemin, ne me qëllim po shënojmë disa shembuj të këtij tipi në tre rubrika, si:

- |     |             |        |     |         |   |             |                |
|-----|-------------|--------|-----|---------|---|-------------|----------------|
| 1/. | (X ose X-e) | Babe   | ose | Babja   | - | (X ose X-e) | Babaj;         |
| 2/. | “           | Zote   | “   | Zotja   | - | “           | Zotaj;         |
| 3/. | “           | Duke   | “   | Dukja   | - | “           | Dukaj.         |
| 4/. | “           | Çamçe  | “   | Çamçja  | - | “           | Çamçaj         |
| 5/. | “           | Gonxhe | “   | Gonxhja | - | “           | Gonxhaj        |
| 6/. | “           | Dake   | “   | Dakja   | - | “           | Dakaj (Dakjaj) |

Kështu përveç zgjidhjes alternative: *trajta e shquar/prapashtesa -AJ*, tash po del në konkurrencë alternative edhe trajta e pashquar me -E ndaj trajtës së shquar me -JA. Sa u shtrua më sipër standardogët kanë mundësi të marrin qëndrimin e duhur që sa më natyrshëm ta zgjidhin këtë çështje, të rekomandojnë trajtën e pashquar ose atë të shquaren, por si zgjidhje alternative në rezervë gjithsesi mbetet trajta me prapashtesën -AJ, Mirëpo kur është fjala te zgjidhja me alternativën -AJ, kemi vërejtur në FP dalin nja 2 raste që zgjidhja me prapashtesën -AJ, nuk është bërë sipas propozimit tonë, por mbi bazë të trajtës së njëjësit të shquar të gjinisë femërore. Krahaso propozimi ynë: f. **Dake Dakja Dakaj, Dede Dedja Dedaj**, ndërkaq aty (f. 80 e 84) jepet kjo zgjidhje f. **Dake Dakja Dakjaj, Dede Dedja Dedjaj**. Ne mendojmë se një zgjidhje e tillë **Dakjaj, Dedjaj** për emrin në gjininë femërore edhe pse sa i përket fjalëformimit është përfitim i drejtë, del fare e panevojshme kuptimisht, sepse, siç e kemi arsyetuar edhe më parë trajta **Dakaj, Dedaj** mjafton për të dyja gjinitë e patronimit. Ndërkaq, në praktikë si paraqitje e konceptit të shkallës së parë: trajtja e pashquar si edhe e shquara, siç u tha, mbetin në konkurrencë për të njëjtin koncept.

Sidoqoftë, standardologët e kanë në dorë rekomandimin për zgjidhjen përfundimtare të këtij rasti të imponuar, dukuri kjo e brendshme, por e shkaktuar si po thuhet nën ndikim e gjuhës fqinje jugore.

## 23.2. Shembuj me fundoren - O në temë

Në gjuhën tonë imponohen disa formime patronimesh nga emrat me fundoren -O në temë në trajtën e pashquar, po në funksion si të ishte trajtë e shquar, si: *Çero, Llazo, Muço, Miho, Kuko, Spaho, Vaso, Vito, Zako, Ago, Aliko, Birko, Çelo, Demo, Diko, Leo, Fundo, Garo, Jako, Hanko, Lito, Lolo, Niko. Sako, Temo, Toto, Ziko, Zeqo, Janko* etj. - numri i të cilëve, sipas FP së kalon 50-shin. Disa shembuj dalin edhe në alternativë edhe trajtën e shquar si: *Mero- Meroja, Kapo-Kapoja, Vito-Vitoja. Simo-Simoja, Ago Agoja. Ibr -Ibroja, Gjoko-Gjokoja* etj. Si veçori e këtij nëntipi emrash është se nga shquarsia nuk dallohet emri sa i përket gjinisë natyrore, siç e kemi parë, kur trajtuam emrat si antroponime e toponime.

Për të kuptuar më mirë zgjidhjen alternative edhe për patronime të tilla po i shënojmë për ilustrim nja 6 raste, sipas njohjes vetjake, 3 të gjinisë mashkullore dhe 3 të gjinisë femërore:

1/.	(X ose X-e)	Llazo ose Llazoja	-	(X ose X-e)	Llazaj
2/.	“	Niko ose Nikoja	-	“	Nikaj
3/.	“	Diko ose Dikoj	-	“	Dikaj
4/.	“	Vito ose Vitoja	-	“	Vitaj
5/.	“	Maro ose Maroja	-	“	Maraj
6/.	“	Kato ose Katoja	-	“	Kataj



Lexuesi i nderuar mund të gjykojë lehtë cili variant i rubrikës së parë del më i mbështetur si patronim, qoftë gramatikisht, qoftë sipas natyrës së gjuhës shqipe, trajta e shquar apo ajo e pashquara? Është e vërtetë, se në burime të tjera si dhe në *Listën e kontabilistëve të miratuar* (Tiranë), ndër 503 shembuj sa ka lista, ndeshëm mbi 40 patronime me **-O** fundore dhe asnjë të shquar me **-JA**. Kjo flet mjaft për shtrirjen e emrave të tillë aktualisht në funksion patronimi. Sidoqoftë, ne mendojmë se kjo dukuri nuk duhet injoruar, por as joshur shumë, kur kemi para vetes me dhjeta variante të tjera me të njëjtën rrënjë emërformuese dhe me prapashtesa të tjera të sprovuara të shqipes, andaj lypset gjykuar cila mund të jetë zgjidhja më mirë. Kështu themi sepse zgjidhja e parë alternative që ofrohet në dy trajta, ajo mund të shprehet edhe në mënyra të tjera, p.sh.: Në Gegni zakonisht pëdoret nyjëmbaresa **-A**: Llaza, Nika, Dika, për gjininë mashkullore (si emra malësorësh), përkatësisht edhe më natyrshëm po me **-A** në gjininë femërore si Marë Mara Vitë Vita, Katë Kata, andaj edhe ekziston mundësi përzgjedhjeje. Po, s’do mend, emërtimi me **-AJ**, është më afër nesh se në të gjitha versionet asesi nuk mund të jetë i qortueshëm. Sidoqoftë, presim rekomandimin e standardologëve edhe për këtë pikë që të japin mendime vendimprerëse.

### 23.3. Shembuj me -I të imponuar në temë

Imponohen si patronime edhe disa shembuj me -I fundore, me shquarsi të paqartë ose të ngurosur ose të pazhvilluar plotësisht. Shembujt e tillë imponohen tri grupesh:

a/. emra diminutivë: **Bici, Budi, Cali, Cani, Bazi, Cici, Feçi, Jani, Jorgji, Geci** etj.

b/. emra përkdhelës: **Cimi, Uki, Gaci, Demi, Babi, Ejlli, Hoxhi, Agi, Ylli** etj.

c/. emra me huazim transfer ose nën ndikimin e gjuhëve të huaja, si: **Meri, Oli, Foti, Eski, Kimi, Mili, Andi, Gjyli, Meli** etj.

Po i shënojmë sa për ilustrim nja 6 shembuj krahas zgjidhjes alternative me **-AJ**:

1/.	(X ose X-e)	Bici	-	(X ose X-e)	Bicaj
2/.	“	Geci	-	“	Gecaj
3/.	“	Budi	-	“	Budaj
4/.	“	Gyli	-	“	Gylaj
5/.	“	Meli	-	“	Melaj
6/.	“	Gili	-	“	Gilaj

Ka mendime që emrat e tillë të cilësohen me shquarsi të plotë, duke cilësuar trajtën e pashquar pa fundoren **-I: Bic Bici, Gec Geci, Bud Budi, Gyl Gyli, Mel Meli, Gil Gili**, por edhe ky farë zberthimi nuk ndihmon në identifikimin e gjinisë, madje ç’është e vërteta, shembujt e tillë në praktikë përdoren vetëm në trajtën e ngurosur me **-I** fundore. Sidoqoftë, zgjidhja alternative e emrave të tipit të tillë si patronime është: **Geci Gecaj, Gili Gilaj, Kili Kilaj**, e kështu me radhë.

Pra problemorë dalin emërtimet sa i përket gjinisë, ngase trajtëformimi sipas shquarsisë nuk e përcakton këtë kategori. Kjo ka të bëjë jo vetëm për raste të huazuara transfer, por edhe për raste vendëse të përvetësuara nga tradita, po edhe nga *moda* nën ndikimin e reklamave të rastit. Sidoqoftë, edhe për rastet e tilla ofrohet zgjidhja alternative, madje le të vlerësohet në këtë shqyrtim cilat dalin më të qëndrueshme trajtat me nyjëmbaresën fundore të imponuar apo ato me prapashtesën **-AJ**?

#### **23. 4. Formimet e patronimeve me fundoren - A e A/J të imponuar dhe prapashtesa - AJ**

**Si pikë** më vete po e trajtojmë paksa involvimin e prapashtesës patronimformuese te shembujt mbi temë po me **-A** e **-AJ** fundore, dukuri kjo homonime që shfaqet në dy mënyra: nga emrat toponimikë të prejardhur mbi bazë antroponimie me mbaresën **-A** apo prapashtesën **-AJ** dhe **së dyti**, te disa shembuj të huazuar kryesisht nga turqishtja po me fundoren **-AJ** në temë.

### 23.5. Nga toponimet me -AJ fundore

Siç dihet nga patronimet (tejantroponimike) me **-AJ** janë formuar në shqipe një mori vendbanimesh, madje edhe analogjikisht pa pasur bazë të mëparshme as antroponimi, as patronimi, si b.f. nga zgjidhja me alternativë **Vata Vataj** thonë se doli si trajtë mbizotëruese **Vataj**, por njëherazi doli edhe vendbanimi i sforcuar po në trajtën **Vataj?!**

Edhe pse për ne një ndërmarrje e tillë te toponimet ishte e qortueshme, kjo mënyrë formimi analogjikisht ka vazhduar pothuaj në mënyrë arbitrare si në Shqipëri më parë, ashtu edhe në Kosovë, mbase me tepri. Kështu në gjuhën tonë është shtuar shumë numri i oikonemeve me **-AJ**, duke krijuar homonimi me patronimet mbi të njëjtën trajtë. Madje në rast shpërnguljeje nga këto vendbanime është shtuar e po shtohet në mënyrë të përligjur edhe numri i patronimeve mbi këtë bazë.

Andaj kur është fjala te dallimi të patronimit *të vjetër* shndërruar në toponim dhe në anën tjetër nga toponimi në patronim mbiemri i ri (si patronim) shkakton njëfarë problemi kontekstor që mund të cilësohet edhe si çështje e diskutueshme, ngase në këtë raport po shkaktohen pa qartësi homonimie. Sidoqoftë, ne, duke e parë këtë dukuri në raportin dy ose tredimensional: **emërtim patronimi/emërtim vendbanimi/emërtim patronimi**, po mbi të njëjtën temë prodhuese, për këtë çështje do të shprehim mendimin tonë, mbase guximtarisht.

Ne mendojmë se aty ku homonimia del e vrazhdë d.m.th. kuptimisht paraqet vështirësi të dukshme, atëherë mendojmë se trajta e toponimeve të ngulitura si Ferizaj, Skënderaj etj. mos të preket, por për t'i ikur homonimisë patronimit mbi bazë toponimi mund t'i shtohet prapashtesa **-AJ**, si p.sh.:

*Familja Ferizaj e shpërngulur para sa vitesh në Elbasan është kthye në Ferizaj, por tash e ka modifikuar mbiemrin me një –AJ shtesë Ferizaja.* Sidoqoftë, sipas nesh kjo është mundësia që propozohet si zgjidhja më e kapshme.

### 23.6. Nga huazimet me -AJ fundore

Po kjo zgjidhje me shtesë të formantit **-AJ** është dhënë në FP për tre shembuj me

-**AJ** fundore të huazuar nga turqishtja: *Jaja, Daja dhe Jahaj*, të cilët si patronime dalin në trajtën e shquar kështu: **Jajaj, Dajaj Jahajaj**( f.397), dukuri kjo që mund të praktikohet edhe në të gjitha rastet ku tema përfundon me -**A/J** ose -**A** të theksuar, siç janë edhe patronimet e tjera me prejardhje nga tuqishtja: *Çullaj e Çullhaj, Mirallaj, Mullaj, Qehaj, Ustaj, Fejzullaj dhe Allaj*, të cilat në shqipe më fort shqiptohen edhe me një -**A** fundore të theksuar në trajtën e pashquar ose me shquarsi dyvariantëshe, si **Mulla Mullaja dhe Mulla Mullai**, por që patronimi del: **Mullajaj**.

Po një zgjidhje të tillë kanë edhe rastet, sipas gojës *popullore*, po sipas nesh jo të drejta shkrimisht: *Avdijaj (Avdija), Baftijaj, Delijaj, Haxhijaj, Ndrejaj* (Ndreja), ngase gramatikisht emrat e tillë shquhen me -**U** të gjinisë mashkullore, si Avdiu, Ndreu, Baftiu etj. sepse siç e përmendëm më parë kemi të bëjmë formën gramatikore të shquarsisë së emrave femërorë, por që në të folmet popullore ngatërrohet gjinia për shkak të huazimit transfer.

Sidoqoftë, shembujt e tillë të gjinisë mashkullore si emra të përgjithshëm në njëjës in e shquar kanë këtë zhvillim: mirallaj mirallaji, mullaj mullaji, qehaj qehaji, ustaj ustaji allaj allaji, andaj edhe në funksion të emrit të përveçëm frymori marrin të njëjtat mbaresa shquarsie dhe së këtejmi zhvillimi e shumësit të tyre normalisht gjen zgjidhje me mbaresën -**Ë** Mirallaj Mirallaji (disa) Mirallajë Mirallajët, (Mullajë Mullajët, Qehajë Qehajët, Ustajët, Allajë Allajët), ndërkaq për t'u shndërruar në funksion të mirëfilltë patronimi normalisht mund ose duhet të marrin prapashtesën e specializuar -**AJ** mbi temën me konsonantin fundor -**J**, si: (familja) Mirallajaj Mirallajajt, Qehajaj Qehajajt, Ustajaj Ustajajt, Ajajaj Ajajajt.

Së fundi, shembujt në shqyrtim me -**AJ** fundore, qoftë si toponime, qoftë si antropopnime edhe pse përputhen dy trajta të njëjta njëra si fundore e temës e tjetra si prapashtesë, kuptimi nuk lejon të veprojë fenomeni e haphologjisë, andaj formanti -**AJ** si prapashtesë, tipi Ferizajaj, është krejtësisht i arsyeshëm, për gjininë mashkullore si edhe atë femërore.

## KREU XIV

### 24. Kujdesi i thjeshtëzimit e konsolidimit të “Patronimeve të shqiptarëve” sipas zgjidhjes së mundshme

Nisur nga fakti se emërtimi i patronimit në të shumtën e rasteve në parim ka rëndësi më të madhe kombëtare se vetë emri personal, ngase qëndrueshmëria dhe përfshirja kuptimore e përfaqësimit të patronimit përkatës ka gamë më të gjerë semantike si në vijën vertikale ashtu edhe atë horizontale, në vijim po vargëzojmë disa venerime që mund të quhen si konstatime përmbyllëse rreth *thjeshtëzimit nga pikëpamja drejshkrimo-fjalëformuese të patronimeve në gjuhën shqipe dhe njëherazi edhe si një përpjekje a sugjerim rreth konsolidimit të **patronimisë shqiptare** me ndihmën e zgjidhjes alternative: *trajta e njëjësit të shquar /prapashtesa -AJ*.*

## 24. 1. Rreth thjeshtëzimit strukturor të patronimeve

Rreth thjeshtëzimit strukturor të patronimeve kur është fjala te *patronime shqiptarësh*, po theksojmë se trajta e pashquar nuk vjen në konsideratë, pos rasteve përjashtuese me gjini të ngurtëzuar, sepse patronimi zakonisht vjen në radhë pas emrit përkatës në trajtën e pashquar, andaj logjika e kërkon që patronimi në rrugë zyrtare duhet patjetër me qenë emri në trajtën e shquar dhe se kjo vlen për të dyja gjinitë, andaj sipas nesh janë të patolerueshme ose shumë të diskutueshme, trajtat që ndeshim në FD:

1/. Si p.sh. shembujt: *Isuf, Kovaç, Muharem, Omer, Emir, Pilaf, Resul, Rustem, Sulejman, Memush, Meleq, Ndreka, Nevruz*, e ndonjë tjetër, madje aq më keq kur ka raste si *Faber, Hastopall, Magar* i ndeshim si lema bazë, të cilat për të shërbyer si patronime duhet të merrnin nyjën shquese - **I** ose **U** apo - **A** ose - **JA** edhe më pëlqyeshëm rezervën -**AJ**.

2/. Po në FP, ndeshim nja dy trajta të gjinisë femërore të shënuara jo sipas drejtshkrimit të sotëm si p.sh.: aty trajta e shquar del *Shaban'ja, Zog'ja* në vend: (*Shabane*) *Shaban/ia* ose *Zoge Zog/ia*. Është kjo si vërejtje për normëvënësit tanë, apo jo le të vlerësohet. Sipas normës në fuqi, s'ka arsye të mos respektohet rregulla drejtshkrimore për këtë pikë, edhe pse në shikim të parë, shikuesit mund t'i shkojë mendja tek patronimet mbi bazë të ndonjë *toponimi me i të theksuar*, si (*Shabani*) *Shabania*, (*Zogi*) *Zogia*. Ne besojmë se sqarimi do të dilte nga vetë konteksti, sepse në ato dy raste kemi të bëjmë me *matronime*: *Shabane Shaban'ja* (*Shabanja?!*) – *Shaban/ia Zoge Zog'ja* (*Zogja?! Zogi/a?*) – *Zog/ia* – *Zogia*.

3/. Në vend që të mjaftonte trajta me -**U** ose me -**AJ** (*Spahiu Spahiaj, Zalliu Zalliaj Saraçiu Saraçiaj* ose *Saraç Saraçi - Saraçaj*, aty del e përzgjedhur trajta me -**n**- epentetike ose *shtuese në mes dy -i-ve* si p.sh. *Spahini, sikurse edhe Zallini, Saraçini, dukuri kjo që* lypset sqaruar, kemi të bëjmë me një -**n**- epentetike apo me huazim transfer. Fundja, edhe në qoftë një përfitim të tillë si rast transfer ne e quajmë të panevojshëm, kur tema fjalëformuese bazë në gjuhën tonë **saraç saraçi, zall zalli, Spahi Spahiu**, është e qartë dhe motivon.

4/. Duke respektuar drejtshkrimin e drejshqiptimin ai dhe shquarsia e fjalëve si kriter fjalori drejtshkrimor normativ, atëherë vetvetiu trajtat si mollagjia, qerragjia, duhen shkruar sipas standardit m. Mollaxhiu, Dardhaxhiu; f. Mollaxhija Dardhaxhija etj. Pastaj jo Shehi po Shehu, jo Maloki po Maloku, jo Hazbi po Hazbiu, jo Qerregjia po Qerrexhiu, jo Terezi, po Terezia ose Tereziu (Tereziaj) etj., pa marrë parasysht lokalizmat.

5/. Ç'është e drejta, mendojmë se në patronimet e sotme, edhe pse nuk kërkohet krejtësisht të ndryshojë gjithçka nga imponimet e së kaluarës, çka, hë për hë, është e pamundur, megjithatë, duhet ndihmuar njerëzit që sadokudo edhe kjo veprimtari të kthehet në rrjedha normale gjithnjë duke respektuar zgjidhjen alternative më të pranueshme për strukturën e shqipes. P.sh. nëse kemi të bëjmë me përzgjedhjen e patronimit për një koncept që lidhet me mbiemrin Marë Mara dhe kur kemi parasysht 7 mënyra normale të zgjidhjes që ofrohen nga shkalla e parë, si: (iks) Mara. (iks) Maro, (iks) Maroja, (iks) Mare, (iks) Marja, (iks) Maria e (iks) Marija, atëherë si thjeshtëzim mund të vijë prapashtesa speciale me **-AJ: Maraj**, trajtë kjo, e cila në bazë të temës së mbështetur prodhuese ka tagër me i zëvendësue gjithsesi pesë trajtat e para, por edhe dy të fundit mund t'i zëvendësojë në bazë të kuptimit që e jep vetë emri përkatës.

6/. Ne e shohim si përpjekje, po s' dimë sa mund të jetë e mjaftueshme për thjeshtëzim veprimi i prof. Ç. Bidollarit, rreth përcaktimit të lemave, i cili me sa pamë, vendin kryesor natyrshëm u ka dhënë shembujve me **-I** fundore mbi 650 shembuj, me **-U** fundore mbi 160. Me **-A** afro 250, me **-JA** afro 50, ndërkaq me **-AJ** përafërisht sa edhe shembujve me **-O** fundore nga 40 shembuj dhe me **-E** fundore ku shembujt arrijnë rreth numrit 20.

7/. Sidoqoftë, ne pa hyrë në hollësi të çështjeve të diskutueshme, edhe pse nuk e shohim gjithçka pozitive kemi vënë re se në **Listën** përkatëse të 100 patronimeve më të përdorura në Shqipëri, që sa i përket fundoreve rezultati del kështu: me **-i** fundore janë 48 shembuj, me **-u** 6, me **-a** 31 dhe me **-ja** vetëm 1 rast, ndërsa me prapashtesën speciale **-aj** 3 shembuj, ndërkaq me **-o** fundore të imponuar 7 shembuj si dhe me fundoren **-e** të imponuar 4 raste-gjithsej 100 shembuj. Mirëpo në *Listën e kontabilistëve të miratuar* dalin mbi 50 patronime me prapashtesën **-AJ** dhe shumica prej tyre me orgjinë nga qytetet e Jugut të Shqipërisë. Edhe ky fakt flet për zgjerimin e përdorimit të prapashtesës **-AJ**, edhe

pse për ne paraqitet vetëm si zgjidhje alternative. Shikuar edhe nga ky aspekt rastet me fundoret e imponuara me **-O** dhe **-E**, edhe pse dalin të diskutueshme, konsiderohen me shquarsi të ngurosor. Gjithsesi gjasat janë që nëse ekzistojnë e aktivizohen bërthamat shkencore përkatëse, atëherë edhe gjendja e patronimeve do të jetë më e mirë, sepse në njëfarë mënyre do ta ketë mbikëqyrjen ose përkujdesjen shoqërore e shkencore.

## **24. 2. Përmbyllje rreth konsolidimit sipas zgjidhjes alternative: emërorja e njëjësit të shquar / prapashtesa – AJ**

Nga tema e shtjelluar në këtë krye të kësaj pjese të punimit konstatimi i nyjëmbaresave të njëjësit të shquar: **-I, -U, -A, -JA** në funksion patronimi ishte i domosdoshëm, edhe pse gramatikisht thuhet se dy nyjet e para (i dhe u) i takojnë shquarsisë së emrit të gjinisë mashkullore të numrit njëjës dhe dy të dytat (a dhe -ja) emrit të gjinisë femërore, nga shembujt konkretë u pa se një ndarje e tillë për patronimet vllente mbase vetëm në parim, sepse asnjëra nga nyjëmbaresat e tilla nuk i përmbahej plotësisht destinimit sipas rregullës gramatikore të përmendur. Vërtet me **-A** fundore prinin patronimet e gjinisë mashkullore, po edhe të tjerat nuk i rrinin në besnikëri gjinisë së destinuar, dhe së këtejmi doli sheshit se edhe raporti i tyre ndërgjinisitor meriton një trajtim të veçantë, por sidoqoftë në trajtimin tonë roli i prapashtesës **-AJ** zuri vend të veçantë, si formant jo vetëm i specifikuar, por edhe si i specializuar për formimin e patronimeve (mbiemrave) në gjuhën shqipe, andaj e pamë të arsyeshme që këtu t'i përsërisim ose t'i ravijëzojmë disa nga veçoritë e saj për këtë destinim dhe kjo të shihet domosdo gjithnjë në raport alternativ ndërlidhur me emëroren e njëjësit të shquar të emërtimeve në shqyrtim. Po i radhisim pra, disa nga konstatimet e vënerimet tona për këtë në të mirë të shndritjes së kësaj çështjeje.

**Së pari**, të gjithë studiuesit duke filluar që nga Xhuvani e Çabej e deri në ditët e sotme e kanë konstatuar autoktoninë e prapashtesës **-AJ**, qoftë si anase, qoftë të përvetësuar që në lashtësi dhe njëherazi kanë vënë re specifikimin e këtij formanti pikërisht për emërtimin e patronimeve.



**Së dyti**, emërtimet me këtë formant, kishin edhe kanë si në të kaluarën edhe aktualisht shtrirje në të gjitha trevat shqiptare dikur më tepër në veri tashti si në jug si në veri.

**Së treti**, ndonëse është shfrytëzuar njëherë rregullisht e tash së voni edhe arbitrarisht prapashtesa **-AJ** për formimin e vendbanimeve (oikonimeve), sipas interpretimeve të gjuhëtarëve, përparësia fillimishtë i takon antroponimit të formëzuar si patronim, prej nga ka dalë emërtimi i vendbanimit e jo e kundërta, por me rastin e shpërnguljeve etj. ka gjasa të shumta që edhe toponimi i tillë të shërbejë për përtëritjen e patronimeve me këtë formant. Një realitet të tillë e kemi të njohur me muhaxherët në Kosovë, por edhe në Shqipëri është e njohur një traditë e tillë e trashëguar që nga epoka antike.

**Së katërti**, siç e pamë kjo prapashtesë shërben edhe për zëvendësimin e prapashtesave vendëse, të cilat zakonisht dalin të specifikuar për nënfusha të tjera semantike, ndërkaq për këtë destinim e kanë të humbur konkurrencën nga prapashtesa **-AJ**.

**Së pesti**, më mirë se asnjë formant tjetër shërben për zëvendësimin ose rikthimin e së drejtës së shkelur nga administratat e huaja, të cilat në vend të saj ose elementeve të tjera shqipe, imponuan prapashtesa me prejardhje të huaj, siç janë prapashtesat identifikuese me prejardhje turke e sllave (serbe, bullgare) e të gjuhëve të tjera.

**Së gjashti**, prapashtesa **-AJ**, siç e pamë ofrohet përherë e gatshme si mjet rezervë në zgjidhje alternative krahas formimeve të patronimeve me një-mbaresën përkatëse të njëjësit të shquar të emrit përkatës (-i, -u, -a dhe -ja) ose edhe të shumësit të shquar, si ademovitet (ademajt) muzakët (muzakajt), kastriotët (kastriotajt) etj.

**Së shtati**, ky formant shërben edhe si mjet ofruar për secilin patronim të të gjitha trajtave, siç u cek paksa më sipër, si element shtesë sforcuese, si b.f. Bajraktari Bajraktaraj, Gjinali Gjinalaj, Devolli Devollaj etj. dhe në rast nevojë ndihmon dallimin e homonimisë përkatëse, siç janë edhe emërvendet të ngulitur me këtë formant, si Skënderaj Skënderajaj, Mirallaj Mirallajaj etj.

**Së teti**, çka është me shumë rëndësi të dihet specializimi i kësaj prapashtese për destinim patronimi, vërtetohet edhe nga ky aspekt, se të gjitha trajtat e tjera mund të përplotësohen, ndryshohen, zëvendësohen me këtë formant, ndërsa emërtimi me formantin -

**AJ** qëndron stabil, ngase asnjë formant tjetër për këtë destinim nuk mund ta modifikojë ose ta zëvendësojë atë me të njëjtën peshë kuptimore. Së këtejmi, pra, ku emri me këtë prapashtesë, duke mos pasur kurrfarë nevojë për përplotësim të vetvetes në të vërtetë e tregon veçorinë e tij të veçantë si formant i specializuar për destinim patronimi.

**Së nënti**, duhet ngulmuar jo vetëm për formimet e patronimeve me këtë prapashtesë, por edhe për formëzimet me njëmbaresat përkatëse: **-i**, **-u** dhe **-a** e **-ja**, sepse, si formimet me njëmbaresat përkatëse të shquarsisë ashtu edhe formimet me **-AJ**, si zgjidhje alternative tregojnë forcën atavike të strukturës formëzuese e fjalëformuese të sistemit vetjak të shqipës. Kjo strukturë, sidomos ajo e shquarsisë që siç e kemi vënë re prapashtesave të huaja si sllave e turke ua ka vënë elementin e vet **-I** ose **U**, duke i hibridizuar ato, prandaj edhe në rrjedhat e tashme e të mëvonshme gramatikanët tanë normëvënës duhet ta sforcojmë zgjidhjen alternative me elemente të shquarsisë së emrit në njëjës in e emërores që ka aq shumë nevojë jetësore gjuha jonë, për ta ruajtur individualitetin e vet. Së këtejmi, në u bashkohemi atyre studiuesve, si Gjovalin Shkurtaç e të tjerë që ngulmojnë jo ta zhdukim shquarsinë e emrave për arsye të ndonjë dukurie të re globaliste e ku ta dimë, por ta ruajmë atë si digë të fortë për mbrojtjen e sistemit optimor të gjuhës shqipe.

**Së dhjeti**, këtë prapashtesë të specializuar për formimin e patronimeve duhet ruajtur nga goditja spontane që po bëhet nga formimi arbitrar i shumësit të disa emrave në kundërshtim me normën në fuqi, siç janë shumësat shpifës, si b. f. çobajt në vend çobanët, politikajt për politikanët, luajt për luanët, katallajt në vend katallanët etj.

Fundi i fundit, po theksojmë se të gjitha rastet me formantet e tjera, që janë me dhjeta e dhjeta, siç u pa, nuk ka nevojë të jenë aktive edhe më për nënfushën semantike të patronimeve, ngase rasti i parë emri, qoftë në gjininë mashkullor në trajtën e shquar me **-I**, **-U** ose qoftë në femërore e mashkullore me **-A** ose **-JA** dhe ai i dyti me **-AJ** po për të dyja gjinitë e emrit përkatës të shndërruar në patronim, mjaftojnë, qoftë për të zëvendësuar eventualisht ekzistueset e diskutueshme, si dhe tendencat që të përvetësohen emërtime gjoja të reja pa kriter, ku s’u dihet as shquarsia as gjinia, madje as kuptimi!

Së këtejmi, të gjitha vënerimet tona prej fillimit e deri këtu le të shërbejnë si konstatime ose sugjerime, së paku orientuese, jo vetëm për kontrollin e kaosit ekzistues terminologjik, por edhe për thjeshtëzimin dhe konsolidimin e duhur të *patronimeve të*

*shqiptarëve* qoftë duke pasivizuar formimet me formantet joadekuate, qoftë në anën tjetër, duke sforcuar e mbështetur zgjidhjen alternative në dobi të formëzimeve me një-mbaresat përkatëse, përkatësisht të formimit me prapashtesën e specializuar **-AJ**.

Kërkojmë nga studiuesit e sidomos nga standardologët që punën e thjeshtësimit dhe të konsolidimit të formëzimit dhe të fjalëformimit të patronimeve ta shpiejnë më tej, ngase kështu kanë vepruar të gjithë kuadrat e gjuhëve të zhvilluara, gjuhë këto që edhe këtë nënfushë të dijes e kanë vënë në binarët e duhur.

Krejt në fund po e theksojmë me plot gojë se trajta me **-AJ** pas këtij shkrimi, edhe pse duket pak si e fryrë, gjithsesi ka me pasë të ardhme edhe më të mirë se trajtat e tjera me prapashtesim për emërtimin e patronimeve, sepse do të respektohet më mirë si formant i specializuar, siç është, e i cekur këtu, jo vetëm sa me lag gojën, por me meritë. Me meritë, ngase, si e tillë, prapashtesë e formëzuar historikisht për këtë destinim, andaj duhet ta shfrytëzojmë për të njëjtin funksion si model të gatshëm. Së këtejmi presim që edhe më qartë do ta vlerësojnë e rekomandojnë institucionet tona kompetente, me në krye standardologët e gjuhës sonë.

Në hyrje të këtij kreu sipas historikut të patronimeve u konstatua se që në Kinën e lashtë në kohën e materialkatit, kur gratë zinin pozitën drejtuese në administrimin e punëve të fiseve etj. emërtimet familjare bëheshin sipas emrave të grave, por ndërkohë pas ndryshimeve shoqërore, kur për administrimin shoqëror burrat zunë pozitën kryesore, periudhë kjo e patriarkatit, atëherë edhe emërtimet familjare bëheshin sipas burrave të familjeve, përkatësisht të klaneve të shquara, vëllazërisë, fisit, krahinës, principatës etj. Po një rrugë të tillë zhvillimi, pak a shumë, patën patronimet edhe te popujt e tjerë të botës e të Europës. Pra, kështu e patën, edhe paraardhësit e gjuhës sonë, kur kemi parasysh ndërlidhshmërinë pellazgo-iliro-arbërore të shqiptarëve, periudhë që daton që nga epoka paraantike dhe qëndroi dhe hapëroi deri në ditët e sotme. Në të vërtetë, kjo ndërlidhshmeri për një periudhë mjaft të gjatë që mbuluar me një tis pluhuri të përmjegullt me plot errësirë subjektive, por që fatmirësisht po zbardhet dita më ditë me fakte gjithnjë e më bindse nga studiuesit tanë e të huaj. Mirëpo në punimin tonë e kemi mbështetur në argumente kohësisht më të përkapshëm. Në shfrytëzuam materialin e përfshirë në dy vepra të studiuesve tanë: Jusuf Shpuza *“Vëzhgim për emrat familjarë të shqiptarëve”*, Shkodër (1998) dhe Çlirim Bidollari *“Fjalor i patronimeve të shqiptarëve”* Tiranë (2011).

Natyrisht ne duke pohuar dhe falenderuar ndihmesën teorike dhe praktike të autorëve të këtyre veprave dhe të tjerëve u përpoqëm të vëmë në pah jo për plotësimin e historikut po pasqyrimin e realitetit tonë të sotëm sipas **zgjidhjes alternative**, që ka të bëjë me veçoritë formëzuese dhe fjalëformuese të emërtimeve të “**patronimeve të shqiptarëve**” që aktualisht, nocion ky që e kemi shtjelluar me krerët e paraqitur të studimit në fjalë që në përgjithësi dhanë një dritëhedhje me përplasje shkencore që sipas mendimit tim ishin mjaft frytëdhënëse. Një debat i tillë shkencor e kërkues s’ka se si mos të quhej ndryshe pos përparim drejtshkencor e kombëtar që është obligim për gjithë studjuesit në drejtim të hulumtimit, që të ndriçojmë sa më shumë shkeljet në drejtim të gjuhës shqipe me degët dhe nëndegët e saja.

**Së pari**, bëme fjalë rreth specifikave që kanë emërtimet e patronimeve në gjuhën shqipe, mbështetur kryesisht në dy veprat e sapocëkura.

**Së dyti**, edhe pa vajtur larg në kohë duke u mbështetur në FP, ku është përfshirë një numër i konsiderueshëm i emërtimeve të tilla, nxorëm mbi 100 shembuj patronimesh me të cilët jo vetëm që dokumentohet identiteti i gjallimit të shqiptarëve dhe të gjuhës shqipe në këto troje që para shek. XIV, por me qartësinë e tyre dhe, shembuj si të tillë janë aq aktualë sa që motivojnë përfitime të ngjashme edhe sot.

**Së treti**, pasi konstatoam se nga pikëpamja drejtshkrimo-fjalëformuese e formëzuese, edhe pse kemi përpjekje stabilizimi, e kemi të trashëguar një mishmash trajtatsh, andaj shtrohet detyrë e ngutshme për mbarështrimin e zgjidhjen e problemeve që dalin në këtë drejtim. Pikërisht në këtë kontekst ne u përqendruam në sqarimin e **zgjidhjes alternative**, veprim i parë ky më i domosdoshëm dhe më i përkapshëm për këtë qëllim, që ndërlidhet me shfrytëzimin nyjëmbaresave emërore të njëjësit të shquar, si zgjidhje e parë dhe në anën tjetër emërtimi me prapashtesën speciale **-AJ**, e cila imponohet si zgjidhje e dytë alternative.

**Së katërti**, pikërisht në këtë pjesë **zgjidhja alternative** del më e qartë rreth përformëzimit të patronimeve në raportin nyjë-mbaresat e emrit në njëjës in e shquar: **I**, **-U**, **-A**, **-JA** ndaj *formimeve me prapashtesë -AJ*, e cila del që moti e specifikuar për këtë destinim, por sipas rrethanave që përjetoi populli ynë nëpër shekuj, pa e gëzuar asnjëherë mëvetsinë shtetërore e bashkimit kombëtar, gjuhës sonë iu imponuan mënyra e formante të

tjera patronimformuese që përveç prapashtesës **-AJ** arrijnë në 50 e sa formante e mënyra të tjera, disa prej të cilave ende mund të quhen konkurruese e disa jo dhe aq. Është vërtetë, sipas shembujve të regjistruar për një koncept në lemën përkatëse ofrohen 40 e sa trajta vetëm për një koncept patronimi, ndërkaq për mbulimin e atij nocioni mjafton një ose në alternativë dy trajta. Ne duke u përqëndruar vetëm në shqyrtime e konkludime rreth zgjidhjes alternative vumë re se trajta e emrit të njëjësit të shquar në funksion patronimimi me nyjën përkatëse të shquarsisë në të dyja gjinitë është zgjidhje konstante e shkallës së parë, ndërkaq specifikimi dhe specializimi i formantit **-AJ** del si zgjidhje alternative e dytë, që padyshim paraqet model favorizues patronimformues për të gjithë tipat e emrave të të dy gjinive. Kështu ky formant mund ose siç u sprovua është i zbatueshëm, qoftë për zëvendësimin me e pa alternativë, qoftë disa fundore të imponuara., qoftë për përplotësimin ose përplotësimin e 10 e sa prapashtesave vendëse, dhe po aq e më shumë me prejardhje të gjuhëve të huaja (turke, sllave e greke etj.)

**Së pesti**, pikërisht dukuria me fundore të imponuara të shkaktuara, qoftë nga zhvillimi i brendshëm i shqipes, qoftë të përfutuara nga ndikimi i jashtëm, u trajtua në nënpjesë të veçantë dhe lidhur me këtë mbetën ende çështje të hapura.

**Së gjashti**, nga krejt punimi del se gjithsesi edhe në gjuhën tonë ka mundësi thjeshtëzimi dhe konsolidimi të trajtave të patronimeve sipas zgjidhjes alternative në përputhje me raportin: *nyjëmbaresa përkatëse e njëjësit të shquar / prapashtesa e specializuar -AJ*. Si poentë më të dalluar nga trajtimi i kësaj lënde nxiret kërkesa që si me rastin e vënien ose verifikimit të emrit vetjak, ashtu edhe lidhur me përzgjedhjen e mbiemrave familjarë (patronimet) në parim duhet vënë rregull. Detyrë e standaoologëve për këtë punë është që pasi paraparakisht të njihen me lëndën në përgjithësi, të pëpiqen me vu rregull, më drejt me vu në zbatim kriteret rreth zgjedhjes së trajtës përkatëse të patronimit. Ne mendojmë se tashmë nga trajtimi ynë del më qartë se kudo gjetiu fakti se thjeshtëzimi dhe konsolidimi i patronimeve të shqiptarëve duhet filluar nga zgjidhja alternative. Kjo është kërkesë logjike për të vënë në jetë kriteret në përputhje edhe me interesin kombëtar. Pra, me respektimin zgjidhjes alternative kemi të bëjmë me dy të mira të mëdha ndaj gjuhës shqipe, së pari sforcohet shquarsia karakteristike që e ruan veçorinë e gjuhës shqipe si mburojë nga erozioni dhe e dyta, sforcohet më tej specializimi i prapashtesës **-AJ**, si model shumë frytdhënës për këtë destinim. Mund të themi pa u rrudhur se me një veprim të tillë nuk bëhet kurrëfarë

mëkati ndaj të drejtës universale të individit ose gjoja se kjo punë do të ngjallte reaksion nga bartësit e trajtave të gjuhëve të huaja e ku ta dimë, sepse në çdo gjuhë të zhvilluar janë konsoliduar edhe trajtat formëzuese e fjalëformuese të mbiemrave të familjeve, madje kemi bindjen se gjithkuj, çdo intelektual, qoftë vendës qoftë i huaj, do t'i vijë mirë kur sheh rregull edhe për këtë pikë në gjuhën shqipe, kur del sheshazi një zgjidhje më e lehtë e normale e emërtimit të patronimeve, siç janë trajtat e njëjësit të emrit në funksion patronimi, duke respektuar domosdo nyjëmbaresën përkatëse: **-i, -u** ose **-a, -ja** të emrit, e cila lidhet me emrin e prindit ose të kryefamiljarit që në njëfarë mënyre tregohet si autoritet dhe së dyti, si shkallë e dytë, ofrohet zgjidhje alternative e natyrshme: **trajta me prapashtesën -AJ**, që ka përhapje në të gjitha trevat shqiptare, që tregon fazë më të lartë të rritës së familjes me elemente gjegjëse, edhe pse jo aq thjesht konkretizuese, siç bëhej me nyjëmbaresa, ngase tashti kemi të bëjmë me përzgjedhje për familjen që nuk është dhe nuk do të mbetet pa histori të veten. Sigurisht, çdo patronim që njihet nga bashkësia përkatëse shoqërore, dhe se një zgjidhje e tillë ka miratimin e shkencës, atëherë edhe duhet konsideruar se është në përputhje me të drejtën universale të njeriut, andaj një konsolidim të tillë, siç u përpoqëm ta ravigëzojmë në këtë punim, do të jetë i pranueshëm së pari për ne dhe i mirëpritur edhe për bashkësinë europiane dhe kulturën në përgjithësi.

## *Përmbledhje*

Në këtë projektstudim, për mbrojtje të Doktoratës, u përpoqëm kryesisht t'i qasemi temës kryesore: *Toponimia dhe antroponimia e Gjakovës me rrethinë (Shqyrtime etnolinguistike)*, që përmban shtatëmbëdhjetë kapituj, lënda e së cilës ka një shqyrtim të gjerë areali për emrat vetjakë (*antroponimet*) dhe emrat përkatës të tyre (*patronimet*), emrat e vendeve (*toponimet*), të cilat duke qenë të shumta dhe të ndryshme, mund të grupohen edhe sipas ndarjeve të tjera që janë *oikonimet* apo emrat e vendeve të banuara (qytete, qyteza, katunde, lagje etj.), që si pjesë e tyre domosdo mund të shihen edhe *etnonimet*, apo emrat e shteteve, kombeve, kombësive, krahinave e nëndarjeve administrative e shoqërore të ndryshme, *hidronimet* apo emrat e ujërave (dete, lumenj, liqene, kënetë, përrenj etj.), si dhe *oronimet* apo emrat e maleve, fushave, kodrave etj.

Këtij projektstudimi domosdo i bashkëngjitet edhe folmja e Malësisë së Gjakovës, që është quajtur: *e folmja e Tropojës*, që përveç shqyrtimeve onomastike e pamë të udhës të bëjmë edhe dallimet themelore të hulumtimit në mes të shqipes standarde dhe shqipes së folur në Kosovë, konkretisht në Gjakovë dhe në Malësi të Gjakovës.

Motiv për trajtimin edhe të kësaj teme, për një hulumtim drejt punës dokto­rale dhe gjendja jo e kënaqshme e përdorimit të standardit të shqipes, ndonëse kanë kaluar më shumë se 4 dekada nga standardizimi i saj në Kongresin e Drejtshkrimit, mbajtur në Tiranë, më 1972.

Në vazhdim do të japim disa vështrime gjuhësore rreth onomastikës së Gjakovës me rrethinë. Në këtë punim kemi përmbledhur dhe trajtuar gjerësisht një sistem të tërë punimesh me rëndësi të veçantë për shkencën albanologjike. Kështu, çështjet onomastike i kemi kundruar vëmendshëm duke i parë vijimisht në dritën e të dhënave gjuhësore, dialektologjike, historike, etnografike, gjeografike etj. Ndërkaq, një trajtesë e tillë e lëndës onomastike, na ka dhënë gjithmonë dorë e krah të fortë, që t'i ruajmë mirëfilli specifikat, veçantitë, koloritin dhe origjinalitetin e gurrave dialektore autoktone shqiptare. Pra, fillimisht kësaj që u tha, do theksuar se punimet e gjithëpërfshira, në këtë përmbledhje studimi e punimesh gjuhësore, nga onomastika shqiptare, pothuajse përgjithësisht kanë gjetur një trajtesë të thellë dhe të thukët një mal të tërë antroponimesh, toponimesh, topoleksemash, ojkonimesh, hidronimesh, tumash etj. Lëndë kjo e gjerë dhe e pasur përmes ekspeditash dialektologjike, me rrethina që i përkasin trungut etnik të të folmeve veriperëndimore të shqipes.

Përgjithësisht onomastikën tonë të trajtuar themelësisht gjithandej, e karakterizon mirëfilli thjeshtësia shqiptare, autoktoniteti, origjinaliteti, fizionomia etnokulturore, forca mitologjike shqiptare larushia fjalëformuese, prapashtesimi i brumit të mirëfilltë të shqipes si dhe një rrjedhojë e tërë dukurish, veçantish, shtresëzimesh e mbijetojash iliro-arbëresho-shqiptare.

Me kalimin e kohës, në rrethana të caktuara historike, një tog i tërë toponimesh, ojkonimesh dhe emrash familjarë thjesht të gurrës së moçme arbërore-shqiptare, iu nënshtrua kalkimit-përkthimit në gjuhën serbo-malazeze, kuptohet vetvetiu përmes faktorëve politikë - administrativë nga ana e pushtuesve të lartë përmendur si:

Syni Oko, Guri Kuq - Crveni Kamen, Lumi-Reka, Gjakovë - Đakovica, Pejë - Peć etj. Këso kalkimesh të onomastikës autentike shqiptare, ndeshim pikërisht në hartat topografike pseudoshkencore dhe në aktet zyrtare pseudoadministrative serbo-malazeze.

Megjithëkëtë, onomastikën tonë ndërshkuj e ka karakterizuar e përveçuar gjithnjë forca përballësuese e popullit tonë, kundrejt trysnive e valëve të tërbuara e të shpeshta asimiluese të romanizimit, të bizantinizimit, osmanizimit dhe sllavizmit-serbizimit. Përfundimisht nga materiali që u paraqit mund të nxirren disa përfundime:

**1.**Ndryshimi i patronimeve, ndonëse ka të bëjë me shfrytërimin e formës së tyre, është ushtruar dhe vazhdon të ushtrohet në kuadrin e përpjekjeve për shkombëtarizimin dhe sllavizmin e shqiptarëve.



Opinionet e shprehura se sllavizmi i shqiptarëve, pra dhe i patronimeve të tyre u bë si rezultati një simbioze të natyrshme me sllavët, janë joshkencore dhe me tendenciozitet antishqiptar.

**2.** Sllavizimi i formës së patronimeve shqiptare ka qenë dhe vazhdon të jetë një operacion i organizuar që u nënshtrohet kriterëve gjuhësore të gjuhëve të shteteve që kanë aneksuar territore me popullsi autoktone shqiptare.

**3.** Përvoja historike i ka mësuar shqiptarët që të ruajnë me fanatizëm çdo element të etnosit të tyre. Ata nuk i kanë reshtur përpjekjet për ruajtjen e gjuhës, zakoneve dhe të emrave të tyre kombëtarë. Kur rrethanat historike njohën momente të zbutjes së përkohshme të dhunës, ata përfituan për kthimin e emrave në formën e origjinës, dhe, kur rrethanat krijojnë momente kërcënimi, shqiptarët mobilizojnë forcat shpirtërore dhe intelektuale për të mbrojtur me dinjitet qënien e tyre kombëtare.

Përveç vështrimeve gjuhësore të onomastikës dhe disiplinave të saj patjetër në këtë përmbledhje do të trajtojmë edhe përdorimin e gjuhës standarde në Gjakovë dhe rrethinën e saj, me që në një masë të dukshme në këtë punim, në kreun e IX janë derdhur të dhëna të rendësishme për shqipen standard në Gjakovë.

Gjatë punës studimore të punimit jemi futur në mënyrë kronologjike, për caktimin e standardizimit të gjuhës shqipe, për përpjekjet e para të atdhetarëve tanë, që të kemi një shtet, një komb dhe një gjuhë.

E dimë që shqipja standarde në Gjakovë ka kaluar në mjaft rrethana sociolinguistike, psikolinguistike, politike duke e shikuar zhvillimin e saj sidomos pas përcaktimit të mbajtjes së Kongresit të Drejtshkrimit të vitit 1972, ku shqipja u standardizua një herë e përgjithmonë.

Shqipja standarde sot është një varietet që përdoret në domene të tilla si në administrata, sisteme arsimore dhe shkolla, por edhe në këto domene përdoret kryesisht në situata formale si një varietet “*i lartë*”. Ndërsa, në familje, shoqëri, e në situata joformale, përdoren edhe varietetet e ndryshme lokale, që konkretisht flasim për vernakularët e dialektit gegë apo varietet i “*ultë*”.

Problemet më serioze shfaqen në rrafshin fonetik, morfologjik, sintaksor, leksikor, diferenca të pjesshme fonologjike dhe semantike që e përbëjnë varietetin, problemet me ndikimet ndërghjuhësore dhe në çështje të tjera që janë reflektim i nivelit të ulët arsimor dhe kulturor të individit, në të cilin nuk jemi thelluar shumë.

Gjuha standarde shqipe në të folur është në një situatë krejt tjetër. Çdo vëzhgim deri diku sistematik i përdorimit të gjuhës së folur standarde në Kosovë lë përshtypjen që ky varietet gjuhësor në Kosovë ende është në konsolidim e sipër<sup>107</sup>. Siç e përmendem më lart, që shqipja e folur standarde përdoret në domene zyrtare, arsimore dhe kulturore, kryesisht në situata formale. Por, edhe në ato raste ndodh që shpesh shqipja standarde të dalë si një kod i përzier me tipare dialektore të gegërishtes, e krahas saj ndodh të përdoret edhe varieteti i gegërishtes letrare.

Përmes këtij hulumtimi të bërë në këtë punim, kemi qartësuar disa probleme me të cilat ndeshen folësit gegë në Gjakovë, të cilët kanë paraqitur vështirësi të përvetësimit të standardit.

Trajtimi i kësaj çështjeje është mjaft aktual në trevat shqipfolëse, sidomos në kohën kur po zhvillohen debate shkencore dhe të tjera lidhur me standardin, vendin dhe akceptueshmërinë e tij në arealin shqipfolës, konkretisht në Kosovë.

Ky shqyrtim do të mund të krijojë një ide më të qartë lidhur me dallimet themelore të shqipes standarde me shqipen e folur në Gjakovë, sidomos në rastin e shqipes dhe do të mund të jepte ndonjë orientim për rrugët e mëtejshme të zhvillimit të gjuhës standarde, zbatueshmërinë e saj në mënyrë korrekte, si dhe ndërtimit të raporteve të gjuhës standarde me dialektet apo vernakularët e shqipes, konkretisht me vernakularët më të fuqishëm.

E vërejtëm që nivelet e sistemit gjuhësor janë të ndjeshme në masë të ndryshme ndaj ndikimit të jashtëm (ndaj ndikimit të faktorëve shoqërorë), konkretisht në Kosovë. Sipas gjuhëtarit italian Gaetano Berruto, në manualin «Fondamenti di sociolinguistika» (Bazat e sociolinguistikës), botuar më 1995-ën, thotë: “**duke nisur nga niveli më pak i**

---

107 Shkumbin Munishi – “Gjuha standarde në Kosovë dhe drejtimet e zhvillimit të saj”- temëedoktoraturës-Prishtinë 2006

**ndjeshëm, (po i një rëndësie shumë të veçantë) do të ishte kjo: morfologjia, sintaksa, fonologjia, leksiko-semantika dhe në fund pragmatika gjuhësore”.**

Ku njësitë e niveleve të sistemit gjuhësor janë të ndjeshme në masë të ndryshme ndaj ndikimit të jashtëm.

Dalluam që mund të kemi ndryshime në realizimin e një njësie gjuhësore të caktuar (mund të ndryshojë një fonemë apo një fjalë) dhe në këtë rast më i ndjeshëm duket sistemi fonetik, por mund të kemi edhe ndryshime të inventarit të njësive (rritja e numrit të fonemave apo të fjalëve) dhe më i ndjeshëm në këtë rast paraqitet niveli leksikor.

Në formën e folur, konkretisht në shqipen e folur (vendos marrëdhënie të drejtpërdrejta në vend dhe kohë) dhe formën e shkruar (marrëdhënie në largësi, në vend dhe në kohë). Dinamika e zhvillimit të këtyre dy formave nuk është e njëjtë. Gjuha e folur është vazhdimisht në lëvizje, në zhvillim të pandërprerë, ndërsa gjuha e shkruar nuk u përgjigjet këtyre zhvillimeve (nuk ka lidhje organike midis të folurit dhe të shkruarit) dhe, për pasojë, lind dhe thellohet vazhdimisht një hendek: gjuha e folur largohet nga gjuha e shkruar. Ka shumë mospërputhje të gjuhës së folur me gjuhën e shkruar, e kjo është diçka normale, në qoftë se duam ta pranojmë gjuhën për atë që është. (Ka disa gjëra në gjuhë që, në pamje të parë, duken sikur janë normale, kur nuk janë të tilla, dhe anasjelltas, ka disa gjëra që janë normale e nuk duken si të tilla.)

Gjuha duhet të vendosë marrëdhënie edhe midis brezave të ndryshëm, duhet të transmetojë idetë nga një brez në tjetrin, të sigurojë kështu trashëgiminë. Pavarësisht zhvillimeve teknologjike, gjuha e shkruar është mjeti më i mirë për të siguruar komunikimin midis brezave, për të përcjellë përvojën nga brezi në brez.

Për këtë arsye, ajo duhet të ruajë njëjtësinë e normës drejtshkrimore, përndryshe, pas tre ose katërqind vjetësh, këto radhë që po shkruhen sot këtu, do të mund të lexohen vetëm nga filologët e specializuar. Sikur është rasti tek gjuha otomane e vjetër, ose turqishtja e vjetër, ku ata që duhet të lexojnë tapitë apo dokumentet zyrtare të asaj kohe, duhet të kryejnë një shkollim të veçantë, ngase nuk është sikur gjuha që tani e flasim dhe e shkruajmë. Është e vërtetë që zbatimi i parimit fonetik siguron përputhjen e normës shkrimore me atë të gjuhës së folur (një lloj ekonomizmi), por, nga ana tjetër, rishikimi i herëpashershëm i normës

drejtshkrimore (për t'iu përgjigjur kërkesës së parimit fonetik) do ta gjymtonte gjuhën. Kjo praktikë do t'i cenonte gjuhës deri edhe funksionet e saj. Kemi vërejtur edhe aspektin sociolinguistik dhe psikolinguistik është e ndërlidhur historia e popullit shqiptarë ndër shekuj, ku e dimë që në ndikime ndërgjuhësore janë fjalët- huazimet serbe apo sllave që deri diku ekzistojnë apo kanë ekzistuar në vernakularin e kosovarëve, si dhe tani më të shpeshtat që i dëgjojmë si në shqipen formale ashtu edhe joformale, anglicizmat e shfaqura sidomos pas luftës së Kosovës 1999.

Diskutimet e ndryshme që po bëhen në lidhje me standardizimin e shqipes, nuk kanë reshtur dhe ka bërë vend ideja sikur faktori subjektiv ka një rol të rëndësishëm, madje vendimtar (e përpunon një standard, nuk e përpunon; e pranon një standard, nuk e pranon; krijon një standard të ri, ndërrohet një standard me një tjetër etj.), por sërish duhet kuptuar se nuk mund të jetë aspak kështu (duke iu referuar gjithësesi «çastit» të standardizimit). Kur i shikuam veçoritë e standardit në temën që e shtjelluam, ndryshe nga dialekti që përdoret vetëm në formën e folur, standardi përdoret si në formën e folur, ashtu edhe në atë të shkruar, për më tepër që është edhe i unisuar.

Është e qartë se çdo folës (normal) është në gjendje të përdorë (dhe përdor) të paktën dy variante të një gjuhe. Ne gjatë analizës së dukurive apo problemeve që na u shfaqen gjatë përmbajtjes së temës, vërejtëm të rinjtë e sotëm kur në çdo shprehje të tyre gjuhësore, kanë të futura anglicizma të panevojshme. Atëherë shtrohet pyetja “ këta po mundkan të përdorin edhe fjalë që nuk i kanë pasur në përdorim më herët, d.m.th. në të folurën e tyre joformale, po me rritjen dhe zhvillimin e tyre që e kanë mësuar një gjuhë të huaj, konkretisht anglishten, pse nuk e përvetësojnë shqipen standarde ashtu si gjuhën e huaj?. Sigurisht këtu është aspekti psikologjik i kompleksit të njeriut që ka ndodhur gjithmonë, që nga gjuhët e mëhershme në kontakt, si turqishtja, serbishtja dhe tani anglishtja, që të bënë të ndjehesh më “ i privilegjuar”.

Në shoqëritë e zhvilluara, ose, të paktën, në ato shoqëri që kanë pranuar përdorimin e një varianti gjuhësor standard, bëhet një dukuri normale. Dihet se shqipfolësit joformal, apo bartësit e një gjuhe fitojnë variantin dialektor si «gjuhë të nënës» dhe duke qenë se asnjë nga variantet dialektore nuk mund të jetë i njëjtë me variantin standard, duhet që ata të përftojnë edhe variantin standard si «gjuhë e bukës». Duke e parë kështu, është fals që shqetësohen bartësit e gegërishtes, ndoshta mund të ndihen të kompleksuar, ngaqë kanë

më tepër vështirësi për të përqaftuar standardin. Mirëpo, shkurt, këtu nuk mund të gjejmë ndonjë arsye për të ndërruar standardin. Megjithatë, është po aq e nevojshme të theksojmë se edhe të konsideruarit e standardit si një sistem i përfunduar, i mbyllur, është gjithashtu i gabuar. Në rritjen e inventarit të njësive qëndron mundësia për pasurim (jo për përmirësim) dhe një nga rrugët më të përshtatshme për këtë qëllim mbetet (gjithmonë) ngritja në normë e mjeteve që vijnë nga gurra popullore dialektore.

Përfundimisht, nuk duhet të kërkojmë «rrugë të reja» për formimin, përmirësimin, ndërrimin, as edhe për mbrojtjen e standardit, por duhet thjesht ta njohim dhe ta lëvrojmë atë; të pranojmë se ai mbetet një sistem i hapur dhe të lëvrojmë, pa komplekse, edhe variantet letrare, që (me ndërmjetësinë tyre) ky sistem i hapur të pasurohet natyrshëm nga gurra dialektore.

Duhet ta kemi parasysh një gjë shumë domethënëse që, në të gjitha proceset e ardhshme që kanë të bëjnë me gjuhën standarde, një rol të rëndësishëm e ka sistemi arsimor. Prandaj, pse mos të mësohet drejt shqipja standarde, si në të shkruar, po gjithnjë edhe në të folur.

Ndoshta, kjo gjë mund të arrihet me ndonjë ligj të veçantë për miratim në Parlamentin e Kosovës (siç e kishim rastin në Francë dhe Maqedoni), që ai/ajo që lejon të shkruajë shqipen standarde sikur të jetë gjuhë e retarduar, të mund të dënohen me ndonjë shumë që iu kushton. Mendoj, se atëherë mund të kemi më pak tolerime dhe gabime në të shkruar, ku si pasojë e përvetësimit sa më të lartë të shqipes së shkruar, shumë lehtë do ta kemi edhe përvetësimin e shqipes standarde në të folur. Rregullat e drejtshqiptimit të shqipes standarde duhet të mos jenë të ngurta, por fleksibile, të pasurohen dhe të krijohen mundësi reale për përvetësimin më të lehtë të normës standarde për shqipfolësit gegë nga varietetet e tyre popullore, po që gjithmonë të jenë brenda normës në të gjitha nivelet gramatikore.

Mendojmë se do të ishte me mjaft dobi që studentët e fakulteteve të gjuhës shqipe kudo në Kosovë, kur t'iu vijë radha e praktikës në shkollat përkatëse, MASHT (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë) e Kosovës të bëjë edhe një marrëveshje bashkëpunimi me MASH (Ministrinë e Arsimit dhe Shkencë) të Shqipërisë, në mënyrë që t'i dërgojnë studentët së paku për një vit përvojë në shkolla kudo në Shqipëri, si dhe studentët nga

Shqipëria të bëjnë praktikë në shkollat tona në Kosovë. Ky komunikim i ndërsjellë ndikon drejtpërdrejt në përvetësimin e normës së gjuhës shqipe.

Dhe për fund për t'ia dhënë vlerën e vërtetë të shqipes së standardizuar, dua të citoj me mjaft të drejtë prof. Musa Nushi, ku thotë: “ Të dy dialektet e gjuhës shqipe, janë si të dy lumenjtë Drini i Bardhë dhe Drini i Zi, po që të dy bashkërisht derdhen dhe e formojnë Drinin e Madh”. Prandaj, edhe shqipja standarde pa këto dy dialektet dhe nëndialektet e saj, nuk do të kishte fuqinë e saj që e ka sot, dhe që ne mburremi si shqiptarë që jemi një komb dhe kemi një gjak, po që dimë ta flasim dhe ta shkruajmë një gjuhë, shqipen standarde.

## **PËRMBLEDHJE**

### **I. QËLLIMI I STUDIMIT**

Në këtë punim synuam që përmes hulumtimeve vumë në dukje dallimet themelore mes shqipes standarde dhe shqipes së folur në Gjakovë. Natyrisht, një punim i tillë synon edhe përcaktimin e nivelit të përvetësimit të standardit si dhe punën që duhet bërë në këtë drejtim për shtrirjen e tij.

Arsyeja për përzgjedhjen e kësaj teme për punim doktrate është gjendja jo e kënaqshme e përdorimit të standardit të shqipes, ndonëse kanë kaluar 40 vjet nga standardizimi i saj në Kongresin e Drejtshkrimit, mbajtur në Tiranë, më 1972.

Përmes këtij hulumtimi, në këtë punim jemi përpjekur të qartësojmë problemet me të cilat janë ballafaquar folësit gegë në Gjakovë, të cilët kanë paraqitur pak a shumë vështirësi në përvetësimin e standardit.

Trajtimi i kësaj çështjeje (jo vetëm për të folmen e Gjakovës), është mjaft aktual në trevat shqipfolëse, sidomos në kohën kur po zhvillohen debate shkencore dhe të tjera lidhur me standardin, vendin dhe akseptueshmërinë e tij në arealin shqipfolës, konkretisht në Kosovë.

### **II. OBJEKTI I STUDIMIT**

Gjuha standarde është pjesë e gjuhës së popullit, por e ngritur në normë sipas kritereve shkencore. Nga ky konstatim del e kuptueshme se varianti standard dhe koineja dialektore janë të pandashme dhe, si të tilla, ato paraqesin një unitet makrogjuhësor.

Si pjesë e këtij uniteti makrogjuhësor dhe duke e shikuar nga aspekti sociolinguistik, anëtarët e një bashkësie folëse gjuhësore, përmes ndryshimesh subfonemike dhe fonemike në nyjëtim tingujsh, njëkohësisht pasqyrojnë indeksikalitetin e përkatësisë rajonale dhe sociale të folësit.

### **III. METODAT**

Metodat që përdorëm në trajtimin e çështjes sonë, i kemi të mbështetura në punime dhe në anketim, observim dhe interpretim. Jemi përpjekur të sjellim një pasqyrë më të qartë të raporteve të vernakularëve të folur në rastin e shqipes, gjithmonë në rastin e shtrirjes së standardit në Gjakovë.

Metoda mbizotëruese është ajo e hulumtimit dhe interpretimit, ndërsa një vend me rëndësi në trajtimin e kësaj teme ka zënë edhe metoda e anketimit/pyetësorit rreth shtrirjes së toponimeve, antroponimeve dhe gjuhës standarde në Gjakovë dhe në trevat e saj. Kemi bërë krahasimin e situatës që po shtjellojmë për shqipen standarde, si dhe me situatat në gjuhët e tjera, të cilat kanë traditë më të gjatë të gjuhës standarde, gjithashtu edhe të vendeve që kanë situata të përafërta zhvillimore të standardit me atë të shqipes.

### **IV. STRUKTURA E PUNIMIT**

Trajtimi i kësaj çështjeje merr rëndësi të veçantë për kohën kur po zhvillohen debate shkencore dhe të tjera lidhur me standardin, vendin dhe pranueshmërinë e tij në arealin shqipfolës. Në vijim kjo rëndësi rritet me marrjen në shqyrtim dhe trajtimin e ligjërit të kësaj treve, ku na mungojnë shumë të dhëna dialektologjike krahasuar me të folmet e trevave të tjera të Kosovës

Ky shqyrtim do të mund të krijonte një ide më të qartë lidhur me dallimet themelore të shtrirjes së shqipes standarde me shqipen e folur në Gjakovë, konkretisht në rastin e shqipes dhe do të mund të jepte, sipas gjykimit tonë, ndonjë orientim me vlerë për rrugët e mëtejshme të zhvillimit dhe kontributit të gjuhës standarde dhe ndërtimit të raporteve të gjuhës standarde me dialektet apo vernakularët e shqipes.



## **ABSTRACT**

### **I. PURPOSE OF STUDY**

Through research in this paper, we aimed to note the fundamental differences between standard Albanian and Albanian spoken language in town. Certainly, such a paper aims to determine the level of the standard acquisition and work that should be done, in this field, toward its expansion. Unsatisfactory condition of using standard Albanian, although 40 years have passed from its standardization of spelling Congress, held in Tirana in 1972, was the reason for selecting this topic for doctoral work. Through this research, in this paper we have tried to clarify the problems that are faced “gege dialect’s” speakers in Gjakova who have presented more or less difficulties in acquiring the standard.

Treatment of this issue (not only the spoken dialect of Gjakova), is quite current in Albanian-speaking territories, especially at a time when scientific and other debates regarding the standard language, place and its acceptability in the Albanian-speaking aerial, specifically in Kosovo, are being developed.

### **II. SCOPE OF STUDY**

Standard language is part of the people language, but increased to the norm according the scientific criteria. From this observation it comes obviously understandable that standard variation and dialectal variant are inseparable and, as such, they represent a macro linguistic unity.

As part of this macro linguistic unity and by sociolinguistic terms view, members of linguistic community speakers, through changes in phonemic and sub phonemic in toggle sounds, at the same time reflect on the regional and social affiliation background of the speaker.

### **III. METHODS**

The methods we have used in the treatment of our case have been supported on the work and the survey, observation and interpretation. We tried to bring a clearer picture of speaking variation reports, in our case of Albanian speaking language, always when we deal with the extension of standard language in Gjakova town.

The method of research and interpretation is the most predominant method in this survey, while an important place in the treatment of this topic is given to methods of surveying / questionnaire about the extent of the standard language in Gjakova town. We have done a comparison of standard Albanian language examination and other languages situations as well, which have a longer tradition of standard language, furthermore countries that have similar development situations with the Albanian standard language.

### **IV. PAPER FORMAT**

Treatment of this issue is of particular significance at a time when scientific and other related debates to standard languages, place and its acceptability in the Albanian-speaking aerial are being developed. Continuously, this importance grows up with the examination and treatment of the discourse of this area, and much dialectological data are missing compared with other dialects of the Kosovo areas.

This review may create a clearer idea regarding the fundamental differences of standard Albanian language extension with spoken Albanian language in Gjakova, specifically in the case of Albanian language, and based on our judgment it could give any

other valuable orientation for additional development of standard language and building relation between Albanian standard language with other Albanian variation dialects.

## **LITERATURË**

**Ahmetaj, Mehmet**

Gjurmët e toponimeve, antroponimeve dhe patronimeve në këngët e mërgimit, GJA, SSHF, 24 – 1994, Prishtinë, 1995.

**Andrassy, Juraj**

Medjunarodno pravo, Zagreb.

**Alexandrini, Appiani**

Historia Romana, ed. Voereck, Rcos et Mendelssohn. Lpsiac in aedibu B.G. Teuhbueri 1915 e 1930, apian, Illyrikë.

**Ajeti, Idriz**

Studime leksikore shqiptaro-sllave, GJA, SShF, Prishtinë, 1968, Nr. 2.

Kontribut për studimin e onomastikës mesjetare në territorin e Malit të Zi, Bosnje Hercegovinës dhe të Kosovës, GJA, Prishtinë, IV – 1974.

Studime gjuhësore në fushë të shqipes I, Rilindja, Prishtinë, 1982.

**Aleksić, dr. Radomir**

Rečnik stranih reči i izraza, Prosfeta, Beograd, 1978.

**Ashta, Kolë**

Leksiku historik i shqipes, I, Shkodër, 1996.

Leksiku historik i shqipes, II, Shkodër, 1998.

**Akademia e Shkencave e Republikës Popullore të Shqipërisë.**

Fjalor Enciklopedik Shqiptar, Tiranë, 1985.

Defteri i regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485 Tiranë, 1974.

### **Arkivi i Kosovës, Prishtinë**

Këshilli Ekzekutiv i Kosovës, 1945 – 1999.

Kuvendi i Kosovës, Prishtinë, 1943 – 1963.

Sallname e Vilajetit të Kosovës e vitit 1311 h. (1893) ; 1894 (1314 h) dhe të vitit 1900 (1318).

Fondi pensional: Ramiz Binishi dhe Fondi pensional: Ibrahim Zherka.

### **Arhiv Serbije (Arkivi i Serbisë), Beograd.**

M I D, P P O, 1912, raporte të ndryshme nga konsullata e Prishtinës, mësuesit, priftërinjtë etj.

### **Arkivi Historik- Gjakovë**

Këshilli Popullor i Rrethit, Gjakovë.

Këshillat Popullore të Vendeve.

Këshillat Popullore të Komunave.

### **Altimari, F**

Heteroglosia arbëreshe: të folmet dhe shqipja standarde, SF, 2002 / 3- 4.

Lingua ed emigrazione nella comunità albanese di Calabria, in “Minoranze etniche e linguistiche”, Palermo-Piana degli Albanesi, pp. 121 – 142, 1985.

### **Bajçinca, Isa**

Çështje aktuale të zbatimit të normës letrare, në “Gjuha jonë”, 1982, Nr. 2

### **Buda, Aleks**

Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe rrënjët e saj historike, në: Konferencën Kombëtare të Studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, Tiranë, 1983.

### **Babović, Branko**

Politika Crne Gore u novu oslobodjenim teritorijama 1912-1914, Titograd, 1984.

### **Berisha, Gjon**

Diskriminimi dhe konvertimi i shqiptarëve në Kosovë gjatë sundimit Nemanjid, Kosova, 22 / 23, Prishtinë, 2003.

**Bajrami, Hakif**

Konventa jugosllavo-turke e vitit 1938 për shpërnguljen e shqiptarëve, "Shpërngulja e shqiptarëve gjatë shekujve", "Shoqata për Kthimin e Shqiptarëve të Shpërngulur nga Kosova, Prishtinë, 1992.

Politika e shfarosjes së shqiptarëve dhe kolonizimi serb i Kosovës (1884- 1995), Prishtinë, 1995. Hadzi Kalfa ili Čatib-Čelebija, Turski geograf XVII, veka, O Balkanskom Poluostrvu, S. Novaković, Spomenik XVII, Beograd, 1892.

**Beci, Bahri**

Sistemi fonologjik i gjuhës së sotme letrare dhe norma fonetike, Studime Filologjike, Nr.4, Tiranë, 1982.

Fonetika, Prishtinë, 2004.

Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik i së folmes së Shkodrës, Tiranë, 1995.

**Barleti, Marin**

Historia e jetës dhe të veprave të Skënderbeut, Tiranë, 1964.

**Balettus, M**

Des Aller Streibarston und teuertem Fuersten und Herrn Georgen Gastrioten genant Scanderbeg, Frankfurt A.M. 1561.

**Bicaj, Isa**

Marrëdhëniet shqiptaro-malazeze (1881- 1914 ), Prishtinë, 2003.

**Aaliu, Begzad**

Demitizimi dhe standardizimi i onomastikës së Kosovës, Tiranë, 2006.

**Beduli, Dhimitër**

Kodiku i Kishës së Shën- Prokopit, Tiranë, 1997. f. 13.

**Buda, Aleks**

Shkrime historike I, Akademia e Shkencave e RSSh, Tiranë, 1989.

Rreth formimit të popullit shqiptar, të kulturës dhe gjuhës së tij, Sh, 1980, Nr. 1.

**Boriçi, Lumnie**

Kontribut mbi aspektin akustik të zanoreve të shqipes e të disa zanoreve të frëngjishtes, Studime filologjike, Nr. I, Tiranë, 1977.

**Belegu, Xhafer**

Lidhja e Prizrenit, Tiranë, 1939.

**Bidollari, Çlirim**

Fjalor i patronimeve të shqiptarëve, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2011.

**Baliu, Begzad**

Gjendja e toponimisë shqiptare në Ballkan, Era, Prishtinë, 2004

**Cana, Zekeria**

Gjenocidi i Malit të Zi mbi popullin shqiptarë 1912-1913, dokumente, Prishtinë, 1996.

Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Kosovë 1908 – 1912, Rilindja, Prishtinë, 1993.

**Cvijiq, Jovan**

Ballkansko poluostrvo i juzhno slobenske zemlje, Osnovi antropogeografije -Zavod za izdavanje udžbenika SR Srbije Beograd, 1966.

**Çabej, Eqrem**

Problemi i autoktonisë së shqiptarëve në dritën e emrave të vendeve, BShSh , 1958.

Disa figura të besimeve popullore shqiptare, GjA, SFE, II, 1972.

Hyrje në historinë e gjuhës shqipe, Pjesa e parë, botuar së pari më 1962.

Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe.

Fonetikë historike e gjuhës shqipe.

Hyrje në indoeuropianistikë.

**Çausi, Bardhyl**

Aspekte Krahasimore Midis së Drejtës Romake dhe së Drejtës Zakonore Shqiptare, Vjetari 1995 ANNUAL, Prishtinë.

**Çeliku, Mehmet**

Çështje të normës tek emrat e njerëzve, GjJ, 1984, Nr. 1.

**Dodi, Anastas**

Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe I. Tiranë, 1985.

Fonetika e gjuhës shqipe (dispensë), Tiranë, 1962.

Rreth problemeve të normës në lëmin e fonetikës së shqipes së sotme letrare, SF, Nr. 2, 1970.

**Daka, Palok**

Mbi disa veçori të formimit të emrave vetjakë në gjuhën shqipe, në “Konferenca e dytë e studimeve albanologjike”, III, Tiranë, 1969.

Vëzhgime mbi emrat vetjakë të ardhur nga leksiku i përgjithshëm i shqipes, SF, 1970, Nr.3.

Rreth antroponimeve të hershme shqiptare, SF, 1984, Nr. 3.

Rreth sistemit vokalik të shqipes, Studime Filologjike, Nr. 3.

**Dozon, A**

Manuel de langue chkepe ou albanaise, Paris, 1879.

**Demiraj, Shaban**

Rreth disa hidronimeve të lashta të Shqipërisë, në SF, 1999, Nr. 3-4, f. 13-29.

Morfologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 1962.

Gramatika e gjuhës shqipe për shkollën pedagogjike, Tiranë, 1971.

Gjuha shqipe dhe historia e saj, ShBLU, Tiranë.

**Domi, Mahir – Shkurtaç, Gjovalin**

Pyetësor për mbledhjen e toponimisë shqiptare, DSh, VI, 1996.

**Drini, Sulejman**

Derivatet semantike-strukturore në onomastikën shqipe të Kosovës, OK, Prishtinë, 1979.

**Duranti, A**

Antropologia del linguaggio, Meltemi, Roma, 2002.

**Dhimo, Ali**

Një vështrim gjuhësor mbi toponiminë e Kurveleshit, SF, 1974, Nr. 3.

Norma dhe kodifikimi, në “Gjuha jonë”, I, f. 48 - 57.

**Frashëri, Sami**

Shqipëria ç’ka qenë e çdo të bëhet, Bukuresht, 1889; Vepra, vëll. I dhe II, Tiranë, 1988.

**Goçi, Ibrahim**

Emrat vetjakë të gjuhës sonë me origjinë nga bota shpirtërore, Ok, Prishtinë, 1979.

**Giorgio, Graffi**

Sintaksa / Strukturat e ligjërit, Përkthyer nga dr. Blerta Topalli, Shtëpia Botuese “Dituria”.

**Golleti, Baffa Vincez**

Arbëreshi merret me politikë, Bibliotheka Gollettiana, Heilidelberg dhe Çivi 1999.

**Gamulli, Nikoll**

Fjalor toponomastik.

**Gruda, Zejnullah**



E Drejta Ndërkombëtare Publike- Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 1987.

**Gjinari, Jorgji- Shkurtaç** Gjovalin

Dialektologjia, Shtëpia Botuese “Libri Universitar”, Tiranë, 1997.

Mbi huazimet sllave në të folmet veriore të shqipes, në “St. fil. “, 2.

Dialektet e gjuhës shqipe, Tiranë.

**Gjini, Gaspër**

Ipeshkvia Shkup- Prizren nëpër shekuj, Drita , Zagreb, 1992.

**Hoxha, Skënder**

Kontribut për studimin e toponimisë së Dshkajës, Prishtinë, 1993.

**Hadri, Ali**

Gjakova prej themelimit deri më 1941, Kosova, IHP, I, Prishtinë, 1972.

Dushan Pejanović, Autonomna Pokrajina Kosovo i Metohija, Beograd, 1968.

Historia e popullit shqiptarë, Prishtinë, 1971.

Gjakova në LNÇ, Prishtinë, 1974.

Shtrembërime historike, dëshmi, “Ora”, Prishtinë, Nr. 7 / 1991.

**Horvat, Branko**

Kosovsko Pitanje, Glonus, Zagreb, 1988.

**Ismaili, Rexhep**

Disa çështje të onomastikës shqiptare të mesjetës, SF, Prishtinë, 1978, Nr. 4.

Emërtimi shiptarski dhe sindromi shiptari, në “Në gjuhë”, dhe “për gjuhë”,

Dukagjini, Pejë, 1998.

Disa fjalë shqipe në maqedonishte, GjA, I, 1971.

**Kostallari, Androkli**

Diaspora e sotme shqiptare dhe gjuha letrare, Tiranë, SF.,1986,Nr. 3.Kontribut për klasifikimin e tipave kryesorë të kompozitave në fushën e mikrotoponimisë shqiptare, SF, 1971.

**Karadžiq, Vuk St.**

Etnografski spisi, Sabrana dela, Knjiga XVII, Beograd,1972.

**Lafe, Emil**

Toponimia latine e shqipes, në “Kuvendi i Studimeve Ilire”, Tiranë, 1974.

Drejtshtkrimi – ligj i botës së qytetëruar, në “Zëri i rinisë”, Nr.14, 10 prill (1992).

**Likaj, Ethem**

Zhvillimi i eptimit në gjuhën shqipe, (Morfologji historike), Shtypshkronja”Julvin”,Tiranë, 2006.

Roli i analogjisë në strukturën morfologjike të shqipes.

Format analitike në gjuhën shqipe.

Eptimi emëror indoevropian.

Fleksioni indoevropian, Gramatika e gjuhës shqipe, I (bashkautor).

**Luka, Kolë**

Elemente toponomastike mbi feudalizmin paraturk të shqipes, Sh, Nr.1, f. 141-146.

Vështrim gjuhësor mbi onomastikën e regjistrave kadastralë të shek. XV, SF, 1983, Nr. 4.

Raste ndërhyrjesh administrative në toponiminë e Defterit të Shkodrës, SF, 1975, Nr.2, f. 89-91.

**Lleshi, Qazim**

Veçoritë regjionale të Metohisë jugore, “Përparimi”, Nr. 1-2, Prishtinë, 1965.

Gjakova dhe rrethi i saj (vështrim fiziko-gjeografik dhe ekonomik, Përparimi, 6, Prishtinë, 1966.

Toponimia e Gjakovës me rrethinë, Kuvendi Komunës Gjakovë- Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve-Tryezë shkencore e mbajtur më 04.05.2001.

**Mansaku, Seit**

Autoktonia e shqiptarëve në dritën e të dhënave të toponimisë së lashtë, SF, 1982, Nr. 3.

Përhapja e krishterimit në dritën e të dhënave gjuhësore, SF, 1999, 1-2, f. 39-51.

**Meyer, Gustav**

Fjalor etimologjik i shqipes.

Bezz. Beitr. VIII, 1985 ff. Alb.Stud. II.

**Morina, Tefik**

Disa të dhëna mbi evidentimin e mikrotoponimeve të Kosovës në librat kadastralë, OK, Prishtinë, 1979.

**Myderrizi, Osman**

Gramatika e re e shqipes për shkollat e mesme (Fonologji e morfologji).

**Morgenthao, J Hans**

Politics Among Nations, A.A. Knopf. N. Y. 1967.

**Mezyri, Hysni**

Arsimi kombëtar shqiptar ( 1908 – 1912 0, Prishtinë, 1966.

**Memushaj, Rami**

Gjuhësia gjenerative (Botim i dytë), ShBLU, Tiranë 2008.

Fonetika e shqipes standarde, botimet Toena, Tiranë, 2009.

Hyrje në gjuhësi, Botimet Toena, Tiranë, 2008.

Morfologji e eptimit të gjuhës së sotme shqipe, 1989.

Shqipja standarde, 2002.

Teste gjuhësore (bashkautor), 2003.

Bukuria e gjuhës, 2007.

Himara, 2004.

Histori e Kurveleshit, 2004.

**Ndreca, Mikel**

Fjalor fjalësh të huaja në gjuhën shqipe, Botimet Toena, Tiranë, 2007.

**Nuhiu, Vesel**

Ndikimet ndërgjuhësore, Redaksia e botimeve, “Rilindja”, Prishtinë, 1990.**Pulaha, Selami**

Defteri i regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485; I, II, Tiranë, 1974.

**Pirraku, Muhamet**

Ndihmesë për hartën arkeologjike të pjesës qendrore të Kosovës, në bazë të mikrotoponimisë arkeologjike konstruktive, gjetjeve dhe burimeve të tjera, OK, Prishtinë, 1979.

**Robins, H Robert**

Historia e gjuhësisë, ShB “Dituria” 2007.

**Sulaj, Avdyl**

Shkrime dhe hulumtime gjuhësore, Tiranë, 2012.

**Samara, Miço**

Roli i dialekteve të shqipes për zhvillimin e normës letrare në fushë të leksikut, Konferenca shkencore “Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot”, Tiranë, 2002.

**Sapir, Eduard**

Language: An Introduction to the Study of Speech. 1921. The classic text on the relation of language and culture, marrë nga interneti [www.bartleby.com](http://www.bartleby.com), 2012.

**Shkurtaç, Gjovalin**

Zbunimi si shkak i lindjes së trajtave të dyta të emrave vetjakë, SF, 1977, Nr. 2.

Disa veçori strukturore semantike të toponimeve të formuara me mjetet e shqipes, SF, 1987, Nr.3.

Shqyrtime sociolinguistike për emrat e farefnisës dhe për emrat vetjakë të shqipes, SF, 1999, Nr. 3 - 4.

Gjuha e fëmijëve- një anë interesante e jetës së të folurit, në “Mësuesi”, 7 nëntor.

Për një vështrim sociolinguistikë të të folmeve të fshehta të shqipes, St. fil, 1-2, 2004.

Pesha e fjalës shqipe, (Studime të zgjedhura për gjuhën dhe letërsinë artistike), Shtëpia Botuese UFO Press Tiranë, Tetor 2009.

Rreth ndryshimeve në gjuhën e fshatit të sotëm të Veriut, në të folmen e Lezhës, në “St. fil.” 3, 1981, f. 155-163.

Nga gjeolinguistika tek dialektologjia urbane, 1995,

(Hapat e parë të sociolinguistikës), Tiranë, 6 prill 1995.

Gjuha shqipe dhe trysnia shoqërore-kulturore e sotme, në “Gjuha dhe ligjërimi në shkollë”, Studime Shqiptare 10, Shkodër, 1998. f. 43-59.

Onomastikë dhe etnolinguistikë, Tiranë, 2002.

Si të shkruajmë shqip, nga drejtshkrimi te shkrimet profesionale,

Botimet Toena, Tiranë, 2008.

Sociolinguistikë e shqipes, (Nga dialektologjia te etnografia e të folurit), Botimi dytë, Shtëpia Botuese Morava, Tiranë, 2009.

Shqipja e sotme / Kulturë të shkruari dhe të foluri / / Baza të gramatikës së shqipes standarde / , Për studentë dhe pasuniversitarë të degëve gazetari, gjuhë letërsi dhe mësuesi, ShBU U. F. O Press, Tiranë, Tetor 2010.

Shpirti i Arbërit rron (1984).

Kultura e gjuhës në skenë dhe ekran (1988).

Gjuha shqipe për të huajt dhe shqiptarët jashtë atdheut, (1996).

Etnografia e të folurit (2004).

Ta duam dhe ta mbrojmë gjuhën tonë të bukur (1998).

Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës ( Tiranë, 2006).

Ligjërimet arbëreshe (2006).

Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe,vëllimi I, Tiranë – Napoli, 2007.

**Shkurtaç, Gj.- Memushaj, R.**

Shkolla dhe shqipja letrare. “Gjuha jonë”, 1-4, 1998. f. 56-63.

**Shuteriqi, Dh.- Domi, M.**

Një vështrim mbi të folmen e Mandricës, 1963, në “St. fil.” 2.

**Shpuza Jusuf**

Vëzhgim për emrat familjarë të shqiptarëve,Shtëpia Botuese “Idromeno” Shkodër,1998

**Topalli, T.**

Antologji letrare për ushtrime sintakse, Shkodër, 2006.

**Topalli, Kolec**

Theksi në gjuhën shqipe, Tiranë, 1995.

Formimi i hiatit në gjuhën shqipe, SF, 1998, Nr. 1-2.

**Trudgill, Peter**

Introducing language and society, Penguin, London,1992.

**Trudgill, Peter**

English dialects and accents, Penguin, London,2002.

**Thomai, Jani**

Leksikologjia e gjuhës shqipe, ShBLU,Tiranë,1984.

**Vinca, Agim**

Gjuha standarde shqipe dhe bota akademike ,Instituti Albanologjik i Prishtinës,2012

**Xhuvani, Aleksandër – Çabej, Eqrem**

Prapashtesat e gjuhës shqipe, Tiranë, 1962.

